RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

(Auditim Financiar dhe Përputhshmërie)

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

SHKURT 2022

Nr Përmbajta Faqe

I.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE
1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit..... 3
2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....3-14
3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....15-18

II.HYRJA
a) Objektivat dhe qëllimi. 19
b) Identifikimi i çështjes.....19
c) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese 19-20
d) Përgjegjësitë e audituesve.....20
e) Kriteret e vlerësimit.....21
f) Standardet e auditimit.....21
g) Metodat e auditimit.....21
h) Dokumentimi i auditimit.....21

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT
1.Informacion i përgjithshëm.....22
3.Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....22
3.1. Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.....22-34
3.2. Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.....34-53
3.3. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.....53-114
3.4. Auditimi i llogarive vjetore të administratës së institucionit.....114-144
3.5. Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe vlerësimi i auditimit të brendshëm..... 145-152
3.6. Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.....

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET.....152-162

V. ANEKSE.....163-171

I.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Mbështetur në ligjin154/2014 datë 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe funksionimin e KLSHò, në zbatim të Programit të Auditimit nr.528/1 prot datë 14.05.2021 i ndryshuar me shkresën nr.528/2 prot datë 25.05.2021,në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), nga data 17.05.2021 deri në 31.07.2021, u krye auditimi Financiar dhe Përputhshmërie, për periudhën e auditimit 01.01.2019 deri në 31.03.2021.
Grupi i auditimit, u mbështet në përputhshmërinë e aktivitetit të MBZHR, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi lidhur me zbatimin e kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, identifikimin, zbatimin e kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimin e planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar, parashikimin dhe realizimin e të ardhurave dytësore, planifikimin mbi identifikimin vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, ruajtjen, arkivimin e informacioneve dokumenteve, procedurat për qarkullim e dokumentacionit dhe auditimin e brendshëm.
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) ka për mision konceptimin dhe implementimin e politikave shtetërore për çështjet e bujqësisë dhe zhvillimit rural, sigurisë ushqimore e mbrojtjes se konsumatorit, peshkimit dhe akuakulturës, përafrimin e legjislacionit dhe krijimin e një baze të konsoliduar ligjore brenda fushës së përgjegjësisë, në përputhje me legjislacionin përkatës Kushtetutën e Shqipërisë, Kodin e Procedurave Administrative, ligjin nr.9000 datë 30.01.2003 ñPër organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministraveò, ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò,ligjin nr.152/2013 ñPër nëpunësin civilò të ndryshuar, ligjin nr.90/2012 ñPër organizimin dhe funksionimin e administratës shtetëroreò, Urdhërit të Kryeministritnr.109, datë 31.07.2018 i ndryshuar si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, në përmbushje të misionit.
Gjithë misioni zhvillohet nëpërmjet financimit të fondeve nga Buxheti i Shtetit.
Rëndësia e këtij auditimi është vlerësimi dhe evidentimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë , në çdo aspect material, në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin financiar mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në mënyrë për të bërë të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, me synimin e mirëpërdorimit të fondeve publike.

2.Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

NR	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	Në kontratën nr.2548 prot., me nr.115 rep, nr.68 kol, datë 24.03.2015 lidhur midis subjektit ñ*A.M.*ò dhe ish-Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave sot (Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural), me objekt për ngritjen e kompleksit blegtoral dhe ndërtimin e fabrikës së përpunimit të qumështit në tokë bujqësore, duke parashikuar **veprimtari blegtorale** si dhe në kontratën nr.2711 prot, nr.827 rep, nr. 679 kol, datë 31.03.2017 lidhur midis subjektit ñ*P.*ò dhe MBZHR, me objekt për dhënien e tokës bujqësore me qira, për kultivimin e bimëve farogjere	FAQE 65-67	I LARTË	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si ministri përgjegjëse të marrë masa në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave, për përmirësimin e VKM nr.373 datë 20.06.2018 të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e kriterevetë rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò, në përputhshmëri me kërkesat e ligjit nr.8318 datë 01.04.1998 ñPër dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të

	për sigurimin dhe **plotësimin e nevojave për ushqim të blegtorisë dhe krijimin e një ferme blegtorale** për mbarështrimin e gjedhit për mish. Për kontratat e mësipërme janë parashikuar veprimtari blegtorale, ndonëse në aktin nënligjor të aplikuar të kohës, të VKM nr.460, datë 22.5.2013ñPër përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar, nuk parashikon veprimtari blegtorale, në referim të kreu VI ñAfatet e dhënies me qira të tokaveò pika 1, shprehet se, tokat jepen me qira për veprimtari bujqësore. Ky fakt juridik është në kundërshtim me ligjin nr.8318 datë 01.04.1998 ñPër dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetëroreò i ndryshuar, neni 8, mbi të cilin është miratuar VKM nr.460, datë 22.5.2013, i ndryshuar me VKM nr.373 datë 20.06.2018 ñPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò, i ndryshuar me VKM nr.487 datë 17.06.2020 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.373 datë 20.06.2018 të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e kriterevetë rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò, të cilat në përmbajtjen e tyre kreu IV, pika 8, nënpika (b, d,dh) dhe kreu VI pika1, nuk janë shprehur për veprimtari për prodhim blegtoral. Ligji nr.8318 datë 01.04.1998 ñPër dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetëroreò i ndryshuar, neni 8,shprehet se: **(1).**deri në 10 vjet për kontratat e qirasë afatshkurtër, ku përfshihen veprimtaritë për **prodhimin e bimëve të arave** dhe eterovajore. **(2).**deri në 30 vjet për kontratat e qirasë afatmesëm, ku **përfshihen veprimtaritë për prodhimin blegtorial**, për prodhimin e fidanëve, mjediset e mbrojtura dhe pyjet e ulëta (cunG.hte). **(3).**deri në 99 vjet për kontratat e qirasë afatgjatë, ku përfshihen veprimtaritë për turizëm, rekreacion, pyll i lartë dhe pemët frutore.			livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetëroreò i ndryshuar, me qëllim për caktimin e drejtë dhe të saktë, të objekteve të kontratave të qiradhënies së tokës bujqësore, duke garantuar zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimin rural në të gjitha dimesionet.
2	Nga auditimi rezultoi se, llog **Llog.210** ñToka Troje,Terenò paraqitet ne kontabilitet ne vlerën 0 lekë. VKM nr. 995, datë 9.12.2015,òVKM nr.45, datë 29.01.2014 si dhe VKM nr.142, datë 24.2.2016 ñPër kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë,	FAQE 65-114	**I LARTË**	**-**Titullari i Institucionit të marrë masa për ngritje e grupit të punës me qëllim vlerësimin dhe saktësimin e vlerës së aktiveve afatgjata jo materiale ñToka troje terrenò, në administrim të institucionit MBZHR. Nga

	Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujëraveò fondi i tokës bujqësore në pronësi të shtetit në përgjegjësi administrimi të MBZHR **është 19,033.95 Ha.** Për periudhën objekt auditimi është dhënë me qira sipërfaqja **prej 714.35** Ha të cilat nga ana se sektorit të monitorimeve është kryer regjistrimit i tyre ne hipotekë. Nga auditimi u konstatua se nuk janë kontabilizuar asnjë nga tokat të cilat MBZHR ka në përdorim, apo tokave të cilat MBZHR ka dhëne me qera. Kjo çështje për grupin e auditimit është konsideruar materiale, pasi në llog.210 ñToka,Troje,Tereò duhet të ishte konatabilizuar, pas regjistrimit të tokë në hipotekë, I cili bëhet nga vetë punonjësit e sektorit të financës, si dhe duke ju referuar zonës kadestrale dhe VKM nr. 89, datë 3.2.2016, ñ*Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë" përcaktohet vlera e secilës nga tokave të cilat MBZHR ka në përdorim.* -Për periudhën objekt auditimi është kryer regjistrimi i pronësisë dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme në inventarin e shtetit sipas kërkesave të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 ñPër inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendoreò, i ndryshuar). Është regjistruar pasuria në Zyrën e Kadastrës Shtetërore, në bazë të përcaktimeve të ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 ñPër pasuritë e paluajtshme shtetëroreò, i ndryshuar si dhe ligjit nr. 33/2010 ñPër regjistrimin e pasurive të paluajtshmeò. Por nga auditimi u konstatua se sipërfaqet e trojeve në llog nr.210 si dhe vlerat e tyre për periudhën objekt auditimi, nuk janë regjistruar në bilancin kontabël dhe janë evidentuar për vleftën 0 lekë. Sipërfaqja totale e tokës që ka MBZHR në dispozicion nuk është vlerësuar dhe nuk është pasqyruar në kontabilitet. Për sa sipër, nuk ka gjetur zbatim pika 3.3 ñRregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar (bilanci)ò , paragrafi 62, dhe paragrafi 91, të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò.			Drejtoria e Buxhetimit dhe Menaxhimit Financiar (Sektori i Financës) të merren masa për të kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare vlerën e drejtë të Aktiveve Afatgjata Materiale, menjëherë pas përfundimit të procesit të vlerësimit nga grupi i punës. **-**Titullari i Institucionit të ngrejë një grup pune për të pasqyruar dinamikën dhe lëvizjet e aktiveve afatgjata materiale, të ndërtojë gjurmën e auditimit të këtyre pasurive, duke saktësuar dhe administruar dokumentacionin e nevojshëm, dhe mbi këtë bazë të ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore dhe të aplikohet për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të institucionit. Të ngrihet një grup pune me qëllim identifikimin me planimetri dhe genplane të sipërfaqes së tokës truall që i përket institucionit dhe pas përllogaritjes së vlerave nga ekspertët e fushës, të ndërmerren veprimet e nevojshme të regjistrimit të saj në kontabilitet, duke evidentuar situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit dhe në pajtueshmëri me legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare. të tokave bujqësore.
3	MBZHR, për periudhën në auditim, në mbështetje të VKM nr.373, datë 20.06.2018 ñPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe të kontratës TIP për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar, ka lidhur **11 kontrata,** të cilat	FAQE 114-144	I LARTË	-MBZHR, të vlerësojë me kujdes burimet njerëzore të disponueshme në funksion të detyrave që lidhen me administrimin e tokës bujqësore, nga pikëpamja sasiore (numër punonjësish në raport me kontratat, subjekt monitorimi) dhe

	u audituan në lidhje mbi përcaktimin e kritereve, mbi përllogaritjen e vlerës së çmimit të qirasë së tokës bujqësore, mbi përzgjedhjen e subjektit qiramarrës, si dhe ecurinë e monitorimit të kontratës deri më 31.03.2021. Gjithashtu, për periudhën nga viti 2013 deri në fund të vitit 2018, janë lidhur **40 kontrata** në mbështetje të VKM-së nr.460, datë 22.5.2013 ñPër përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò ndryshuar, me VKM nr.373, datë 20.06.2018, nga të cilat 11 kontrata prej tyre u përzgjodhën për auditim për fazën e ecurisë së monitorimit të kontratës. Në bazë të Urdhërave të Kryeministrit nr.168, datë 05.10.2017 ñPër miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Ruralò i ndryshuar me Urdhër të Kryeministrit nr.39 datë 22.01.2021, ku sipas rregulloreve të brëndshme të miratuara nga titullari i MBZHR me urdhërat nr.324/1 datë 25.09.2018 ñPër miratimin e strukturës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Ruralò dhe nr.4276 prot datë 02.06.2021, është Sektori i Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të Kontratave me përbërje (1 shef sektori dhe 3 specialistë) pranë Drejtorisë së Prokurimeve dhe Partneriteteve, përgjegjës për monitorimin dhe mbajtjen e regjistrit të kontratave të qerasë dhe ecurinë e up date të tyre, në përbushje të detyrave funksionale. Kjo strukturë nuk ka funksionuar asnjëherë me staf të plotë me burime njërëzore për shkak të mos rekrutimit të punonjësve nga ana e DAP si dhe punonjësit e pakët e këtij sektori, përtej kryerjes së detyrave funksionale, janë përfshirë rast pas rasti nga titullari i MBZHR (Ministri), duke marrë pjesë edhe në: (1) grupet të vlerësimit në terren, të tokës bujësore që jepet me qira, me detyrë, verifikimin e gjendjes faktike të sipërfaqes së tokës bujqesore, verifikimin e gjendjes së infrastrukturës ujitëse dhe kulluese te saj, distancën nga tregjet, nivelin e industrisë agropërpunuese, si dhe shkallën e zhvillimit të infrastrukturës rrugore të zonës; (2) grupet e përllogaritjes së vlerës së çmimit të qerasë vjetore për tokën që jepet me qira, me detyrë, përcaktimin e shkallës së bonitetit të tokës me qëllim përcaktimin e qerasë fillestare minimale,			nga pikëpamja e ekspertizës, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike. -Nga titullari i MBZHR, për realizimin e procedurës së dhënies me qira të tokës bujqësore, të vendosë në grupet e punës persona, në mënyrë të tillë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, dhe kontrollin, sipas kërkesave që dikton ligji nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar.

	mbivlerën e të cilës shtohen (në %) dhe komponentë të tjerë[1]. Kështu,vendosja në grupe të ndryshme të punonjësve të sektorit, për propozimin, miratimin, monitorimin, në të njëjtën kohë, nuk është në përputhshmëri, sipas kërkesave që dikton ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar. Nga auditimi, në lidhje mbi punën e monitorimit të kontratave nga sektori bashkëfinancimit, partneriteteve dhe monitorimit të kontratave, për periudhën e audituar, u konstatua se; - deri në në fund të vitit 2019, ka realizuar 8 monitorime, nga 40 kontrata në fuqi (ose monitoruara rreth 20 % të kontratave) ; -përgjatë vitit 2020, ka realizuar 6 monitorime nga 50 kontrata ne fuqi (ose monitoruara rreth 12% të kontratave); -përgjatë 3 mujorit të parë të vitit 2021, nuk ka realizuar asnjë monitorim nga 51 kontrata. Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, edhe një strukturë ndihmëse, Sekretariati Teknik i Komisionit Qeveritar të Tokës, nuk funksionon prej datës 31.12.2019, për shkak të shfuqizimit të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008 ñPër shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokënò, i ndryshuar. Pra si përfundim, struktura përgjegjëse e vetme (sektori i bashkëfinancimit, partneriteteve dhe monitorimit të kontratave) për monitorimin e kontratave të qirasë të tokës bujqësore, nuk është me kapacitet të plotë me burime njërëzore si dhe vendosja e punonjësve të pakët nga ana e titullarit të MBZHR, në disa procese pune në të njëjtën kohë, për vlerësimin e tokës në terren, përllogaritjen e vlerës së çmimit të qerasë vjetore , për hartimin e kontratës së qirasë si dhe monitorimin e tyre, nuk ka bërë të mundur të kemi efektivitet të plotë të monitorimit të ecurisë së kontratave të qirasë të tokave bujqësore, kjo në kundërshtim me detyrimin që parashikon VKM nr.373 datë 20.6.2018 ñPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò kreu VII ñMonitorimi i kontrataveò, pika 5 si dhe me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar			

[1] 1. Gjendja e infrastruktures ujitëse dhe kulluese te saj,
2. Distanca nga tregjet (pika grumbullimi, tregjeve te zonave urbane)
3. Shkallen e e zvillimit të infrastruktures rrugore të zonës
4. Distanca nga sipërmarrjet agro-përpunuese(të produkteve bujqesore ose blegtorale)

	dhe kontrollinò, i ndryshuar.			
4	Nga auditimi në lidhje mbi respektimin e strukturave në MBZHR për periudhën 01.01.2019 deri më 30.03.201, u konstatua se, aparati i Ministrisë së Bujqësisë ka pësuar ndryshime në strukturë dhe organikë, në bazë të: **(1)** Urdhërit të Kryeministritnr.109, datë 31.07.2018 ñ*Për disa ndryshime në urdhërin nr.168 datë 05.10.2017 të kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe organikës së MZHBR*ò me numër total të strukturës plan 163 punonjës, ndërsa fakti në fillim të vitit 2019 rezultoi me 136 punonjës, me diferencë prej 27 vende vakande, nga të cilat 16 vënde për nëpunës civil dhe 11 vënde me kod pune. Deri në fund të vitit 2020 në dhjetor, numri i vakancave ka pësuar ulje në 17 vënde vakante nga të cilat 9 vënde për nëpunës civil dhe 8 vënde me kod pune. Në zbatim të Urdhërit të Kryeministritnr.109, datë 31.07.2018, Ministri i MBZHR, ka miratuar urdhërin me nr.324/1 datë 25.09.2018 ñPër miratimin rregullores së strukturës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Ruralò **(2)** Urdhërit të Kryeministrit nr.150,datë 05.11.2020 ñ*Për miratimin e strukturës dhe organikës së MZHBR*ò numri total i strukturës plan u bë 174 punonjës. Ky ndryshim në strukturë është kërkuar nga Ministri i MBZHR në bazë të Relacionit me shkresë nr. 7892/1, datë 06.10.2020 **(3)** Urdhërit të Kryeministrit nr.162, datë 14.12.2020 ñ*Për disa ndryshime në urdhërin nr.150 të kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe organikës së MZHBR*ò, ku nuk ka ndryshim të numrit total të strukturës plan 174 punonjës, por ka vetëm ndryshime në emërtimin e disa sektorëve. Gjithashtu, sipas Urdhërit nr.39 të Ministrit të MBZHR-së, datë 22.01.2021, në zbatim të urdhërit nr.150 të Kryeministrit, datë 09.11.2020 ñ*Për miratimin e strukturës dhe organikës së MBZHR*ò është miratuar struktura plan e MBZHR-së, me numër total plan 174 punonjës në aparatin e MBZHR-së, ndër kohë që struktura fakt deri në Mars të vitit 2021 ka qenë 142 punonjës, duke rezultuar 32 vënde vakante, nga të cilat 26 vënde për nëpunësit civil dhe 6 vënde me Kod Pune. Kjo është edhe struktura plan që ka Aparati i MBZHR-së deri më datën 31.03.2021. Nga sa më sipër, ndonëse kemi rritje të numrit në plan të punonjësve të aparatit	FAQE 34-53	I LARTË	MBZHR të mbajë një korespondencë të vazhdueshme dhe më e shpeshtë me Departamentin e Administratës Publike si dhe të gjënden mekanizmat e nevojshmeme qëllim që të kryhet rekrutimi i personelit dhe si rrjedhojë minimizimi i vakancave për të arritur një kapacitet sa më të plotë në personelin e Aparatit të MBZHR-së.

	të MBZHR, kemi vakanca gati prej 20% të pozicioneve të vendeve të punës, të cilat konsistojnë më shumë në nivel specialist, i cili është tregues jo pozitiv për funksionimin me kapacitet të plotë të MBZHR, për pasojë mund të sjellë performancë të dobët të institucionit në realizimin e objektivave në lidhje me faktin që sistemi bujqësor dhe zhvillimi rural, mbetet një nga sektorët me potencialin më të madh të zhvillimit në Shqipëri. Vlen të përmëndet që nga ana e Sektorit të Burimeve Njerzore të MBZHR-së janë bërë shpallje për plotësimin e vakancave si në sistemin e HRMIS (Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore) për të kaluar më pas në sistemin online të rekrutimit, në platformën administrata.al. Por gjithashtu vlen të theksohet se nuk është gjetur një bashkëpunim institucional me Departamentin e Administratës Publike dhe mekanizmat e nevojshëm për zgjidhjen e këtij problem. Pra është përgjegjësi e strukturave përgjegjëse të aparatit të MBZHR-së për gjetjen e mekanizmave të nëvojshëm për rekrutimin dhe plotësimin e këtyre vakancave.			
5	Për periudhën në auditim nga MZHBR, janë realizuar 11 procedura dhënie me qira të tokës bujqësore, nga të cilat nga grupi i auditimit u përzgjodhën 7 kontrata, ku në 2 procedura gjatë procesit të realizimit të dhënies me qira, u konstatua që, përllogaritja e çmimit fillestar të qerasë të tokës bujqësore pas verifikimit në terren, nga grupet e punës të ngritura me urdhër të titullarit të MBZHR, është llogaritur më pak, e për pasojë vlera e qirasë të tokës bujqësore ka sjellë të ardhura më pak në vlerën prej **196,776.94 lekë si efekte negative** në Buxhetin e Shtetit, konkretisht: **1.**Për Kontratën nr.180 Rep, nr.33/4Kol nr.317 prot datë 15.01.2020 me subjektin ñA.B.Fò shpk; **2.**Për Kontratën nr.305 Rep, nr.613 Kol, nr.748/1 prot datë 22.09.2020 me subjektin ñF.Aò, Kjo në kundërshtim me ligjin nr.8318 datë 01.04.1998 ñPër dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetëroreò i ndryshuar,sipas VKM nr.373 datë 20.06.2018 ñPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar me VKM nr.487 datë 17.06.2020 ñPër disa ndryshime dhe	FAQE 67-114	I LARTË	Nga MBZHR, të merren masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës prej 196,776.94 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit, konkretisht: -Vlera prej 32,864 lekë për subjektin ñA.B.Fò. -Vlera prej 163,912.94 lekë për subjektin ñF.Aò.

	shtesa në Vendimin nr.373 datë 20.06.2018 të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e kriterevetë rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit.ò			
6	Nga verifikimi i monitorimit të kontratave në lidhje me detyrimin kontraktor të realizimit të investimeve kapitale, në 3 kontrata, të cilat janë dhënë mbi bazën nënligjore të aplikuar të kohës, me VKM nr.460, datë 22.5.2013ñPër përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar, u konstatua se, qiramarrësit megjithëse kanë kryer investime në terren **nuk** mund tã mbështesin investimet me dokumenta justifikues (fatura apo deklarata doganore dhe situacione punimesh/shërbimesh), për rrjedhojë për këto kontrata **nuk** provohet plotësimi i kushteve të kontratës, për realizimin e investimit jo më pak se 20% e vlerës së parashikuar brenda vitit të 3-të pas lidhjes së kontratës si dhe 70% brenda vitit të 5-të, e për pasojë mosplotësimi i detyrimeve kontraktore, në kundërshtim me nenin 6, pika 5/b, me nenin 7, pika 3 të kontratës, duke përllogaritur penalitetet, më konkretisht: **1**.Shoqëria "A.." shpk dhe ish-MBUMK (Ministria e Bujqesisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit) kanë lidhur Kontratë nr.3819 prot datë 16.09.2013, për dhënien e tokës bujqësore me qira me afat për 60 vite, me object të kultivimit të drufrutorë të arrës së bashku me fidanishte dhe të kultivimit të ullinjëve, me vlerë qiraje 622,440 lekë në vit. Nga auditimi rezultoi se, MBZHR ka zgjidhur kontratën në mënyrë të njëanshme me shkresë me urdhër të titullarit, nr.227 datë 01.06.2021, për shkak se, subjekti nuk ka kryer investimet në vlerën deri 20% të vlerës së investimit, si dhe ky subjekt nuk ka kryer investimet në vlerën deri në 70% të vlerës së investimit brenda 5 viteve të para. Grupi i auditimit kreu përllogaritjet e penaliteteve për investimin e pakryer nga ku rezultoi se: Investimi i parashikuar në planin e biznenist është në vlerën 3,155,883 Euro brenda një afati 5 vjecar; Investimi i realizuar është në total rreth 126,346 Euro: nga të cilat 13,306,926 leke dhe 31.500 Euro; dhe Investimi i parealizuar rezulton rreth 3,029,536 Eur (ose 425,044,008 lekë[2])	FAQE 65-114	I LARTË	Nga MBZHR, të merren masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **28,304,528.3** lekë si pasojë e mos plotësimit të detyrimit kontraktor nga mos kryerja e investimeve në kohë, duke krijuar vlera financiare të cilat përfaqësojnë të ardhura të munguara ndaj buxhetit të shtetit, si vijon: -Për subjektin ñA..ò, në vlerën prej 14,672,752.09 lekë (ose 104,581 Euro). -Për subjektin ñP.I.ò shpk, në vlerën 13,631,776.32 lekë. -Për subjekti K. ñC.", në vlerën 448,064 lekë.

[2] Për efekt perllogaritjesh kursi I këmbimit Euro/ALL është 140.30, sipas kursit të kembimit nga BSH më datë 16.09.2013 - data e

	Totali i penaliteteve në masën 2% të vlerës së investimeve kapitale të pakryera është **14,672,752.09 lekë** (ose 104,581 Euro). **2**. Shoqëria ñP.I.ò shpk dhe ish-MBUMK (Ministria e Bujqesisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit) kanë lidhur Kontratë Nr.3620/1 prot datë 06.09.2013, për dhënien e tokës bujqësore me qira me afat për 60 vite, ndryshuar me Shtojcën 5 nr.4307, nr.1228 Rep, nr.298 Kol, datë 29.05.2017. Nga auditimi konstatua se, për realizimin e investimit me vlerë prej 351,036,645 lekë sipas Kontratë Nr.3620/1 prot datë 06.09.2013 në Plan biznesit të vitit 2013, u kontatuan dokumentacion në dosjen fizike sipas faturave të dorëzuara në vlerën prej 44,399,037 lekë, dmth 13% të vlerës së investimit, në mos plotësim të detyrimit kontraktor, sipas neni 6 pika 5/a e për rrjedhojë penaliteti i parashikuar në masën 2% të vlerës së investimeve kapitale të të pakryera është në vlerën 12,265,504.32 lekë. -Ndërsa për kontratën shtesë nr.4307 Prot, Nr.1225 Rep, Nr.298 Kol, datë 29.05.2017 sipas Plan Biznesit të vitit 2017, nuk u konstatua dokumentacion justifikues në dosjen fizike, për vlerën e investimit të parashikuar në kontratë dhe për këtë arsye investimi konsiderohet në masën 0 %, për rrjedhojë penaliteti i parashikuar në mos plotësim të detyrimit kontraktor sipas neni 6 pika 5/b penaliteti i parashikuar në masën 2% sipas nenit 7 pika 3, është në vlerën 1,366,272.00 lekë. Pra në total, penalitetet për mos realizimin e investimeve kapitale sipas Plan biznesi të vitit 2013 dhe vitit 2017 është në vlerën **13,631,776.32** lekë. **3**. Subjekti K. ñC." shpk dhe Ministria e Bujqesisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave kanë lidhur Kontratë nr.1001 Prot, nr.396 Rep, nr.369 Kol, datë 05.02.2016, për dhënien e tokës bujqësore me qira me afat për 60 vite, ngritje vreshti për kultivimin rrushi dhe prodhim vere me vlerë qiraje 321,565 lekë në vit. Nga auditimi mbi monitorimin e kontratës në dosjen fizike u konstatua se, me urdhër të titullarit Ministrit të MBZHR nr.9763/1 datë 19.10.2018, (pra 2 vite e 8 muaj pas lidhjes së kontratës),është ngritur grupi i punës ñPër dorëzimin e tokës qiramarrësit subjektit Z. P. C.ò shpk, ndërsa në procesverbalin nr.9763/3 datë 26.10.2018 mbajtur nga grupi i dorëzimit,citohet se ñ*qiramarrësi e ka*			

lidhjes së kontratës

	përdorur këtë sipërfaqe që prej momentit të nënshkrimit të kontratës", fakt që tregon se nga ana e MBZHR veprimet administrative janë bërë me vonesë, por kjo vonesë nuk ka penguar përdorimin i tokës bujqësore nga qiramarrësi. Investimi i parashikuar në planin e biznesi për 5 vitet e para është në vlerën 154,286,259 lekë, ndërsa nga auditimi i dosjes fizike nuk u konstatua asnjë dokument ose fatura për të vërtetuar realizimin e investimit të vitit të pestë kryer në masën prej 70%, pra duhet të kishte të provuar vlerën e investimit prej 108,000,381 lekë, penaliteti me vonesë të investimit për 53 ditë është në vlerën prej **448,064 lekë.**			
7	Në bazë të kontratave tip të mëposhtme, subjektet kanë likuiduar me vonesë pagesat e qerasë vjetore, në kundërshtim me nenin 7, pika 1, sipas të cilit qiramarrësi, paguan kamatë vonesën në vlerën 0.5% të detyrimit vjetor të qirasë për çdo ditë vonese në pagesën e qirasë, duke filluar nga data e përcaktuar në kontratën respective. Penaliteti nuk është pëllogaritur nga struktura përgjegjëse për monitorimin e kontratave. Kamatë vonesat të llogaritura nga grupi i auditimit për mos pagimin në kohë të vlerës së qerasë, janë si vijon: **1.** Shoqëria "A.." shpk dhe ish-MBUMK (Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit) kanë lidhur kontratë nr.3819 prot datë 16.09.2013, me detyrimin prej vlerës **9,682,054** lekë. **2**.Shoqëria ñP.I.ò shpk dhe ish-MBUMK (Ministria e Bujqesisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit) kanë lidhur kontratë nr.3620/1 prot datë 06.09.2013, me detyrimin prej vlerës **15,197,238.15** lekë. **3.**Subjekti K. ñC." shpk dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave kanë lidhur kontratë nr.1001 prot, nr.396 rep, nr.369 kol, datë 05.02.2016, me detyrimin prej vlerës **184,900.73** lekë. **4.**Subjekti ñA.M.ò dhe Ministria e Bujqesisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit Të Ujrave kanë lidhur Kontratë nr Nr. 2548 Prot, nr.115 Rep, nr.68 Kol, datë 24.03.2015, me detyrimin prej vlerës **1,341,629.10**lekë. **5.**Subjekti ñP.ò shpk dhe MZHBR kanë lidhur kontratë nr.2711 prot, nr.827 rep, nr. 679 kol, datë 31.03.2017, me detyrimin prej vlerës **5,895,051.75** lekë. **6.**Subjektin ñR.S.ò dhe MZHBR kanelidhur kontrata nr.178 rep, nr.32/4 Kol, nr.311 prot datë 15.01, me detyrimin prej vlerës **889,200 lekë.**	FAQE 67-114	I LARTË	Nga MBZHR, të merren masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **33,208,072.75** lekë të krijuara si pasojë e penaliteteve e moslikuidimit ne kohe të qerave vjetore, duke krijuar vlera financiare të cilat përfaqësojnë të ardhura të munguara ndaj buxhetit të shtetit, si vijon: -Për subjektin ñR.S.ò, në vlerën prej 889,200 lekë. -Për subjektin ñF.Aò, në vlerën prej 18,000.21 lekë. -Për Subjektin "A..", në vlerën prej 9,682,054 lekë. -Për subjektin ñP.I.ò,në vlerën prej 15,197,238.15lekë. -Për Subjekti K. ñC.", në vlerën prej 184,900.73lekë. -Për Subjekti ñA.M.ò, në vlerën prej 1,341,629.10lekë. -Për Subjekti ñP.ò, në vlerën prej 5,895,051.75 lekë.

	7.Subjektin ñF.Aò lidhur kontrata nr.305 rep,nr.613 kol, nr.748/1 prot datë 22.09.2020, me detyrimin prej vlerës **18,000.21 lekë.**			
8	Nga auditimi me zgjedhje i urdhër shpenzimeve të dietave për periudhen objekt auditimi rezulton se pavarësisht se znj, B.K. (Drejtori i NJAB pranë MZHBR) nuk ka qenë pjesë e programeve të auditimeve, eshte shtuar në trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës duke u ndryshuar përbërja e grupit të auditimit me autorizimet e Drejtorit të Përgjithshëm dhe si pasojë ka një rritje në kostot e auditimit me vlerën 606,430 lekë, në kundërshtim *me udhëzimin nr.30, datë 26.12.2011 dhe ligjin nr.114/2015 "Për Auditin e Brendshëm".* Drejtoria e Auditimit në MBZHR është në varësi direkte dhe vihet në lëvizje vëtëm me urdhër të Ministrit, në përputhje me *ligjin nr 114/2015 "Për Auditin e Brendshëm" Kreu IV, neni 10, pika 2.* Në urdhër shpenzimet e audituara nuk ka asnjë shkresë të Ministrit të MZHBR-së që të ndryshohet përbërja e grupeve të auditimit duke shtuar drejtorin e NJAB znj.B.K.. Gjithashtu nga auditimi me përzgjedhje u konstatua se në 3 urdhër shpenzime është përfituar dieta për ditën e premte (dieta ditore dhe fjetje hoteli) duke u kthyer në qëndren e punës (Tiranë) me datë 03.10.2020 dhe 10.10.2020 (e shtunë) dhe si pasojë ka një rritje në kostot e auditimit me vlerën 27,500 lekë. Sa më sipër është vepruar në kundështim me *VKM nr.997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, Brenda vendit", i ndryshuar, kreu V, pika 2. Me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik", i ndryshuar, Kreu III, pika 36. Me rregulloren e brëndshme të institucionit me nr,1984/1 datë 10.10.2019. Me Ligjin nr.114/2015 "Për Auditin e Brendshëm" Kreun IV, neni 10, pika 2 " NJAB është e pavarur funksionalisht dhe raporton në mynyrë të drejtpërdrejtë tek titullari i njësisë publike" dhe Neni 14 pika c dhe ii dhe meVKM nr.511 datë 24.10.2002 i ndryshuar"Për kohëzgjatjen e punës dhe pushimit në institucionet shtetërore"*	FAQE 55-50	I LARTË	Nga titullari MBZHR, të ngrihet një grup pune, për të evidentuar parregullsitë e konstatuara mbi urdhër shpenzime për vlerën prej 633,930 lekë, e cila është përdorur pa ekonomicitet, efektivitet dhe efiçensë.

3.Konluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

Nga auditimi në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, u konstatuan problematika si vijon:

a) mosevidentim të plotë dhe të saktë të pasqyrave financiare të vitit 2020, në llogarinë ñT*oka troje terren*ò, e cila është kontabilizuar në mënyrë të padrejtë në vlerën 0 lekë.

b) mosevidentim me evidenca kontabël si dhe saktësim të vlerës të Aktiveve Afatshkurtra Jo Materiale, konkretisht llogaria 423 ñ*Personeli, paradhënie, deficiti, gjoba"* për gjobat qe vijnë si rezultat i mos zbatimit të kushteve të kontratës për dhënie me qera të tokave bujqësore e lidhur midis përfituesit dhe MBZHR.

c) Regjistrimi dhe saktësimi i llogarisë 486 ñ*Debitore të ndryshëm*ò,duhet të realizohet saktë, për të evidentuar klasifikimin e debitorëve, me qëllim ndjekjen e të gjitha hapave dhe shkallëve ligjore për arkëtimin e tyre.

d) Sipërfaqet të lira, tokë bujqësore *prej 15 896 ha e 5334m*^{2} në administrim nga MBZHR, *gjendja juridike e tyrë është e pa rregjistruar* pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, duke rritur riskun e tjetërsimit të pronave bujqësore, nga palë të treta. Ndërsa sipërfaqja prej 3137 ha është rregjistruar, në momentin kur ka filluar procedura e dhënies me qira të tokës bujqësore nga MBZHR, për të cilat nga auditimi Pasqyrave financiare për vitin 2019 dhe 2020, llogaria (210) ñtoka, trojeò figuron në vlerën 0 lekë.

e)Nga auditimi për disa kontratave me objekt për dhënie me qira të tokave bujqësore për periudhën në auditimin vitet 2019 deri më 30.03.2021, gjatë procesit të realizimit dhe monitorimit, u konstatua se:

(i) Në përllogaritjen e çmimit fillestar të qerasë të tokës bujqësore pas verifimimeve në terren, nga grupet e punës të ngritura me urdhër të titullarit të MBZHR, është llogaritur më pak, e për pasojë vlera e qirasë të tokës bujqësore ka sjellë të ardhura më pak në vlerën prej *196,776.94 lekë si efekte negative në Buxhetin e Shtetit.*

(ii) Nga subjektet qiramarrëse nuk janë zbatuar detyrimet kontraktore, konkretisht për mospagesat e qirasë në kohë, për mosrealizimin e investimeve të paraqitur sipas plan-investimeve, për pasojë *vlera prej 61,512,600.75 lekë përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Shtetit.*

f) ndonëse ka rritje të numrit në plan të punonjësve të aparatit të MBZHR, kemi vakanca në disa pozicione pune janë në masën 20% të numrit total të punonjësve, të cilat konsistojnë më shumë në nivel specialist, i cili është tregues jo pozitiv për funksionimin me kapacitet të plotë të MBZHR, për pasojë mund të sjellë performancë të dobët të institucionit në realizimin e objektivave në lidhje me faktin që sistemi bujqësor dhe zhvillimi rural, mbetet një nga sektorët me potencialin më të madh të zhvillimit në Shqipëri.

g) *Vlera prej 633,930 lekë* është është përdorur pa ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet, duke paguar padrejtësisht nga udhëtimet/dietat për punonjësit e strukturave të auditit të brendshëm në MBZHR.

OPINIONI I AUDITIMIT

<u>Opinion mbi pasqyrat financiare (i pamodifikuar/pakualifikuar me theksim të çështjes)</u>

Ne audituam pasqyrat financiare të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (Aparati), deri më datë 31.12.2020 të cilat përbëhen nga Bilanci, Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, Pasqyra e Fluksit të Arkës, dhe Pasqyra e Lëvizjes së Kapitalit si dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat.

Në opinionin tonë, veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi ñ*Theksimi i Çështjes*ò.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), Manuali i Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 64, datë 22.06.2020, si edhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin *"Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare"*, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI-P 10, Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 130- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2008, të Kryetarit të KLSH-së.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e **opinionit të pamodifikuar/pakualifikuar të auditimit me theksim të çështjes [3].**

Theksimi i çështjes:

Theksojmë nevojën e marrjes së masave nga ana e drejtimit e më pas në linjë hierarkike nga gjithë personeli i subjektit Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sa i takon:

- evidentimit të plotë dhe të saktë në pasqyrat financiare të vitit 2020, të llogarisë ñT*oka troje terren*ò, e cila është kontabilizuar në mënyrë të padrejtë në vlerën 0 lekë, me qëllim saktësimin e vlerës së këtij zëri kontabël dhe rritjen e besueshmërisë së pasqyrave financiare.
- evidentimit me evidenca kontabël si dhe saktësimin e vlerës të Aktiveve Afatshkurtra Jo Materiale, konkretisht llogaria 423 ñ*Personeli, paradhënie, deficiti, gjoba"* për gjobat qe vijnë si rezultat i mos zbatimit të kushteve të kontratës për dhënie me qera të tokave bujqësore e lidhur midis përfituesit dhe MBZHR, me qëllim detajimin e këtij zëri për të rritur saktësinë dhe plotësinë e të dhënave.
- Regjistrimi dhe saktësimi i llogarisë 486 ñ*Debitorë të ndryshëm*ò, për të evidentuar klasifikimin e debitorëve, me qëllim ndjekjen e të gjitha hapave dhe shkallëve ligjore për arkëtimin e tyre.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

Menaxhimi i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatorë në fuqi.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Gjithashtu ne krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

---

[3] ***Opinioni i pamodifikuar/pakualifikuar me theksim të cështjes****: Një opinion i pamodifikuar me theksim çështje, jepet kur audituesi arrin në konkluzionin se për të gjitha aspektet materiale, pasqyrat financiare paraqesin një pamjen të vërtetë dhe të drejtë si dhe pasqyrat janë përgatitur në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar. Theksimi i referohet një çështjeje të paraqitur ose shpalosur në mënyrë të duhur në pasqyrat financiare e cila, sipas gjykimit të audituesit, ka një rëndësi thelbësore për përdoruesin në mënyrë që të arrijnë të kuptojnë pasqyrat financiare. (ISSAI 1706.5)*

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Opinion mbi përputhshmërinë (*Opinion i Modifikuar/ Kualifikuar*)

Ne audituam përputhshmërinë, mbi zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe respektimin e strukturave organike të miratuara, mbi zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare, mbi administrimin dhe monitorimin e tokës bujqësore, mbi zbatimin e legjislacionit në lidhje mbi realizimin dhe ekzekutimin e procedurave të prokurimit publik, etj. Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e MBZHR janë evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e ñBazës për Opinioninò, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar.

Baza për kufizimin e sigurisë të opinionit të përputhshmërinë

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI-t). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin *"Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përputhshmërisë"*, pjesë e projektraportit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI-P 10, Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 130- Kodi Etik, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 òStandardi i Auditimit të Përputhshmërisëò si dhe në mbështetje të Kodit të Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 27, datë 20.04.2018. Dokumentacioni administrativ, për secilin nga drejtimet e Programit të auditimit, janë përzgjedhur, mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, përfshirë marrjen në konsideratë të risqeve të mospërputhshmërisë materiale të vendim marrjes nga MBZHR, me kriteret e parashikuara.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një nivel të arsyeshëm për dhënien **e opinionit i modifikuar/ i kualifikuar**[4]

Në vijim konstatuam sa më poshtë:

-Sipërfaqet të lira, tokë bujqësore *prej 15 896 ha e 5334m²* në administrim nga MBZHR, *gjendja juridike e tyre është e pa regjistruar* pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, duke rritur riskun e tjetërsimit të pronave bujqësore, nga palë të treta. Ndërsa sipërfaqja prej 3 137 ha është regjistruar, në momentin kur ka filluar procedura e dhënies me qira të tokës bujqësore nga MBZHR, për të cilat nga auditimi Pasqyrave financiare për vitin 2019 dhe 2020, llogaria (210) ñtoka, trojeò figuron në vlerën 0 lekë.

-Nga auditimi për disa kontratave me objekt për dhënie me qira të tokave bujqësore për periudhën në auditimin vitet 2019 deri më 30.03.2021, gjatë procesit të realizimit dhe monitorimit, u konstatua se:

(i) Në përllogaritjen e çmimit fillestar të qerasë të tokës bujqësore pas verifikimeve në terren, nga grupet e punës të ngritura me urdhër të titullarit të MBZHR, është llogaritur më pak, e për pasojë vlera e qirasë të tokës bujqësore ka sjellë të ardhura më pak në vlerën prej *196,776.94 lekë si efekte negative në Buxhetin e Shtetit.*

(ii) Nga subjektet qiramarrëse nuk janë zbatuar detyrimet kontraktore, konkretisht për mospagesat e qirasë në kohë, për mosrealizimin e investimeve të paraqitur sipas plan-investimeve, për pasojë *vlera prej 61,512,600.75 lekë përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Shtetit.*

(iii) ndonëse ka rritje të numrit në plan të punonjësve të aparatit të MBZHR, kemi vakanca në disa

2.Opinioni i modifikuar/i kualifikuar, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, janë evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të cilat janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar.

pozicione pune janë në masën 20% të numrit total të punonjësve, të cilat konsistojnë më shumë në nivel specialist, i cili është tregues jo pozitiv për funksionimin me kapacitet të plotë të MBZHR, për pasojë mund të sjellë performancë të dobët të institucionit në realizimin e objektivave në lidhje me faktin që sistemi bujqësor dhe zhvillimi rural, mbetet një nga sektorët me potencialin më të madh të zhvillimit në Shqipëri.
(iv)*Vlera prej 633,930 lekë* është përdorur pa ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet, duke paguar padrejtësisht nga udhëtimet/dietat për punonjësit e strukturave të auditit të brendshëm në MBZHR.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, është përgjegjëse për zbatimin e veprimtarisë në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara.
Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:
Përgjegjësia jonë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të MBZHR, në lidhje mbi menaxhimin e fondeve buxhetore vjetorë, për zbatimin me rigorozitet të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues për zhvillimin e sektorit bujqësor.
Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.
Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në materialet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në projektraport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. Hyrja.
Mbështetur në ligjin nr.154/2014 datë 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e KLSHò, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 528/1 prot, datë 14.05.2021, i ndryshuar me shkresën nr.528/2 prot datë 25.05.2021, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nga data 17.05.2021 deri në 31.07.2021, për periudhën e auditimit 01.01.2019 deri në 30.03.2021, u krye auditim Financiar dhe Përputhshmërie, nga grupi i auditimit me përbërje:
1. V.G (*përgjegjës grupi*),
2. E.K, anëtare
3. M.R, anëtare
4. H.K, anëtar
5. A.V, anëtar
6. A.Z, anëtar

1) Titulli:
Projektraporti i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

2) Marrësi:
Ky Raport Përfundimtar i adresohet Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural zj.F.K..

METODOLOGJIA DHE OBJEKTIVAT E AUDITIMIT
3) Objektivat dhe qëllimi i auditimit:
Objektivat specifike të auditimit janë, dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare të institucionit, nëse janë paraqitur saktë, në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar dhe dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu procedurat e prokurimeve dhe shpenzimet vjetore të buxhetit.

Qëllimi i auditimit është, vlerësimi dhe evidentimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë, në çdo aspekt material, janë në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin financiar mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në mënyrë për të bërë të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, me synim të mirëpërdorimit fondeve të financuara nga Buxheti i Shtetit.

4) Identifikimi i çështjes:

Në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe kushtetuese, misioni i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) është zbatimi i programit të qeverisë në fushën e veprimtarisë si vijon:

-Hartimi dhe zbatimi i politikave që synojnë mbështetjen e rritjes së qëndrueshme të prodhimit bujqësor dhe blegtoral;

-Hartimi dhe përafrimi i legjislacionit në fushat e bujqësisë dhe zhvillimit rural në koherencë të plotë me kërkesat e BE-së;

-Mbrojtja e shëndeti i kafshëve, bimëve, dhe garantimin e shëndetit të njerëzve nga sëmundjet që mund të vijnë nga kafshët dhe cilësia e ushqimeve;

-Mbledhjen dhe perpunimin e informacionit bujqësor;

-Menaxhimin dhe administrimin e qëndrueshëm të tokës bujqësore;

-Ofrimin e asistencës dhe informacionit për fermerët;

-Menaxhimin e sistemit të kullimit dhe koordinimin e veprimeve për administrimin e sistemit të ujitjes.

Aktiviteti i përgjithshëm i MBZHR drejtohet nga Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm, Drejtor të Përgjithshëm, Drejtor, Sektor, ku zhvillohen veprimtaritë në bazë të rregullores miratuar me Urdhër të Ministrit ñPër miratimin e rregullores së brëndshme ñPër organizimin dhe funksionimin e MBZHRò, në të cilat përfshihen objekti i punës, detyrat, struktura dhe detyrat funksionale të çdo punonjësi.

Gjithë misioni zhvillohet nëpërmjet financimit të fondeve nga Buxheti i Shtetit.

Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në Programin e Auditimit nr. 528/1 prot, datë 14.05.2021, i ndryshuar

5) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është përgjegjëse për zbatimin me rigorozitet të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues, zhvillimin e një strategjie të përshtatshme për hartimi dhe zbatimi i politikave që synojnë mbështetjen e rritjes së qëndrueshme të prodhimit bujqësor dhe blegtoral, për mbrojtjen e shëndetit të kafshëve, të bimëve, dhe garantimin e shëndetit të njerëzve nga sëmundjet që mund të vijnë nga kafshët dhe cilësia e ushqimeve, për menaxhimin dhe administrimin e qëndrueshëm të tokës bujqësore, zbatimine kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, proceduratpër qarkullim e dokumentacionit dhe auditimin e brendshëm.

6) Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të MBZHR-së, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me

auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

7) Kriteret e vlerësimit:

-Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
-Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò.
- Ligji 10296, datë 08.07.2010 ñMbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.ò
- Ligji nr. 9936, datë 26,06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHò, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016
-Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò indryshuar.
- Ligji nr.114/2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publik.ò
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publik.ò
-VKM nr.918 datë 29.12.2014 ñPër kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë eletronikeò
-VKM-së nr.160, datë 02.03.2016 ñPër mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publike.
-VKM nr. 248, datë 10.04.1998 ñPër miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësive që varen prej tyreò, i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001.
- VKM nr.997 datë 10.12.2010 ñPër trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda venditò, i ndryshuar.
-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.14, datë 28.12.2006 ñPër përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.ò
-Udhëzimii APP-së nr. 2 datë 27.01.2015 ñPër hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të prokurimit publikò, udhëzim e APP-së nr.2 datë 08.01.2018 ñMbi përdorimin e procedurës me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimit të saj me mjete eletronikeò i ndryshuar.
- Udhëzimii MF nr. 30, datë 27.12.2011, ñPër menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publikò, i ndryshuar.
- si dhe çdo bazë ligjore me të cilën është operuar për vitin 2019 dhe 2020 si dhe aktet juridike që janë në funksion për funksionimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

8)Standardet e Auditimit

-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI (ISSAI).
-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) t ë IFAC.
-ISSA 4000-4899 Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë
-ISSAI 400-499 Parimet e Auditit të Përputhshmërisë.
- ñLibri Jeshilò i GAO-s, etj;
-ISSAI 1000-2999 ñUdhëzues të Auditimit Financiarò;
-ISSAI 1300 ñPlanifikimi i auditimit të pasqyrave financiareò;

9)Medodat e auditimit

Auditimi ynë përfshin përputhshmërinë e aktivitetit të MBZHR, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi lidhur me zbatimin e kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, identifikimin, zbatimin e kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimin e planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar, parashikimin dhe realizimin e të ardhurave dytësore, planifikimin mbi identifikimin

vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, ruajtjen, arkivimin e informacioneve dokumenteve, proceduratpër qarkullim e dokumentacionit dhe auditimin e brendshëm.

10)Dokumentimi i auditimit

Auditimi financiar dhe i përputhshmërisë, është realizuar në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI) mbështetur në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e (SAI) si dhe ISSAI 30 Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 ñStandardi i Auditimit të Përputhshmërisëò, ISSAI 1000-2999 ñUdhëzues të Auditimit Financiarò; ISSAI 1300 ñPlanifikimi i auditimit të pasqyrave financiareò; Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së si dhe Rregullore ñMbi Procedurat e auditimit në KLSHò, miratuar me Vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 , e ndryshuar me Vendimin nr.63 datë 22.06.2020, të Kryetarit të KLSH-së.

Grupi i audituesve, *<u>për të realizuar objektin e auditimit</u>*, për dhënien e opinionit financiar dhe të përputhshmërisë e veprimtarisë së MBZHR, u fokusua mbi zbatimin në mbështetje të kuadri rregullator në fuqi, në lidhje mbi procedurat mbi zbatimin e kritereve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, identifikimin, zbatimin e kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimin e planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar, parashikimin dhe realizimin e të ardhurave dytësore, planifikimin mbi identifikimin vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, ruajtjen, arkivimin e informacioneve dokumenteve, proceduratpër qarkullim e dokumentacionit,prokurimet duke filluar nga buxhetimi i fondit, hartuesi i specifikimeve, komisionet evlerësimit, kontraktuesi, zbatuesii kontratës, procedurat përpagesat dhe auditimin e brendshëm në zbatim të Ligjit organik të KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, Ligjit 10296, datë 08.07.2010 ñMbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, i ndryshuar; Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.ò, Ligji nr. 9936, datë 26,06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHò, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016 , Ligji nr.114/2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publik, VKM nr. 248, datë 10.04.1998 ñPër miratimin e planit kontabël publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësive që varen prej tyreò, ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 ñPër disa shtesa e ndryshime të VKM nr. 248, datë 10.04.1998ò, VKM-së nr.160, datë 02.03.2016 ñPër mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publike,ligji nr.8318 datë 01.04.1998 ñPër dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetëroreò i ndryshuar,VKM nr.373 datë 20.06.2018 ñPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar me VKM nr.487 datë 17.06.2020 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.373 datë 20.06.2018 të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e kriterevetë rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit.òetj.

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) ka për mision konceptimin dhe implementimin e politikave shtetërore për çështjet e bujqësisë dhe zhvillimit rural, sigurisë ushqimore e mbrojtjes se konsumatorit, peshkimit dhe akuakulturës, përafrimin e legjislacionit dhe krijimin e një baze të konsoliduar ligjore brenda fushës së përgjegjësisë, në përputhje me legjislacionin përkatës Kushtetutën e Shqipërisë, Kodin e Procedurave Administrative, ligjin nr.9000 datë 30.01.2003 ñPër organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministraveò, ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò,ligjin

nr.152/2013 ñPër nëpunësin civilò të ndryshuar, ligjin nr.90/2012 ñPër organizimin dhe funksionimin e administratës shtetëroreò, Urdhërit të Kryeministritnr.109, datë 31.07.2018 i ndryshuar si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, në përmbushje të misionit.
Gjithë misioni i MBZHR zhvillohet nëpërmjet financimit të fondeve nga Buxheti i Shtetit.
Kontrolli i Lartë i Shtetit si organi Kushtetues i kontrollit të fondeve buxhetore nga studimi i vlerësimit të riskut në lidhje me menaxhimin e fondeve buxhetore vjetorë të MBZHR për sigurimin e kushteve të duhura për zbatimin me rigorozitet të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues për bujqësinë dhe zhvillimin rural. Qëllimi është auditimi i fondeve publike nëse janë përdorur me eficencë, efektivitet dhe ekonomicitet.

3.1. MBI HARTIMIN DHE ZBATIMIN E BUXHETIT TË SHTETIT

Auditimi u kryepër vitet 2019 dhe 2020, 4-mujorin e vitit 2021,në zbatim të:
- Ligjit me nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar;
- Ligjit nr. 88/2019 ñPër buxhetin e vitit 2020ò
- Me Ligjin nr. 137/2020 ñPër buxhetin e vitit 2021ò,
- Udhëzim nr. 22 datë 17.11.2016 ñPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendroreò;
- Udhëzimit të MF nr. 36 datë 17.12.2019ñPër përgjegjësitë e përdoruesve në sistemin informatik të menaxhimit financiar për modulin e përgatitjes së buxhetit, modulin e menaxhimit të investimeve publike dhe modulin e monitorimit të buxhetit dhe portofolit të projekteve**”**
- VKM nr. 523 datë 25.07.2019 ñ Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve për PBA 2020-2022ò
-VKm nr.577, datë 22.07.2020 ñ Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve për PBA 2021-2023ò
- Udhëzimi nr. 21 datë 28.02.2018 ñ Për përgatitjen e programeve buxhetore afatmesëm 2020-2021
- Udhëzimi nr. 8, datë 28.12.2019 ñPër buxhetin e vitit 2020ò

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka për mision zbatimin e programit të qeverisë në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, i ndërthurur me sektorë të tjerë si turizmi, infrastruktura dhe shërbimet, për nxitjen e prodhimit bujqësor dhe blegtoral, nëpërmjet uljes së kostos dhe rritjes së konkurueshmërisë, menaxhimit të qëndrueshëm të tokës dhe të ujitjes, kullimit e mbrojtjes nga përmbytja, përmirësimin e sigurisë ushqimore në funksion të mbrojtjes së konsumatorit.

Aparatit të Ministrisë dhe nëpërmjet saj institucioneve të varësisë i planifikohen nga buxheti i shtetit për çdo vit fonde buxhetore.
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për vitet2019-2021 administroi dhe menaxhoi fondet publike sipas shtatë programeve, konkretisht:
1. Programi ñPlanifikim, Menaxhim dhe Administrimò
2. Programi ñSiguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatoritò
3. Programi ñInfrastruktura e Kullimit dhe Ujitjesò
4. Programi ñZhvillimi Ruralò
5. Programi ñKëshillimi dhe Informacioni Bujqësorò
6. Programi ñMenaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësoreò
7. Programi ñMbështetja për Peshkiminò

<u>Viti 2019 Zbatimi i Buxhetit</u>

Me Ligjin nr. 99/2018 ñPër buxhetin e vitit 2019ò, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Ruraljanë planifikuar fonde buxhetore në shumën totale **9,903,962,000** lekë, të cilat janë shpërndarë në 7 programe buxhetore, për 8 mujorin e vitit 2018.

Për 7 programet e Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural situata në lidhje me ndryshimet në planifikimin e buxhetit gjatë 12 - mujorit të Vitit 2019, përfshirë këtu buxhetin fillestar, buxhetin me ndryshime gjatë periudhës raportuese të kësaj periudhe, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Nr.	Emërtimi i programeve	Buxheti fillestar 12-M-2019	Buxheti me ndryshime përfundimtar 12-M-2019	(Buxh me ndryshime) (Buxh. fillestar)
1	Planifikim Menaxhim Administrimi	391,292,000	321,842,000	-69,450,000
2	Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit	1,745,338,000	1,462,681,255	-282,656,745
3	Mbështetje për Peshkimin	342,600,000	404,540,000	+61,940,000
4	Menaxhimi i Infrastrukturës se Kullimit dhe Ujitjes	3,245,800,000	3,528,506,108	+282,706,108
5	Zhvillimi Rural duke Mbështetur Bujqësinë, Blegtorinë dhe Agroindustrine	3,640,932,000	2,934,478,000	-706,454,000
6	Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor	508,000,000	432,291,495	-75,708,505
7	Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore	30,000,000	18,500,000	-11,500,000
Totali		**9,903,962,000**	**9,102,838,858**	**-801,123,142**

Plani fillestar, ndryshimet, plani përfundimtar, dhe realizimi i planit të buxhetit për vitin 2019 sipas artikujve buxhetor, paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Artikulli	Emri	Buxheti Fillestar	Buxheti Përfundimtar	Realizimi në lekë	Realizimi në %
600	Paga	1,519,881,000	1,342,800,787	1,280,288,472	95.3
601	Sigurime Shoqërore	269,619,000	239,675,501	212,481,683	88.6
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	1,528,042,000	1,500,626,532	1,360,793,607	90.7
603	Subvencione	0	0	0	0
604	Transferta Korente të Brendshme	0	125,000,000	125,000,000	100
605	Transferta Korente të Huaja	19,280,000	19,280,000	18,957,493	98.3
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	600,720,000	720,036,038	682,537,216	94.8
Nen-Totali	***Shpenzime Korrente***	**3,937,542,000**	**3,947,418,858**	**3,680,058,471**	**93.2**
230	Kapitale të Patrupëzuara	22,420,000	39,600,560	37,361,617	94.3
231	Kapitale të Trupëzuara	2,852,000,000	2,423,819,440	2,151,038,505	88.7
232	Transferta Kapitale	0	0	0	0
Nen -Totali	***Shpenzime Kapitale me financim te brendshëm***	**2,874,420,000**	**2,463,420,000**	**2,188,400,122**	**88.8**
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	3,092,000,000	2,692,000,000	1,393,618,472	52
232	Transferta Kapitale	0	0	0	0
Nen -Totali	***Shpenzime Kapitale me financim te huaj***	**3,092,000,000**	**2,692,000,000**	**1,393,618,122**	**52**
Jashtë Buxhetore		0	99,421,000	22,829,000	**23**
Totali (korrente + kapitale + jashtë buxhetore)		**9,903,962,000**	**9,202,259,858**	**7,284,905,715**	**79.2**

Për vitin 2019, evidenca e realizimit të shpenzimeve të buxhetit sipas secilit program, krahasuar me planin për vitin 2020*, (përfshirë shpenzimet me financim të brendshëm, investimet me financim të huaj)* paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi i Nënprogrameve	Buxheti me ndryshime 12-M-2019	Fakt 12-M-2019	Realizimi në %
1	Planifikim Menaxhim Administrimi	321,842	292,428	91
2	Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit	1,462,681	1,378,437	94
3	Mbështetje për Peshkimin	404,540	248,138	61
4	Menaxhimi i Infrastrukturës se Kullimit dhe Ujitjes	3,528,506	3,293,192	93
5	Zhvillimi Rural	2,934,478	1,639,883	56

6	Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor	432,291	396,602	92
7	Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore	18,500	13,396	72
Totali		**9,102,838**	**7,262,076**	**80**

Nërealizimin për vitin 2019 nënivelin 80 %ndajplanit,peshënmëtëmadheezëprogrami buxhetor ñSiguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatoritò me 94 %, pasuar nga programiñMenaxhimi i Infrastruktures se Kullimit dhe Ujitjes"me 93 %, programiñKeshillimi dhe Informacioni Bujqesorò me 92%, programi ñPlanifikim Menaxhim dhe Administrimòme 91 %, programiñMenaxhimi i Qendrueshem i tokes Bujqesoreòme 72%,programiñMbeshtetja per Peshkimòme 61 %, dhe programibuxhetorñZhvillimi Ruralò me 56%.

Realizimi i buxhetit për vitin 2019 për Ministrinë është në masën 80 %, të specifikuar sipas kategorive kryesore të shpenzimeve si më poshtë:

Llog (600&601) Realizimet në shpenzimet e personelit që i korespondojnë artikujve 600 dhe 601 paraqiten mesatarisht 94%, përkatësisht 95.3% dhe 88.6%, kjo prej vendeve vakante. Kryesisht këto vakanca janë në programet 04230 ñMbështetje për Peshkiminò 91%, 04860 ñKëshillimi dhe Informacioni Bujqësorò dhe 04220 ñSiguria Ushqimoreò, me nga 93% si dhe 01110 ñPlanifikim Menaxhim Administrimiò me 95%.

Llog (602) Realizimi i art. 602 paraqitet 90.7% dhe kjo nga;

-Në programin e Aparatit të MBZHR ñPlanifikim Menaxhim Administrimiò realizimi me 82%, vjen nga mos realizimi pagesës së shpenzimeve të parashikuara për tarifën e shërbimit të përfaqësimit të Shqipërisë, në Arbitrazhin Ndërkombëtar në çështjen me ñV. srlò, kjo pasi nuk pati pagesë të këstit të radhës nga moszhvillimi i seancave, ashtu si është përcaktuar në kontratën lidhur nga Avokati Shtetit.

-Në programin ñSiguria Ushqimoreò, realizimi ishte 88% dhe kjo kryesisht nga mosrealizimi i blerjes së reagentëve (AKU+DRAKU) dhe (ISUV) të domosdoshëm për kryerjen e analizave në kuadër të monitorimit të mbetjeve në kafshët e gjalla dhe molusqet bivale. Kjo si pasojë e mosfinalizimit nga Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara, të procedurës së prokurimit. Gjithashtu kishte mosrealizim edhe tek zëri ñEmergjenca Veterinareò, pasi gjatë vitit 2019 nuk pati shpërthime epidemiologjike.

-Në programin ñZhvillimi Ruralò realizimi paraqitet me 88% dhe kjo nga mosrealizimi i shpenzimeve për Vendime Gjyqësore, parashikuar nga AZHBR .

-Në programin ñMenaxhimi i qëndrueshëm i tokës bujqësoreò Për objektin ñKrijimi i Sistemit të Informacionit për Tokën Bujqësore LIS, i Integruar në G., në 16 Njësi Administrativeò është bërë prokurimi dhe procedura është anulluar për shkak të mospërmbushjes nga operatorët ekonomikë të kritereve të përcaktuara në dokumentet standard dhe koha e mbetur nuk mundësonte realizimin e procedurës së mësipërme, duke e minimizuar realizimin në 6 Njësi Administrative.

-Në programin ñMbështetje për Peshkiminò realizimi paraqitet 87% dhe kjo pasi gjatë vitit, është kryer mirëmbajtja e sistemittëvrojtim-monitorimit dhe survejimit në anijet e peshkimit, ndërsa pjesa e Blubox-eve nuk është realizuar pasi në dhjetor 2019 janë anulluar procedurat e tenderimit.

Diferencat e tjera në realizim, vijnë prej procesit të prokurimit ku fitojnë ofertuesit me vlerë më të ulët.

Llog (604&605) Realizimet në shpenzimet e artikujve buxhetorë 604 dhe 605, paraqiten në kufijtë e parashikimit.

Llog (606) Sa i përket artikullit 606 ñtransferta në buxhetet familjareò, realizimi paraqitet 95% . Pesha kryesore e këtij artikulli përfaqësohet nga skema kombëtare e mbështetjes së fermerëve, që menaxhohet nga AZHBR dhe konkretisht në vitin 2019 mosrealizimi me 5% vjen nga efekti i realizimit të masës ñInvestime në Bujtinaò me 43% të fondit të parashikuar.

Sa i përket investimeve të brendëshme art. 230 paraqitet me 94% dhe kjo diferencë e krijuar në prokurim, ndërsa artikulli 231 realizimi me 88.7% dhe ky nivel kryesisht prej;

-Në programin ñZhvillimi Ruralò realizimi faktik i fondeve rezulton me vlera të ulëta 40.5%, kjo kryesisht nga mosrealizimi i bashkëfinancimit për IPARD II, për faktin se procesi i vlerësimit dhe verifikimit të aplikimeve nga programi IPARD, pas thirrjes së dytë nga AZHBR, kërkon kohë;

procedurat e tenderimit për rikonstruksionin e zyrave të AZHBR-së u anuluan në fund të vitit; procesi i blerjes së makinave nga Ministria e Brendshme u anulua ,
-Në programin ñSiguria ushqimoreò realizimi rezulton 90%, kjo kryesisht nga mosrealizimi me 35% të bashkëfinancimit për projektin ñBashkefinancim për Dokumenti Sektorial për Sigurinë Ushqimore dhe Veterinarinë (IPA II)ò, kjo për faktin se nga Fondi kombëtar që menaxhohet nga MFE, nuk pati kërkesa për disbursime.
Diferencat e tjera në realizim, vijnë prej procesit të prokurimit.

Llog(231) Sa i përket investimeve të huaja artikulli 231 realizimi me 52% vjen kryesisht prej programit ñZhvillimi ruralò ku ndikon ndjeshëm mosrealizimi I kontratave në kuadër të IPARD II pasi thirrja e dytë për aplikime u bë në shtator 2019 dhe procesi i vlerësimit dhe verifikimit të aplikimeve nga programi IPARD, pas thirrjes së dytë nga AZHBR, kërkon kohë pra përtej vitit buxhetor.

Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave.

Parashikimi i të ardhurave për sistemin e MBZHR-së është kryer për çdo program buxhetor në Anekset e pasqyrave të Projekt Buxheteve të vitit 2019, me klasifikimet përkatëse sipas burimit të krijimit të tyre. Parashikimi është bërë kryesisht duke u bazuar në eksperiencën e krijimit të tyre nga vitet buxhetore paraardhëse.
Realizimi i tyre kundrejt parashikimit vjetor, klasifikimi i realizimit të tyre, për pjesën që i takojnë institucionit dhe derdhjes së tyre në buxhetin e shtetit, si dhë përdorimi i tyre kundrejt limitit të përcaktuar, paraqitet në tabelën e mëposhtme;

Në mijë lekë

Programet Buxhetore 2019	**Planifikim (PBA)**	**Realizimi i te ardhurave nga buxheti i shtetit**			**Realizimi në (%) kundrejt Planifikimit**	**Përdorimi**	
		Gjithsej	**Institucioni**	**Derdhje ne buxhet**		**Plan limit**	**Fakt**
Te ardhura nga qerate	16,712	34,790	0	34,790	208%	0	0
Te ardhura nga licenca/dhënie lejesh	42,945	43,374	13,012	30,362	101%	1,164	691
Te ardhura nga gjoba/urdhër-zhdëmtime	14,650	72,465	0	72,465	495%	0	0
Te ardhura nga taksa regjistrimi, pulle, ekzekutive dhe tarifa te ndryshme	29,267	14,193	4,258	9,935	48%	0	0
Te ardhura nga shitje dhe veprimtari e drejtpërdrejte	100,579	129,463	116,517	12,946	129%	38,090	23,386
Te tjera	84,280	36,601	10,980	25,621	43%		
Totali	**288,433**	**330,886**	**144,767**	**186,119**	**115%**	**39,254**	**24,077**

Viti 2020

Për auditimin e planifikimit dhe realizimit të fondeve buxhetore u bazuam në Urdhrin nr. 111 date 06.02.2019 të Ministrit ñ*Per ngritjen e Ekipeve te Menaxhimit te Programeve Buxhetore"*, Udhëzimin e Ministrisë së Financës nr. 8 datë 28.02.2019 ñ*Për përgatitjen e PBA 2020-2022*ò.
Projekt buxheti për vitin 2020-2022është hartuar konform legjislacionit përkatëse, në hartimin dhe formulimin e deklaratave të politikave të programeve buxhetore, janë mbajtur në konsideratë kërkesat e strategjive sektoriale e ndër sektoriale dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Financave me relacionin shpjegues, për fazën e parë dërguar me shkresën nr.3485/1 datë 30.04.2019, për fazën e dytë dërguar me shkresën nr. 6193/1, datë 02.09.2019 brenda afatit të përcaktuar.
Kërkesat buxhetore përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimet për hartimin e PBA 2020-2022, si misionin, deklaratat, shpenzimet sipas programeve, artikujve, produkteve, si dhe projektet me financim të brendshëm e të huaj, si dhe raportet e projekteve të investimeve.
Struktura buxhetore për Programin Buxhetor Afatmesëm të këtij institucioni, paraqitet në 7 programe buxhetore gjatë hartimit të PBA për vitet 2020-2022 janë përcaktuar ñPërshkrimiò i çdo program, ñPolitika e programitò, ñQëllimi i Politikës së programitò, ñObjektivat e politikës së programitò. Gjithashtu çdo program ka të përcaktuar produktet e programeve buxhetore, në të dyja fazat e përgatitjes së tij.

Planifikimi i zërave të shpenzimeve për *"fondin e pagave &"sigurimeve shoqërore*ò *(600 &601),* llogaritja e tyre është bazuar në nivelin aktual të punonjësve sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin në fuqi,

Planifikimi i zërave të shpenzimeve për *Shpenzime të tjera korrente (602-606)* llogaritja për programimin e tyre është bërë bazuar në kërkesat e institucioneve të vartësisë së këtij institucioni, limiteve të miratuara nga Ministria e Financave, limiteve të shpenzimeve të periudhave paraardhëse dhe realizimi i pritshëm të vitit 2020 si dhe rishikimi i politikes së programeve dhe planifikimi i shpenzimeve sipas produkteve dhe aktiviteteve

Për vitin 2020, kërkesat buxhetore të paraqitura nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në fazën e parë janë 7,271 milion lekë më shumë se tavani përfundimtar i dërguar nga Ministria e Financës për këtë vit prej **3,946** milion lekë.

Programet e ministrisë që rezultojnë me rritje të theksuar të kërkesave të paraqitura në PBA-në 2020-2022, në raport me limitin e dhënë për shpenzimet e vitit 2020 janë:

1. Menaxhimi i Infrastrukturës së Kullimit dhe Ujitjes

- Investimet me financim të huaj me një rritje në shumën prej 1,461 milion lekë.

Kërkesat shtesë për këtë program kanë të bëjnë me Projektin e Burimeve Ujore dhe Ujitjes, ku parashikohet permirësimi i infrastrukturës së ujitjes në degën e Lushnjes, Cukasis, skema Leminotit në Maliq, Skema e Sllanicës etj. Gjithashtu ne mbrojtjen nga përmbytja parashikohet rreth 20 km argjinaturë mbrojtëse nga përmbytja në segmentet Vjosë, Shkumbin.Osum, Buna etj.

2. Zhvillimi Rural

Kërkesat për vitin 2020 arrin në vlerën totle prej 5,278,202 000 lekë nga ku përkatësisht:

-shpenzime operative në vlerën 109,990,000 lekë

-skema kombëtare në vlerën 2,884,100,000 lekë

-shpenzime kapitale të brendshme nës vlerën 1,890,248,000 lekë

-shpenzime kapitale të huaja në vlerën 393,864,000 lekë

Ne shpenzimet operative janë përfshire edhe shpenzimet e pafinancuara për vitin 2019 për munges fondesh si kadastrat e vreshtit dhe ullirit, ruajtja e racave autoktone etj. Shtesa e skemës kombetare vjen si arsye e pakësimit të fondeve për vitin 2019 ku një nr i konsideruar masash mbetën pa mbështetje si mbjellja e dyfrutoreve, prodhimi organik, ujitja me pika etj. Në shpenzimet kapitale janë përfshore investimet për AZHBR,ESHFF,AKDC si dhe QTTB Fushë Krujë si dhe është planifikuar një prjekt i ri ï Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale në Shqipëri (G.) me vlerë 6,350,000 lekë. Për shpënzimet kapitale janë planifikuar 2 prijekte të reja

3. Mbështetje për Peshkimi

Janë kërkuar në një rritje prej 73 milion lekë në këtë program për, Investime në Bankinat notuese ne Shkodër, Pogradec e Prespë në vlrën 11 milion lekë, Ndërtimi i markatës së Peshkut në portin e peshkimit Vlorë ne vlerën 50 milion lekë si dhe Kontrollet e inpektoriatit të peshkimit të subjekteve që ushtrojnë aktivitet peshkimi dhe akuakulturë ne vlerën 12 milion lekë.

4. Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor

- Investimet të brendshme pajisje për A. dhe QTTB me një rritje në vlerën 63 milion lekë

Prioritetet për vitin 2020 për këtë program janë përmirësimi i njohurive të fermerëve dhe agrobizneseve duke afruar asistence teknike falas, duke ofruar 45 karat dhe paketa teknologjike për adaptimin dhe aplikimin e 63000 fermerev, trajnimin e 225 specialistëve të stafit të A., asisitimin rreth 12,700 fermerevë aplikues për skemat kombëtare hde IPARD etj

5 Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore

NE këtë program ka një rritje në vlerën 20 milion lekë për blerjë paisje komjuterike/laboratorike për sitemin G.. Kjo paisje vjen si nevojë për laboratorin e G.-it në sektorin e Hartografisë dhe Përdorimit të Tokës në QTTB Fushë Kruje, pasi për shkak të ngarkesës së madhe për sekotin ku ponohet me imazhe dhe ortofoto, makineria është amortizuar.

6. Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit

- Reforma në Shërbimin Veterinar (500) në vleren 414 milion lekë.

Domosdoshmëria e rritjes së kufirit të shpenzimeve për këtë program është përqëndruar në (ARSHVMB) Agjencitë Rajonale të Shërbimit Veteriant dhe Mbrotjtja e Bimëve, ISUV Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare si dhe (AKU) Autoriteti Konbëtar i Ushqimit.
7.Planifikim, Menaxhim. Administrim(Aparati i MBZHR) është parashikuar një ritje në Shpenzimet operative në vlerëm 22 milion lekë.
- Për vitin 2020, kërkesat buxhetore të paraqitura nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**në fazën e dytë dhe finale,** pas rishikimit të fazës së 1, duke u mbështetur në tavanet e shpenzimeve të miratuara me VKM nr. 523, per vitin 2020 **janë 3.927** milion lekë më shumë se tavani përfundimtar i dërguar nga Ministria e Financës për këtë vit prej 11.4 milion lekë.
Programet e ministrisë që rezultojnë me rritje të theksuar të kërkesave të paraqitura në PBA-në 2020-2022, në raport me limitin e dhënë për shpenzimet e vitit 2020 programet:
1. Menaxhimi i Infrastrukturës së Kullimit dhe Ujitjes
- Financim i Huaj (IBRD) për projketin e Burimeve Ujore dhe Ujitëse me një rritje në vlerën 1,461 milion lekë.
2. Zhvillimi Rural
- Skema Kombetare me nje rritje ne vlerën 856 milion lekë.
-Shpenzime operative per instutucionet, Panaire si dhe Statistika prej një shtese ne vlerën 31 milion lekë.
-Investime të Huaja si IPARD II, Prjekti Mjedisor AZHBR dhe Protokolli Italian me një shtesë ne vlerën 462 milion lekë.
Në total shtesa e kerkësen për prohramim Zhvillim Rural shkon në 1,998 milion lekë e cila ze dhe peshën me ta madhe.
3. Mbështetje për Peshkimin
-Eshte parashikuar një shtesë në vlerën 12 milion lekë për kontrollet e inspetoriatit të peshkimit të subjektet që ushtrojnë aktivitet peshkimi dhe akuakulturë, shpenzime Personeli si dhe Grumbullimi i të shenave (flotë, yeniet, social-ekonomike, biologjike)
4. Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësor
- Në këtë program ka një rritje në vlerën 20 milion lekë për blerjë paisje komjuterike/laboratorike për sitemin G.. Kjo paisje vjen si nevojë për laboratorin e G.-it në sektorin e Hartografisë dhe Përdorimit të Tokës në QTTB Fushë Kruje, pasi për shkak të ngarkesës së madhe për sekotin ku ponohet me imazhe dhe ortofoto, makineria është amortizuar.
5. Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit
- Reforma në Shërbimin Veterinar (500) në vleren 414 milion lekë
Domosdoshmëria e rritjes së kufirit të shpenzimeve për këtë program është përqëndruar në (ARSHVMB) Agjencitë Rajonale të Shërbimit Veteriant dhe Mbrotjtja e Bimëve, ISUV Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare si dhe (AKU) Autoriteti Konbëtar i Ushqimit.
6.Planifikim, Menaxhim. Administrim(Aparati i MBZHR) është parashikuar një ritje në Shpenzimet operative në vlerëm 22 milion lekë

Me Ligjin nr. 88/2019 ñPër buxhetin e vitit 2020ò, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Ruraljanë planifikuar fonde buxhetore në shumën totale **11,112 milion** lekë, të cilat janë shpërndarë në 7 programe buxhetore. Referuar ligjit nr. 88/2019 ñPër buxhetin e vitit 2020ò dhe akte ligjore e nënligjore, ky buxhet fillestar është ndryshuar duke u ulur për shumën **577,000 mijë** lekë. Plani i buxhetit përfundimtar për vitin 2020 është **10,535 milion** lekë. Ndryshimet janë bërë:
-Me Aktin Normativ nr. 15 datë 15.04.2020 ñ Për disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr. 88/2019 ñ Për buxhetin e vitit 2020ò
-Me Aktin Normativ nr. 28 datë 02.07.2020 ñ Për disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr. 88/2019 ñ Për buxhetin e vitit 2020ò të ndryshuar
-Me Aktin Normativ nr.34 datë 16.12.2020 ñ Për disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr. 88/2019 ñ Për buxhetin e vitit 2020ò të ndryshuar

Për 7 programet e Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural situata në lidhje me ndryshimet në planifikimin e buxhetit gjatë 12 -Mujorit të Vitit 2020, përfshirë këtu buxhetin fillestar, buxhetin me ndryshime gjatë periudhës raportuese të këtij viti, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi programeve	Buxheti fillestar 12-M-2020	Buxheti me ndryshime përfundimtar 12-M-2020	(Buxh me ndryshime) (Buxh. fillestar)
1	Planifikim Menaxhim Administrimi	411,000,000	309,660,000	-101,340,000
2	Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit	1,897,122,000	1,500,813,460	-396,308,540
3	Mbështetje për Peshkimin	966,635,000	245,231,000	-721,404,000
4	Menaxhimi i Infrastrukturës se Kullimit dhe Ujitjes	3,610,800,000	4,332,273,489	+721,473,489
5	Zhvillimi Rural duke Mbështetur Bujqësinë, Blegtorinë dhe Agroindustrine	3,675,443,000	3,683,560,000	+8,117,000
6	Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor	524,000,000	451,505,900	-72,494,100
7	Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore	27,000,000	12,200,000	-14,800,000
Totali		**11,112,000,000**	**10,535,243,849**	**-576,756,151**

Plani fillestar, ndryshimet, plani përfundimtar, dhe realizimi i planit të buxhetit për vitin 2020 sipas artikujve buxhetor, paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Artikulli	Emri	Buxheti Fillestar	Buxheti Përfundimtar	Realizimi në lekë	Realizimi në %
600	Paga	1,563,719,000	1,375,181,382	1,353,328,576	98.4%
601	Sigurime Shoqërore	271,781,000	234,117,770	224,323,773	95.8%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	1,468,480,000	1,272,680,848	1,186,103,242	93.2%
603	Subvencione	0	0	0	-
604	Transferta Korente të Brendshme	0	0	0	-
605	Transferta Korente të Huaja	29,400,000	44,900,000	44,399,882	98.9%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	744,620,000	1,152,215,850	1,151,913,150	100.0%
Nen-Totali	***Shpenzime Korrente***	**4,078,000,000**	**4,079,095,850**	**3,960,068,623**	**97.1%**
230	Kapitale të Patrupëzuara	34,940,000	55,427,222	52,946,700	95.5%
231	Kapitale të Trupëzuara	3,227,060,000	2,890,057,777	2,739,392,407	94.8%
232	Transferta Kapitale	0	0	0	-
Nen -Totali	***Shpenzime Kapitale me financim te brendshëm***	**3,262,000,000**	**2,945,484,999**	**2,792,339,107**	**94.8%**
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	
231	Kapitale të Trupëzuara	3,772,000,000	3,511,163,000	3,288,199,960	93.6%
232	Transferta Kapitale				
Nen -Totali	***Shpenzime Kapitale me financim te huaj***	**3,772,000,000**	**3,511,163,000**	**3,288,199,960**	**93.6%**
Jashtë Buxhetore		0	119,432,000	1,025,000	0.9%
Totali (korrente + kapitale + jashtë buxhetore)		**11,112,000,000**	**10,655,175,849**	**10,041,632,690**	**94.2%**

Në 12- mujorin e vitit 2020, evidenca e realizimit të shpenzimeve të buxhetit sipas secilit program, krahasuar me planin vjetor me ndryshime, *(përfshirë shpenzimet me financim të brendshëm, investimet me financim të huaj)* paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi i Nënprogrameve	Buxheti me ndryshime 12-M-2020	Fakt 12-M-2020	Realizimi në %
1	Planifikim Menaxhim Administrimi	309,660	301,561	97.4
2	Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit	1,500,814	1,375,680	91.7
3	Mbështetje për Peshkimin	245,231	206,518	84.2
4	Menaxhimi i Infrastrukturës se Kullimit dhe Ujitjes	4,332,274	4,226,761	97.6
5	Zhvillimi Rural	3,683,560	3,491,252	94.8
6	Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor	451,506	426,731	94.5
7	Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës	12,200	12,103	99.2

Bujqësore			
Totali	**10,535,245**	**10,040,606**	**95.3**

Nërealiziminsi 12-mujornënivelin 95 %ndajplanit,peshënmëtëmadheezëprogrami buxhetor ñInfrastrukturae ujitjesdhe kullimitò me 41.1 %, pasuar nga programiñZhvillimi Rural"me 34.8%, programiñSiguria Ushqimoreò me 13,7%, programi ñPlanifikim Menaxhim dhe Administrimòme 3 %, programiñKëshillimi dheInformacioni Bujqësorò me 4.3%, programibuxhetorñMbështetjapër Peshkiminò me 2.1%dheprogramiñMenaxhimi ïTokës Bujqësoreòme 0.1 %.
Realizimi i buxhetit të 12 -Mujorit të vitit 2020 për Ministrinë është në masën 95,3 %, të specifikuar sipas kategorive kryesore të shpenzimeve si më poshtë:
LLog. (600&601) realizimet në shpenzimet e personelit që i korespondojnë artikujve 600 dhe 601 paraqiten mesatarisht 98%, përkatësisht 98.4% dhe 93.5%, kjo prej vendeve vakante. Kryesisht këto vakanca janë në AZHBR dhe 4 A.-et.
Llog. (602) Realizimi i art. 602 paraqitet 93.2% dhe kjo nga;
-në programin ñSiguria Ushqimoreò, realizimi ishte 92% dhe kjo kryesisht nga mosrealizimi i zërit ñEmergjenca Veterinareò, pasi gjatë vitit 2020 nuk pati shpërthime të larta epidemiologjike. Ky zë u realizua vetëm 75%.
-në programin ñZhvillimi Ruralò realizimi paraqitet me 88% dhe kjo nga mosrealizimi 100% i produktit ñNjësi vreshti dhe ullishteò, që ndiqet nga QTTB Fushë Krujë është kryer procesi i identifikimit për njësitë e vreshtit dhe ullishtes për vitin 2020, për qarqet e Fierit dhe Beratit, dhe për arësye të procedurave të tenderimit (dy herë anulluar procedura), vetëm në fund të vitit u mundësua rifillimi i punës, gjë që çoi në kalimin e regjistrimit të njësive në vitin 2021
Diferencat e tjera në realizim, vijnë prej procesit të prokurimit ku fitojnë ofertuesit me vlerë më të utët.
Realizimet në shpenzimet e artikullit buxhetorë 605, paraqiten në kufijtë e parashikimit.
Sa i përket artikullit 606òTransferta në buxhetet familjareò, realizimi paraqitet 100% .
LLog. (230&231 Sa i përket investimeve të brendëshme art. 230 paraqitet me 95.5% dhe kjo diferencë e krijuar në prokurim, ndërsa artikulli 231 realizimi me 94.8% dhe ky nivel kryesisht prej;
-në programin ñMbështetje për Peshkiminò realizimi faktik i fondeve rezulton me vlera të ulëta 71%, kjo kryesisht nga mosrealizimi i 36 milion lekët ë projektit VMS (vrojtimi i anijeve të peshkimit) me AKSHI-n pasi kontratat u lidh në fund të vitit dhe nuk u mundësua lëvrimi i fondeve të këtij viti.
-në programin ñSiguria ushqimoreò realizimi rezulton 90%, kjo kryesisht nga mosrealizimi me 60% të bashkëfinancimit për projektin ñBashkefinancim për Dokumenti Sektorial për Sigurinë Ushqimore dhe Veterinarinë (IPA II)ò, kjo për faktin se nga Fondi kombëtar që menaxhohet nga MFE, nuk pati përsëri kërkesa për disbursime, kjo referuar kontrtave të lidhura nga delegacioni KE.
Diferencat e tjera në realizim, vijnë prej procesit të prokurimit
Sa i përket investimeve të huaja artikulli 231 realizimi me 93.6% vjen kryesisht prej programit ñSiguria ushqimoreò ku ndikon mosrealizimi i kontratave në kuadër të projektit ñMonitorimi per vaksinimin e semundjes se terbimit ï IIIò.

Parashikimi dhe realizimi i te ardhurave.
Parashikimi i të ardhurave për sistemin e MBZHR-së është kryer për çdo program buxhetor në aekset e pasqyrave të Projekt Buxheteve të vitit 2020, me klasifikimet përkatëse sipas burimit të krijimit të tyre. Parashikimi është bërë kryesisht duke u bazuar në eksperiencën e krijimit të tyre nga vitet buxhetore paraardhëse.
Realizimi i tyre kundrejt parashikimit vjetor, klasifikimi i realizimit të tyre, për pjesën që i takojnë institucionit dhe derdhjes së tyre në buxhetin e shtetit, si dhë përdorimi i tyre kundrejt limitit të përcaktuar, paraqitet në tabelën e mëposhtme;
Në mijë lekë

Programet Buxhetore	Planifikim (PBA) 2020	Realizimi i te ardhurave nga buxheti i shtetit			Realizimi në (%) kundrejt Planifikimit	Përdorimi	
		Gjithsej	Institucioni	Derdhje ne buxhet		Plan limit	Fakt
Te ardhura nga qerate	44,667	44,363	0	44,363	99.3%	0	0
Te ardhura nga licenca/dhënie lejesh	34,900	103,352	31,006	72,346	296.1%	1,170	924
Te ardhura nga gjoba/urdhër-zhdëmtime	65,605	64,785	0	64,785	98.8%	0	0
Te ardhura nga taksa regjistrimi, pulle, ekzekutive dhe tarifa te ndryshme	32,326	15,559	4,668	10,891	48.1%	0	0
Te ardhura nga shitje dhe veprimtari e drejtpërdrejte	154,395	131,815	118,634	13,182	85.4%	38,730	26,740
Te tjera	34,711	73,134	21,940	51,194	210.7%	0	0
Totali	**366,604**	**433,008**	**176,247**	**256,761**	**118.1%**	**39,900**	**27,664**

Viti 2021

Për auditimin e planifikimit dhe realizimit të fondeve buxhetore u bazuam në Urdhrin nr.310 date 06.08.2021 të Ministrit ñ*Per ngritjen e Ekipeve te Menaxhimit te Programeve Buxhetore*ò, si dhe në Udhëzimit nr. 7 datë 28.02.2018 ñ Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëmò, të Udhëzimi nr. 28 datë 10.07.2020 ñPër Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023ò.

Projekt buxheti për vitin 2021-2023është hartuar konform legjislacionit përkatëse, në hartimin dhe formulimin e deklaratave të politikave të programeve buxhetore, janë mbajtur në konsideratë kërkesat e strategjive sektoriale e ndër sektoriale dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Financave me relacionin shpjegues,

Për fazën e parë, referuar Aktit Normativ nr.17 datë 22.04.2020 miratuar nga Kryeminitri ñ*Për per përjashtimin e zbatimit të procedurave dhe të afateve për përgatitjen e projektdokumentit ë programit buxhetor afatmesëm 2021-2023*ò përjashtohen procedurat dhe afatet duke mos u zbatuar. Për fazën e dytë te PBA është dërguar në MFE me shkresën nr. 6189/2, datë 01.09.2020 brenda afatit të përcaktuar.

Struktura buxhetore për Programin Buxhetor Afatmesëm të këtij institucioni, paraqitet në 7 programe buxhetore. Gjatë hartimit të PBA faza e II për vitet 2021-2023 janë përcaktuar ñPërshkrimiò i çdo program, ñPolitika e programitò, ñQëllimi i Politikës së programitò, ñObjektivat e politikës së programitò. Gjithashtu çdo program ka të përcaktuar produktet programeve buxhetore.

Tavani përfundimtar i miratua me VKM 577, datë 22.07.2020 ñPër miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023, për vitin e parë të saj është 11,518 lekë nga 10,810 milion që është buxheti aktual i vitit 2020.

Sipas artikujve tavanet e parashikuara me VKM nr. 577, datë 22.07.2020 ñPër miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023ò janë:

- Total i Shpenzime korrente 4.5 miliard lekë
- Shpenzime për investime (financim i Brendshëm), 3.4 miliard lekë
- Shpenzime për investime (financim i Huaj), 3.5 miliard lekë

Programet e ministrisë që rezultojnë me rritje të theksuar të kërkesave të paraqitura në PBA-në 2021-2023 ne vlerën 6,996 milion lekë, në raport me limitin e dhënë për shpenzimet e vitit 2021 janë si më poshtë vijon:

1. Menaxhimi i Infrastrukturës së Kullimit dhe Ujitjes me një kërkesë shtesë në vlerën 1,421 milion lekë

- Financim i Huaj për projektin IBRD Ujitja dhe Kullimi në vlerën 358 milion lekë
- TVSH për projektin IBRF ujitja dhe kullimi ne vlerën 205 milion lekë
- Investime të brendshme Ujitje, Kullimi e Mbrotjtje nga Përmbytja në vlerën 831 milion lekrë

Kërkesat shtese per vitin 2021, janë në nivelin e investimeve, me synim prioritar objektet e mbrojtjes nga permbytja, vazhdimin e financimit të objekteve te Bashkive në vlrëm 1 miliard lekë si dhe përfundimi i Projektit të B.B..

2. Zhvillimi Rural me një kërkesë shtesë në vlerën 5,485 milion lekë

- Skema Kombëtare ne vleren 3,154 milion lekë
- Investime të huaja për IPARD II në vlerën 1,704 lekë
- Investime të brendshme për bashkëfinancimin IPARD II në vlerën 627 milion lekë

Skema Kombetare propozohet nga AZHBR në vlerën 4,000,000,000 lekë duke parashikuar për te pasur 9,500 përfitues nga 2,300 që pritet per vitin 2020.

Shpenzimet kapitle të brendshme janë përfshirë kostot e bashkëfinancimit për projektet e huaja operojnë në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural IPARD II

Shpenzimet kapitale të huaja është përfshirë financimi për projekete e huaja qe operojnë ne fushën e bujqësë dhe zhvillimit rural IPARD II dhe projekti G. ñZhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale në Shqipëri.

3. Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit me një shtes kërkese në vlerën 80 milion lekë

-Shpenzime korrente për ISUV teste të akreditimit dhe AKU për akreditimin e laboratorëve.

Për sa më sipër është kërkuar shtes fondi në zërin shpenzime operative për te rritur gamën e analizave që do të kryhen si dhe shtimi i testeve të akreditimit.

4-Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokabe Bujqsore

-Paisje kopjuterike/laboratorike për sistemin G.

Me Ligjin nr. 137/2020 ñPër buxhetin e vitit 2021ò, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Ruraljanë planifikuar fonde buxhetore në shumën totale **12,980,320,000** lekë, të cilat janë shpërndarë në 7 programe buxhetore, për 4 mujorin e parë të viti 2021

Për 7 programet e Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural situata në lidhje me ndryshimet në planifikimin e buxhetit gjatë 4- Mujorit të Vitit 2021, përfshirë këtu buxhetin fillestar, buxhetin me ndryshime gjatë periudhës raportuese të kësaj periudhe, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi programeve	Buxheti fillestar 12-M-2021	Buxheti me ndryshime përfundimtar 4-M-2021	(Buxh me ndryshime) (Buxh. fillestar)
1	Planifikim Menaxhim Administrimi	327,000,000	328,000,000	1,000,000
2	Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit	2,134,099,000	2,136,999,000	2,900,000
3	Mbështetje për Peshkimin	1,047,970,000	1,048,070,000	100,000
4	Menaxhimi i Infrastrukturës se Kullimit dhe Ujitjes	3,893,232,000	3,894,632,000	1,400,000
5	Zhvillimi Rural duke Mbështetur Bujqësinë, Blegtorinë dhe Agroindustrine	4,986,031,000	4,986,631,000	600,000
6	Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor	572,000,000	573,700,000	1,700,000
7	Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore	20,000,000	20,000,000	-
Totali		**12,980,332,000**	**12,988,032,000**	**7,700,000**

Plani fillestar, ndryshimet, plani përfundimtar, dhe realizimi i planit të buxhetit për 4-mujorin e 2021 sipas artikujve buxhetor, paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Artikulli	Emri	Buxheti Fillestar	Buxheti Përfundimtar (4-mujori)	Realizimi në lekë (4-mujori)	Realizimi në %
600	Paga	1,933,600,000	1,933,600,000	542,622,081	28.1%
601	Sigurime Shoqërore	368,639,000	368,639,000	90,096,267	24.4%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	1,237,143,000	1,236,363,000	424,559,069	34.3%
603	Subvencione	0	0	0	0
604	Transferta Korente të Brendshme	0	0	0	0

605	Transferta Korente të Huaja	20,000,000	20,000,000	19,880,391	99.4%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	1,754,857,000	1,763,337,000	1,297,050	0.1%
Nen-Totali	***Shpenzime Korrente***	**5,314,239,000**	**5,321,939,000**	**1,078,454,858**	20.3%
230	Kapitale të Patrupëzuara	30,000,000	30,000,000	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	3,470,000,000	3,470,000,000	716,946,181	20.7%
232	Transferta Kapitale	0	0	0	0
Nen -Totali	***Shpenzime Kapitale me financim te brendshëm***	**3,500,000,000**	**3,500,000,000**	**716,946,181**	20.5%
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	4,166,093,000	4,166,093,000	1,600,388,718	38.4%
232	Transferta Kapitale	0	0	0	0
Nen -Totali	***Shpenzime Kapitale me financim te huaj***	**4,166,093,000**	**4,166,093,000**	**1,600,388,718**	**38.4%**
Jashtë Buxhetore					
Totali (korrente + kapitale + jashtë buxhetore)		**12,980,332,000**	**12,988,032,000**	**3,395,789,757**	**26.1%**

Në 4- mujorin e vitit 2021, evidenca e realizimit të shpenzimeve të buxhetit sipas secilit program, krahasuar me planin 4mujorit për 2021*, (përfshirë shpenzimet me financim të brendshëm, investimet me financim të huaj)* paraqitet si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr.	**Emërtimi i Nënprogrameve**	**Buxheti me ndryshime 4-M-2021**	**Fakt 4-M-2021**	**Realizimi në %**
1	Planifikim Menaxhim Administrimi	328,000	103,804	31.6%
2	Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit	2,136,999	400,687	18.7%
3	Mbështetje për Peshkimin	1,048,070	370,524	35.4%
4	Menaxhimi i Infrastrukturës se Kullimit dhe Ujitjes	3,894,632	1,148,567	29.5%
5	Zhvillimi Rural	4,986,631	1,231,339	24.7%
6	Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor	573,700	140,868	24.6%
7	Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës Bujqësore	20,000	0	0
Totali		**12,988,032**	**3,395,790**	**26.1%**

Në realizimin e 4-mujor në nivelin 26.1% ndaj planit,peshën më të madhe e zë programi buxhetor ñMbeshtetja per Peshkimò me 35.4 %, pasuar nga programi ñPalnifikim,Menaxhim,Administrim"me 31.6 %, programi ñMenaxhimi i Infrastruktures se Kullimit dhe Ujitjesò me 29.5%, programi ñZhvillimi Ruralòme 24.7 %, programi ñKeshillimi dhe Informacioni Bujqesorò me 24.6%, programi ñSiguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatoritòme 18.7 %, programibuxhetorñMenaxhimi i Qendrueshem i Tokes Bujqesoreò me 0%.

Parashikimi dhe realizimi i te ardhurave

Parashikimi i të ardhurave për sistemin e MBZHR-së është kryer për çdo program buxhetor në Anekset e pasqyrave të Projekt Buxheteve të vitit 2021, me klasifikimet përkatëse sipas burimit të krijimit të tyre. Parashikimi është bërë kryesisht duke u bazuar në eksperiencën e krijimit të tyre nga vitet buxhetore paraardhëse.

Realizimi i tyre kundrejt parashikimit vjetor, klasifikimi i realizimit të tyre, për pjesën që i takojnë institucionit dhe derdhjes së tyre në buxhetin e shtetit, si dhe përdorimi i tyre kundrejt limitit të përcaktuar për 4-mujorin e parë të vitit 2021, paraqitet në tabelën e mëposhtme;

Në mijë lekë

Programet Buxhetore	**Planifikim (PBA)**	**Realizimi i te ardhurave nga buxheti i shtetit 4-M-2021**			**Realizimi në (%) kundrejt Planifikimit**	**Përdorimi**	
		Gjithsej	**Institucioni**	**Derdhje ne buxhet**		**Plan limit**	**Fakt**
Te ardhura nga qerate	44,683	12,043	0	12,043	27%	0	0
Te ardhura nga licenca/dhënie lejesh	113,000	38,403	11,520	26,883	34%	0	0
Te ardhura nga gjoba/urdhër-	66,087	10,794	0	10,794	16%	0	0

zhdëmtime							
Te ardhura nga taksa regjistrimi, pulle, ekzekutive dhe tarifa te ndryshme	17,211	4,340	1,300	3,040	25%	0	0
Te ardhura nga shitje dhe veprimtari e drejtpërdrejte	136,347	12,722	11,472	1,250	9%	31,150	4,203
Te tjera	79,871	0	0	0	0	0	0
Totali	**457,199**	**78,302**	**24,292**	**54,010**	**17%**	**31,150**	**4,203**

Nga MBZHR janë paraqitur vetëm observacion mbi Akt konstatimin nr.1, datë 30.07.2021, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 30.07.2021, ndërsa për projektraportin nuk u paraqitën, për rrjedhojë qëndrimi i grupit të auditimit mbetet i njëjtë.
Pretendimi i subjektit: "*Nuk kuptojmë ku qëndrojnë përgjegjësitë e veprimeve dhe mosveprimit nga Sekretari I Përgjitshmëm, Drejtori I Drejtorisë se Buxhetimit dhe Menaxhimit Financiar dhe Përgjegjesit se sektorit të Finances"*
Qëndrimi i Grupit të Auditimit:
Në cilësinë e nëpunësit autorizues, nëpunesit zbatues dhe pergjegjësit të hartimit të PBA, referuar materialit të trajtuar nga grupi i auditimit, janë përendur personat përgjegjes për veprimet e kryera.

3.2. ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE PËR MARRËDHËNIET E PUNËS DHE PAGAVE:

a. Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin.
b**.** Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve.

Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave:
a. Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin.
b**.** Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve.
u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
Baza ligjore
-Kodi Procedurës Civile
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 ñKodi i punës i Republikës së Shqipërisëò
-Ligji nr.152/2013, ñPër Nëpunësin Civilò i ndryshuar
- Ligji nr.90/2012, ñPër organizimin dhe funksionimin e administratës shtetëroreò
- Ligji nr.9584, datë 17.07.2006 ñPër pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligjò
- Ligji nr.187, datë8.3.2017 ñpër miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektitò, I ndryshuar;
- VKM nr. 893, datë 17.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëmò
- VKM nr.512, datë 13.09.2017 ñPërpërcaktiminefushëssëpërgjegjësisështetërorenë MZHBRò
-VKM Nr.117, datë 05.03.2014, ñPërpërmbajtjen,procedurëndheadministrimin e dosjeve të personelitetëregjistritqendrortëpersonelitò
- Urdhërit të Kryeministrit nr.150, datë 05.11.2020 ñPër miratimin e strukturës dhe organikës së MZHBRò

Grupi i audituesve të KLSH-së, për të realizuar objektin e auditimit, në lidhje mbi auditimin Për zbatimin e dispozitave ligjorepër marrëdhëniet e punës dhe pagave, drejtimi nr.2 i Programit të mësipërm duke u fokusuar, në përputhshmërinë e akteve ligjore dhe nënligjore përçështjet si vijon:
a) Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin.
b) Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve.

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë

1. Rregullorja e brendshme dhe urdhrat për organizimin dhe funksionimin

2. Urdhrat e Kryeministrit për miratimin e struktures dhe organikes për periudhen objekt auditimit

3. Struktura Organizative e Ministrisë së Brendshme dhe numri i punonjësve

4. Listepagesa, Urdher Shpenzime të pagave

5. Planet e nevojave për rekrutim, Dosje të personelit të punësuar

6. Databaza e vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna

7. Informacionmbi punonjës të larguar nga puna gjatë periudhës 2019, 2020 deri në fund të muajit mars të vitit 2021 të cilët kanë ngritur padi.

8. Veprimtaria e komisionit disiplinor

a)Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin

Nga auditimi në lidhje mbi respektimin e strukturave në MBZHR për periudhën 01.01.2019 deri më 30.03.201, u konstatua se, aparati i Ministrisë së Bujqësisë ka pësuar ndryshime në strukturë dhe organikë, në bazë të:

(1) Urdhërit të Kryeministritnr.109, datë 31.07.2018 ñ*Për disa ndryshime në urdhërin nr.168 datë 05.10.2017 të kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe organikës sëMZHBR*ò me numër total të strukturës plan 163 punonjës, ndërsa fakti në fillim të vitit 2019 rezultoi me 136 punonjës, me diferencë prej 27 vende vakande, nga të cilat 16 vënde për nëpunës civil dhe 11 vënde per punonjes qe rekrutohen ose qe rregullohen mardheniet e punes me Kod Pune .Deri në fund të vitit 2020, numri i vakancave ka pësuar ulje në 17 vënde vakante nga të cilat 9 vënde për nëpunës civil dhe 8 vënde me kod pune. Në zbatim të Urdhërit të Kryeministritnr.109, datë 31.07.2018, Ministri i MBZHR, ka miratuar urdhërin me nr.324/1 datë 25.09.2018 ñPër miratimin rregullores së strukturës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Ruralò

(2) Urdhërit të Kryeministrit nr.150, datë 05.11.2020 ñ*Për miratimin e strukturës dhe organikës së MZHBR*ò numri total i strukturës plan u bë 174 punonjës. Ky ndryshim strukturë është kërkuar nga Ministri i MBZHR në bazë të Relacionit me shkresë nr. 7892/1, datë 06.10.2020, ku qëllimi ka të bëjë me:

- Ndryshimet e propozuara janë të diktuara nga zhvillimet e fundit të vendit, lidhur me negociatat për integrimin evropian, ku Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kontribuon për përmbushjen e misionit të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, për krijimin dhe zbatimin e planit të veprimit lidhur me politikat integruese, për përafrimin e legjislacionit vendas në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, me normat dhe kërkesat e Bashkimit Evropian, me qëllim arritjen e objektivit kryesor të integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian nëpërmjet zbatimit të politikave prioritare dhe ka një peshë të konsiderueshme në rolin e ministrisë lider për tre kapitujt e Planit Kombëtar të Integrimit Evropian. Në fazën e përfundimit të fazës së parë të procesit të shqyrtimit analitik të legjislacionit, MBZHR duhet të angazhohet për përafrimin e legjislacionit sipas kapitujve përkatës dhe fushave të mbulimit të tyre.
- Komisioni Evropian në Progres Raportet për Shqipërinë, ka sugjeruar në mënyrë të vazhdueshme krijimin e një strukture të veçantë, përgjegjëse për Kapitullin 13 ñPeshkimiò Krijimi dhe organizimi i kësaj drejtorie vjen si nevojë e mbarëvajtjes dhe funksionimit më të mirë të sektorëve brenda një drejtorie me qëllim të ndarjes së detyrave dhe përgjegjësive sipas fushave konkrete të veprimtarisë si dhe në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Peshkimit të miratuar me VKM nr. 701, datë 12.10.2016 ñPër miratimin e strategjisë kombëtare të peshkimit 2016-2021ò dhe rekomandimet e fundit të KLSH-së.

(3) Urdhërit të Kryeministrit nr.162, datë 14.12.2020 ñ*Për disa ndryshime në urdhërin nr.150 të kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe organikës sëMZHBR*ò, ku nuk kemi ndryshim të numrit total të strukturës plan 174 punonjës, por kemi vetëm ndryshime në emërtimin e disa sektorëve, konkretisht;

-në ñDrejtorinë e Politikave dhe Programeve të Bujqësisëdhe Zhvillimit Ruralò ñSektori i politikave të bujqësisë dhe zhvillimit ruralò u emërua ñSektori i politikave të bujqesisë, zhvillimit rural dhe skemave të cilësisëò.
-në ñDrejtorinë e Politikave dhe Programeve të Bujqësisëdhe Zhvillimit Ruralò ñSektori i skemave të cilësisë dhe prodhimit organikò u emërua ñSektori i prodhimit organik dhe standarteve të tregtimit të produkteve bujqësore dhe blektoraleò
Gjithashtu, sipas Urdhërit nr.39 të Ministrit të MBZHR-së, datë 22.01.2021, në zbatim të urdhërit nr.150 të Kryeministrit, datë 09.11.2020 ñ*Për miratimin e strukturës dhe organikës sëMBZHR*ò është miratuar struktura plan e MBZHR-së, me numër total plan 174 punonjës në aparatin e MBZHR-së.
Kjo është edhe struktura plan që ka Aparati i MBZHR-së deri më datën 31.03.2021.

Nga auditimi u konstatua se pas ristrukturimit sipas Urdhërit nr.39 të Ministrit të MBZHR-së, datë 22.01.2021, në zbatim të urdhërit nr.150 të Kryeministrit, datë 09.11.2020 ñ*Për miratimin e strukturës dhe organikës sëMBZHR*ò, struktura fakt e aparatit të MBZHR-së, paraqitet si më poshrë;
-në muajin janar të vitit 2021, fakt 143 punonjës, duke rezultuar 31 vënde vakante, nga të cilat 24 vënde për nëpunësit civil dhe 7 vënde me Kod Pune.
-shkurt të vitit 2021, fakt 143 punonjës, duke rezultuar 31 vënde vakante, nga të cilat 24 vënde për nëpunësit civil dhe 7 vënde me Kod Pune.
-mars të vitit 2021, fakt 142 punonjës, duke rezultuar 32 vënde vakante, nga të cilat 26 vënde për nëpunësit civil dhe 6 vënde me Kod Pune.
Nga auditimi u konstatua se, për ndryshimet e strukturës dhe organikës së MBZHR, është kërkuar dakortësia pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Departamentit të Adminstratës Publike **me shkresë nr.7892/1 prot, datë 06.10.2020.**

Gjithashtu nga auditimi u konstatua se, në zbatim të urdhërit nr.150 të Kryeministrit, datë 09.11.2020 ñ*Për miratimin e strukturës dhe organikës sëMBZHR*ò, nga titullari Ministri I MBZHR, është miratuar me shkresë nr.4276 prot datë 02.06.2021 ñRregullore për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Ruralò , fakt që tregon se për disa muaj të vitit 2021, institucioni ka funksionuar me Rregullorën e mëparshme miratuar me shkresë nr.324/1 datë 25.09.2018 ñPër miratimin rregullores së strukturës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Ruralò, kjo në kundërshtim me ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò i ndryshuar neni 20 dhe meUrdhërin nr.150 të Kryeministrit, datë 09.11.2020 ñ*Për miratimin e strukturës dhe organikës së MBZHR*ò.
Pra sa më sipër, ndonëse kemi rritje të numrit në plan të punonjësve të aparatit të MBZHR, kemi vakanca gati prej 20% të pozicioneve të vendeve të punës, të cilat konsistojnë më shumë në nivel specialist, i cili është tregues jo pozitiv për funksionimin me kapacitet të plotë të MBZHR, për pasojë mund të sjellë performancë të dobët të institucionit në realizimin e objektivave në lidhje me faktin që sistemi bujqësor dhe zhvillimi rural, mbetet një nga sektorët me potencialin më të madh të zhvillimit në Shqipëri.
Vlen të përmëndet që nga ana e Sektorit të Burimeve Njerzore të MBZHR-së janë bërë shpallje për plotësimin e vakancave si në sistemin e HRMIS (Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore) për të kaluar më pas në sistemin online të rekrutimit, në platformën administrata.al. Por gjithashttuvlen të theksohet se nuk është gjetur një bashkëpunim institucional me Departamentin e Administratës Publike dhe mekanizmat e nevojshëm për zgjidhjen e këtij problem.
Pra është përgjegjësi e strukturave përgjegjëse të aparatit të MBZHR-së për gjetjen e mekanizmave të nëvojshëm për rekrutimin dhe plotësimin e këtyre vakancave.

Ristrukturimet në Strukturat e varësisë në MBZHR

Nga auditimi u konstatua se, gjatë periudhën nën auditim 2019-2020, kanë pësuar ristrukturime dhe strukturat e varësisë në MBZHR, si vijon:

Sipas strukturave të MBZHR-së dhe bazuar në numrin e punonjësve buxhetore të miratuar me Ligjin nr. 99/2018, datë 03.12.2018 ñPër Buxhetin e vitit 2019ò, numri total i punonjësve të MBZHR-së dhe strukturave të saj të varësisë, në janar 2019 ishte 1915 punonjës.

Gjatë vitit 2019 ka pasur ndryshim n*ë* strukturën e AZHBR-së, me Urdhërin nr.156, datë 18.11.2019 për disa ndryshime në urdhërin nr.140 datë 17.09.2018 të Kryeministrit *"Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjensisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural"* ku struktura e ndryshuar është shoqeruar me një shtese prej 14 punonjësish e reflektuar kjo shtesë edhe në tabelen e numrit te punonjesve, ndryshuar me Akt Normativ nr. 11 i Këshillit të Ministrave, datë 24.12.2019, per ñrishikimin e buxhetit te vitit 2019ò. Pra numri total i punonjesve buxhetore per MBZHR shkoi nga 1915 ne 1929 punonjes.

Argumentet e shteses jane; në zbatim të Ligjit nr. 37, datë 09.04.2015, ñPër ratifikimin e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, mbi zbatimin e Programit IPARD II (2014-2020), të Ligjit nr. 30, datë 17.03.2016 ñPër ratifikimin e Marrëveshjes Sektoriale ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, që përcakton dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të asistencës financiare të BE-së, për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit, në fushën ñBujqësia dhe Zhvillimi Ruralò (IPARD), të rekomandimeve të Dg-Agri, si dhe mbështetur në Vendimin nr. 893, datë 17.12.2014, të Këshillit të Ministrave ñPër miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëmò, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 322, datë 31.05.2018, ñPër disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 719, datë 31.10.2014ò, të urdhrit të Kryeministrit nr. 140, datë 17.09.2018, ñPër miratimin e Strukturës dhe Organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Ruralò (Agjencia e Pagesave), në urdhrin nr. 20, datë 19.01.2018, të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ñPër krijimin e Sporteleve Unike të Shërbimeve për fermerët- Agropikaò, është këkuar miratimi i disa ndryshimeve në strukturën e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Agjencia e Pagesave).

- Relacioni mbi këtë ristrukturim, shkresa nr. 7525/1 prot, datë 02.10.2019, u është dërguar për miratim edhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe Departamentit të Administratës Publike

Ne vitin 2020, struktura e MBZHR-së, (Aparati së bashku me strukrurat e varësisë), pas ristrukturimit të bërë në strukturën e AZHBR-së (Agjensia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural), e cila ishte 1929 punonjës, bazuar në Ligjin nr. 88, date 18.12.2019 ñPer Buxhetin e vitit 2020ò, numri total i punonjësve të MBZHR-së referuar PBA-së të vitit 2020-2022, u bë 1952 punonjës. Pra pati një shtesë prej, 23 punonjësish, shtesë kjo në zbatim të VKM nr. 537, datë 25.07.2019 ñPër mënyren e organizimit dhe të fumksionimit të Laboratorëve të diagnostikimit të parazitëve të Departamentit të Mbrojtjes së Bimëveò, e cila efektet financiare per fuksionimin e ketij Departamentei i kishte te parashikuara ne janar 2020.

Gjthashtu gjatë vitit 2020 janë bërë edhe ridtrukturime në struktura varësie të MBZHR-së shtjelluar si më poshtë

- Ristrukturimi i AKU (Autoriteti Kombëtar i Ushqimit), sipas Urdhërit të Kryeministrit nr.128 datë 26.10.2020, duke shtuar 15 punonjes.

- Relacioni mbi këtë ristrukturim, shkresa nr. 6258/1 prot, datë 15.08.2020 u është dërguar për miratim edhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe Departamentit të Administratës Publike.

- U mundesua krijimi i AKVMB (Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe 4 rajonet e saj sipas Urdhërit të Kryeministrit nr.165 datë 16.12.2020, reformim ky bazuar Ligjit të Shërbimit Veterinar në Republikën e Shqipërisë nr. 71/2020 ñPër disa ndryshime

dhe shtesa në Ligjin nr. 10465, datë 29.9.20011 ñPër Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisëò, të ndryshuar, duke shtuar 430 punonjes.
- Relacioni mbi këtë ristrukturim, shkresa nr. 8050 prot, datë 12.10.2020 u është dërguar për miratim edhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe Departamentit të Administratës Publike.

➢ U Ristrukturua AZHBR (Agjensia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural) sipas Urdhërit te Kryeministrit nr.143, dt.3.11.2020 duke shtuar 20 punonjes.
- Relacioni mbi këtë ristrukturim, shkresa nr. 4474 prot, datë 17.06.2020 u është dërguar për miratim edhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe Departamentit të Administratës Publike

Pra deri në fund të vitit 2020 në strukturën e MBZHR-së, (Aparati së bashku me strukrurat e varësisë), nga 1929 punonjës që pati në fillim të vitit 2020 u shtua me:
23 punonjës, në zbatim të VKM nr. 537, datë 25.07.2019 ñPër mënyren e organizimit dhe të fumksionimit të Laboratorëve të diagnostikimit të parazitëve të Departamentit të Mbrojtjes së Bimëveò dhe që u parashikuan në PBA-ë e vitit 2020-2022 dhe përkatësisht ka patur një shtesë;
-prej 11 punonjësish, në aparatit të MBZHR-së, i cili nga 163 u bë 174 punonjës, sipas Urdhërit të Kryeministrit nr.150, datë 9.11.2020,
-prej 6 punonjës në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) Sipas Urdhërit të Kryeministrit nr.126 dhe,
-prej 6 punonjës për Drejtorinë e Shërbimeve të Peshkimit dhe të Akuakulturës (DSHPA), sipas Urdhërit të Kryeministri nr.95, datë 17.07.2020.
Gjithashtu pati edhe një shtesë;
-prej 15 punonjësish, në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit (AKU), i cili nga 418 u bë 433 punonjës, sipas Urdhërit të Kryeministrit nr.128 datë 26.10.2020,
-prej 20 punonjësish, në Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, (AZHBR), i cili nga 183 u bë 203 punonjës, sipas Urdhërit të Kryeministrit nr.128 datë 26.10.2020,
- krijimi i Autoritetin Kombëtar i Veterinarisaë dhe mbrojtjes së Bimëve (AKVMB), me efekt një shtesë në numërin total të punonjësve prej 430 punonjës, sipas Urdhërit të Kryeministrit nr.165 datë 16.12.2020.
Sa më sipër gjatë vitit 2020, si pasojë e ristrukturimeve pati një shtesë prej 488 punonjës duke shkuar nga 1929 punonjës që kishte struktura e MBZHRsë në fillim të vitit 2020 në 2417 punonjësqë, struktura plan e MBZHR-së e cila është edhe struktura plan deri në fund të periudhës së auditimit;

Planifikimi Rekrutimeve në MBZHR

Në zbatim të nenit 18, Kreu II, të Ligjit nr. 152/2013 ñPër nëpunësin civilò, i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 108, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave ñPër planin vjetor të pranimit në shërbimin civilò, përgatitet plani vjetor i pranimit në shërbimin civil për pozicionet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm, si dhe për pozicionet e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues.
Nga auditimi u konstatua se MBZHR ka bërë planifikimin e rekrutimit për vitin 2019, ku me shkresën nr. 10773/12, datë 20.12.2018, lënda ñKthim përgjigje suajës nr. 8264/3, datë 20.11.2018ò, MBZHR ka dërguar në Departamentin e Administratës Publike ñPlanin e nevojave për rekrutim **për vitin 2019**ò
Planifikimi dhe nevojat e MBZHR-së për vitin 2019 ishin kanë qenë për 12 punonjës në shërbimin civil dhe realizimika qenë për 14 punonjës.
Gjithashtu me shkresën nr. 29, datë 6.1.2020 ñMbi planifikimin e nevojave për pranim për vitin 2020 për MBZHR dhe institucionet e varësisëò, MBZHR ka dërguar në departamentin e Administratës Publike ñPlanin e nevojave për rekrutim për vitin 2020ò
Planifikimi dhe nevojat e MBZHR-së për vitin 2019 kanë qenë për 20 punonjës në shërbimin civil ndërsa realizimi ka qenë për 15 punonjës.

Dosjet e Personelit

-Gjatë auditimit u konstatua se, për nëpunësit e MBZHR zbatohen procedurat e legjislacionit për nëpunësin civil parashikuar për institucionet e administratës shtetërore. Nga auditimi me

përzgjedhje i dosjeve të personelit rezultoi se ato administrohen të inventarizuara në zbatim të VKM nr. 117, datë 05.03.2014 ñPër përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelitò.
U audituan gjithsej 19 dosje personale të punonjësve të MBZHR-së nga të cilat:
- 7 dosje personale të nëpunësve të rekrutuar sipas Ligjit nr. 152/2013 ñPër nëpunësin civilò, i ndryshuar;
- 3 dosje personale të nëpunësve të punësuar në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë;
- 3 dosje personale të studentëve të ekselencës, të punësuar sipas VKM nr. 766, datë 26.12.2018 ñPër punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil, për vitin 2019ò dhe VKM Nr. 586, datë 30.8.2019 ñPër punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetëroreò;
- 2 dosje personale të punonjësve mbështetës, të punësuar sipas Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, ñKodi i Punës i Republikës së Shqipërisëò, i ndryshuar;
- 2 dosje personale të punonjësve me kontratë të përkoshme (6 orë/ditë), të punësuar sipas VKM Nr. 47, datë 22.1.2020, ñPër përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2020, në njësitë e qeverisjes qendroreò dhe VKM Nr. 1151, datë 24.12.2020, ñPër përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2021, në njësitë e qeverisjes qendroreò;
- 1 dosje personale Drejtor i përgjithshëm;
- 1 dosje personale Drejtor Drejtorie;

Nga auditimi i këtyre dosjeve të personelit u konstatua se, janë plotësuar në zbatim të VKM nr. 117, datë 05.03.2014, ñ*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit*. Në dosjen teknike të nëpunësit janë përfshirë : LIDHJA NR 1. *"Fletëinventari me listën e gjithë dokumentacionit që ndodhet në dosje dhe* LIDHJA NR 2. *"Të dhënat që duhet të përmbajë fleta prezantuese e dosjes teknike të nëpunësit 1. Numri i identifikimit të nëpunësit civil; 2. Emri, atësia, mbiemri; 3. Numri kombëtar i identifikimit;4. Shtetësia; 5. Gjinia; 6. Datëlindja; 7. Gjendja civile; 8. Përbërja familjare; 9. Adresa e vendbanimit të përhershëm; 10. Adresa e vendbanimit të përkohshëm; 11. Arsimimi; 12. Diploma; 13. Kualifikimi (llojet); 14. Gradë shkencore (titulli); 15. Njohuri gjuhe të huaj; 16. Data e fillimit të punës në pozicionin përkatës;"17. Trajnimet e ndryshme pranë DAP, nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA).*

b) Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve.

Në tabelën e mëposhtëme janë pasqyruar celja e fondit të pagave, shpenzimet operative,fondi pagave plan dhe pondi pagave fakt për vitin 2019

Nr	Viti 2019 Emertimi	Çelja	Shkresa nr. dt	Shpenzime Operative		Plan	Fakt	%
				+	-			
1	Paga	260,100,000	Nr. 24/2, dt 8.01.2019 e MBZHR	50,000,000(kaluar ne 602 për Vendime GJyqësore)	100,000,000	160,100,000	156,637,810	97.8%
	Shtese fondi paga efekt i rritjes pagave (600)	0	-	-	0	0		
2	Sigurime Shoqërore Shëndetësor(601)	51,900,000	Nr. 24/2, dt 8.01.2019 e		20,000,000	31,900,000	24,859,449	77.9%

			MBZHR					
	Totali	**312,000,000**	**0**	**50,000,000**	**120,000,000**	**192,000,000**	**181,497,259**	**94.5%**

Shënim: Të dhënat janë disponuar nga Sektori i Financës në MBZHR

Në tabelën e mëposhtëme janë pasqyruar celja e fondit të pagave, shpenzimet operative,fondi pagave plan dhe pondi pagave fakt për vitin 2020

Nr	**Viti 2020 Emertimi**	**Çelja**	**Shkresa nr. dt**	**Shpenzime Operative**		**Plan**	**Fakt**	**%**
				+	**-**			
1	Paga	260,100,000	Nr.312, dt 15.01.2020 e MBZHR	45,000,000(kaluar ne 602 për Vendime GJyqësore)	105,000,000	155,100,000	154,973,458	99.9%
	Shtese fondi paga efekt i rritjes pagave (600)	0	-	-	0	0		
2	Sigurime Shoqërore Shëndetësor(601)	51,900,000	Nr.312, dt 15.01.2020 e MBZHR	12000000	26,800,000	25,100,000	25,022,715	99.7%
	Totali	**312,000,000**	**0**	**57,000,000**	**131,800,000**	**180,200,000**	**179,996,173**	**99.9%**

Shënim: Të dhënat janë disponuar nga Sektori i Financës në MBZHR

Në tabelën e mëposhtëme janë pasqyruar celja e fondit të pagave, shpenzimet operative,fondi pagave plan dhe pondi pagave fakt për vitin katër mujorin e parë të vitit 2021

Nr	**Viti 2021 Emertimi**	**Çelja**	**Shkresa nr. dt**	**Shpenzime Operative**		**Plan**	**Fakt**	**%**
				+	**-**			
1	Paga	214,200,000	Nr.982, dt 26.01.2020 e MBZHR			214,200,000	53,097,533	24.8%
	Shtese fondi paga efekt i rritjes pagave (600)	0	-			0		
2	Sigurime Shoqërore Shëndetësor(601)	35,800,000	Nr.982, dt 26.01.2020 e MBZHR			35,800,000	8,691,795	24.3%
	Totali	**250,000,000**	**0**	**0**	**0**	**250,000,000**	**61,789,328**	**24.7%**

Shënim: Të dhënat janë disponuar nga Sektori i Financës në MBZHR.

Nga auditimi u konstatua se se në tabelat e mësipërme pasqyrohen treguesit e realizimit të fondit të pagave për periudhat raportuese 2019-2020 ku rezulton se për vitin 2019, realizimi është 94.5% ndërsa për vitin 2020 është 99.9%.
Nga auditimi u konstatua se pakësimi i fondit të pagave me 50,000,000 lekë për vitin 2019 ka ardhur si pasojë e transferimit në artikullin 602 për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, diferencë e krijuar nga vëndet vakante. Ndërsa 50,000,000 të tjera pakësuar me akt normativ të ministris së financës ñpër rishikimin e buxhetit të shtetit për vitin 2019ò
Gjthashtu pakësimi i fondit të pagave me 45,000,000 lekë për vitin 2020 ka ardhur si pasojë e transferimit në artikullin 602 për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, diferencë e krijuar nga vëndet vakante. Ndërsa 65,000,000 të tjera pakësuar me akt normativ të ministris së financës ñpër rishikimin e buxhetit të shtetit për vitin 2020ò
-Krahasimi përmbledhëses i listëpagesave me shumat e urdhër shpenzimit e pagesa e kryer.
U bë krahasimi përmbledhëses i listë pagesave me likuidimet, ndërsa nuk u konstatuan pasaktësi në shpenzimet për paga e sigurime. Pagesat janë shoqëruar me dokumentacionin mbështetës listë-prezencat, urdhër-shpenzimet për paga dhe urdhra të veçantë të titullarit të nënshkruara nga nënpunësi urdhërues, zbatues (Përgjegjësi i financës dhe buxhetit) të nënshkruara edhe nga Dega e Thesarit .
-Respektimi i dispozitave ligjore për përcaktimin e nivelit të pagave, hapja dhe azhornimi periodik i rregjistrit të punëmarrësve (libri i pagave).
Niveli i pagave është përcaktuar në zbatim të VKM nr. 187, datë 08.03.2017 ñ*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunsve civilë/nëpunësve, zëvendës ministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qëndror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura , institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit*ò, lidhja 1 ñ*Struktura e pagave për nëpunësit civilë/nëpunësit në të gjitha institucionet pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi*ò
Nga auditimi me përzgjedhje rastësore i listëpagesave për periudhat raportuese (3/mujori IV-të 2019; 3/mujori I-të 2020) u verifikua niveli pagave për çdo punonjës, arsimimi sipas diplomës, vjetërsia në punë me librezën e secilit, ndërsa nuk u konstatuan mospërputhje të nivelit të diplomës me kategorinë e vendit të punës dhe funksionit sipas emërimit. Për rrjedhoje rezultoi se ato janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM nr. 545, datë 11.08.2011 i ndryshuar. Përllogaritjet e kontributit sigurime shoqërore e shëndetësore përballuar nga punëmarrësi dhe ato nga punëdhënësi, deklarimet, ndalesat si dhe derdhjet e tyre janë bërë në përputhje me ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 ñPër sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, ligjin nr. 7770, datë 13.10.1994 ñPër sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar dhe ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 ñPër tatimin mbi të ardhuratò i ndryshuar. Listë pagesat janë përpiluar me gjithë elementet përbërës, sipas listë prezencave dhe shumat e tyre janë të rakorduara. Vendosja e pagave e shtesave mbi pagë janë bërë me klasën përkatëse për çdo kategori dhe ndalesat janë përllogaritur në përputhje me dispozitat ligjore për kontributet e sigurimeve dhe tatimi mbi të ardhurat, sipas pasqyrës së realizimit të buxhetit.
Për përdorimin e fondit të pagave, sigurime shoqërore e shëndetësore është respektuar legjislacionin përkatës ligji nr. 9136, datë 11.09.2013 ñPër mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, UMF nr. 26, datë 16.04.2009 ñPër mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësoreò i ndryshuar dhe ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 ñPër tatimin mbi të ardhuratò i ndryshuar janë bërë llogaritjet dhe ndalesat për tatimin mbi të ardhurat si dhe derdhjet e tyre në favor të tatimeve.
Nuk është kryer asnjë pagesë për ndihmë ekonomike dhe nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve në strukturën organizative. Është mbajtur libër për pagat e punonjësve, dhe janë hedhur pagesat e kryera për secilin punonjës për periudhën të përcaktuara nga emërimi, fillimi marrëdhënieve të punës dhe të rakorduar me listë pagesat.
<u>Fondi Veçantë</u>

Për periudhën objekt auditimi, Ministria e Bujqësisë (Drejtoria e Buxhetimit dhe Menaxhimit Financiar) në zbatim te VKM Nr.929, datë 17.11.2010 ñ Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantëòô ka planifikuar (krijuar) dhe realizuar fondin e veçantë, si më poshtë:

Në tabelën e mposhtëme pasqyrohet planifikimi dhe përdorimi i Fondit të Veçantë

(në lekë)

Nr	Viti buxhetor	Fondi i pagave i planifikuar	Fondi i vecante I planifikuar deri 5%)	Fondit i vecante i Realizuar
1	2019	160,100,000	550,000	1,259,590
2	2020	155,100,000	800,000	1,495,203
3	3 mujori i pare i vitit 2021	214,200,000	1,000,000	135,000

Shënim: Të dhënat janë disponuar nga Sektori i Financës në MBZHR.

Nga auditimi në lidhje me destinacionin e përdorimit të fondit të veçante në respektim të përcaktimeve të VKM Nr.929, datë 17.11.2010 u konstatua:
Gjate periudhës objekt auditimi fondi veçantë është përdorur në këto destinacione:

(në lekë)

Nr rendor	Vitet	Ndarja sipas natyres se perfitimit			Totali(në lekë)
		Rimbursim karburanti per Zv Ministrat(në lekë)	Ndihma per dalje ne pension pleqerie (në lekë)	Ndihma ne raste fatkeqesie, Semundje ose vdekje(në lekë)	
1	2019	561,750	397,840	300,000	1,259,590
2	2020	540,000	365,203	590,000	1,495,203
3	Deri 30.03.2021	135,000			135,000
Shuma 2019-2021		**1,236,750**	**763,043**	**890,000**	**2,889,793**

Shënim: Të dhënat janë disponuar nga Sektori i Financës në MBZHR.

Siç tregohet në tabelë, pjesën më të madhe të përdorimit të fondit të veçante e ka zënë vlera e shpenzimeve të karburantit të paguara për zëvendësministrat të cilët përfitojnë këto pagesa, nga Ligji nr. 10 160, datë 15.10.2009 óõPër rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilëò. Konkretisht:
-Për vitin 2019, fondi i veçantë është përdorur në vlerën 561,750, 000 lekë ose 45% e fondit te veçante të realizuar për vitin 2019.
-Për vitin 2020 fondi i veçantë është përdorur në vlerën 540,000 lekë ose 36% e fondit te veçante të realizuar për vitin 2020.
-Për 3mujorin e parë të vitit 2021 fondi i veçante është përdorur në vlerën 135,000 lekë ose 100% e fondit te veçante të realizuar për tre mujorin e parë të vitit 2021.
Këto shpenzime janë kryer, në zbatim të nenit të 1 i Ligjit nr. 10160, datë 15.10.2009 óõPër rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilëò, i cili përcakton se: ñFunksionarëve publikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë, në përmbushje të detyrimeve dhe të përgjegjësive të ngarkuara nga detyra që kryejnë, shërbimi i transportit u mbulohet nga buxheti i institucioneve përkatëse, sipas kategorive të përcaktuara në këtë ligjò. Dhe sipas pikës 2 të nenit 2 të këtij Ligji, në kategorinë e përfituesve bëjnë pjesë edhe zëvendësministrat, të cilëve u caktohet një përfitim financiar mujor për shërbime transporti. Masa e përfitimit financiar mujor për çdo zëvendësministër është përcaktuar në lidhjen 3 të ligjit ñPër përfitimin financiar mujor të shërbimit të transportit, për disa funksione në institucionet e varësisë së Këshillit të Ministrave dhe ministriveò, dhe është përcaktuar 35 000 lekë në muaj.

Por pagesat e bëra me distinacionin e mësipërm me burim nga fondi i veçantë nuk janë në përputhje me VKM Nr.838, datë 21.10.2010 ñPër krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantëò e cila në nenin 1 dhe 2 përcakton se:
ñFondi i veçantë në njësitë e qeverisjes së përgjithshme krijohet në masën 5% të fondit të pagave. Fondi i pagave, për efekt të llogaritjes së fondit të veçantë, do të përfshijë vetëm fondin e pagave për numrin faktik organik të punonjësve buxhetorë. Fondi i veçantë, i përllogaritur sipas pikës 1, përdoret nga drejtuesit e njësive të qeverisjes së përgjithshme për:

a) shpërblimin e punonjësve për rezultate të mira në punë;
b) shpërblimin e punonjësve në fund të vitit kalendarik;
c) shpërblime të tjera, të parashikuara me akte të tjera ligjore apo nënligjore;
ç) dhënie ndihmash të menjëhershme për raste fatkeqësish dhe për raste të tjera;
d) veprimtari social-kulturore.
Pra, buxheti i krijuar për fondin të veçantë do të përdoret vetëm për distinacionet e mësipërme të përcaktuara qartësisht në VKM Nr.838, datë 21.10.2010, dhe nuk mund të përdoret për mbulimin e shpenzimeve për shërbimin e transportit, të cilat zëvëndësministrat e përfitojnë me qëllim përmbushjen e detyrimeve dhe të përgjegjësive të ngarkuara për detyrat që kryejnë.
Në zbatim të Ligjit me nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, shpenzimet e transporti (karburantit) duheshin mbuluar nga shpenzimet operative (artikulli 602) dhe jo nga fondi i veçantë i cili krijohet 5% e fondit të pagave (artikulli 600).
Sa më sipër, përdorimi i fondit të veçantë për shpenzimet e transportit, denatyron qëllimin e krijimit të këtij fondi, duke lënë pa fonde përkatëse mbulimin e disashpenzimeve përqëllime tëveçanta, veçanërishtpër, dhënie ndihmash të menjëhershme për raste fatkeqësish apo dhe shpërblimin e punonjësve, veprimtari social-kulturore etj.

<u>Proceset Gjyqësore</u>
-Nga auditimi u konstatua se, përsa i përket **planifikimit të vlerës së detyrimit për vendimet gjyqësore në PBA, për vitet 2019 dhe 2020**, referuar tavanit të ulët për parashikim, janë planifikuar jo më shumë se 5 milion lekë në vit për zërin buxhetor ò60274. Shpenzime për ekzekutim të vendimeve gjyqësore për largim nga punaò, ndërsa për vitin 2021janë parashikuar 25 milion lekë.
-Kështu, megjithë planifikimin në PBA, detyrimet janë paguar gjatë viteve duke kryer rialokimet përkatëse, nëpërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nga fondet e lira në paga, rrjedhojë e vendeve vakante, në shpenzime korrente 602, për ekzekutim te Vendimeve Gjyqësore të formës së prerë.

Detyrimi i paguar , ndarë në vlerë detyrimi dhe tarifë përmbarimore, për gjithë periudhën e auditimit, paraqitet në tabelën e mëposhtëme

Viti	Pershkrimi	Pagese per vendimin gjyqesor (në lekë)	Pagese permbarimore (në lekë)	TOTALI (në lekë)
2019	Pagese per Vendimet gjyqesore	22,653,123	526,672	23,179,795
2020	Pagese per Vendimet gjyqesore	12,031,987	1,138,232	13,170,219
2021	Pagese per Vendimet gjyqesore	976,816	0	976,816
	TOTALI	**35,661,926**	**1,664,904**	**37,326,830**

Burimi nga Drejtoria e Buxhetimit dhe menaxhimit financiar

Gjithashtu, përsa i përket detyrime të mbartura, u konstatua se, këto Vendime Gjyqësore, janë për rikthim në vendin e punës dhe sipas listave, <u>nuk janë mbartur detyrime pasi pagesa ndaj gjyqfituesve bëhet mujore nga Sektori i financës.</u>
Gjithashtu nga auditimi u konstatua se:

Nga kryerja e auditimit mbi urdhër shpenzimet për vitin 2019 u konstatua se në 3 praktika, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është kryer nëpërmjet përmbaruesve privat për të cilën janë shpenzuar si pagesë përmbarimore në vlerën prej **526,672 lekë.**
Gjithashtu nga kryerja e auditimit mbi urdhër shpenzimet për vitin 2020 u konstatua se në 4 praktika, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është kryer nëpërmjet përmbaruesve privat për të cilën janë shpenzuar si pagesë përmbarimore në vlerën prej **1,138,232 lekë.**
Sa më sipër, për vitet buxhetore 2019 dhe 2020, vendimet gjyqësore të formës së prerë, nuk janë ekzekutuar vullnetarisht nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me marrjen e njoftimit të vendimit të formës së prerë dhe kthimit të tij në titull ekzekutiv, por janë kryer në bazë të urdhër ekzekutimeve të lëshuara nga përmbaruesit privat, duke paguar tarifa përmbarimore, veprime të cilat kanë sjellë kosto shtesë për buxhetin e MBZHR-së, **në total për dy vitet buxhetore 2019 dhe 2020 në vlerën prej 1,664,904 lekë.**Vlen të theksohet se detyrimet e mbartura për vendimet gjyqësore të formës së prerë janë të periudhës para vitit 2019, periudhë në të cilën nuk janë respektuar afatet kohore për ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv për gjyqfituesit, gjë që ka sjellë kryerjen e ekzekutimit të këtyre vendimeve me përmbarues gjyqësor dhe si pasojë rritjen e shenzimeve.
Sipas Kodit të Procedurës Civile, neni 130 ñRregullat e njoftimit shkresor të akteveò ku citon se ñ*Në rastin e personave juridikë publikë njoftimi bëhet në qendrën e tij dhe i dorëzohet titullarit ose personave të ngarkuar për pranimin e akteve", nenit 451/a ku citon se "Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët" dhe neni 510/a "Titujt ekzekutivë*ò, institucionit MBZHR, i lind e drejta për ti kërkuar gjyqëfituesit paraqitjen e titullit ekzekutiv të vendimit të formës së prerë, për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, me qëllim shmangien e kostove shtesë të tarifave të përmbaruesit gjyqësore.Nga auditimi u konstatua se, nga MBZHR nuk është aplikuar ekzekutimi vullnetar me palën gjyqfitues.
Por në bazë të Udhëzimit të Përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë, nr.1 datë 04.06.2014 ñPër mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesaritò, pika 4, 5 dhe pika 7, deri diku i mbron njësitë shpenzuese në këtë rast MBZHR.
Në bazë të auditimit u konstatua se, Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore Aseteve dhe Shërbimeve, Sektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, ka një data base për vendimet gjyqësore, por në të mungojnë vlera e përllogaritura për secilin nga proceset.
- Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore Aseteve dhe Shërbimeve, Sektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore i dërgon Drejtorisë se Buxhetit dhe Menaxhimit financiar vendimet gjyqësore vetëm në rastin kur këto vendime janë për likuidim apo ekzekutim. Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore Aseteve dhe Shërbimeve, Sektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore nuk informon në vazhdimësi Drejtorisë se Buxhetit dhe Menaxhimit financiar për të gjitha vendimet gjyqësore, të cilat kanë kaluar shkallën e dytë të procesit të apelimit, me qëllim që nga drejtoria e financës dhe buxhetit të merren masa për krijimin e provizionet për shpenzime, të cilat janë ngjarje të ndodhura, që do të sjellin një probabilitet që do të ketë një detyrim për tâu paguar nga ana e njësisë, me qëllim njohjen e tyre në kontabilitet dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare vjetore të njësisë, duke bërë të mundur dhe planifikim në kohë të burimeve të financimit dhe një parashikim të besueshëm mbi vlerën e detyrimeve, si dhe shmangien e detyrimeve të akumuluar dhe të pagesave të tarifave përmbarimore si pasojë e mosekzekutimit vullnetar të vendimeve. Veprime e mësipërme janë në mospërputhje me Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar neni 61, Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 ñ*Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësinë e qeverisjes së përgjithshme*ò kapitull III pika 34, si dhe VKM nr.50, datë 05.02.2014 ñ*për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit*ò.
Kështu, për vitin 2019 nga MBZHR, Ministri në bazë të Autorizimit për likujdim vendimi gjyqësor për paditësen R.L.(M.), me shkresë nr.1435/1 prot datë 12.02.2019, në mbështetje të VKM nr. 335 datë 02.06.1998 ñ*Për procedurat e zbatimit të vendimeve gjyqësore, për detyrimet*

*që prekin buxhetin e shtetit*ò, të Udhëzimit nr.1 datë 04.06.2014 ñ*Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit*ò, të Vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr.121, datë 24.01.2017, të Vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë nr.4341 datë 27.11.2018, të lajmërimit për ekzekutim vullnetar të detyrimit nr.29, datë 17.01.2019 të përbaruesit gjyqësor privat D.B.

Sa më sipër, ***me Urdhër-shpenzimi nr.83 datë 21.02.2019****është likujduar* **gjyqfituesi R.L.** në vlerën 993.280 lekë (likujdim vendimi gjyqësor) dhe në vlerën 3.000 lekë (shpenzime gjyqësore), ndërsa ***me Urdhër-shpenzimi nr.84 datë 21.02.2019***është likujduar zyra përmbarimore ñE.B.O shpkò në vlerën prej 118.362 lekë.

Me Urdhër-shpenzimi nr.283 datë 18.06.2019 është likujduar zyra përmbarimore ñT.B.S SHPKò në vlerën 369.310 lekë, tarifë shërbimi përmbarimor për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr.23, datë 01.03.2011 të gjykatës së apelit për **gjyqfituesin *V.P.*.**

Me Urdhër-shpenzimi nr.284 datë 18.06.2019 është likujduar zyra përmbarimore ñT.B.S Shpkò vlerën prej 36.000 lekë, tarifë shërbimi përmbarimor për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr.1562, datë 17.03.2015 të gjykatës së apelit për **gjyqfituesin E.H..**

Për vitin 2020

Me Urdhër-shpenzimi nr.35 datë 29.01.2020 është likujduar zyra përmbarimore ñD.M.PFò në vlerën 113.796 lekë, tarifë shërbimi përmbarimor për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr.811, datë 14.10.2019 të gjykatës së apelit për **gjyqfituesin M.A..**

Me Urdhër-shpenzimi nr.340 datë 28.07.2020 është likujduar zyra përmbarimore ñD.S.PFò në vlerën 432.327 lekë, tarifë shërbimi përmbarimor për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr.308, datë 12.02.2020 të gjykatës së apelit për **gjyqfituesin R.Q.**.

Me Urdhër-shpenzimi nr.320 datë 16.07.2020 është likujduar zyra përmbarimore ñK.B.S. SHPKò në vlerën 448.266 lekë, tarifë shërbimi përmbarimor për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr.167, datë 04.02.2015 të gjykatës së apelit **për gjyqfitusin A.O..**

Nga auditimi u konstatua që ky vendim i formës së prerë nuk është ekzekutuar vullnetarisht nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Si pasojë më datë 13.10.2017, zyra përmbarimore ñK.B.S SHPKò, me shkresën nr. 1726/3prot., datë 13.10.2017, ka filluar procedurën për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.167, datë 04.02.2015 të gjykatës së apelit.

Rezulton se për gjyqfituesin A.O. likujdimi ka filluar nga data 25.01.2018 me urdhër shërbimi nr.20, në shumën 2.602.180 lekë, likujdim për pagën e gjyqfituesit që nga nëntori i vitit 2014 deri në tetorin e vitit 2017, duke filluar ekzekutimin vendimin gjyqësor të formës së prerë nr.167, datë 04.02.2015 të gjykatës së apelit që detyron debitorin (MBZHR-në) të paguaj gjyqfituesin deri në rikthimin e këtij të fundit në punë në pozicionin e mëparshëm apo një pozicion të barazvlefshëm me pozicionin e mëparshëm.

Pas këtij urdhër shpenzimi pagesat për këtë gjyqfitues janë bërë përiodike çdo 3-4 muaj por duke mos shkëputur zyrën përmbarimore deri në korrik të vitit 2020. Shkëputja e zyrës përmbarimore erdhi si pasojë e marrëveshjes së MBZHR-së me gjyqfituesin për të bërë likujdimin e tij çdo 2 muaj. Nëse kjo marrëveshje apo ekzekutimi vullnetar i vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.167, datë 04.02.2015, do të bëhëj më parë do të kishim një reduktim të shpenzimeve nga buxheti i aparatit të MBZHR-së.

Me Urdhër-shpenzimi nr.426 datë 21.09.2020 është likujduar zyra përmbarimore ñE.B.O shpkò në vlerën 143.843 lekë, tarifë shërbimi përmbarimor për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr.401, datë 03.03.2015 të gjykatës së apelit për **gjyqfituesin S.C.**.

Nga auditimi u konstatua që ky vendim i formës së prerë nuk është ekzekutuar vullnetarisht nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Si pasojë më datë 15.03.2018, zyra përmbarimore ñE.B.O shpkò, me shkresën nr. 755 prot., datë 15.03.2018, ka filluar procedurën për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.401, datë 03.03.2015 të gjykatës së apelit.

Rezulton se për gjyqfituesin **S.C.** likujdimi ka filluar nga data 19.07.2018 me urdhër shërbimi nr. 318, në shumën 3.436.571 lekë, likujdim për pagën e gjyqfituesit që nga nëntori i vitit 2014 deri në 30.06.2018, duke filluar ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.401, datë 03.03.2015 të gjykatës së apelit që detyron debitorin (MBZHR-në) të paguaj gjyqfituesin deri në

rikthimin e këtij të fundit në punë në pozicionin e mëparshëm apo një pozicion të barazvlefshëm me pozicionin e mëparshëm.
Pas këtij urdhër shpenzimi pagesat për këtë gjyqfitues janë bërë përiodike çdo 3-4 muaj por duke mos shkëputur zyrën përmbarimore. Konkretisht pagesat qe i janë kryer Gjyqfituesit S.C. janë;
- Urdhër Shërbimi nr.318, datë 19.07.2018 janë paguar 3.436.571 lekë likujdim për pagën e gjyqfituesit **S.C.** që nga nëntori i vitit 2014 deri në 30.06.2018.
- Urdhër Shërbimi nr.459, datë 11.10.2018 janë paguar 246.000 lekë likujdim për pagën e gjyqfituesit **S.C.** që nga korriku vitit 2018 deri në tetori i vitit 2018.
- Urdhër Shërbimi nr. 555 datë 26.11.2018 dhe Urdhër Shërbimi nr. 626 datë 26.12.2018,janë paguar 246.000 lekë likujdim për pagën e gjyqfituesit **S.C.** që nga tetori vitit 2018 deri në dhjetorin e vitit 2018.
- Urdhër Shërbimi nr.214, datë 10.05.2019 janë paguar 328.000 lekë likujdim për pagën e gjyqfituesit **S.C.** që nga janar vitit 2019 deri në prill i vitit 2019.
- Urdhër Shërbimi nr.343, datë 23.07.2019 janë paguar 164.000 lekë likujdim për pagën e gjyqfituesit **S.C.** që nga maj vitit 2019 deri në qeshor i vitit 2019, (paga e dy muajve).
- Urdhër Shërbimi nr.472, datë 24.09.2019 janë paguar 164.000 lekë likujdim për pagën e gjyqfituesit **S.C.** që nga korriku vitit 2019 deri në gusht i vitit 2019, (paga e dy muajve).
- Urdhër Shërbimi nr.584, datë 11.11.2019 janë paguar 164.000 lekë likujdim për pagën e gjyqfituesit **S.C.** që nga shtator vitit 2019 deri në tetor i vitit 2019, (paga e dy muajve).
- Urdhër Shërbimi nr.664, datë 11.12.2019 janë paguar 164.000 lekë likujdim për pagën e gjyqfituesit **S.C.** që nga nëntori i vitit 2019 deri në dhjetor i vitit 2019, (paga e dy muajve).
- Urdhër Shërbimi nr.77, datë 20.02.2020 janë paguar 22.363 lekë likujdim për pagën e gjyqfituesit **S.C.** që nga 01.01.2020 deri në 08.01.2020, (paga e 6 ditë punë).
Më shkresën nr.9394/15, datë 18.12.2029, MBZHR i dërgon DAP akt-rekomandimin për sistemimin e gjyqfituesit S.C. në pozicionin ñInspektor në Sektorin e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteveò në AZHBR.
Pas akt-emrimit të nxjerrë nga DAP gjyqfituesi S.C. ka filluar pune si ñInspektor në Sektorin e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteveò pranë AZHBR-së.
Nga auditimi gjithashtu u konstatua që më me urdhër shërbimi nr. 332, datë 30.07.2018, është likujduar zyra përmbarimore ñE.B.O shpkò, me vlerën 329.910 lekë, faturë përmbarimore e dalë pas likujdimit të pagave të akumuluara për gjyqfituesin S.C. për periudhën nëntori i vitit 2014 deri në 30.06.2018
Por edhe pas fillimit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.401, datë 03.03.2015 të gjykatës së apelit që detyron debitorin (MBZHR-në) të paguaj gjyqfituesin deri në rikthimin e këtij të fundit në punë në pozicionin e mëparshëm apo një pozicion të barazvlefshëm me të, nuk është bërë shkëputja e zyrës përmbarimore ñE.B.O shpkò deri në momentin e kthimit të gjyqfituesit S.C. në punë.
Rezulton që *urdhër-shpenzimi nr.426 datë 21.09.2020* është likujduar zyra përmbarimore ñE.B.O shpkò në vlerën 143.843 lekë, tarifë shërbimi përmbarimor për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr.401, datë 03.03.2015 të gjykatës së apelit për **gjyqfituesin S.C.**.
Nga auditimi konstatohet se shkëputja e zyrës përmbarimore vetëm pas kthimit të tij në punë si ñInspektor në Sektorin e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteveò pranë AZHBR-së
Por nëse MBZHR do të kryente ekzekutimin vullnetar për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.401, datë 03.03.2015 të gjykatës së apelit, apo edhe nëse do të kishte arritur një marrveshje me gjyqfituesin të cilit po i kryhej likujdimin, për shkëputjen e zyrës përmbarimore në ekzekutimin e vendimit të formës së prerë, do të kishim një reduktim të shpenzimeve të MBZHR-së.
Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi ka patur 12 gjyqfitues për të cilët ekzekutimi i vendimeve të formës së prerë është kryer gjatë periudhës 01.01.2019-31.03.2021, për të cilët është kryer likujdimi financiar për pagat sipas vendimit të formës së prerë, si dhe një gjqfitues që vendimi i formës së prerë është vetëm për rikthim në pozicionin e mëparshëm të ponës apo një pozicion të barazvlefshëm me të.

Për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, përdorimit të fondeve buxhetore dhe parandalimin e akumulimit të detyrimeve të prapambetura në të ardhem, me qëllim uljen e riskut dhe koston shtesë të pagesave të vonuara, pranë çdo Institucioni /njësie publike është detyrim të krijohet Komisioni i Posaçëm ñPër shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave të reja të lindura pas marrjes së vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për rikthimin e nëpunësve civile në detyrëò, konforme detyrimit të përcaktuar në pikën 1 të Kreut IV të Urdhërit nr 5151, datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike ñPër zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civilò.

Gjatë periudhës objekt auditimi Komisioni i Posaçëm eshtë krijuar 11 herë duke nxjerrë akt rekomandimet për sistemimin e gjyqfituesve. Vlen të përmëndet që pas krijimit dhe nxjerrjes së akt rekomandimeve janë rikthyr në punë 9 gjyqfitues dhe vetëm 4 prej tyre janë akoma në pritje per rikthim në punë.

Për sa është trajtuar në këtë Akt-Konstatim nr.10, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 5590 prot., datë 30.07.2021 dhe observacioni me shkresë nr.3501/7 prot datë 24.12.2021, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

- Lidhur mepërdorimi ne fondit të veçantë;

Në zërin buxhetor artikulli 606ò Transfertanë Buxhetet Familjareò, për MBZHR janë të përfshira:

- Skema Mbështetëse për bujqësinë (mbështetje për fermerët), që çelet me buxhetin fillestar vjetor;
- Kompensimi për naftë i Zv/ministrave, referuar Ligjit nr. 10160, datë 15.10.2009 ñPër rregullimin e shërbimeve të transportit për funksionarët publik dhe nënpunësit civil ñ, i ndryshuar, është kryer kompensimi për Zv/Ministrat.

Fondi i veçantë që bazuar në ligjin vjetor të buxhetit, e konkretisht neni 12, e më pasudhëzimit në zbatim të këtij neni, përcaktohet që fondi i veçantë çelet në një shumë të caktuar nga MFE për çdo institucion dhe përdoret nga vete institucioni vetem per rastet e ndihmes së menjehershme.

Në asnjë rast nuk është përdorur fondi i vecantë për kompensimin e naftës për Zv/Ministrat, pasi bazuar në ligjin vjetor të buxhetit, konkretisht viti 2019 dhe 2020, shpenzimet për kompensimin e naftës së ZV/ministrave, hapen në fillim të vitit si pjesë e ligjit fillestar, ndërsa shpenzimet për fond të vecantë, sipas përcaktimeve në VKM nr. 929, e ndryshuar, çelen rast pas rasti sipas nevojave të institucioneve.

Meqenëse ky fond përdoret përi ndividë dhe ka destinacion të përcaktuar me aktet ligjore/nënligjorë të sipërpërpërmendura, ky fond nuk është object I ligjit të prokurimit, dhe për ta dalluar atë nga fondet e tjera operative (602) të institucionit, ky fond çelet nga MFE në artikullîn buxhetor 606. Në po këtë artikull, çelet gjithashtu çdo fond tjetër buxhetor, që shkon tek individi, që është punonjës buxhetor dhe që përfitohet nga ai, nëpermjet një akti ligjor/nënligjor.

- Proceset gjyqësore dhe ekzekutimi vendimeve të formës së prerë me zyrë përmbarimore

Sa i përket pjesës së përmbarimit, në zbatim të udhëzimit nr. 1, datë 4.06.2014 "Për mënyrëne ekzekutimit të Vendimeve Gjyqësoreò, në cdo rast të paraqitur zyrtarisht, pranë Drejtorisësë Buxhetimit dhe Menaxhimit Financiar (DBMF), për likujdimin apo ndërprerjen e pagesës është vepruar në zbatim të akteve ligjore. Gjithsesi në leximin e Vendimit të Gjykatës, thuhet pagesa e pagës deri në rikthimin në pozicionin e punës. Sqarojmë se Neni 510 e në vijim i Kodit të Procedurës Civile përcakton se: " Titulli ekzekutiv, pra vendimi i formës së prerë) vendoset në ekzekutim me anë të përmbaruesit gjyqësorò. Në asnjë rast nuk është bërë pagesa e përmbaruesit pas tërheqjes së tij, zyrtarisht. Megjithatë ju bëjmë me dije se; nga ana jonë, nuk mund tõI kërkohet kreditorit, të mos marrë përmbarues, pasi në këtë mënyrë kreditori do të hiqte dorë nga të drejtat e tij, pra edhe nga rikthimi tij në vendin e punës. Kreditori me anë të përmbaruesit gjyqësor synon rivendosejen me vend të gjithë të drejave të tij, deri në rikthimin në vendin e punës.

-Kreditori mund ti drejtohet përmbaruesit menjëherë pas njoftimit nga gjykata të vendimit që përbën titull ekzekutiv, për fillimin e veprimeve përmbarimore për vënien në ekzekutim. MBZHR nuk mund ti ndalojë gjyqfituesit tí drejtohen shërbimit përbarimor për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv.

-për të paraqitur kërkesën për pezullim vendimi pranë Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 479/a dhe nenin 615/a të Kodit të Procedurës Civile, referuar praktikës së kësaj gjykate (shëmbull bashkëlidhur shkresa nr.47/1 prot datë 10.01.2017 e Gjykatës së Lartë ñKthim pezullimiò), së bashku me kërkesë, ndër të tjera duhet të depozitohet edhe lajmërimi për ekzekutimin nga shërbimi përmbarimor, në të kundërt kërkesa nuk merret në shqyrtim nga gjykata.

Ka pas raste që MBZHR ka shlyer detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë edhe me vetëm kërkesën e kreditorit, pa iu drejtuar ky i fundit shërbimit përmbarimor për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv.

Megjithatë, Sektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, në vijim:

1.Do të informojmë Drejtorinë e Buxhetimit dhe Menaxhimit Financiar për të gjita vendimet gjyqësore të fromës së prerë, për qëllime provigjionimi përgjatit të pasqyrave financiare.

2.Me njohjen zyrtarisht të vendimit gjyqësor të formës së prerë, MBZHR do të informojë kreditorin për njohjen e vendimit dhe ndërmarrjen e hapave konkret nga institucioni me qëllim ekzekutimin e tij, duke shmangur në këtë formë kostot shtesë të shërbimit përmbarimor.

Qëndrimi i grupit të auditimit:
Përsa i përket observacionit në lidhje me destinacionin e përdorimit të fondit të veça*, grupi i audfitimit nuk ka rekomanduar për kompensimin e karburantit për zv. ministrat ndryshimin e zërit buxhetor, artikullin 606 "transferta të brëndshme", sikurse është specifikuar në observacion. Grupi i auditimit ka konstatuar se në bazë të dokumentacionin të servirur nga ana e sektorit të financës, një* pjesë të madhe të përdorimit të fondit të veçante e ka zënë vlera e shpenzimeve të karburantit të paguara për zëvendësministrat të cilët përfitojnë këto pagesa, nga Ligji nr. 10 160, datë 15.10.2009 ôÊPër rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilëò
Si konklozion grupi i auditimit duke u bazuar në dokumentacionin e servirur ka dalë në rekomandimin e lënë në Akt konstatimin nr.10
Observacion merret pjesërisht në konsideratë.

Sa i përket proceseve gjyqësore dhe ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë me zyrë përmbarimore, vlen të theksohet se detyrimet e mbartura për vendimet gjyqësore të formës së prerë janë të periudhës para vitit 2019, periudhë në të cilën nuk janë respektuar afatet kohore për ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv për gjyqfituesit, gjë që ka sjellë kryerjen e ekzekutimit të këtyre vendimeve me përmbarues gjyqësor dhe si pasojë rritjen e shenzimeve. Sipas Kodit të Procedurës Civile, neni 130 ñRregullat e njoftimit shkresor të akteveò ku citon se ñ*Në rastin e personave juridikë publikë njoftimi bëhet në qendrën e tij dhe i dorëzohet titullarit ose personave të ngarkuar për pranimin e akteve", nenit 451/a ku citon se "Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët" dhe neni 510/a "Titujt ekzekutivë*ò, institucionit MBZHR, i lind e drejta për ti kërkuar gjyqëfituesit paraqitjen e titullit ekzekutiv të vendimit të formës së prerë, për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, me qëllim shmangien e kostove shtesë të tarifave të përmbaruesit gjyqësore. Nga auditimi u konstatua se, nga MBZHR nuk është aplikuar ekzekutimi vullnetar me palën gjyqfitues.

Titulli i gjetje	Vakancat e krijuara ne aparatin e MBZHR-së
Situata:	Nga auditimi në lidhje mbi respektimin e strukturave në MBZHR për periudhën 01.01.2019 deri më 30.03.201, u konstatua se, aparati i Ministrisë së Bujqësisë ka pësuar ndryshime në strukturë dhe organikë, në bazë të: **(1)** Urdhërit të Kryeministrit nr.109, datë 31.07.2018 ñ*Për disa ndryshime në urdhërin nr.168 datë 05.10.2017 të kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe organikës së MZHBR*ò me numër total të strukturës plan 163 punonjës, ndërsa fakti në fillim të vitit 2019 rezultoi me 136 punonjës, me diferencë prej 27 vende vakande, nga të cilat 16 vënde për nëpunës civil dhe 11 vënde me kod pune. Deri në fund të vitit 2020 në dhjetor, numri i vakancave ka pësuar ulje në 17 vënde vakante nga të cilat 9 vënde për nëpunës civil dhe 8 vënde me kod pune. Në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit nr.109, datë 31.07.2018, Ministri i MBZHR, ka miratuar urdhërin me nr.324/1 datë 25.09.2018 ñPër miratimin rregullores së strukturës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Ruralò **(2)** Urdhërit të Kryeministrit nr.150,datë 05.11.2020 ñ*Për miratimin e strukturës dhe organikës së MZHBR*ò numri total i strukturës plan u bë 174 punonjës. Ky ndryshim në strukturë është kërkuar nga Ministri i MBZHR në bazë të Relacionit me shkresë nr. 7892/1, datë 06.10.2020. **(3)** Urdhërit të Kryeministrit nr.162, datë 14.12.2020 ñ*Për disa ndryshime në urdhërin nr.150 të kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe organikës së MZHBR*ò, ku nuk ka ndryshim të numrit total të strukturës plan 174 punonjës, por ka vetëm ndryshime në emërtimin e disa sektorëve. Gjithashtu, sipas Urdhërit nr.39 të Ministrit të MBZHR-së, datë 22.01.2021, në zbatim të urdhërit nr.150 të Kryeministrit, datë 09.11.2020 ñ*Për miratimin e strukturës dhe organikës së MBZHR*ò është miratuar struktura plan e MBZHR-së, me numër total plan 174 punonjës në aparatin e MBZHR-së, ndër kohë që struktura fakt deri në Mars të vitit 2021 ka qenë 142 punonjës, duke rezultuar 32 vënde vakante, nga të cilat 26 vënde për nëpunësit civil dhe 6 vënde me Kod Pune. Kjo është edhe struktura plan që ka Aparati i MBZHR-së deri më datën 31.03.2021. Nga sa më sipër, ndonëse kemi rritje të numrit në plan të punonjësve të aparatit të MBZHR, kemi vakanca gati prej 20% të pozicioneve të vendeve të punës, të cilat konsistojnë më shumë në nivel specialist, i cili është tregues jo pozitiv për funksionimin me kapacitet të plotë të MBZHR, për pasojë mund të sjellë performancë të dobët të institucionit në realizimin e objektivave në lidhje me faktin që sistemi bujqësor dhe zhvillimi rural, mbetet një nga sektorët me potencialin më të madh të zhvillimit në Shqipëri. Vlen të përmëndet që nga ana e Sektorit të Burimeve Njerzore të MBZHR-së janë bërë shpallje për plotësimin e vakancave si në sistemin e HRMIS (Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore) për të kaluar më pas në sistemin online të

	rekrutimit, në platformën administrata.al. Por gjithashtu vlen të theksohet se nuk është gjetur një bashkëpunim institucional me Departamentin e Administratës Publike dhe mekanizmat e nevojshëm për zgjidhjen e këtij problem. Pra është përgjegjësi e strukturave përgjegjëse të aparatit të MBZHR-së për gjetjen e mekanizmave të nëvojshëm për rekrutimin dhe plotësimin e këtyre vakancave.
Kriteri:	- Urdhërit të Kryeministritnr.109, datë 31.07.2018 ñ*Për disa ndryshime në urdhërin nr.168 datë 05.10.2017 të kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe organikës sëMZHBR*ò; - Urdhërit të Kryeministrit nr.150, datë 05.11.2020 ñ*Për miratimin e strukturës dhe organikës së MZHBR*ò; - Urdhërit të Kryeministrit nr.162, datë 14.12.2020 ñ*Për disa ndryshime në urdhërin nr.150 të kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe organikës së MZHBR*
Ndikimi/Efekti	Vakancat janë një fenomen jo pozitiv për funksionimin me kapacitet të plotë të aparatit të MBZHR-së e për pasojë mund të sjellë performancë të dobët të institucionit në realizimin e objektivave.
Shkaku	Lëvizje të shpeshta të personelit në aparatin e MBZHR-së si dhe vonesat e Departamentit të Administratës Publike në shpalljen e konkurseve për të bërë rekrutimin e personelit per vëndet vakante të krijuar.
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	MBZHR të mbajë një korespondencë të vazhdueshme dhe më e shpeshtë me Departamentin e Administratës Publike si dhe të gjënden mekanizmat e nevojshmeme qëllim që të kryhet rekrutimi i personelit dhe si rrjedhojë minimizimi i vakancave për të arritur një kapacitet sa më të plotë në personelin e Aparatit të MBZHR-së.

Titulli i gjetje	Mos informimi periodik dhe në vazhdimësi i Drejtorisë se Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar nga ana e Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore Aseteve dhe Shërbimeve, Sektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, për gjyqfituesit për të cilët është marrë vendimi i formës së prerë.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve/Sektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, i dërgon Drejtorisë se Buxhetit dhe Menaxhimit financiar vendimet gjyqësore vetëm në rastin ku ato janë për likuidim. Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore Aseteve dhe Shërbimeve/Sektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, nuk informon në vazhdimësi Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit financiar për të gjitha vendimet gjyqësore, duke penguar: • Për çështjet që kanë kaluar shkallën e dytë të procesit të apelimit, krijimin e provizioneve nga drejtoria e financës dhe buxhetit për vendimet gjyqësore si ngjarje të ndodhura, t^{y} cilat sjellin një probabilitet që do të ketë një detyrim për tôu paguar nga ana e njësisë, me qëllim njohjen e tyre në kontabilitet dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare vjetore të njësisë, në përputhje me Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 ñProcedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësinë e qeverisjes së përgjithshmeò, kapitull III pika 34. Pra Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve/Sektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, i dërgon Drejtorisë se Buxhetit dhe Menaxhimit financiar vendimet gjyqësore vetëm në rastin ku ato janë për likuidim dhe nuk nukinformon në vazhdimësi Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit financiar për të gjitha vendimet gjyqësore për kryerjen e një planifikimi të shpenzimeve; • Për vendime të formës së prerë, buxhetimin e saktë dhe të besueshëm për këtë zë shpenzimesh me qëllim shmangien e detyrimeve të akumuluara, por dhe të pagesave të tarifave përmbarimore si pasojë e mosekzekutimit vullnetar të vendimeve, në përputhje me VKM nr.50, datë 05.02.2014 ñPër miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimitò dhe Udhëzimin nr.1, datë 04.06.2014 ñPër mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit.ò
Kriteri:	-Kodi Procedurës Civile - Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar -Ligi nr.152/2013, ñPër Nëpunësin Civilò i ndryshuar - VKM nr.50, datë 05.02.2014 ñPër miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimitò. - Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 ñProcedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të

	pasqyrave financiare vjetore në njësinë e qeverisjes së përgjithshmeò - Udhëzimit nr.1 datë 04.06.2014 ñPër mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesaritò
Ndikimi/Efekti	Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore Aseteve dhe Shërbimeve, Sektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, nuk informon në vazhdimësi Drejtorisë se Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar për të gjitha vendimet gjyqësore, të cilat kanë kaluar shkallën e dytë të procesit të apelimit, pra marrjen e vendimit të fotrmës së prerë, me qëllim që nga drejtoria e financës dhe buxhetit të merren masa për krijimin e provizionet për shpenzime, të cilat janë ngjarje të ndodhura, që do të sjellin një probabilitet që do të ketë një detyrim për tôu paguar nga ana e njësisë, me qëllim njohjen e tyre në kontabilitet dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare vjetore të njësisë, duke bërë të mundur dhe planifikim në kohë të burimeve të financimit dhe një parashikim të besueshëm mbi vlerën e detyrimeve, si dhe shmangien e detyrimeve të akumuluar dhe të pagesave të tarifave përmbarimore si pasojë e mosekzekutimit vullnetar të vendimeve Veprime e mësipërme janë në mospërputhje me Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar neni 61, Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 ñProcedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësinë e qeverisjes së përgjithshmeò kapitull III pika 34.
Shkaku	Në bazë të auditimit u konstatua se, Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore Aseteve dhe Shërbimeve, Sektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, ka një data base për vendimet gjyqësore, por në të mungojnë vlera e përllogaritura për secilin nga proceset.
Rëndësia	E mesme
Rekomandime	Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve/Sektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, në cdo rast të mbajë databazën e ecurisë së proceseve gjyqësore e cila gjithashtu duhet tôi vendoset në dispozicion sektorit të financës për qëllime provigjionimi përgjatë hartimit të pasqyrave financiare. **-** MBZHR, gjate vitit buxhetor, nëprëmjet sektorëve përkatës të marr masa për mbajtjen e database-s së vendimeve gjyqësore të formës së prerë që parashikojnë detyrime monetare, si dhe për shumat e detyrimeve, shuma totale e të cilëve duhet të bëhet pjesë e procesit të programimit buxhetor të vitit të ardhshëm, sipas përcaktimeve të akteve ligjorë e nënligjorë përkatës.

Titulli i gjetje	Ekzekutimi me zyrë përmbarimore i vendimeve gjyqësore të formës së prerë për gjyqfituesit
Situata:	Nga auditimi rezultoi se, sipas çeljes fillestare me ligj buxheti për vitin 2019, u planifikuan shpenzime për vendime gjyqësore në vlerën 5,000,000 lekë dhe u realizaun 23,180,000 lekë (ose 363% më shumë nga sa planifikuar). Gjithashtu nga auditimi rezultoi se, sipas çeljes fillestare me ligjin e buxhetit, për vitin 2020 u planifikuan shpenzime per vendime gjyqësore në vlerën 5,000,000 lekë dhe u realizuan 13,170,000 lekë (ose 163% më shumë nga sa planifikuar). -Kështu, megjithë planifikimin, diferencat ndërmjet planifikimit dhe realizimit mbulohen nepermjet rialokimeve nga diferencat e lira në fond pagash që rrjedhin nga vëndet vakante. Përsa i përket detyrimeve të mbartura, u konstatua se këto vendime gjyqësore janë për gjyqfituesit ku vendimi i formës së prerë është për likujdimin e pagës deri në rikthim në vendin e punës. Aktualisht, për gjyqfituesit që nuk janë sistemuar ende në vëndin e tyre të punës, pagesa i bëhet mujore apo në çdo dy muaj nga sektori i financës në MBZHR. Pra nga auditimi i kryer u konstatua se në total për periudhën objekt auditimi janë paguar për vendimet gjyqësore të formës së prerë një total prej **37,326,830 lekë.** Vlen të theksohet se të gjitha këto pagesa janë kryer gjatë periudhës objekt auditimi edhe pse vendimet e formës së prerë mund të jenë marrë edhe para kësaj periudhe. Gjithashtu u konstatua se: Nga kryerja e auditimit mbi urdhër shpenzimet për vitin 2019 u konstatua se në 3 praktika, nga 12 praktika të likuidura gjithsej, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është kryer nëpërmjet përmbaruesve privat për të cilën janë shpenzuar si pagesë përmbarimore në vlerën prej **526,672 lekë.** Nga kryerja e auditimit mbi urdhër shpenzimet për vitin 2020 u konstatua se në 4 praktika, nga 12 praktika të likuidura gjithsej, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është kryer nëpërmjet përmbaruesve privat për të cilën janë shpenzuar si pagesë

	përmbarimore në vlerën prej **1,138,232 lekë.** Sa më sipër, për periudhën objekt auditimi, vendimet gjyqësore të formës së prerë, për praktikat e sipërpërmëndura, **nuk** janë ekzekutuar vullnetarisht nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me marrjen e njoftimit të vendimit të formës së prerë dhe kthimit të tij në titull ekzekutiv, por në 7 raste janë kryer në bazë të urdhër ekzekutimeve të lëshuara nga përmbaruesit privat, duke paguar tarifa përmbarimore, veprime të cilat kanë sjellë kosto shtesë për buxhetin e MBZHR-së për periudhën objekt auditimi **në vlerën 1,664,904 lekë**. Referuar udhëzimit nr.1, datë 04.06.2014, pika 9, përmbaruesi gjyqësor fillon procedurat e ekzekutimit të detyruar nga llogaria e thesarit vetëm, në ato raste kur njësia shpenzuese nuk ka ndjekur vullnetarisht asnjë nga procedurat e parashikuara në pikat 5 ose 6 të këtij udhëzimi, cfare në këtë rast ka ndodhur pasi MBZHR nuk rezulton të ketë paraqitur zyrtarisht nëpërmjet publikimit në faqen on-line, apo në forma të tjera të publikimit, grafikun e shlyerjes sipas rradhes, të cilit gjithashtu duhet tõ përmbahet përmbaruesi, nëpërputhje me pikën 5 të po këtij udhëzimi.
Kriteri:	-Kodi Procedurës Civile - ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 ñKodi i punës i Republikës së Shqipërisëò -Ligi nr.152/2013, ñPër Nëpunësin Civilò i ndryshuar - Udhëzimit nr.1 datë 04.06.2014 ñPër mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesaritò
Ndikimi/Efekti	Ekzekutimi i vendimeve të formës së prerë nga zyrat përmbarimore, sjell kosto shtesë në shpenzimet buxhetore të institucionit.
Shkaku	Mos ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë me ekzekutim vullnetar apo me marrëveshje me gjyqfituesin për të evituar kryerjen e tyre me zyrë përmbarimore.
Rëndësia	E mesme
Rekomandime	Strukturat përgjegjëse të MBZHR-së të marrin masa që shuma totale e detyrimeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të bëhet pjesë e procesit të programimit buxhetor të vitit të ardhshëm, sipas përcaktimeve të akteve ligjorë e nënligjorë përkatës. Ekzekutimi i vendimeve gjyqesore që janë parashikuar të shlyhen nga buxheti përkatës, të bëhet sipas rradhës së paraqitjes zyrtare të tyre në vitin paraardhës dhe grafiku i shlyerjes të bëhet publik nëpërmjet publikimit në faqen on-line të MBZHR, apo në forma të tjera të publikimit, që ju bëhen të ditura publikut, në mënyrë që edhe përmbaruesi tõ përmbahet grafikut të shyerjes së detyrimit të publikuar, duke shmangur kështu kostot e përmbarimit të cilat rëndojnë buxhetin e shtetit.

Sa më sipër,nga auditimi rezultoi se, sipas çeljes fillestare me ligj buxheti për vitin 2019, u planifikuan shpenzime për vendime gjyqësore në vlerën 5 milion lekë dhe u realizaun 23 milion 180 mijë lekë **(ose 363% më shumë nga sa planifikuar);**

Gjithashtu nga auditimi rezultoi se, Sipas celjes fillestare me ligj buxheti, për vitin 2020 u planifikuan shpenzime per vendime gjyqësore ne vlerën 5 milion lekë dhe u realizuan 13 milion170 mijë lekë **(ose 163% më shumë nga sa planifikuar)**.

-Kështu, megjithë planifikimin, diferencat ndërmjet planifikimit dhe realizimit mbulohen nepermjet rialokimeve nga diferencat e lira në fond pagash që rrjedhin nga vëndet vakante

Përsa i përket detyrimeve të mbartura, u konstatua se këto vendime gjyqësore janë për gjyqfituesit ku vendimi i formës së prerë është për likujdimin e pagës deri në rikthim në vendin e punës. Aktualisht, për gjyqfituesit që nuk janë sistemuar ende në vëndin e tyre të punës, pagesa i bëhet mujore apo me çdo dy muaj nga sektori i financës në MBZHR.

3.3. ZBATIMI I DISPOZITAVE LIGJORE PËR ADMINISTRIMIN, RUAJTJEN, DOKUMENTIMIN DHE QARKULLIMIN E VLERAVE MATERIALE E MONETARE .

a.Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet, bankës dhe arkës në lekë dhe në valutë.

b.Saktësia dhe rregullariteti i veprimeve të kryera në magazinë.

c.Inventarizimi dhe administrimi i pronës shtetërore.

Në zbatim të pikës nr.3 të programit të auditimit nr.528/1, datë 14.05.2021ò, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentet bazë të kontabilitetit si: fletëhyrje, fletëdalje, faturë, mandatarkëtim, mandatpagesë, urdhër-shpenzim.
- Transaksionet e llogarive bankare
- Procedurat për blerje te vogla.
- Shpenzimet për udhetime dhe dieta.
- Invetarizimi

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:
Nga ana e Ministrisë së Brendshme nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 *i ndryshuar "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik",* pika 36.

a) Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera përmes arkës

Nga auditimi me zgjedhje për vitin 2019 mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, mandatarkëtim, mandatpagesë, urdhër shpenzim, etj.) i kryer në Sektorin e Financës, për veprimet e arkës në valutë rezultoi se, veprimet janë kryer konform kërkesave të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 10.04.1998 ñPër miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve shtetërore qendrore si dhe njësive që varen prej tyreò, i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 ñPër përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetoreò, i ndryshuar. Transaksionet janë kontabilizuar në mënyrë kronologjike dhe gjendja e llogarive bankare rakordon me ekstraktet e bankës në fund të çdo muaji. Të gjitha tërheqjet me çek nga banka në lekë dhe valutë, janë bërë hyrje në arkë dhe kontabilizimi i tyre në ditarin e bankës dhe të arkës. Nga auditimi i dokumentacionit justifikues të mandat pagesave rezultoi se, mandat pagesat e kontrolluara ishin të plotësuara në rregull dhe të firmosura me të tre firmat që duhet të kishte ky format për të justifikuar pagesën.

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera përmes bankës

Në pagesat e kryera me urdhër shpenzime nuk u konstatuan mangësi në hartimin dhe mbajtjen e dokumentacionit justifikues për lëvrimin e tyre, përvec urdhër- shpenzimeve të dietave. Është bërë regjistrimi dhe kontabilizimi i rregullt dhe në fund të çdo muaji, shuma e pagesave të bankës është e barabartë me ekstraktin e saj, kjo për sa i përket veprimeve të kryera gjatë vitit. Nga verifikimi i regjistrimit të veprimeve, shpenzimet janë regjistruar me numra rendor, në mënyrë kronologjike. Në përgjithësi urdhër shpenzimet kishin të bashkëlidhur dokumentin justifikues si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, proces verbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve

Shpenzimet për udhëtime e dietat.

Nga auditimi me përzgjedhje i mbi 70 praktikave për shpenzimet e udhëtimit dhe dietave për periudhën objekt auditimi, u konstatua se në 18 ***raste nuk është evidentuar qëllimi i shërbimit, dhe mungon dokumentacioni justifikues bashkangjitur*** pavarësisht se këto shërbime janë kryer me autorizim e Drejtorit të Përgjithshëm z.A.M., të cilit i është deleguar kjo e drejtë në bazë të Urdhërave të Ministrit të MBZHR Urdhëri nr.570 datë 16.10.2019, me shkresë nr.7975 prot dhe Urdhëri nr.7 datë 07.01.2021.

Urdhërat e mësipërme janë në mbështetje të Kushtetutës neni 102 pika 4, Ligji nr.44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë ò kreu II ñDelegimi dhe zëvëndësimi i kopetencaveò të VKM nr.997 datë 10.12.2010 ñ*Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit"*pika V, 2, a,i.

Mungesa e dokumentacionit është në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 ñ*Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, Brenda vendit", i ndryshuar, kreu V, pika 2, dhe Udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik", i ndryshuar, Kreu III, pika 36.*

Nga shqyrtimi me zgjedhje i dokumentacionit të urdhër-shpenzimeve të dietave për periudhën objekt auditimi u konstatua me mangësi si:

Me urdhër shpenzim nr.339 datë 10.07.2019, është likuiduar znj, B.K. në shumën **44,980 lekë**, për shpenzime shërbimi dieta në lidhje me auditimin sipas planit vjetor nr.8812/2 datë 19.10.2018.
Në dokumentacionin justifikues, ndodhet autorizimi për sherbime brenda vendit (dieta, shpenzime udhëtimi, shpenzime hoteli). Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm A.M. me nr.4354/2 prot datë 05.06.2019 është shtuar në përbërjen e grupit të auditimit Zj. B.K., duke përfituar në trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës.

Me urdhër shpenzim nr.707 datë 13.12.2019, është likuiduar znj, B.K. në shumën **114,480 lekë**, për shpenzime shërbimi dieta në lidhje me auditimin sipas planit vjetorë nr.8812/2 datë 19.10.2018.
Në dokumentacionin justifikues, ndodhet autorizim për sherbime brenda vendit (dieta, shpenzime udhëtimi, shpenzime hoteli). Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm z.A.M. me nr.7678/1 prot datë 11.10.2019 është shtuar në përbërjen e grupit të auditimit Zj. B.K., duke përfituar në trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës.
Me urdhër shpenzim nr.62 datë 10.02.2020, është likuiduar znj, B.K. në shumën **38,500 lekë**, për shpenzime shërbimi dieta në lidhje me auditimin sipas planit vjetorë nr.8812/2 datë 19.10.2018.
Në dokumentacionin justifikues, ndodhet autorizim për sherbime brenda vendit (dieta, shpenzime udhëtimi, shpenzime hoteli). Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm z.A.M. me nr.9559/1 prot datë 23.12.2019 është shtuar në përbërjen e grupit të auditimit Zj.B.K., duke përfituar në trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës.
Me urdhër shpenzim nr.93 datë 22.02.2020, është likuiduar znj, B.K. në shumën **22,610 lekë**, për shpenzime shërbimi dieta në lidhje me auditimin sipas planit vjetorë nr.7455/1 datë 18.10.2019.
Në dokumentacionin justifikues, ndodhet autorizim për sherbime brenda vendit (dieta, shpenzime udhëtimi, shpenzime hoteli). Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm z.A.M. me nr.680/1 prot datë 31.01.2020 është shtuar në përbërjen e grupit të auditimit Zj. B.K., duke përfituar në trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës.
Me urdhër shpenzim nr.371 datë 10.08.2020, është likuiduar znj, B.K. në shumën **44,610 lekë**, për shpenzime shërbimi dieta në lidhje me auditimin sipas planit vjetorë nr.7455/1 datë 18.10.2020.
Në dokumentacionin justifikues, ndodhet autorizim për sherbime brenda vendit (dieta, shpenzime udhëtimi, shpenzime hoteli). Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm z.A.M. me nr.3742/1 prot datë 01.06.2020 është shtuar në përbërjen e grupit të auditimit Zj.B.K., duke përfituar në trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës.
Me urdhër shpenzim nr.409 datë 10.09.2020, është likuiduar znj, B.K. në shumën **45,920 lekë**, për shpenzime shërbimi dieta në lidhje me auditimin sipas planit vjetorë nr.7455/1 datë 18.10.2020.
Në dokumentacionin justifikues, ndodhet autorizim për sherbime brenda vendit (dieta, shpenzime udhëtimi, shpenzime hoteli). Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm z.A.M. me nr.4912/1 prot datë 06.07.2020 është shtuar në përbërjen e grupit të auditimit Zj.B.K., duke përfituar në trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës.
Me urdhër shpenzim nr.457 datë 28.09.2020, është likuiduar znj, B.K. në shumën **23,140 lekë**, për shpenzime shërbimi dieta në lidhje me auditimin sipas planit vjetorë nr.7455/1 datë 18.10.2020.
Në dokumentacionin justifikues, ndodhet autorizim për sherbime brenda vendit (dieta, shpenzime udhëtimi, shpenzime hoteli). Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm z.A.M. me nr.5810/2 prot datë 20.07.2020 është shtuar në përbërjen e grupit të auditimit Zj.B.K., duke përfituar në trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës.
Me urdhër shpenzim nr.484 datë 12.10.2020, është likuiduar znj, B.K. në shumën **46,840** lekë, për shpenzime shërbimi dieta në lidhje me auditimin sipas planit vjetorë nr.7455/1 datë 18.10.2020.
Në dokumentacionin justifikues, ndodhet autorizim për sherbime brenda vendit (dieta, shpenzime udhëtimi, shpenzime hoteli). Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm z.A.M. me nr.2100/4 prot datë 10.08.2020 është shtuar në përbërjen e grupit të auditimit Zj. B.K., duke përfituar në trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës.

Me urdhër shpenzim nr.522 datë 27.10.2020, është likuiduar znj, B.K. në shumën **46,560** lekë, për shpenzime shërbimi dieta në lidhje me auditimin sipas planit vjetorë nr.7455/1 datë 18.10.2020.
Në dokumentacionin justifikues, ndodhet autorizim për sherbime brenda vendit (dieta, shpenzime udhëtimi, shpenzime hoteli). Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm A.M. me nr.2100/4 prot datë 10.08.2020 është shtuar në përbërjen e grupit të auditimit Zj. B.K., duke përfituar në trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës.
Me urdhër shpenzim nr.569 datë 27.10.2020, është likuiduar znj, B.K. në shumën **23**,**140** lekë, për shpenzime shërbimi dieta në lidhje me auditimin sipas planit vjetorë nr.7455/1 datë 18.10.2020.
Në dokumentacionin justifikues, ndodhet autorizim për sherbime brenda vendit (dieta, shpenzime udhëtimi, shpenzime hoteli). Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm z.A.M. me nr.5810/2 prot datë 20.07.2020 është shtuar në përbërjen e grupit të auditimit Zj. B.K., duke përfituar në trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës
Me urdhër shpenzim nr.673 datë 16.12.2020, është likuiduar znj, B.K. në shumën **69,580** lekë për shpenzime shërbimi dieta në lidhje me auditimin sipas planit vjetorë nr.7455/1 datë 18.10.2020.
Në dokumentacionin justifikues, ndodhet autorizim për sherbime brenda vendit (dieta, shpenzime udhëtimi, shpenzime hoteli). Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm z.A.M. me nr.9222/2 prot datë 20.10.2020 është shtuar në përbërjen e grupit të auditimit Zj. B.K., duke përfituar në trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës
Me urdhër shpenzim nr.724 datë 24.12.2020, është likuiduar znj, B.K. në shumën **86,070** lekëpër shpenzime shërbimi dieta në lidhje me auditimin sipas planit vjetorë nr.7455/1 datë 18.10.2020.
Në dokumentacionin justifikues, ndodhet autorizim për sherbime brenda vendit (dieta, shpenzime udhëtimi, shpenzime hoteli). Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm A.M. me nr.9930/1 prot datë 13.11.2020 dhe nr.10732/1 është shtuar në përbërjen e grupit të auditimit Zj. B.K., duke përfituar në trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës
Të gjithë urdhër shpenzimet e mesipërm janë të firmosura me të tre firmat nga Nënpunesi Autorizues z.E.H., Nënpunsi Zbatues z.A.V.dhe nga Nëpunesi i thesarit, sipas formatit për të justifikuar pagesat.
Grupi i auditimit konstatoi se në të gjithë urdhër shpenzimet e mësipërm znj, B.K. nuk ka qënë pjesë e programit të auditimeve, por me autorizimet e sipërcituar të Drejtorit të Përgjithshëm z.A.M. është ndryshuar përbërja e grupit të auditimit ñduke u shtuarò në trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës Zj. B.K.. Ndërkohë Drejtoria e Auditimit në MBZHR është në varësi direkte dhe vihet në lëvizje vëtëm me urdhër të Ministrit. Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm z.A.M. për të ndryshuar përbërjen e grupeve të auditimit bie në kundërshtim me rregulloren e brendshme të institucionit me nr 1984/1 datë 10.10.2019 dhe me Kreun IV, neni 10, pika 2 e Ligjit nr 114/2015 për Auditin e Brendshëm *" NJAB është e pavarur funksionalisht dhe raporton në mynyrë të drejtpërdrejtë tek titullari i njësisë publike".*
Në urdhër shpenzimet e mësipërme nuk ka asnjë shkresë të Ministrit të MZHBR-së që të ndryshohet përbërja e grupeve të auditimit duke shtuar drejtorin e NJAB znj.B.K..

Observacion i subjektit mbi Projekt Raportin e Auditimit me nr 528/3 dstë 01.12.2021 , vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 06.01.2022 me nr.528/4 prot.

Pretendimi i Subjektit:
Jam pjesë e Autorizimit ***nuk jam shtuar***, autorizimi ka edhe grupin e auditimit, jam autorizuar për lëvizje dhe ***nuk ka urdhër*** nga Drejtori i Përgjithshëm.
Grupi i auditimit ***nuk përcaktohet/shtohet*** nga Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse por nga Drejtori i Drejtorisë AB sipas Formatit Standard 1 ñAutorizimò dhe Formatit Standard 8 ñProgrami i angazhimit të auditimitò të Manualit të Auditimit të Brendshëm. Auditimi ***është kryer sipas Planit Vjetor*** *(e ka cituar edhe grupi i auditimit)* të miratuar nga Ministri i MBZHR-së dhe Komiteti i Auditimit të Brendshëm. Autorizimi ka referencë në të gjitha rastet Planin Vjetor 2019 dhe 2020, i cili **ka kotot e auditimit të miratuara nga Ministri** për 5 persona (4 specialist+1 drejtor). Në asnjë rast **nuk është tejkaluar Plani i miratuar nga ministri** referuar Pasqyës nr.5 të Planeve.

Në të gjitha rastet drejtori i Auditimit të Brendshëm ka miratuar Programet e auditimeve, në 2 Urdhër Shpenzime të përzgjedhura: Nr.62, datë 10.2.2020 dhe Nr.569, datë 10.112020, përkatësisht në subjektet QTTB Fushë Krujë dhe QTTB Vlorë, ***ka qënë pjesë e grupit të auditimit.***

Dërgimi me shërbim i drejtorit ***nuk bie në kundërshtim me rregulloren e brendshme*** të institucionit ku përcaktohet roli mbikqyrës e monitorues, dhe argumentohet me:

organizimin e angazhimit të auditimit sipas standarteve, metodologjisë së miratuar.

mbajtjen e takimit fillestar me subjektin për prezantimin e grupit të auditimit, diskutimin e aspekteve të realizimit të auditimit, paraqitjen e objektivave kryesore që përmban angazhimi i auditimit dhe të Projekt Programit të punës, si dhe aspekte të tjera që vlerësohen të nevojshme nga audituesit dhe të audituarit.

zgjidhjen e të gjitha problematikave të dala gjatë punës në terren.

realizimin e takimit përmbyllës.

Drejtori i Përgjithshëm ***ka miratuar Autorizimin*** e përgatitur nga Drejtoria e Auditimit, ***nuk ka ndryshuar*** përbërjen e grupeve e cila është detyrë e Drejtorit të AB sipas **Formatit Standard 1 "Autorizim" dhe Formatit Standard 8** ñProgrami i angazhimit të auditimitò të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Drejtoria e Auditimit është strukturë në varësi të Ministrit të MBZHR, **nga ana funksionale,** ndërsa nga **ana administrative** funksionon sipas Ligjit Nr.90, datë 90/2012 ñPër organizimin dhe funksionimin e administratës shtetëroreò, VKM Nr.893, datë 17.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin, dhe miratimin e organizimit të brendshëmò, në zbatim të Ligjit 90/2012.

VKM 893/2014 për strukturën e auditimit të brendshëm në pikën 25 shprehet:

ñ*Funksioni i auditimit të brendshëm grupohet në një njësi organizative që, në rastin e ministrive, i* ***raporton nga ana funksionale ministrit****, ndërsa nga* ***ana administrative varet nga sekretari i përgjithshëm .....",*** ashtu siç shprehet edhe Ligji nr. 114/2015 ñPër Auditin e Brendshëmò Kreu IV, neni 10, pika 2 ñ*NjAB është e pavarur* ***funksionalisht dhe raporton*** *në mënyrë të drejtëpërdrejtë tek titullari i njësisë publike*ò, pra <u>për raportimin jo për lëvizjen dhe për organizimin e angazhimeve të auditimit</u>.

Nuk është përcaktuar baza ligjore *që kufizon të drejtën* e lëvizjes së drejtuesit të njësisë vetëm nëse *figuron në programet e auditimit, ndarjen e detyrave dhe nënshkrimin e deklaratave të pavarësisë.* Roli mbikqyrës dhe monitorues si drejtuese e Drejtorisë së AB, ushtrohet në të gjitha fazat e procesit të auditimit, të cilat nuk janë në Programin e auditimit të dorëzuar në subjektin që auditohet me çështjet/drejtimet që do të auditohen, dhe nuk ka fazat e planifikimit, diskutimit të aspekteve të realizimit të auditimit, kryerjes, monitorimit, mbikqyrjes dhe raportimit të auditimit, faza që kërkojnë pjesmarrje në subjekt, të përcaktuara me bazë ligjore, për:

organizimin e angazhimit të auditimit sipas standarteve, metodologjisë së miratuar.

takimin fillestar me subjektin për prezantimin e grupit të auditimit, diskutimin e aspekteve të realizimit të auditimit, prezantimin e audituesve, paraqitjen e objektivave kryesore që përmban angazhimi i auditimit, Projekt programin e punës, si dhe aspekte të tjera që vlerësohen të nevojshme nga audituesit dhe të audituarit.

zgjidhjen e të gjitha problematikave të dala gjatë punës në terren.

realizimin e takimit përmbyllës.

Roli monitories bazuar në Kreu III, neni 13, pika 3 e Ligjit nr.90/2012 ñPër organizimin dhe funksionimin e administratës shtetëroreò, Kapitulli IV, *faqe 79-121* Manuali AB, Nenin 14 të Ligjit për AB, Rregullorja e Institucionit.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Autorizimi i dhënë për udhëtime dhe dieta është dhënë referuar planit vjetor të miratuar nga Ministri. Por theksojmë se autorizimi duhet të jepej sipas planit të miratuar nga Ministri, por dhe sipas programit të miratuar nga Drejtori e NJAB, ku janë përcaktuar dhe audituesit që do të auditojnë subjektin. Plani i miratuar nga Ministri përfshin subjektet që do të auditohen dhe numri i grupit të auditueseve që do të auditojnë subjektin.

Drejtori i NJAB znj.B.K. nuk figuron në programete auditimit, ndarjen e detyrave dhe nuk ka nënshkruar deklaratat e pavarësisë. Për këto 2 arsye Drejtori I NJAB nuk duhet të qëndronte në subjekt përvec takimit fillestar dhe takimit përmbyllës që mund të bëhen nga Drejtori i NJAB ose përgjegjësi i grupit të auditimit.

Pjesëmarrja e drejtuesit të njësisë së auditit të brendshëm në auditim është e pajustifikuar dhe e pa precedent, pasi drejtuesi i njësisë në detyrat e tij funksionale ka vlerësimin e cilësisë së punës audituese. Ndërkohe ai nuk mund të jëtë anëtar grupi në një auditim me risk të mesëm apo të ulët dhe tëi caktohen detyra në program nga përgjegjësi i grupit, i cili në hierarki është në varësi direkte të drejtuesit. Gjithashtu Drejtori i Auditit të Brendeshem nuk mund të vendos veten pjestarë në programet e auditim pasi është po Drejtori i NJAB që miraton programin dhe është në kushtet e konfliktit të mundshëm të interesit rast pas rasti.

Observacioni meret pjesërisht në konsideratë.

Nga auditimi u konstatua se urdhër shpenzimet e dietave janë likujduar pa dokumentacion justifikues dhe janë likujduar me autorizimin e dhënë nga Drejtori i Përgjithshëm, faturat tatimore për shpenzime hoteli dhe shpenzime udhëtimi dhe jo programin e auditimit apo dokumenta të tjerë justifikues. Në këto raste znj, B.K. nuk ka qenë pjesë e programit. *Këto veprime janë në kundeshtim me Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 i ndryshuar "Për menaxhimin e aktiveve në*

njësitë e sektorit publik", pika 36 citon: Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasior edhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eleminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë si dhe atë të mashtrimeve.

Observacion i subjektit mbi Projekt Raportin e Auditimit me nr 528/3 dstë 01.12.2021 , vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 06.01.2022 me nr.528/4 prot.

Pretendimi i Subjektit:
Lidhur me gjetjen tuaj për shtimin nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm Z.A.M., në përbërjen e grupit të auditimit të Drejtores së auditimit, ju sqarojmë se autorizimi për shërbim brenda vendit, në të gjitha rastet ka referencë planin vjetor të auditimit përkatësisht vitet 2019 dhe 2020, në të cilët janë referuar kostot e këtyre planeve, të miratuara nga Ministri i MBZHR-së, sipas shkresës nr. 8812/2, datë 19.10.2018, për vitin 2019 dhe shkresës nr. 7455/1, date 18.10.2019, për vitin 2020. Në te dy vite kostot e auditimit janë të miratuara nga Ministri për 5 persona dhe përfshihet edhe Drejtorja e Drejtorisë së Auditimit. Në asnjë rast Drejtori i PergjithshÜm Z.A.M., nuk ka tejkaluar planin e miratuar nga Ministri, referuar pasqyrave n r.5, bashkëlidhur planeve tè miratuar.
Nisur nga sa më sipër, nuk jemi dakort me konstatimin bërë nga ana juaj, për dëm ekonomik, pasi në asnjë rast, nuk ka tejkalim të planit vjetor të miratuar nga Ministri.
Me Urdhérin e Ministrit Nr. 414 dhe nr. 9308 prot. datè 4.10.2018, Z. A.M. është autorizuar për të firmosur urdhër shërbimet (bashkëlidhur urdhëri).
Gjithashtu Nënpunësi Autorizues, Nënpunesi Zbatues, kanë zbatuar korrektësisht detyrimet që rrjedhin nga aktet ligjore dhe nënligjore sa i përket trajtimit financiar me dieta.
Qëndrimi i Grupit të Auditimit:
Autorizimi i dhënë për udhëtime dhe dieta është dhënë referuar planit vjetor të miratuar nga Ministri sic e keni cituar dhe ju. Por theksojmë se autorizimi duhet të jepej sipas planit të miratuar nga Ministri, por dhe sipas programit të miratuar nga Drejtori e NJAB, ku janë përcaktuar dhe audituesit që do të auditojnë subjektin. Programi i auditimi është dokument i rregullt, justifikues dhe vërteton që punonjesi (audituesi) që mer trajtim financiar (udhetime/ dieta) është pjesë e programit të auditimit. Gjithashtu përvec shpenzimeve të fjetjes si fatura tatimore që janë bashkangjitur në urdhër shpenzimeve, nuk disponohet asnjë dokument justifikues që të vërtetojë veprimin ose ngjarjen që përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, sipas *Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 i ndryshuar "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 36.*
Observacioni meret pjesërisht në konsideratë.

Në këto raste, ndryshimi i përbërjes se grupit të auditimit ñduke u shtuarò në grupet e audutimit dhe marrja e dietave nga znj.B.K. **është shpenzimi jo i drejtë dhe në mospërputhje me parimet e efiçencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit** dhe ka rritur në mënyrë të pa justifikuar koston e auditimit në vlerën 606,430 lekë.
Personat përgjegjës për veprimet dhe mos veprimet e tyre janë Nënpunesi Autorizues z.E.H., Nënpunësi Zbatues z.A.V., Drejtori i Përgjithshëm z.A.M., Drejtori i njësi së Auditit të Brëndshëm znj,B.K. dhe Shefi i Finances znj, L.B..
Me urdhër shpenzim nr.614 datë 24.11.2020, është likuiduar znj, B.K. në shumën 55,000 lekë për shpenzime shërbimi dieta në lidhje me auditimin e urdhëruar me nr.7495 prot datë 23.09.2020 të Ministrit të MZHBR-së.
Në dokumentacionin justifikues, Me shkresë nr.7495 prot, Ministri urdhëron ngritjen e grupit të punës për kryerjen e auditmit me anetarë A.H., B.K. dhe F.S.. Gjithashtu bashkangjitur ndodhet dhe autorizim për sherbime brenda vendit (dieta, shpenzime udhëtimi, shpenzime hoteli), i Drejtorit të Përgjithshëm A.M. me nr.7495/2 prot datë 25.09.2020 me përbërjen e grupit të auditimit A.H., B.K. dhe F.S. duke përfituar në trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës.
Grupi i auditimit konstatoi se në urdhër shpenzimin e mesipërm znj, B.K. ka përfituar dieta për ditën e premte (dieta ditore dhe fjetje hoteli) duke u kthyer në qëndren e punës (Tiranë) me datë **03.10.2020** (e shtunë). Duke përfituar 5,500 lekë (dieta ditore në vlerën 2,500 lekë dhe fjetje hoteli në vlerën 3,000 lekë).
Gjithashtu u konstatua se po në urdhër shpenzimin e mesipërm znj, B.K. ka përfituar dieta dhe për ditën e premte (dieta ditore dhe fjetje hoteli) duke u kthyer në qëndren e punës (Tiranë) me datë

10.10.2020 (e shtunë). Duke përfituar 5,500 lekë (dieta ditore në vlerën 2,500 lekë dhe fjetje hoteli në vlerën 3,000 lek). Në këtë rast kemi të bjëm **me shpenzim jo të drejtë dhe në mospërputhje me parimet e efiçencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit** pasi ka rritur koston e auditimit ne vlerën **11,000** lekë.
Me urdhër shpenzim nr.568 datë 10.11.2020, është likuiduar z.F.S. në shumën 55,000 lekë për shpenzime shërbimi dieta në lidhje me auditimin e urdhëruar me nr.7495 prot datë 23.09.2020 të Ministrit të MZHBR-së.
Në dokumentacionin justifikues, Me shkresë nr.7495 prot, Ministri urdhëron ngritjen e grupit të punës për kryerjen e auditmit me anetarë A.H., B.K. dhe F.S.. Gjithashtu bashkangjitur ndodhet dhe autorizim për sherbime brenda vendit (dieta, shpenzime udhëtimi, shpenzime hoteli), i Drejtorit të Përgjithshëm A.M. me nr.7495/2 prot datë 25.09.2020 me përbërjen e grupit të auditimit A.H., B.K. dhe F.S. duke përfituar në trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës.
Grupi i auditimit konstatoi se në urdhër shpenzimin e mesipërm z, F.S. ka përfituar dieta për ditën e premte (dieta ditore dhe fjetje hoteli) duke u kthyer në qëndren e punës (Tiranë) me datë **03.10.2020** (e shtunë). Duke përfituar 5,500 lekë (dieta ditore në vlerën 2,500 lekë dhe fjetje hoteli në vlerën 3,000 lekë).
Gjithashtu u konstatua se po në urdhër shpenzimin e mesipërm z, F.S. ka përfituar dieta dhe për ditën e premte (dieta ditore dhe fjetje hoteli) duke u kthyer në qëndren e punës (Tiranë) me datë **10.10.2020** (e shtunë). Duke përfituar 5,500 lekë (dieta ditore në vlerën 2,500 lekë dhe fjetje hoteli në vlerën 3,000 lek). Në këtë rast kemi të bjëm **me shpenzim jo të drejtë dhe në mospërputhje me parimet e efiçencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit** pasi ka rritur koston e auditimit ne vlerën **11,000** lekë.
Me urdher shpenzim nr.569 datë 10.11.2020, është likuiduar z.A.H. në shumën 27,500 lekë për shpenzime shërbimi dieta në lidhje me auditimin e urdhëruar me nr.7495 prot datë 23.09.2020 të Ministrit të MZHBR-së.
Në dokumentacionin justifikues, me shkresë nr.7495 prot, Ministri urdhëron ngritjen e grupit të punës për kryerjen e auditmit me anetarë A.H., B.K. dhe F.S.. Gjithashtu bashkangjitur ndodhet dhe autorizim për shërbime brenda vendit (dieta, shpenzime udhëtimi, shpenzime hoteli), i Drejtorit të Përgjithshëm A.M. me nr.7495/2 prot datë 25.09.2020 me përbërjen e grupit të auditimit A.H., B.K. dhe F.S. duke përfituar në trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës.
Grupi i auditimit konstatoi se në urdhër shpenzimin e mësiperme z.A.H. ka përfituar dieta për ditën e premte (dieta ditore dhe fjetje hoteli) duke u kthyer në qëndren e punës (Tiranë) me datë **10.10.2020** (e shtunë). Duke përfituar dieta ditore në vlerën 2,500 lekë dhe fjetje hoteli në vlerën 3,000 lekë. Në këtë rast kemi të bjëm **me shpenzim jo të drejtë dhe në mospërputhje me parimet e efiçencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit** pasi ka rritur koston e auditimit ne vlerën **5,500** lekë.
Të gjithë urdhër shpenzimet e mesipërm janë të firmosura me të tre firmat nga Nënpunesi Autorizues z.E.H., Nënpunsi Zbatues z.A.V.dhe nga Nëpunesi i thesarit, sipas formatit për të justifikuar pagesat.
Nga auditimi u konstatua se në 3 urdhër shpenzime e mësipërm është përfituar dieta për ditën e premte (dieta ditore dhe fjetje hoteli) duke u kthyer në qëndren e punës (Tiranë) me datë 03.10.2020 dhe 10.10.2020 (e shtunë) në kundeshtim *me VKM nr.997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit" i ndryshuar dhe VKM nr.511, datë 24.10.2002 i ndyshuar "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore" Kreu I "Kohëzgjatja e punës"* ***Pika 1*** *citon: Kohëzgjatja javore e punës është 40 orë në javë për nëpunësit civilë dhe punonjësit e tjerë, në institucionet e administratës publike të nivelit qendror, si dhe në institucionet e tjera shtetërore.* ***Pika 2*** *citon: Orari ditor i punës fillon çdo ditë në orën 8.00 dhe përfundon në orën 16.30, ndërsa ditën e premte fillon në orën 8.00 dhe përfundon në orën 14.00.*

Observacion i subjektit mbi Projekt Raportin e Auditimit me nr 528/3 dstë 01.12.2021 , vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 06.01.2022 me nr.528/4 prot.

Pretendimi i Subjektit:
Me Urdhër të Ministrit nr.371, nr.7495 prot, datë 23.9.2020 ñPër auditimin përputhshmërie dhe financiarò të tre punonjësit A.H., B.K. dhe F.S. janë urdhëruar të kryejnë shërbim auditimi nga data 28.9.2020-9.10.2020 dhe me Urdhërin nr.431, datë 20.10.2020, ky afat është shtyrë deri më datë 23.10.2020. Në zbatim të Urdhrave të mësipërm, Autorizimit nr.7495/2 prot datë 25.09.2020 dhe programit të auditimit grupi i punës ka ndjekur dhe zbatuar afatet e përcaktuara. Datat e kthimit që ju evidentoni në akt konstatim data 3.10.2020 dhe 10.10.2020 janë brenda periudhës që ishim urdhëruar për shërbim. Periudhën e shtyrë 12.10.2020 - 23.10.2020 grupi auditimit i ka shfrytëzuar për të punuar me mbledhje informacioni në zyrë në Tiranë për cështjet e tjera të programit që nuk kishin lidhje me inspektimet fizike dhe nuk është trajtuar me dietë. Për pretendimin së është shkelur VKM nr.997, datë 10.12.2002 ñPër trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda venditò, i ndryshuar sqarojmë se: ñnë paragrafin nr.I, **përcaktohet**: ñ*Punonjësit e njësive të qeverisjes së përgjithshme, të cilët* ***shkojnë me shërbim*** *jashtë qendrës së punës, brenda vendit, trajtohen financiarisht për përballimin e shpenzimeve të shërbimit"*. ***Në këtë paragraf nuk ka*** *kufizim për ditët e kryerjes së shërbimit, pra dhe kryerja e shërbimit ditën e premte dhe kthimi ditën e shtunë nuk kufizohet.* Për sa më sipër nuk kemi shkelur VKM 997/2002, të ndryshuar. Për pretendimin së është shkelur VKM nr.511 datë 24.10.2002 ñPër kohëzgjatjen e punës dhe pushimit në institucionet shtetëroreò sqarojmë se baza ligjore nuk përputhet me rastin që ka marrë në shqyrtim ky akt konstatim, pasi Kreu I-rë, Pika 1 të vendimit, rregullon kohën normale të punës në institucionet e administratës publike ku kohëzgjatja javore e punës është 40 orë në javë dhe nuk rregullon orarin zyrtar të shërbimit jashtë qendrës së punës, brenda vendit. Rregullimi i kryerjes së shërbimit është me VKM 997/2002, të ndryshuar. Për sa më sipër nuk kemi shkelur VKM 511/2002, të ndryshuar. Llogaritja si dëm ekonomik e dietës së plotë ditore në masën 2,500 lekë dhe për ditën e premte dhe kthim të shtunë, nuk llogarit kthimin nga shërbimi në një rast për z. A.H. dhe për dy raste për z. F.S.. Argumentime për kryerjen e shërbimit me kthim ditën e shtunë. Nisur nga rëndësia dhe vecoritë këtij auditimi theksojmë se për të realizuar objektivat e përcaktuara grupi i punës i përbërë nga z. A.H., z.F.S. dhe znj.B.K., ishte i detyruar të punonte jashtë orarit zyrtar të punës (mbas orës 14.00 të premte dhe ditën e shtunë në kthim), kjo e kushtëzuar nga:
Inspektimi fizik i kafshëve në ferma që ishte dhe objektivi kryesor, i cili mund të kryhej vetëm në orët e para të mëngjesit dhe orët e vona të mbrëmjes, kohë në të cilën kafshët ktheheshin nga kullota në stallë,
Distanca shumë e largët nga ferma në fermë dhe midis njësive administrative të cdo bashkie të qarkut Gjirokastër dhe Fier, e bënte të paarritshëm respektimin e afatit të planifikuar në Urdhrin e Ministrit brenda orarit zyrtar.
Për të vërtetuar punën e kryer në datat respektive 3 dhe 10.10.2020 bashkalidhur po ju vëmë në dipsozicion dokumentacionin i cili ndodhet në dosjen fizike të auditimit, gjithsej 27 fletë, si më poshtë:
Qëndrimi i Grupit të Auditimit:
Heqja e fjalisë ñditë zyrtareò tek VKM nr.130 nuk e legjitimon që punonjesi do të paguhet me dieta edhe për ditë pushimi. Gjithashu me Urdhër të Ministrit nr.371, nr.7495 prot, datë 23.9.2020 ñPër auditimin përputhshmërie dhe financiarò të tre punonjësit janë urdhëruar të kryejnë auditimin nga data 28.09.2020 - 09.10.2020 dhe me Urdhërin nr.431, datë 20.10.2020, ky afat është shtyrë deri më datë 23.10.2020. Periudha e sipërcituar është koha që audituesit kane në dispozicion për të audituar subjektin (institucionin) i cili gjithashtu operon sipas *VKM nr.511, datë 24.10.2002 i ndyshuar "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore"*, kjo nuk përfshin edhe ditët e pushimit.
Observacioni meret pjesërisht në konsideratë.

Në rastet e mesipërm marrja e dietave (dieta ditore dhe fjetje hoteli) për ditën e premte nga znj.B.K., z. A.H. dhe z. F.S. është **shpenzim jo i drejtë dhe në mospërputhje me parimet e efiçencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit** pasi ka rritur në mënyrë të pa justifikuar koston e auditimit ne vlerën **27,500 Lekë**.
Personat përgjegjës për veprimet e tyre janë, Nënpunësi Autorizues z.E.H., Nënpunësi Zbatues z.A.V., Shefi i finances znj, L.B., znj,B.K., z. A.H. dhe z. F.S..

b) Saktësia dhe rregullueshmëria e veprimeve të kryera në magazinë
Organizimi i evidentimit të lëvizjes së mallrave nga magazina dhe kontabilizimi i saj është bërë në mënyrë manuale. Fletë daljet e fletë hyrjet e magazinës ishin me blloqe dhe numra të ndarë veç për hyrjet dhe daljet e ñjashtmeò dhe veç për hyrjet dhe daljet e ñbrendshmeò.
Nga audituan me zgjedhje hyrjet dhe daljet e ñjashtmeò dhe rezultoi:
Fletë Hyrjet ishin të plotësuara në rregull me numër artikulli, sasi, çmim e vlerë (me gjithë TVSh), shoqëruar nga fletë dalja e furnitorit dhe proces verbali i marrjes në dorëzim.
Fletë Daljet e jashtme ishin të plotësuara në rregull me numër artikulli, sasi, çmim vlerë (me gjithë TVSh), shoqëruar me kartelën shoqëruese, planë shpërndarjen të firmosur nga Sekretari i

Përgjithshëm i Ministrisë, autorizimin e njësisë ku do të shkonte malli dhe me kopjen e fletë hyrjes në njësinë e furnizuar.
Nga audituan me zgjedhje hyrjet dhe daljet e ñbrendshmeò dhe rezultoi:
Fletë Hyrjet e mallrave dhe materialeve ñnë përdorimò ishin të plotësuara në rregull me numër artikulli, sasi, çmim vlerë, shoqëruar me urdhër dorëzimi.
Fletë Daljet e brendshme janë të ndara për dalje të mallrave e materialeve, për dalje të inventarit të imët dhe mobilieri e pajisje. Fletë Daljet ishin të plotësuara në rregull me numër artikulli, sasi, çmim vlerë të firmosura nga marrësi në dorëzim, shoqëruar me urdhër dorëzimi.
Magazina përkon me specialisten e financës me kartelat respektive çdo 3 muaj dhe në fund të vitit firmosin për lëvizjet, gjendjet në librat dhe regjistrat respektiv.

c) Inventarizimi

Nisur nga rëndësia dhe materialiteti sasior dhe në natyre të aspekteve të menaxhimit material dhe mundësisë për veprime të pajustifikuara, ky aspekt është audituar shtrirë për periudhën 2019-2020.
Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar se për periudhën 2019-2020 çdo vit janë realizuar proceset e inventarizimit parashikuar në Paragrafi nr.74, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò i ndryshuar që sanksionin se:
*"Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të **paktën një herë në vit** ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës" dhe neni 31, citohet " ...për objektet e dhëna me qira – sipërfaqja e objektit ne m^2, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës...*
Regjistrimi i aktiveve është kryer konform Kreut III, "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre", të Udhëzonit te Ministrisë Financave nr. 30, date 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësite e Sektorit Publik*". Hyrja e aktiveve për çdo raste dokumentohet me flete hyrjen përkatëse, të hartuat sipas gjendjes fizike te tyre, konforrn pikës 37, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, date 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik". Dalja e aktiveve për çdo rast, janë kryer konform pikës 38, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, date 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve ne Njësite e Sektorit Publik*".

***Më konkretisht*:**

Procesi i inventarizimit të aktiveve, ***për vitin 2019-2020*** është kryer nga disa komisioni të ngritur sipas urdhrit të Titullarit të Institucionit ñPër krijimin e komisionit të inventarizimitò

Për vitin 2019

Urdhëri nr.605/1 datë 27.11.2019 ñPër kryerjen e Invetarit te Përgjitshëmò për vitin 2019.

Për vitin 2020

Urdheri nr.400 datë 04.12.2020 Për kryejen e inventarit të përgjitshëm për vitin 2020
Urdhëri nr.221 datë 04.06.2020 Për kryerjen e vlerësimi të materialeve jashtë përdorimi për vitin 2020
Urdhëri nr.491 datë 04.12.2020 ñNxjerrjen nga përdorimi të aktiveve të vlerësuara jshtë përdorimitòpëe vitin 2020
Komisionit të Inventarizimit i është ngarkuar të verifikojë gjendjen fizike dhe cilësore të aktiveve në ngarkim/ përdorim, të hartojë procesverbalin përkatës, të bëjë krahasimet me librat e kontabilitetit dhe të japë mendim për diferencat që mund të lindin.
Komisioni është bazuar në të dhënat e regjistrit kontabël për kryerjen e inventarizimit të pasurisë.
Për sa sipër është vepruar në bazë të përcaktimeve të paragrafit nr.26, të Udhëzimit të MF me nr.30/2011, ku përcaktohet se:
ñ*Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo kanë administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar".*
Për vitin 2019, me shkresën nr.8140/3 datë 30.12.2019 ñMbi rezultatet e inventarizimit për vitin 2019 të aseteve të Aparatit të MBZHRò drejtuar Sekretarit të Përgjitshëm.

Komisioni i inventarizimit ka hartuar një raport në lidhje me rezultatet e invetarizimit sipas grup llogarive 214, 215, 218, 311, 327 dhe 212 nga ku ka konsatuar se ñmallra e nxjerra nga përdorimi për vitin 2017 nuk janë asgjesuar akoma ashtu si dhe ka rezultuar po prap mallra të cilat duhet të dalin nga përdorimi për vitin 2020.
Nga auditimi u konstatua se për vitin 2019 nuk ka perfunduar deri ne fund procesi i invetarizimit, ku nga ana e MBZHR nuk është ngritur nje komision mbi vlerësimin e aktiveve si dhe vlerësimin e mallrave jashtë përdorimit duke mos e cuar kështu procesin deri ne fund në kundërshtim me pika 95 e Udhëzimin nr.30/2011.
Për vitin 2020 me urdhrin nr.490 datë 04.12.2020 ñPër kryerjen e invetarit të përgjithshëmò miratuar nga Sekretari i Pergjithshëm, është ngritur grupi i punës per invetarizimin e aseteve.
Me shkresën nr.10739/2 datë 31.12.2020 drejtuar dhe miratuar nga Sekretari i Pergjithshem i MBZHR komisioni i invetarizimit ka hartuar një raport në lidhje me invetarizimin e aseteve sipas llogarive 214, 215, 218, 311, 327 dhe 212 si dhe është mbajtur proces verbali më datë 31.12.2020 per llogaritë përkatese firmos nga komisioni pas verifikimit faktik.
Me urdhrin nr.221 datë 04.06.2020 miratuar nga Sekretari i Pergjithshëm është ngritur grupi i punës ñ*për kryerjen e vlerësimit të materialeve jashte përdorimit*ò i përbërë nga z.A.V.kryetar grupi, znj.A.D.dhe znj.V.G.
Nga auditimi u konstatua se nuk është mbajtur një proces verbali i vlerësimit të aktiveve për llogaritë përkatëse në kundërshtim me pikën 105 të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin E Aktiveve Në Njësitë E Sektorit Publikò, i ndryshuar i cili hartohet nga komisioni i vlerësimit pas verifikimit faktik të të gjitha aktiveve duke argumentuar arsyet për vlerësimin e secilit prej tyre:
a) nëse është i nevojshëm apo jo për veprimtarinë e njësisë;
b) nëse nuk rezulton i nevojshëm për njësinë, a është në gjendje të mirë fizike dhe ka mundësi përdorimi të mëtejshëm në njësi të tjera;
c) nëse duhet të nxirret përfundimisht jashtë përdorimit nëpërmjet shitjes si material mbeturinë apo asgjësimit përfundimtar.
Si dhe në kundërshtim me pikën 105 të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin E Aktiveve Në Njësitë E Sektorit Publikò, i ndryshuar i cili citon se ñ*Procesverbali hartohet në tri kopje dhe nënshkruhet nga përgjegjësi material dhe komisioni i vlerësimit. Procesverbali miratohet nga titullari i njësisë publike*ò.
Aktivet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të ricikluesshme, hiqen nga regjistri i aktiveve në përdorim, bëhen hyrje në magazinë dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë (me përjashtim të rasteve kur sipas rregullave të shëndetësisë duhet të asgjësohen), kurse të tjerat asgjësohen nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi duke ndryshuar formën e tyre fillestare, groposur ose djegur.
Me urdhri nr.491 datë 04.12.2020 ñ*Për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve vlerësuar jashtë përdorimit*ò miratuar nga titullari i institucionit është ngritur grupi i punes i përbërë nga znj.A.N., znj.A.D., z.B.C.dhe znj.L.T. , por nga auditimi u konsatuar se nuk është marrë asnjë masë për ato aktive të cilat jane vlerësuar jashtë përdorimi e ku si rezultat nuk është hartuar as procesverbali për nxjerrjen nga përdorimi ku përshkruhet procedura e ndjekur sipas rastit për çdo aktiv lidhur me dhënien në përdorim ose tjetërsimin e tyre, ose nxjerrjen jashtë përdorimit dhe destinacionin përfundimtar të aktiveve, dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit në kundërshtim me pikën 110 të udhëzimit Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin E Aktiveve Në Njësitë E Sektorit Publikò i ndryshuar.

Observacion i subjektit mbi Projekt Raportin e Auditimit me nr 528/3 datë 01.12.2021 , vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 06.01.2022 me nr.528/4 prot.

Pretendimi i Subjektit: ñSa i përket invetarizimit e konkretisht konstatimi tuaj për mospërfundim të procesit të invetarizimit në kundërshtim me pikëm 95 të udhëzimit 30/2011, bashkelidhur po ju riveme ne disppozicion nje kopje te proces verbalit të vlerësimit t mallrave të vlerësuara për nxjerrje jasht përdorimit për vitin 2020 ndërsa për vitin 2019, sqarojme se nuk ka pasur mallra të vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimi.

Lidhur me nxjerrjen jjashtë përdorimit, sqarojme se pas vlerësimit dhe nënshkrimit të grupit përkatës, është kryer heqaja nga regjistri i akiveve duke i bëre hyrje ne llogarinë 24 dhe gjendje në makazinë rikupëro, duke pritur procesin e ankandit nga sektori përkatës. **Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Referua observacionit tuaj, përsa i përket invetarizimit për vitit 2019, pretendimi se ñnuk ka pasur mallra të vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimiò nuk dokumentohet me shkresat perkatese, ku mungon urdhri i titularit për ngritjen e grupit të punës mbi vlerësimin e aktiveve për nxjerje jashtë përdorimi si dhe procesverbali & relacioni ku grupi i punes relaton dhe i drejton titullarit për këtë konstatim. Persa i përket invetarizimit per vitin 2020, ashtu si dhe ju keni informuar titullarin se jeni në pritje të procesit të ankandit, nga titullari është ngritur me urdhrin nr 491 datë 04.12.2020 prot me nr 10739/1 ñNxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të vleresuara jashtë përodrimitò por bashkëlidhur nuk ka asnjë procesverbal për masat qe janë marre ne kundërshtim me me pikën 110 të udhëzimit Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin E Aktiveve Në Njësitë E Sektorit Publikò. ***Observacioni merret pjesërisht ne konsideratë.***

1: Titulli i Gjetjes	Shpenzimet për udhëtime e dietat.
Situata:	- Nga auditimi me përzgjedhje i dokumentacionit për shpenzimet e udhëtimit dhe dietave për periudhën objekt auditimi, u konstatua se në disa *raste nuk është evidentuar qëllimi i shërbimit, dhe mungon dokumentacioni justifikues* pavarësisht se këto shërbime janë kryer me autorizimin e Drejtorit të Përgjithshëm. - Me autorizimet e Drejtorit të Përgjithshëm është ndryshuar përbërja e grupit të auditimit duke u shtuar në trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës Zj. B.K.. Ndërkohë Drejtoria e Auditimit në MBZHR është në varësi direkte dhe vihet në lëvizje vëtëm me urdhër të Ministrit. Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm z.A.M. për të ndryshuar përbërjen e grupeve të auditimit bie në kundërshtim me rregulloren e brëndshme të institucionit me nr 1984/1 datë 10.10.2019 dhe me Kreun IV, neni 10, pika 2 e Ligjit nr 114/2015 për Auditin e Brendshëm *" NJAB është e pavarur funksionalisht dhe raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë tek titullari i njësisë publike".*
Kriteri:	VKM nr.997, datë 10.12.2010 ñPër trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, Brenda venditò, i ndryshuar, kreu V, pika 2. Udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2012, ñPër menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publikò, i ndryshuar, kreu III, pika 36 dhe Ligjit nr.114/2015 ñPër Auditin e Brendshëmò Kreun IV, neni 10, pika 2 e *" NJAB është e pavarur funksionalisht dhe raporton në mynyrë të drejtpërdrejtë tek titullari i njësisë publike"*
Ndikimi/Efekti:	Mos justifikim i shërbimit të kërkuar dhe kryer.
Shkaku:	Parregullsi në plotësimin e dokumenteve justifikues.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi:	Nënpunësi autorizues/i deleguar në bashkëpunim me sektorin e financës të marrë masa që për cdo udhëtim të verifikohet paraprakisht ligjshmëria përpara dhënies së autorizimit të personave përkatës. Gjithashtu pasi të jepet autorizimi, të bashkëlidhen kërkesat e argumentuara nga personi përgjegjes, ku të citohet data e kërkesës, arsyeja e lëvizjeve të kërkuara si dhe ditët e qëndrimit. Sektori i financës të marrë masa që pas plotësimit të dokumentave justifikuese të cilat argumentojnë në mënyrë shkresore lëvizjet e punonjësve, të kryhet likuidimi i tyre.

2: Titulli i Gjetjes	Rritje e kostove të auditimit pa ekonomicitet, efektivitet dhe eficence
Situata:	- Nga auditimi me zgjedhje i urdhër shpenzimeve të dietave për periudhen objekt auditimi rezulton se pavarësisht se znj, B.K. (Drejtori i NJAB pranë MZHBR) nuk ka qenë pjesë e programeve të auditimeve, eshte shtuar në trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës duke u ndryshuar përbërja e grupit të auditimit me autorizimet e Drejtorit të Përgjithshëm dhe si pasojë ka një rritje në kostot e auditimit me vlerën **606,430 lekë**. - Drejtoria e Auditimit në MBZHR është në varësi direkte dhe vihet në lëvizje vëtëm me urdhër të Ministrit, në përputhje me *Ligjin nr 114/2015 "Për Auditin e Brendshëm" Kreu IV, neni 10, pika 2.* Në urdhër shpenzimet e audituara nuk ka asnjë shkresë të Ministrit të MZHBR-së që të ndryshohet përbërja e grupeve të auditimit duke shtuar drejtorin e NJAB znj.B.K..

	- Gjithashtu nga auditimi me përzgjedhje u konstatua se në 3 urdhër shpenzime është përfituar dieta për ditën e premte (dieta ditore dhe fjetje hoteli) duke u kthyer në qëndren e punës (Tiranë) me datë 03.10.2020 dhe 10.10.2020 (e shtunë) dhe si pasojë ka një rritje në kostot e auditimit me vlerën **27,500 lekë**.
Kriteri:	VKM nr.997, datë 10.12.2010 ñ*Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, Brenda vendit*ò, i ndryshuar, kreu V, pika 2. Me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011, ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik*ò, i ndryshuar, Kreu III, pika 36. Me rregulloren e brëndshme të institucionit me nr,1984/1 datë 10.10.2019. Me Ligjin nr.114/2015 ñPër Auditin e Brendshëmò Kreun IV, neni 10, pika 2 *" NJAB është e pavarur funksionalisht dhe raporton në mynyrë të drejtpërdrejtë tek titullari i njësisë publike"* dhe Neni 14 pika c dhe ii dhe meVKM nr.511 datë 24.10.2002 i ndryshuar*"Për kohëzgjatjen e punës dhe pushimit në institucionet shtetërore"*
Ndikimi/Efekti:	Rritja e kostos në auditim për shkak të keq menaxhimit të njësisë së auditimit duke përdorur fonde pa ekonomicitet, efeciencë dhe efektivitet.
Shkaku:	Mos zbatimi i bazes ligjore.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga titullari MBZHR, të ngrihet një grup pune, për të evidentuar parregullsitë e konstatuara mbi urdhër shpenzime për vlerën prej 633,930 lekë, e cila është përdorur pa ekonomicitet, efiçensë dhe efektivitet.

3: Titulli i gjetjes	Për vitin 2020 procedurat e inventarizimit nuk rezultojnë të finalizuara duke kryër vetem procesin e invetarizimit dhe vlerësimit të daljes jashtë përdorimit por mungon procesi i asgjësimit për aktivet qe nuk kanë destinacion tjetër, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*ò. I ndryshuar
Situata1:	Nga auditimi rezultoi se, për vitin 2020 nuk janë finalizuar procedurat e inventarizimit, duke mos pasuar më tej procesin e asgjësimit për aktivet që nuk kanë destinacion tjetër. Nga ana e komisionit të ngarkuar me kryerjen e inventarizimit fizik si dhe vlerësimin për nxjerrje jashtë përdorimit, janë evidentuar aktive të qëndrueshme, aktive qarkulluese e gjendje inventari që janë jashtë funksionit, për të cilat është bërë dhe regjistrimi përkatës por jo përfundimtar pasi Rezultoi se, nuk ka një vendimmarrje nga ana e menaxhimit, mbi masat që duhën marrë për aktivet te cilat janë vlerësuar për tu nxjerr jashtë përdorimit.
Kriteri:	UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*òi ndryshuar. Pika 110
Ndikimi/Efekti	Pasqyrat financiare nuk sigurojnë të dhënave të plota dhe nuk paraqesin, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje, në rregjistrat kontabël.
Rëndësia	I mesëm
Rekomandime	Insititucioni, të ndjekin hapat e mëtejshëm bazuar në konkluzionet e grupeve te inventarizimit për proçesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese si dhe referuar urdhrit të ngritur nga titullari të hartojne dhe miratojnë procesverbalin për dhënien në përdorim/ tjetërsimin/asgjesim të aktiveve të vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimit duke bërë të mundur kështu përfundimin e procesit te invetarizimit si dhe heqjen nga kontabiliteti referuar masave te cilat do merren per aktivet e vlerësuara për tu nxjerr jashtë përdorimit.

MBI AUDITIMIN E ADMINISTRIMIT TË TOKËS BUJQËSORE

Grupi i audituesve të KLSH-së, për të realizuar objektin e auditimit, *u fokusua*, në zbatimin akteve ligjore dhe nënligjore, në lidhje mbi, ligjit nr.8318 datë 01.04.1998 ñPër dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetëroreò i ndryshuar, VKM 460/2013 e ndryshuar me nr.VKM nr.373 datë 20.06.2018 ñPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar me VKM nr.487 datë 17.06.2020 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.373 datë 20.06.2018 të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e kriterevetë rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit.ò;VKM-së nr. 45/2014, ñPër kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit

Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe ishinstitucioneve kërkimore-shkencore të kësaj ministrie, aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronaveòsi dhe çdo akt juridik që ka lidhje me këtë fushë objekti, në Republikën e Shqipërisë.

Informacion i përgjithshëm

I.Nga auditimi në lidhje mbi administrimin e tokave bujqësore në pronësi të shtetit në administrim të Ministrisë së Bujqësisë Zhvillimit Rural, të cilat jepen me qira me qëllim për zhvillimin e sipërfaqeve të lira në fushën e bujqësisë, sipas ligjit nr.8318 datë 01.04.1998 ñPër dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetëroreò i ndryshuar, u konstatua se:

-Ligji neni 8, ka përcaktuar të drejtën e shtetit për dhënien me qira personave fizike e juridikë vendas ose të huaj, tokë qëështë në pronësi të tij, me kohëzgjatje:

(1)deri në 10 vjet për kontratat e qirasë afatshkurtër, ku përfshihen veprimtaritë për **prodhimin e bimëve të arave** dhe eterovajore.

(2)deri në 30 vjet për kontratat e qirasë afatmesëm, ku **përfshihen veprimtaritë për prodhimin blegtorial**, për prodhimin e fidanëve, mjediset e mbrojtura dhe pyjet e ulëta (cunG.hte).

(3)deri në 99 vjet për kontratat e qirasë afatgjatë, ku përfshihen veprimtaritë për turizëm, rekreacion, pyll i lartë dhe pemët frutore.

Kur veprimtaria sipas pikave 1 dhe 2, shoqërohen me investime për përpunimin e tyre, ato trajtohen si kontratë qiraje afatgjatë.

-Kriteret *për llogaritjen e vlerës vjetore të tokave-pasuri shtetërore dhe procedura e dhënies me qira nga MBZHR dhe mënyra e pagesës së vlerës me qira nga qiramarrës*i, neni 9&10, përcaktohen në bazë të VKM nr.373 datë 20.06.2018 ñPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar me VKM nr.487 datë 17.06.2020 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.373 datë 20.06.2018 të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e kriterevetë rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit.ò

Gjithashtu nga auditimi u konstatua se, sipërfaqet e tokës bujqësore të dhëna me qira janë siguruar në mbështetje të Vendimeve të Këshillit të Ministrave si vijon:

(i)VKM nr.995, datë 9.12.2015,òPër kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të sipërfaqes së tokës bujqësore prej 926.55 Ha, në pronësi shtetërore, dhënë në përdorim Komunave Buçimas, Çërravë dhe Udenisht dhe për disa ndryshime në Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.244, datë 4.4.2012, nr.417, datë 8.6.2011 dhe nr.534, datë 1.5.2008ò ka kaluar në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së toka bujqësore në pronësi të shtetit me *sipërfaqe 926.55 Ha.*

(ii)VKM nr.45, datë 29.01.2014 ñPër kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërrmarjeve bujqësore dhe institucioneve kërkimore shkencore të kësaj ministrie aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronaveò, pika 1, ka kaluar në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së toka bujqësore në pronësi të shtetit me *sipërfaqe 18,076 Ha.*

(iii)VKM nr.142, datë 24.2.2016 ñPër kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Uëjrave të sipërfaqes së tokës bujqësore, në pronësi të shtetërore, në fshatin Vojnik, Njësia Administrative Maqellarë, Bashkia Dibërò ka kaluar në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së toka bujqësore në pronësi të shtetit me *sipërfaqe 31,4 Ha, pasuria nr.2/17, Zona Kadastrale 3811.*

Sa më sipër, fondi i tokës bujqësore në pronësi të shtetit në përgjegjësi administrimi të MBZHR është **19,033.95 ha.**

Nga kjo sipërfaqe janë dhënë me qira nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për periudhën 2013-2021 sipërfaqja prej 2,519 ha e 7,366 m^2.

Gjithashtu nga fondi i disponueshëm i tokave në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së, është kaluar sipërfaqa prej 617,68 ha nën administrim të AIDA-s, për zhvillimin e investimeve strategjike të programuara.

Për periudhën 2019-2021 është dhënë me qira sipërfaqja prej 714ha e 3,484m^2.
Aktualisht sipërfaqja e lirë e disponueshme në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së, për tâu dhënë me qira, është 15,896 ha e 5, 334 m^2.
Në bazë të ligjit nr.8318 datë 01.04.1998 ñPër dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetëroreò i ndryshuar, neni 17, shprehet se, rregjistrimi i kontratës së dhënies me qira të tokës në Zyrën e Rregjistrimit të Pasurisë së Paluajshme, është i përjashtuar nga pagesa e tarifës.
Ndërsa për pjesën e sipërfaqeve të lira në administrim nga MBZHR, të përfituara sipas VKM-të e mësipërme, u konstatua se, gjendja juridike e sipërfaqes së lirë prej 15 896 ha e 5334m^2 është e pa rregjistruar pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, duke rritur riskun e tjetërsimit të pronave bujqësore, nga palë të treta. Ndërsa sipërfaqja prej 3137 ha është rregjistruar, në momentin kur ka filluar procedura e dhënies me qira të tokës bujqësore nga MBZHR, por nga auditimi Pasqyrave financiare për vitin 2019 dhe 2020, llogaria (210) ñtoka, trojeò figuron në vlerën 0 lekë.
Kjo situatë është e mbartur në vite në Ministrinë e Bujqësië dhe nga struktura përgjegjëse të saj, nuk është ndërmarrë asnjë masë për rregjistrimin e sipërfaqes në pronësi.
-Lidhur me fondin e tokës bujqësore disponibël shtetërore, objekt i VKM-së nr. 45/2014, ñPër kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe ishinstitucioneve kërkimore-shkencore të kësaj ministrie, aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronaveò
Nga auditimi u konstatua se, me shkresë nr.7254 prot datë 24.09.2019 të MBZHR nga Sekretari i Përgjithshëm, i është kërkuar Këshillit të Ministrave, vënia në dispozicion të kopjes së njëhësuar me origjinalin e listës së inventarit për pasuritë përfshirë në Vendimin nr.45, datë 29.01.2014 të Këshillit të Ministrave, por nga Këshilli i Ministrave nuk ka pasur asnjë përgjigje në lidhje mbi këtë kërkesë.
II. MBZHR, në mbështetje të VKM nr.373, datë 20.06.2018 ñPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe të kontratës TIP për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar, ka lidhur **10 kontrata** *mbas janarit të vitit 2019 deri në dhjetor të vitit 2020* dhe **1 kontratë** *deri më 31.03.2021*, të cilat janë audituar në lidhje mbi përcaktimin e kritereve, mbi përllogaritjen e vlerës së çmimit të qirasë së tokës bujqësore, mbi përzgjedhjen e subjektit qiramarrës, mbi hartimin dhe miratimin e kontratës si dhe ecurinë e moritorimit të kontratës deri më 31.03.2021.
Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, **40 kontrata** janë lidhur sipas VKM nr.460, datë 22.5.2013 ñPër përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò ndryshuar, me VKM nr.373, datë 20.06.2018, për periudhën nga viti 2013 deri në janar të vitit 2019, *duke përzgjedhur disa prej tyre për auditim, në lidhje për fazën e ecurisë së monitorimit të kontratës*.
Në bazë të të Urdhërave të Kryeministrit nr.168, datë 05.10.2017 ñPër miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Ruralò i ndryshuar me Urdhër të Kryeministrit nr.39 datë 22.01.2021, ku sipas rregulloreve të brëndshme të miratuara nga titullari i MBZHR me urdhërat nr.324/1 datë 25.09.2018 ñPër miratimin e strukturës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Ruralò dhe nr.4276 prot datë 02.06.2021, është Sektori i Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të Kontratave me përbërje (1 shef sektori dhe 3 specialistë) pranë Drejtorisë së Prokurimeve dhe Partneriteteve, përgjegjës për monitorimin dhe mbajtjen e regjistrit të kontratave të qerasë dhe ecurinë e up date të tyre, në përbushje të detyrave funksionale.
Kjo strukturë nuk ka punuar asnjëherë me staf të plotë me burime njërëzore si dhe punonjësit e pakët e këtij sektori, përtej kryerjes së detyrave funksionale, janë përfshirë rast pas rasti nga titullari i MBZHR, duke marrë pjesë edhe në:
(1) grupet të vlerësimit në terren, të tokës bujësore që jepet me qira, me detyrë për, verifikimin e gjendjes faktike të sipërfaqes së tokës bujqesore, verifikimin e gjendjes e infrastruktures ujitëse dhe kulluese te saj, distancën nga tregjet, nivelin e industrisë agropërpunuese, si dhe shkallën e

zhvillimit të infrastrukturës rrugore të zonës;
(2) grupet e përllogaritjes së vlerës së çmimit të qerasë vjetore për tokën që jepet me qira, me detyrë për, përcaktimin e shkallës së bonitetit të tokës me qëllim përcaktimin e qerasë fillestare minimale, mbivlerën e të cilës shtohen (në %) dhe komponentë të tjerë[5].
Kështu,vendosja në grupe të ndryshme, për propozimin, miratimin, monitorimin, në të njëjtën kohë, nuk është në përputhshmëri, sipas kërkesave që dikton ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar.
Sa më sipër, në lidhje mbi punën e monitorimit të kontratave nga sektori bashkëfinancimit, partneriteteve dhe monitorimit të kontratave, për periudhën e audituar, u konstatua se;
- **deri në në fund të vitit 2019**, ka realizuar 8 monitorime, nga 40 kontrata në fuqi (ose monitoruara rreth 20 % të kontratave) ;
-**përgjatë vitit 2020**, ka realizuar 6 monitorime nga 50 kontrata ne fuqi (ose monitoruara rreth 12% të kontratave);
-**përgjatë 3 mujorit të parë të vitit 2021**, nuk ka realizuar asnjë monitorim nga 51 kontrata.
Pra, sektori bashkëfinancimit, partneriteteve dhe monitorimit të kontratave, nuk ka mundur të realizojë me efektivitet dhe cilësi, monitorimin e kontratave të qirasë, duke mos përmbushur detyrimin qe parashikon kreu VII ñMonitorimi i kontrataveò, pika 5 e VKM nr. 373, datë 20.6.2018 ñPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò, ku kërkohet që për çdo kontratë të lidhur, në fund të vitit struktura përgjegjëse në MBZHR, harton raport të hollësishëm për respektimin e kushteve të secilës kontratë dhe ia paraqet ministrit brenda datës 20 janar.
Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, edhe një strukturë ndihmëse,Sekretariati Teknik i Komisionit Qeveritar të Tokës, nuk funksionon prej datës 31.12.2019, për shkak të shfuqizimit të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008 ñPër shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokënò, i ndryshuar.
Pra si përfundim, struktura përgjegjëse e vetme (sektori i bashkëfinancimit, partneriteteve dhe monitorimit të kontratave) për monitorimin e kontratave të qirasë të tokës bujqësore, nuk është me kapacitet të plotë me burime njërëzore si dhe vendosja e punonjësve të pakët nga ana e titullarit të MBZHR, në disa procese pune në të njëjtën kohë, konkretisht; për vlerësimin e tokës në terren, përllogaritjen e vlerës së çmimit të qerasë vjetore , për hartimin e kontratës së qirasë si dhe monitorimin e tyre, nuk ka bërë të mundur të kemi efektivitet të plotë të monitorimit të ecurisë së kontratave të qirasë të tokave bujqësore, kjo në kundërshtim me detyrimin që parashikon VKM nr. 373, datë 20.6.2018 ñPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò kreu VII ñMonitorimi i kontrataveò, pika 5 si dhe me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar.
Grupi i auditimit, auditoi 7 kontrata të cilat kanë të bëjmë me realizimin e dhënies me qira në vitet 2019 deri në 31.03.2021 dhe 8 kontrata të cilat kanë të bëjnë me monitorimin e tyre, të lidhura nga viti 2013 deri në fillim të 2019.
Pra në total janë audituar 15 kontrata ose 29.4 % , nga 51 kontrata të cilat kanë objektin e dhënies me qira të tokës bujqësore.
Më poshtë po paraqesin disa prej procedurave të audituara në lidhje mbi realizimin e procedurës së dhënies me qira dhe pjesa e monitorimit të tyre, për të cilat kemi konstatuar problematikat, si vijon:
Auditimi i përputhshmërisë dhe financiar, në lidhje mbi ecurinë e realizimit të procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit, në administrim të MBZHR.

[5] 1. Gjendja e infrastruktures ujitëse dhe kulluese te saj,
2. Distanca nga tregjet (pika grumbullimi, tregjeve te zonave urbane)
3. Shkallen e e zvillimit të infrastruktures rrugore të zonës
4. Distanca nga sipërmarrjet agro-përpunuese(të produkteve bujqesore ose blegtorale)

Nga auditimi u konstatua se, disa prej kontratave vlera e qirasë nuk është paguar në kohë dhe si rrjedhojë janë krijuar penalitete si pasojë e mos plotësimit të detyrimit kontratator, të cilat po i paraqesim më poshtë të trajtuara së bashku me problematikat e tjera të evidentuara.

1.SUBJEKTI "G.E.F." SHPK

-Nga auditimi u konstatua se, subjekti juridik shoqeria ñG.E. F.ò shpk me NIPT L92607203V, me shkresë nr.2909 prot datë 08.04.2019 ka shprehur kërkesen dhe ofertën pranë MZHBR për marje toke bujqësore në pronesi të shtetit me qera, për 99 vite, për të kultivuara kulturën (Bajame).

-Nga MBZHR, në mbështetje të VKM nr.373 datë 20.06.2018, Kreu IV ñ Procedurat që ndiqen për dhënien e tokave bujqesore në pronesi të shtetit ñ pika 3 shkronja (b) dhe (f) me shkresë nr.2909/2 datë 09.04.2019, i është kërkuar shoqeria ñG.E F.ò shpk, plotësimi i dokumentacionit respektiv dhe në përbushje të tij, me shkresë nr.3740 prot datë 08.05.2019 shoqeria ñG.E F.ò shpk, ka ridërguar kërkesen pranë MBZHR për marjen e tokës bujqësore në pronësi të shtetit me qera.

-Nga MBZHR (sektori i bashkëfinancimit, partneriteteve dhe monitorimit të kontratave) pas verifikimit të bërë dokumentave të dorëzuara nga subjekti, ka kërkuar miratimin e fillimit të procedurës së dhënies së tokës bujqësore me qera, me Memo me shkresë nr.3740/1 prot datë 09.05.2020, drejtuar titullarit Ministri të MBZHR, i cili me shkresat nr.4164 prot datë 22.05.2019, nr.4165 prot datë 22.05.2019, duke ngritur grupet e punës:

(i) për verifikimin në terren mbi gjendjen faktike të sipërfaqes bujqesore, i cili ka konstatuar se tregu më i afert për grumbullimin e produkteve bujqësore ndodhet në qytetin e Cerrikut dhe distancë nga parcelat është 7 km.

(ii) për përgatitjen e procedurës konkurruese dhe për llogaritjen e cmimit vjetore fillestar të qerasë, ku me anë të shkresës nr.4165/1 prot datë 20.08.2019 gupi i punes pas verifimimeve në terren është bërë përllogaritja e qerasë.

- Boniteti klasa II është në vlerën prej 15,000 lekë/ha
- Infrastruktura ujitëse/kulluese 20%
- Infrastruktura rrugore 20%
- Largësia nga tregu 15%
- Niveli i industrisë agropërpunuese 10%
- 15000 leke x 65% = 9750 lekë/ha

Total i vlerës 15,000 + 9,750 = 24,750 lekë/ha

Përllogaritja e qërase nga grupi i punës për siperqaqen 31,981 ha është:

31,981 ha x 24,750 lekë = **791,529.750** lekë/viti.

Grupi i auditimit, nga verifikimi i dokumentave në dosjen fizike, konstatoi se përllogaritja e qerasë për zëri ñlargësia nga treguò grupi i punës e ka llogaritur largesin 7 km largesine nga tregu dhe është llogaritur 15% por në fakt duhet të ishte 25% pasi sipas udhezimit nr.12 datë 30.07.2018 Kreu IV ñKriteret e Përcaktimit të vlerës minimale të qerase së tokes bujqësore shtetëroreò përcaktohët se 0-10 km vlera e qerasë fillestare (në %) mbi vlerën minimale është 25%. Dhe përllogaritja e qerasë duhet të ishte:

- Boniteti klasa II eshte ne vlerën 15,000 lek/ha
- Infrastruktura ujitëse/kulluese 20%
- Infrastruktura rrugore 20%
- **Largësia nga tregu 25%**
- Niveli i industrisë agropërpunuese 10%
- 15000 leke x**75%** = 11250lekë/ha

Total i vlerës 15,000 + 11250= **26250** lekë/ha

Përllogaritja e qerase për siperqaqen 31,981 ha është:

31,981 ha x 26,250 lekë =**839,501.250** lekë/viti.

Sa më sipër, për llogaritjen e cmimit vjetore fillestar të qerasë me përbërje (M.K., L.K.dhe M.S.), është bërë më pak në vlerën prej **47,971 lekë** në vit, por nga subjekti është ofruar që vlera e qirasë të jetë në vlerën prej 900,000 lekë /vit e cila është referuar dhe në Kontratën nr.5414 rep, nr.936/2 kol, nr.7864/6 prot date 15.11.2019 duke mos sjellë efekt negative në ardhurat dytësore të Buxhetin e shtetit.

-Nga auditimi mbi zhvilimine procedures, u konstatua, se nga MBZHR është realizuar në përputhje me VKM nr.373 datë 20.06.2018, Kreu IV ñ Procedurat që ndiqen për dhënien e tokave bujqesore në pronesi të shtetitò dhe në përfundim Bordi i Vlerësimit të Ofertave (BVO) i ngritur me Urdhër nr.6766 prot datë 27.08.2020 nga Titullari i MBZHR, sipas
Oferta të dorëzuara për dhenien e tokës bujqësore shtetërore me qira janë:

Nr	Subjektet	Oferta lekë	Kualifikuar/S'Kualifikuar
1	ñG.E F.ò	900,000	**Kualifikohet**
2	ñE.P.ò	795,000	**Skualifikohet** Nuk ploteson dokumentacionin conform kërkesave dhe kritereve të përcaktuara në vendimin nr.373 datë 20.06.2018.

Ka kualifikuar, me shkresë nr.4165/2 prot datë 07.11.2019, duke bërë njoftimin e fituesit subjektin ñG.E F.ò, i cili ka paguar detyrimin e pagesës së 2% në vlerën 774,865.00 lekë të sigurimit të investimeve të parashikuar në plan bisnesin, kjo në bazë të mandate pagesës nr. Serial 070120020028687 datë 14.11.2019 paguar pranë Kompanisë e Sigurimit Eurosige cila citon: *Ky sigurim eshte I vlefshme deri ne zbatimin e plote të kontratës.*
Kontratën nr.5414 rep, nr.936/2 kol, nr.7864/6 prot date 15.11.2019 është lidhur midis subjektit ñG.E F.ò, dhe MBZHR, me kohëzgjatje me afat për 99 vite.
-Zbatimi i Kontratës, në bazë nga Kontrata e qirasë dhe Plan Biznesi i miratuar në procedurën konkuruese për dhënien me qira të sipërfaqes së sipërcituar**, u konstatua se,**

- Investime në ngritjen e pemtores: 2,153,800 lekë
- Investime në mbjelljen e të gjithë sipërfaqes: 13,043,856 lekë
- Investime në sistemin e ujitjes: 20,309,990 lekë
- Investime në infrastrukturë (magazinë): 3,235,566 lekë
- Pagat e administratorit dhe specialistëve të kontraktuar: 3,600,000 lekë
- Kostot e hartimit të projektit: 120,000 lekë
- Garancia e aplikimit për tokën bujqësore: 65,960 lekë
- Qiraja bujqësore dhe kosto të tjera paguar në Shtet: 791,530 lekë
- Investimi në total: 43,320,702 lekë

Grupi i auditimit, nga verifikimi i dokumentave në dosjen fizike, konstatoi se,
(a) Sigurimi i kontratës për vitin e parë është konform VKM nr.373 datë 20.06.2018, ndersa për vitin pasëardhes nuk është dorezuar sigurimi, pasi në sigurimin e dorëzuar vitin e parë kompania e sigurimit citon se: *Ky sigurim eshte i vlefshme deri në zbatimin e plote të kontratës.* Në kundështim me VKM nr.373 datë 20.06.2018 dhe Kontratën nr.5414 rep, nr.936/2 kol, nr.7864/6 prot date 15.11.2019. neni 5, shprehet se :*Sigurimi i Kontratës lëshohet për një afat kohor 1-vjeçar dhe do të rinovohet çdo vit deri në përfundimin e investimeve kapitale të parashikuara. Qiramarrësi ka detyrimin të rinovojë dhe të paraqesë sigurimin e kontratës, 30 ditë kalendarike, para përfundimit të periudhës së garancisë paraardhëse.*
(b) Në kontratën e qirasë neni 1 ñObjekti, afati dhe vlera e kontratësò, pika 2, paragrafi i dytë, parashikohet se ñ*Palët bien dakord që vlera e qirasë vjetore për marrjen me qira të Pasurisë të jetë 900,000 (nëntëqind mijë) lekë vlera e qirasë vjetore ("Çmimi i Qirasë" ose "Qiraja"), sipas ofertës fituese të procedurës konkurruese dhe të përcaktuar me vendim nga autoriteti qiradhënës. Vlera e qirasë së tokës objekt i kësaj kontrate, parapaguhet nga ana e qiramarrësit. Pagesa e qirasë për vitin e parë të qiramarrjes kryhet si parapagim menjëherë në momentin e lidhjes së kontratës,<u>ndërsa për periudhën vijuese brenda tremujorit të parë të vitit përkatës</u>ò.*
Nga auditimi u konstatua se, subjekti qiramarrësi ñG.E F.ò shpk ka kryer pagesat e qirasë si më poshtë :
-Viti i parë, pagesa është bërë më datë 11 shkurt 2020, në vlerën 900,000 lekë, kjo në kundërshtim me parashikimet në kontratë, pagesa duhet të ishte paguar menjëherë në momentin e nënshkrimit të kontratës, pra është në vonesë 87 ditë. Në zbatim të nenit 1, dhe nenit 7, pika 1 të kontratës, 1

ditë vonesë × 0.5 % e detyrimit vjetor të qirasë = 4,500 lekë kamatëvonesa ditore. Kamat vonesë ditore (4,500 lekë) x 87 ditë (nga 16 nëntor 2019 deri 11 shkurt 2020) = 391,500 lekë.
-Viti i dytë , pagesa është bërëmë datë 15 janar 2021, ka paguar shumën 400,000 lekë, ndërsa pjesa tjetër prej 500.000 lekë, është paguar me datë 04.05.2021. Kjo në kundërshtim me parashikimet në kontratë, ku pagesa duhet të ishte kryer brenda tre mujorit të parë të vitit përkatës, deri me datë 15.02.2021. Për pjesën e paguar prej 500,000 lekë qiramarrësi është në vonesë 77 ditë dhe në zbatim të nenit 1 pika 3 dhe nenit 7 pika 1 të kontratës, detyrimi i shlyer me vonesë është 500,000 lekë, 1 ditë vonesë × 0.5 % e detyrimit pjesor të qirasë (500,000 lekë) = 2,500 lekë kamatëvonesa ditore. Kamat vonesë ditore (2,500 lekë) x 77 ditë (nga 16 shkurt 2021 deri 4 maj 2021) = 192,500 lekë.
Sa më sipër, si pasojë e pagesës së qirasë për ditë të vonuara, janë krijuar Të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 584,000 lekë për Kontratën_nr.5414 rep, nr.936/2 kol, nr.7864/6 prot date 15.11.2019.Ky detyrim është paguar më datë 30.08.2021 nga subjekti ñG .E F.òshpk, paraqitur me anë të mandatit të pagesës nga MBZHR, me sobservimet me shkresë nr.3501/8 prot datë 28.12.2021.
Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, në bazë të kontratëssë qirasë neni 6 shprehet se, ñZgjidhja e kontratësò pika 3/3.1, parashikohet se ñ*Qiradhënësi ka të drejtë të zgjidhë në mënyrë të njëanshme kontratën në rast të konstatimit të mospërmbushjeve të detyrimeve nga Qiramarrësi"* si më poshtë*: 3.1 Qiramarrësi nuk ka paguar vlerën e qirasë brenda afatit të përcaktuar në kontratë. Në këtë rast Qiradhënësi dërgon një njoftim paraprak për mospërmbushjen e konstatuar dhe inicimin e zgjidhjes së kontratës. Në rast se qiramarrësi nuk ekzekuton detyrimin brenda 30 ditëve nga dërgimi i njoftimit, Qiradhënësi njofton Qiramarrësin për vendimin për zgjidhjen e kontratës, si dhe përcakton datën në të cilën përfaqësuesit e tij të autorizuar do të marrin në dorëzim tokën*ò.
Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, parashikon se :
Neni 830 ñQiramarrësi shlyen çmimin e qirasë në kohën dhe në mënyrën e caktuar në kontratëò;
Neni 835 ñShlyerja e çmimit të qirasëò ñ*Çmimi i qirasë shlyhet sipas afateve të caktuara në kontratë*ò.
Kështu, nga MBZHR me shkresë nr.2711 prot datë 06.04.2021, për shlyerjen e detyrimeve financiare si shkak i mos plotësimit të detyrimeve kontraktore, për shumën prej 1,079,500 lekë si vlerë qiraje e papaguar viti 2021 dhe kamatvonesa në pagesën e saj (vitit 2019-2021), brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi, si dhe është bërë me dije se në rast të mospagesës brenda këtij afati MBZHR, do të zbatojë detyrimet kontratore.
Gjithashtu, nga auditimi në dosjen fizike, u konstatua se, në lidhje mbi zbatimin e planit të biznesit, nga struktura monitoruese e kontratave më datë 21.01.2021 është verrifikuar në terren, duke rezultuar se, ñ*..sipërfaqja e pasurive me nr.349, nr.350, nr.340/20 ishte e mbjellë me kulturën e bajameve. Ishin kryer pastrimet e nevojshme të kanaleve të kullimit midis parcelave por edhe kanalit kryesor. Ishin vendosur tombinot për të lejuar kalimin e ujit drejt kanaleve dhe gjithashtu ishte ndërtuar dhe një urë betoni e cila lidhte parcelën me rrugën kryesore. Ishin kryer investime në sistemin ujitës, ku në të gjithë parcelat ishte shtrirë sistemi ujitës me pika, i cili garanton një ujitje të plotë dhe të sigurt për gjithë periudhën vjetore. Pasuria nr.348 e cila është dorëzuar më vonë, për shkak të problematikave të zaptimit të zgjidhura, ishte e punuar, pluguar dhe e sistemuar bërë gati për mbjelljen e fidanëve.*
Në këtë proces i është lënë detyrë përfaqësuesit të qiramarrësit të paraqesë pranë Njësisë në MBZHR faturat të cilat vërtetojnë investimet e kryera si dhe të shlyejë në kohë vlerëne qirasë vjetore."
Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, në kontratë parashikohet që i gjithë investimi i parashikuar të realizohet vitin e parë të qiramarrjes. Qiramarrësi ka paraqitur faturat në vlerën e përgjithshme 11,055,504 lekë, e llogaritur në përqindje ka realizuar investimet 25.52% pra jo 100% siç është parashikuar si dhe në bazë të neni 6 ñZgjidhja e Kontratësò, pika 10, shkronja ñaò, parashikon se ñ*Verifikimi i realizimit të programit të investimeve kapitale bëhet nga grupi i monitorimit i ngritur për këtë qëllim nga Qiradhënësi", si më poshtë: Nëse në përfundim të vitit të parë konstatohet që Qiramarrësi nuk ka realizuar vlerën e investimeve kapitale të parashikuara në*

Planin e Biznesit për këtë vit, atëherë Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë prishjen e kontratës dhe sekuestrimin e garancisë".

Sa më sipër, nga MBZHR, duhej të merreshin të gjitha veprimet administrative për të bërë të mundur realizimin në kohë të detyrimeve kontraktore, për të pasur kontratë të sukseshme, në të kundërt MBZHR pasi të ketë ezuruara të gjitha veprimat administrative për shlyerjen e detyrimeve financiare të prapambetura , të zbatojë detyrimin kontraktor e miratuar në kontratë.

2.SUBJEKTI "N." SHPK

-Nga auditimi u konstatua se, subjekti juridik ñN.ò shpk me NIPT K63413003I, me shkresë nr.1784 prot datë 20.02.2019 ka shprehur kërkesen dhe ofertën pranë MZHBR për marje toke bujqësore në pronesi të shtetit me qera, për 99 vite, për krijimin e vrështave të rrushit.

-Nga MBZHR (sektori i bashkëfinancimit, partneriteteve dhe monitorimit të kontratave) pas verifikimit të bërë dokumentave të dorëzuara nga subjekti, ka kërkuar miratimin e fillimit të procedurës së dhënies së tokës bujqësore me qera, me Memo me shkresë nr.1784/1 prot datë 20.02.2019, drejtuar titullarit Ministri të MBZHR, i cili me shkresat nr.1848 prot datë 21.02.2019 dhe nr.1849 prot datë 21.02.2019, duke ngritur grupet e punës:

(i) për verifikimin në terren mbi gjendjen faktike të sipërfaqes bujqesore, i cili ka konstatuar se nuk kishte sistem të ujitjes dhe kullimit ne këto parcela.

(ii) për përgatitjen e procedurës konkurruese dhe për llogaritjen e cmimit vjetore fillestar të qerasë, ku me anë të shkresës nr.1848/2 prot datë 18.03.2019 gupi i punes pas verifimimeve në terren ka bërë përllogaritja e qerasë.

- Boniteti klasa VIII-IX është në vlerën prej 6,000 lekë/ha
- Infrastruktura ujitëse/kulluese 0%
- Infrastruktura rrugore 20%
- Largësia nga tregu 15%
- Niveli i industrisë agropërpunuese 25%
- 6000 leke x 60% = 3600 lekë/ha

Total i vlerës 6,000 + 3,600 = 9,600 lekë/ha

Përllogaritja e qërase nga grupi i punës për siperqaqen 15.399 ha është:

15.399 hax 9,600 lekë/ha = 147836.16 lekë/viti.

-Nga auditimi, mbi dhënien e procedurës me qira, u konstatua, se nga MBZHR është realizuar në përputhje me VKM nr.373 datë 20.06.2018, Kreu IV ñ Procedurat që ndiqen për dhënien e tokave bujqësore në pronesi të shtetitò dhe në përfundim Bordi i Vlerësimit të Ofertave (BVO) i ngritur me Urdhër nr.4498 prot datë 05.06.2019 të titullarit të MBZHR, sipas procesverval nr.5509/1 datë 09.07.2019, pas verifikimit të ofertës së ardhur deklaroi se ofertuesit i mungon dokumentacioni i paraqitur sipas VKM nr.373 datë 20.06.2018, Kreu III pika 9 shronja b dhe d.

Me urdhër nr.433 prot datë 23.07.2019, duke vendosur anullimi i procedurës së konkurimit për dhënien me qira të tokës bujqësore në pronesi të shtetit.

Më pas, me shkresë nr.6032 prot datë 29.07.2019 është urdhëruar fillimi i procedurës së konkurimit për dhënien me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit, duke konstatuar, se zhvillimi i procedurës, është realizuar në përputhje meVKM nr.373 datë 20.06.2018, Kreu IV ñProcedurat që ndiqen për dhënien e tokave bujqesore në pronesi të shtetitò dhe në përfundim Bordi i Vlerësimit të Ofertave (BVO) i ngritur me Urdhër nr.5509/1 datë 09.07.2019 nga Titullari i MBZHR,

Oferta të dorëzuara për dhenien e tokës bujqësore shtetërore me qira janë :

Nr	Subjektet	Oferta lekë	Kualifikuar/S'Kualifikuar
1	ñN.ò	150,000	**Kualifikohet**

BVO ka kualifikuar, me shkresë nr.6979/3 prot datë 18.09.2019, duke bërë njoftimin e fituesit subjektin ñN.ò, i cili ka paguar detyrimin e pagesës së 2% në vlerën 1,231,305.7 lekë të sigurimit

të investimeve të parashikuar në plan bisnesin, kjo në bazë të pagesës nr.Serial 0000770 datë 17.10.2019 paguar dhe ngurtesuar pranë Kompanisë së Sigurimit I..
Kontrata nr.4818 rep, nr.878/2 kol, nr.6979/7 prot datë 23.10.2019 është lidhur midis subjektit ñN.ò dhe MBZHR, me kohëzgjatje me afat për 30 vite.
-Mbi auditimin në lidhje mbi zbatim/monitorim i Kontratës, u konstatua se, me shkresë nr.680 prot datë 19.01.2021 MZHBR i kërkon informacion subjektit mbi realizimin e kontratës se qerasë.
Me procesverbal nr.680/1 date 21.01.2021 struktura përgjegjëse për monitorimin e kontratës së qerasë (Sektori i Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të Kontratave) pranë MZHBR ka kryer monitorimin në terren duke verifikuar se, subjekti qiramarrës ñN.ò, nuk ka kryer asnjë investim të parashikuar në plan biznes.
Me shkrese nr.1771 datë 02.02.2021 ardhur pranë MZHBR, subjekti qiramarrës shprehet se nuk ka realizuar investimet e parashikuara në plan biznes për arsye:
1. Pandemisë botërore të shkaktuara nga COVID-19.
2. Shpallja e gjendjes së jashtë zakonshme për shkak te fatkeqesise natyrore te shkaktuara nga COVID-19 për një periudhe 3 mujore.
3. Termeti i nëntorit bëri që sektori i K.ve të ishte me i demtuari.
Nisur nga situata e mësipërme, midis MBZHR dhe subjektit ñN.ò, është realizuar Marrëveshje Siguruese (Amendim Kontratë) nr.1702 rep, nr.184 kol, nr 1171/1 prot datë 17.05.2021, nga ku është parashikuar afati për fillimin e investimeve sipas plan biznesit tëfillojë nga momentii nënshkrimit të kesaj marveshje nga palët.
Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2021 është bërë pagesa së 2% në vlerën 1,194,475.71 lekë të sigurimit të investimeve të parashikuar në plan bisnesin, kjo në bazë të Letër Garancisë nr.serial 0000775 datë 21.05.2021 ngurtesuar pranë Kompanisë së Sigurimit I..
PROBLEMATIKA:
a) Në kontratën e qirasë neni 1 ñObjekti, afati dhe vlera e kontratësò, pika 2, paragrafi i dytë, parashikohet se ñ*Palët bien dakord që vlera e qirasë vjetore për marrjen me qira të Pasurisë 150,000 (njëqind e pesedhjetë) lekë/ha/viti ("Çmimi i Qirasë" ose "Qiraja"), sipas ofertës fituese të procedurës konkurruese dhe të përcaktuar me vendim nga autoriteti qiradhënës. Vlera e qirasë së tokës objekt i kësaj kontrate, parapaguhet nga ana e qiramarrësit. Pagesa e qirasë për vitin e parë të qiramarrjes kryhet si parapagim menjëherë në momentin e lidhjes së kontratës, ndërsa për periudhën vijuese brenda tremujorit të parë të vitit përkatës*ò.
Nga auditimi u konstatua se, subjekti qiramarrësi ñN.ò shpk ka kryer pagesat e qirasë si më poshtë:
-Viti i parë më datë 06 nentor 2019, në vlerën 150,000 lekë, kjo në kundërshtim me parashikimet në kontratë, pagesa duhet të ishte paguar menjëherë në momentin e nënshkrimit të kontratës, pra është në vonesë 13 ditë me vonesë. Në zbatim të nenit 1, dhe nenit 7, pika 1 të kontratës 1 ditë vonesë × 0.5 % e detyrimit vjetor të qirasë = 750 lekë kamatëvonesa ditore. Kamatë vonesa ditore (750 lekë) x 13 ditë (nga 24 tetor 2019 deri 06 nentor 2019) = **9,750** lekë.
-Viti i dytë më datë 10.03.2021, është pagura qeraja e tokës në shumën 150,000 lekë, kjo në kundërshtim me parashikimet në kontratë, ku pagesa duhet të ishte kryer brenda tremujorit të parë të vitit përkatës, deri me datë 23.01.2021. pra është në vonesë 45 ditë me vonesë. Në zbatim të nenit 1, dhe nenit 7, pika 1 të kontratës 1 ditë vonesë × 0.5 % e detyrimit vjetor të qirasë = 750 lekë kamatëvonesa ditore. Kamatë vonesa ditore (750 lekë) x 45 ditë (nga 24.01.2021 deri 10.03.2021) = 33,750 lekë.
Sa më sipër, si pasojë e pagesës së qirasë për ditë të vonuara, janë krijuar Të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 43,500 lekë për Kontratën nr.4818 rep, nr.878/2 kol, nr.6979/7 prot datë 23.10.2019. Kjo pagesë është likujduar më datë 23.12.2021 nga subjekti, bashkëshoqëruar me mandatin e pagesës , përcjellë nga MBZHR në observimet me shkresë nr.3501/8 prot datë 28.12.2021.

3.SUBJEKTI "A.B.F" SHPK

-Nga auditimi u konstatua se, Shoqeria ñA.B.Fò shpk me NIPT L73128401P, me shkresë nr.9664 prot datë 17.10.2018 ka paraqitur kërkesen dhe ofertën pranë MZHBR për marrje me qira tokë bujqësore në pronesi të shtetit, për 99 vite, për kultivimin e arrorëve (lajthi shegë kivi).
-Nga MBZHR (Sektori i bashkëfinancimit, partneriteteve dhe monitorimit të kontratave) pas verifikimit të bërë dokumentave të dorëzuara nga subjekti, ka kërkuar miratimin e fillimit të procedurës së dhënies së tokës bujqësore me qera, me Memo me shkresë nr.9664/2 prot datë 05.11.2018, drejtuar titullarit Ministri të MBZHR, i cili me shkresat nr.9664/6 prot datë 15.11.2018 dhe nr.9664/7 prot datë 15.11.2018, duke ngritur grupet e punës:
(i) për verifikimin në terren mbi gjendjen faktike të sipërfaqes bujqesore, i cili ka konstatuar se infrastruktura ujitjes dhe kullimit ne këto parcela nuk ekziston, tregu me i afërt për grumbullimin e produkteve bujqesore ndhidhet ne qytetitn e Fierit dhe distance është 20 km, niveli i industrisë agropërpunuese është e pa zhvilluar dhe ndodhet ne qytetin e Fierit dhe distancë është 20 km, zhvillimi i infrastrukturës rrugore jo i mirë, distancë nga rruga kryesore është 16 km.
(ii) për përgatitjen e procedurës konkurruese dhe për llogaritjen e çmimit vjetore fillestar të qerasë, ku me anë të shkresës nr.9664/9 prot datë 26.06.2019 të grupit të punësi i ngritur me Urdhër nr.9664/7 prot datë 15.11.2018, pas verifimimeve në terren ka bërë përllogaritja e qerasë.

1.Parcela nr 84/1 sipërfaqe 13.68 ha

- Boniteti klasa III është në vlerën prej 12,000 lekë/ha
- Infrastruktura ujitëse/kulluese 0%
- Infrastruktura rrugore 10%
- Largësia nga tregu 0%
- Niveli i industrisë agropërpunuese 0%

12,000 leke x 10% = 1200 lekë/ha
Total i vlerës 12,000 + 1,200 = 13,200 lekë/ha
Përllogaritja e qërase nga grupi i punës për siperqaqen **13.68** ha është:
13.68ha x 13,200 lekë/ha = 180,576 lekë/viti.

2.Parcela nr 84/3 sipërfaqe 8.68 ha

- Boniteti klasa II është në vlerën prej 15,000 lekë/ha
- Infrastruktura ujitëse/kulluese 0%
- Infrastruktura rrugore 10%
- Largësia nga tregu 0%
- Niveli i industrisë agropërpunuese 0%

15,000 leke x10% = 1500 lekë/ha
Total i vlerës 15,000 + 1,500 = 16,500 lekë/ha
Përllogaritja e qërase nga grupi i punës për siperqaqen **8.68** ha është:
8.68 ha x 16,500 lekë/ha =143,220 lekë/viti.

3.Parcela nr 84/8 sipërfaqe 7.06 ha

- Boniteti klasa III është në vlerën prej 12,000 lekë/ha
- Infrastruktura ujitëse/kulluese 0%
- Infrastruktura rrugore 10%
- Largësia nga tregu 0%
- Niveli i industrisë agropërpunuese 0%

12,000 leke x 10% = 1200 lekë/ha
Total i vlerës 12,000 + 1,200 = 13,200 lekë/ha
Përllogaritja e qërase nga grupi i punës për siperqaqen 7.06 ha është:
7.06 ha x 13,200 lekë/ha =93,192 lekë/viti.
Vlera e përgjithshme për dhenien e tokes me qera të siperqaqes 29.42 ha është 416,988 lekë/viti
Grupi i auditimit, nga verifikimi i dokumentave në dosjen fizike, konstatoi se, përllogaritja e qerasë për zërin largësia nga tregu, infrastruktura rrugore dhe niveli i industrisë agropërpunuese, nga grupi i punës i MBZHR, nuk është llogaritur drejtë përqindjet dhe nuk është mbajtur i njëjtin standart llogaritje, në krahasim me procedurat e tjera të dhënies së tokave shtetërore më qera.
Përllogaritja e qerasë sipas formulës së përdorur në procedurat e tjera duhet të ishte:

1. Parcela nr 84/1 sipërfaqe 13.68 ha
- Boniteti klasa III është në vlerën prej 12,000 lekë/ha
- Infrastruktura ujitëse/kulluese 0%
- Infrastruktura rrugore 15.6%
- Largësia nga tregu 12.5%
- Niveli i industrisë agropërpunuese 12.5%

12,000 leke x 40.6% = 4,872 lekë/ha
Total i vlerës 12,000 + 4,872 = 16,872 lekë/ha
Përllogaritja e qërase nga grupi i punës për siperqaqen **13.68** ha është:
13.68ha x 16,872 lekë/ha =230,809 lekë/viti.

2. Parcela nr 84/3 sipërfaqe 8.68 ha
- Boniteti klasa II është në vlerën prej 15,000 lekë/ha
- Infrastruktura ujitëse/kulluese 0%
- Infrastruktura rrugore 15.6%
- Largësia nga tregu 12.5%
- Niveli i industrisë agropërpunuese 12.5%

15,000 leke x 40.6% = 6,090 lekë/ha
Total i vlerës 15,000 + 6,090 = 21,090 lekë/ha
Përllogaritja e qërase nga grupi i punës për siperqaqen **8.68** ha është:
8.68 ha x 21,090 lekë/ha =183,061 lekë/viti.

3. Parcela nr 84/8 sipërfaqe 7.06 ha
- Boniteti klasa III është në vlerën prej 12,000 lekë/ha
- Infrastruktura ujitëse/kulluese 0%
- Infrastruktura rrugore 15.6%
- Largësia nga tregu 12.5%
- Niveli i industrisë agropërpunuese 12.5%

12,000 leke x 40.6% = 4,872 lekë/ha
Total i vlerës 12,000 + 4,872 = 16,872 lekë/ha
Përllogaritja e qërase nga grupi i punës për siperqaqen 7.06 ha është:
7.06 ha x 16,872 lekë/ha = 119,116 lekë/viti.
Për parcelen 84/1 me sipërfaqe 13.68 ha vlera e qeradhënies është 230,809 lekë/viti.
Për parcelen 84/3 me sipërfaqe 8.68 ha vlera e qeradhënies është 183,061 lekë/viti.
Për parcelen 84/8 me sipërfaqe 7.06 ha vlera e qeradhënies është 119,116 lekë/viti.
Vlera e përgjithshme për dhenien e tokës me qera të sipërqaqes 29.42 ha duhet të ishtë 532,986 lekë/viti.
Sa më sipër,nga grupi i punës për llogaritjen e cmimit vjetore fillestar të qerasë me përbërje (M.K., L.K.dhe M.S.), është përcaktuar në vlerën prej 416,988 lekë/viti.
Grupi auditimit ka përllogaritur vlerën prej *532,986 lekë/viti*, pra kemi diferencë prej *115,988 lekë/vit,* ndërsa nga subjekti ñA.B.Fò është ofruar dhe më pas është miratuar në kontratë, që vlera e qirasë të jetë në vlerën prej *500,140 lekë/vit* e cila është referuar dhe në Kontratën nr.180 rep, nr.33/4 kol, nr.317 prot date 15.01.2020 duke sjellë efekt negativë në ardhurat dytësore të Buxhetin e shtetit në vlerën 32,864 lekë për vite kalendarike.Kjo pagesë u likujdua më datë 24.12.2021 në bazë të mandatit të pagesën, dorëzuar nga MBZHR në observimet e sjella me shkresë nr.3501/8 prot datë 28.12.2021.
-Zhvilimi i procedures, nga auditimi u konstatua, se nga MBZHR është realizuar në përputhje me VKM nr.373 datë 20.06.2018, Kreu IV ñProcedurat që ndiqen për dhënien e tokave bujqesore në pronesi të shtetitò dhe në përfundim Bordi i Vlerësimit të Ofertave (BVO) i ngritur me Urdhër nr.8713 prot datë 12.11.2019 nga Titullari i MBZHR.

Oferta të dorëzuara për dhënien e tokës bujqësore shtetërore me qira janë:

Nr	Subjektet	Oferta lekë	Kualifikuar/S'Kualifikuar

1	ñA.B.Fò	500,1400	**Kualifikohet**

BVO kualifikuar, me shkresë nr.8837/3 prot datë 30.12.2019, duke bërë njoftimin e fituesit shoqerinë ñA.B.Fò shpk, i cili ka paguar detyrimin e pagesës së 2% në vlerën 1,674,952 lekë të sigurimit të investimeve të parashikuar në plan bisnesin, kjo në bazë të mandate pagesës nr. Serial 0134821 datë 15.11.2019 paguar pranë Kompanisë e Sigurimit S..
Kontratën nr.180 rep, nr.33/4 kol, nr.317 prot date 15.01.2020 është lidhur midis shoqërisë ñA.B.Fò shpk dhe MBZHR, me kohëzgjatje me afat për 99 vite.
PROBLEMATIKA:
a) Në kontratën e qirasë neni 1 ñObjekti, afati dhe vlera e kontratësò, pika 3, paragrafi i dytë, parashikohet se ñ*Palët bien dakord që vlera e qirasë vjetore për marrjen me qira të pasurisë 500,140 lekë/ha/viti ("Çmimi i Qirasë" ose "Qiraja"), sipas ofertës fituese të procedurës konkurruese dhe të përcaktuar me vendim nga autoriteti qiradhënës. Vlera e qirasë së tokës objekt i kësaj kontrate, parapaguhet nga ana e qiramarrësit. Pagesa e qirasë për vitin e parë të qiramarrjes kryhet si parapagim menjëherë në momentin e lidhjes së kontratës, ndërsa për periudhën vijuese brenda tremujorit të parë të vitit përkatës*ò.
Nga auditimi, u konstatua se subjekti qiramarrësi ñA.B.Fò shpk ka kryer pagesat e qirasë si më poshtë :
-Viti i parë pagësa është bërë më datë 29.01.2020, në vlerën prej 500,140 lekë, kjo në kundërshtim me parashikimet në kontratë, pagesa duhet të ishte paguar menjëherë në momentin e nënshkrimit të kontratës, pra është në vonesë 13 ditë me vonesë. Në zbatim të nenit 1, dhe nenit 7, pika 1 të kontratës 1 ditë vonesë × 0.5 % e detyrimit vjetor të qirasë = 2,501 lekë kamatëvonesa ditore. Kamat vonesë ditore (2,501 lekë) x 13 ditë (nga 16 janar 2020 deri 29 janar 2020) 32,509 lekë.

4. SUBJEKTI "R.S." SHPK
-Nga auditimi u konstatua se, Shoqeria ñR.S.ò shpk me NIPT L91709008O, me shkresë nr.4274 prot datë 27.05.2019 ka shprehur kërkesen dhe ofertën pranë MZHBR për marje toke bujqësore në pronesi të shtetit me qera, për 99 vite, për kultivimin e arrorëve dhe shegëve (arrorë, shegë, kivi)
-Nga MBZHR (sektori i bashkëfinancimit, partneriteteve dhe monitorimit të kontratave) pas verifikimit të bërë dokumentave të dorëzuara nga subjekti, ka kërkuar miratimin e fillimit të procedurës së dhënies së tokës bujqësore me qera, me Memo me shkresë nr.4274/1 prot datë 13.06.2019, drejtuar titullarit Ministri të MBZHR, i cili me shkresat nr.4274/11 prot datë 13.06.2019 dhe nr.4274/12 prot datë 13.06.2019, duke ngritur grupet e punës:
(i) për verifikimin në terren mbi gjendjen faktike të sipërfaqes bujqesore, i cili ka konstatuar se infrastruktura ujitjes dhe kullimit ne këto parcela nuk ekziston, tregu me i afërt për grumbullimin e produkteve bujqesore ndhidhet ne qytetitn e Fierit dhe distance është 20 km, niveli I industrisë agropërpunuese është e pa zhvilluar dhe ndodhet ne qytetin e fierit dhe distance është 20 km, zhvillimi I infrastructures rrugore jo i mirë, distance nga rruga kryesore është 16 km.
(ii) për përgatitjen e procedurës konkurruese dhe për llogaritjen e cmimit vjetorë fillestar të qerasë, ku me anë të shkresës nr.9664/9 prot datë 26.06.2019 gupi i punës pas verifimimeve në terren ka bërë përllogaritja e qerasë.
Vlera e përgjithsme për dhënien e tokës me qera të sipërqaqes 91.7552 ha duhet të jetë 775,089.576 lekë/viti.
- Nga auditimi u konstatua, se zhvillimi i proçedurës, nga MBZHR është realizuar në përputhje me VKM nr.373 datë 20.06.2018, Kreu IV ñProcedurat që ndiqen për dhënien e tokave bujqesore në pronesi të shtetitò dhe në përfundim Bordi i Vlerësimit të Ofertave (BVO) i ngritur me Urdhër nr.8713 prot datë 12.11.2019 nga Titullari i MBZHR.

Oferta të dorëzuara për dhenien e tokës bujqësore shtetërore me qira janë:

Nr	Subjektet	Oferta lekë	Kualifikuar/S'Kualifikuar

1	ñR.S.ò	780,000	**Kualifikohet**

BVO ka kualifikuar, me shkresë nr.8837/3 prot datë 30.12.2019, duke bërë njoftimin e fituesit shoqerinë ñR.S.ò shpk, i cili ka paguar detyrimin e pagesës së 2% në vlerën 3,870,860.40 lekë të sigurimit të investimeve të parashikuar në plan bisnesin, kjo në bazë të mandate pagesës nr. Serial 4577, BND0012285 datë 15.01.2020 paguar pranë Kompanisë e Sigurimit S.I..
Kontrata nr.178 rep, nr.32/4 kol, nr.311 prot datë 15.01.2020 është lidhur midis shoqërisë ñR.S.ò shpk dhe MBZHR, me kohëzgjatje për 99 vite.
-Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës u konstatua se, me shkresë nr.676 prot datë 19.01.2021 MZHBR i ka kërkuar informacion subjektit mbi realizimin e kontratës së qerasë.
Me process verbal nr.405/1 datë 27.01.2021 struktura përgjegjëse për monitorimin e kontratës së qerasë pranë MZHBR ka kryer monitorimin në terren, ku është verifikuar se, subjekti qiramarrës nuk ka kryer asnjë investim të parashikuar në plan biznes mbi të cilën ka konkuruar për marrjen e kontratës së tokës bujqësore.
Nga subjekti, me shkrese nr.684/1 datë 20.01.2021 ardhur pranë MZHBR, shprehet se nuk ka realizuar investimet e parashikuara në plan biznes për arsye të pandemisë botërore të shkaktuara nga COVID-19 dhe shpallja e gjëndjes së jashtë zakonshme për një periudhë 3 mujore. Subjekti qiramarrës ka kërkuar shtyrje të afatit për realizimin e investimeve.
Kështu, midis MBZHR dhe subjektit qiramarrës ñR.S.ò është bërë Marëveshje Siguruese (amendim) nr.1687 rep, nr.178 kol, nr 684/2 prot datë 12.05.2021, nga ku është parashikuar se afati për fillimin e investimeve sipas plan biznesit fillon nga momenti i nënshkrimit të kësaj marrëveshje nga palët.

PROBLEMATIKA:

a) Sipas kontratëssë qirasë neni 1 ñObjekti, afati dhe vlera e kontratësò, pika 3, paragrafi i dytë, parashikohet se ñ*Palët bien dakord që vlera e qirasë vjetore për marrjen me qira të Pasurisë 780,000 lekë/ha/viti ("Çmimi i Qirasë" ose "Qiraja"), sipas ofertës fituese të procedurës konkurruese dhe të përcaktuar me vendim nga autoriteti qiradhënës. Vlera e qirasë së tokës objekt i kësaj kontrate, parapaguhet nga ana e qiramarrësit. Pagesa e qirasë për vitin e parë të qiramarrjes kryhet si parapagim menjëherë në momentin e lidhjes së kontratës, ndërsa për periudhën vijuese brenda tremujorit të parë të vitit përkatës*ò.
Nga auditimi, u konstatua se subjekti qiramarrësi ñR.S.ò shpk ka kryer pagesat e qirasë si më poshtë :
-Nga auditimi i dosjes fizike të monitorimit, u konstatua se, për vitin e pare, pagesa është bërë më datë 31.08.2020, në vlerën prej 780,000 lekë/vit, kjo në kundërshtim me parashikimet në kontratë, pasi pagesa duhet të ishte paguar menjëherë në momentin e nënshkrimit të kontratës, pra është në vonesë 228 ditë me vonesë. Në zbatim të nenit 1, dhe nenit 7, pika 1 të kontratës 1 ditë vonesë × 0.5 % e detyrimit vjetor të qirasë = 3,900 lekë kamatëvonesa ditore. Kamat vonesë ditore (3,900lekë) x 228 ditë (nga 16 janar 2020 deri 31 gusht 2020) = **889,200 lekë.**
Nga auditimi deri në momentin e hartimit të këtij materiali nuk është kryer pagesa e vitit 2021 dhe sipas kontratës neni 1 pika 3 citon: *Pagesa e qirasë për vitin e parë të qiramarrjes kryhet si parapagim menjëherë në momentin e lidhjes së kontratës, ndërsa për periudhën vijuese brenda tremujorit të parë të vitit përkatës.*
Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentave në dosjen fizike, konstatoi se sigurimi i kontratës për vitin e parë është konform VKM nr.373 datë 20.06.2018, ndërsa për vitin pasardhës për vitin 2021,është dorëzuar sigurimi i kontratës, e cila nuk ka të bëjë me kontratën nr.178 rep, nr.32/4 kol, nr.311 prot datë 15.01.2020, por me një tjetër kontratë tjetër lidhur midis AZHBR dhe subjektin ñR.S.ò.
Sa më sipër, si pasojë e pagesës së qirasë për ditë të vonuara, janë krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 889,200 lekë për Kontratën nr.178 rep, nr.32/4 kol, nr.311 prot datë 15.01.2020.

Nga sektori i bashkëfinancimit, partneriteteve dhe monitorimit të kontratave me përbërje (M.K. dhe E.Q.) nuk janë përllogaritur vlerat e penaliteteve, nuk është realizuar sigurimi i kontratës për vitin 2021, për të cilat duhej të dërgohej zyrtarisht shkresa për shlyerjen e detyrimeve financiare në zbatim të kontratës.

5.SUBJEKTI "F.A" SHPK

-Nga auditimi u konstatua se, Shoqeria ñF.Aò shpk me NIPT L11504014T, me shkresë nr.3045 prot datë 10.04.2019 ka shprehur kërkesen dhe ofertën pranë MZHBR për marje toke bujqësore në pronesi të shtetit me qera, për 99 vite, për kultivimin e majdanozit, laker brukseli dhe investimin në përpunimin e tyre

-Nga MBZHR (sektori i bashkëfinancimit, partneriteteve dhe monitorimit të kontratave) pas verifikimit të bërë dokumentave të dorëzuara nga subjekti, ka kërkuar miratimin e fillimit të procedurës së dhënies së tokës bujqësore me qera, me Memo me shkresë nr.3045/1 prot datë 12.04.2019, drejtuar titullarit Ministri të MBZHR, i cili me shkresat nr.3045/11 prot datë 12.04.2019 dhe nr.3045/12 prot datë 12.04.2019, duke ngritur grupet e punës:

(i) për verifikimin në terren mbi gjendjen faktike të sipërfaqes bujqesore, i cili ka konstatuar se infrastruktura ujitjes dhe kullimit ne këto parcela ekzistojn por janë të papastruara dhe jo funsionale te mbuluara me bimesi, tregu me i afërt për grumbullimin e produkteve bujqesore ndhodhet në qytetitn e Diviakes dhe distance është 13-16 km, niveli i industrisë agropërpunuese është jo i mirë dhe ndodhet ne qytetin e Diviakes dhe distance është afërsisht 13-16 km, zhvillimi i infrastructures rrugore shum i mirë, distance nga rruga kryesore është 10 m.

(ii) Për përgatitjen e procedurës konkurruese dhe për llogaritjen e çmimit vjetore fillestar të qerasë, ku me anë të procesverbalit pa numër prot datë 10.02.2020 gupi i punës pas verifimimeve në terren ka bërë përllogaritja e qerasë.

1. Parcelatme nr pasurie 447/1, 448/1, 449/1, 449/8 me sipërfaqe totale 5.9658 ha.

- Boniteti klasa III është në vlerën prej 12,000 lekë/ha
- Infrastruktura rrugore 25%
- Largësia nga tregu rreth 13km 19%
- Niveli i industrisë agropërpunuese rreth 13km 19%
- 12,000 leke x 63.46% = 7,615.38 lekë/ha

Total i vlerës 12,000 + 7,615.38 = 19615.38 lekë/ha

Përllogaritja e qërase nga grupi i punës për siperqaqen 5,9658 ha është:

5,9658 ha x19615.38 = **117,021.46** lekë/viti.

2. Parcelat me numër pasurie nr.450/1, nr.450/3 me sipërfaqetotale 1.2676 ha

Boniteti klasa IV është në vlerën prej 10,000 lekë/ha

- Infrastruktura rrugore 25%
- Largësia nga tregu rreth 16km 15.6%
- Niveli i industrisë agropërpunuese rreth 16km 15.6%
- 10,000 leke x 56.25% = 5,625 lekë/ha

Total i vlerës 10,000 + 5,625 lekë/ha = 15,625 lekë/ha

Përllogaritja e qërase nga grupi i punës për siperqaqen 1.2676 ha është:

1.2676 hax 15,625 = **19,806.25** lekë/viti.

3. Parcelat me numër pasurie nr.72/1, nr.72/8, nr.72/9 me sipërfaqe totale 5.3630 ha

-Boniteti klasa V është në vlerën prej 7,000 lekë/ha

-Infrastruktura rrugore 25%

-Largësia nga tregu rreth 16km 15.6%

-Niveli i industrisë agropërpunuese rreth 16km 15.6%

-7,000 leke x 56.25% = 3,937.5 lekë/ha

-Total i vlerës 7,000 + 3,937.5 lekë/ha = 10,937.5 lekë/ha

-Përllogaritja e qërase nga grupi i punës për sipërqaqen 5.3630 ha është:

5.3630 ha x 10,937.5 lekë/ha = 58,657.81 lekë/viti.

4. Parcelat me numër pasurie nr.4/1, nr.79/1, nr.79/4, nr.81/1 VI (gjashtë) dhe nr.14/1, nr.14/3, nr.16/1, nr.17/1, VII (shtatë) me sipërfaqe totale 80.9031 ha.
Boniteti klasa VI dhe VII është në vlerën prej 5,000 lekë/ha
- Infrastruktura rrugore 25%
- Largësia nga tregu rreth 16km 15.6%
- Niveli i industrisë agropërpunuese rreth 16km 15.6%
- 5,000 leke x 56.25% = 2,812.5 lekë/ha

Total i vlerës 5,000 + 2,812.5 lekë/ha = 7,812.5 lekë/ha
Përllogaritja e qërase nga grupi i punës për siperqaqen 80.8851 ha është:
80.8851 ha x7,812.5 lekë/ha = **631,914.84** lekë/viti.
5. Parcelat me numër pasurie nr.67/1, nr.67/4, nr.67/8, nr.67/9, nr.68/1, nr.68/4, nr.68/7, nr.68/8, nr.69/1, nr.70/1, nr.71/1, nr.82/1, nr.84/1, boniteti VIII (tetë); nr.22/1, nr.23/1, nr.24/1, nr.24/4, nr.61/4, nr.62/1, boniteti IX (nëntë); nr.5/1, nr.15/1, nr.15/3, nr.18/1, nr.19/1, nr.20/1, nr.20/3, nr.21/1, nr.25/1, bonitetit X (dhjetë), me sipërfaqe totale 210.9979 ha.
Boniteti klasa VI dhe VII është në vlerën prej 6,000 lekë/ha
- Infrastruktura rrugore 25%
- Largësia nga tregu rreth 16km 15.6%
- Niveli i industrisë agropërpunuese rreth 16km 15.6%
- 6,000 leke x 56.25% = 3,375 lekë/ha

Total i vlerës 6,000 + 3,375 lekë/ha = 9,375 lekë/ha
Përllogaritja e qërase nga grupi i punës për siperqaqen 80.8851 ha është:
210.9979 ha x 9,375 lekë/ha = **1,978,105.31** lekë/viti.
Vlera totale për dhënien me qera të sipërfaqes 304 ha e 4,794 m^2 ha është përllogaritur nga MBZHR në vlerën prej 2,807,266.19 lekë/viti.
Grupi i auditimit, nga verifikimi i dokumentave në dosjen fizike, konstatoi se përllogaritja e qerasë për zëri ñInfrastruktura ujitëse/kullueseò grupi i punës i ngritur me Urdhër nr.3045/11, me përbërje (M.K., M.S. dhe L.K.) nuk e ka llogaritur këtë zë, pasi sipas tyre është jo funskional, por grupi i punes për verifikimin në terren i ngritur me Urdhër nr.3045/12, me përbërje (M.S. dhe L.K.dhe K.G. nga Agjensia rajonale e ekstecionit bujqesore citon ñ*..se infrastruktura ujitjes dhe kullimit në këto parcela ekzistojnë por janë të papastruara dhe jo funsionale të mbuluara me bimësi".*
Gjithashtu nga auditimi, duke përdorur medotën krahasimore me Kontratën nr.5414 rep, nr.936/2 kol, nr.7864/6 prot datë 15.11.2019 e lidhur me subjektit ñG.E F.ò për të njëjtin zë, referuar përllogaritjes së çmimit vjetor fillestar të qerasë, grupi i punës së MBZHR ka vepruar me dy standarte pasi citon ñé *në këtë sipërfaqe nuk ka kanal kullues por në krahun e rrugës është kanali kullues jo funksional dhe i pa pastruar".*
Pra në këtë rast është përllogaritur zëri (Infrastruktura ujitëse/kulluese 20%) nga të njëjtët punonjës në cilësinë e anëtarit të grupit për llogaritjen e çmimit fillestar të vlerës së qirasë.
Grupi i auditimit ka bërë rillogaritjet, duke shtuar zërin (Infrastruktura ujitëse/kullues 20%), si më poshtë viojn:
1. Parcelat me nr pasurie 447/1, 448/1, 449/1, 449/8 me sipërfaqe totale 5.9658 ha.
- Boniteti klasa III është në vlerën prej 12,000 lekë/ha
- **Infrastruktura ujitëse/kulluese 20%**
- Infrastruktura rrugore 25%
- Largësia nga tregu rreth 13km 19%
- Niveli i industrisë agropërpunuese rreth 13km 19%
- 12,000 leke x **83.46%** = 10,015.20 lekë/ha

Total i vlerës 12,000 + 10,015.20 = 22,015.20 lekë/ha
Përllogaritja e qërase nga grupi i punës për siperqaqen 5,9658 ha është:
5,9658 ha x 22,015.20 = **131,338.28**lekë/viti.
2. Parcelat me numër pasurie nr.450/1, nr.450/3 me sipërfaqetotale 1.2676 ha
Boniteti klasa IV është në vlerën prej 10,000 lekë/ha

- Infrastruktura rrugore 25%
- **Infrastruktura ujitëse/kulluese 20%**
- Largësia nga tregu rreth 16km 15.6%
- Niveli i industrisë agropërpunuese rreth 16km 15.6%
- 10,000 leke x 76.25% = 7,625 lekë/ha

Total i vlerës 10,000 + 7,625 lekë/ha = 17,625 lekë/ha
Përllogaritja e qërase nga grupi i punës për siperqaqen 1.2676 ha është:
1.2676 ha x 17,625 = **22,341.45** lekë/viti.

3. Parcelat me numër pasurie nr.72/1, nr.72/8, nr.72/9 me sipërfaqe totale 5.3630 ha
Boniteti klasa V është në vlerën prej 7,000 lekë/ha
- Infrastruktura rrugore 25%
- **Infrastruktura ujitëse/kulluese 20%**
- Largësia nga tregu rreth 16km 15.6%
- Niveli i industrisë agropërpunuese rreth 16km 15.6%
- 7,000 leke x 76.25% = 5,337.5 lekë/ha

Total i vlerës 7,000 + 5,337.5 lekë/ha = 12,337.5 lekë/ha
Përllogaritja e qërase nga grupi i punës për siperqaqen 5.3630 ha është:
5.3630 ha x 12,337.5 lekë/ha = **66,166.01**lekë/viti.

4. Parcelat me numër pasurie nr.4/1, nr.79/1, nr.79/4, nr.81/1 VI (gjashtë) dhe nr.14/1, nr.14/3, nr.16/1, nr.17/1, VII (shtatë) me sipërfaqe totale 80.9031 ha.
Boniteti klasa VI dhe VII është në vlerën prej 5,000 lekë/ha
- Infrastruktura rrugore 25%
- **Infrastruktura ujitëse/kulluese 20%**
- Largësia nga tregu rreth 16km 15.6%
- Niveli i industrisë agropërpunuese rreth 16km 15.6%
- 5,000 leke x 76.25% = 3,812.5 lekë/ha

Total i vlerës 5,000 + 3,812.5 lekë/ha = 8,812.5 lekë/ha
Përllogaritja e qërase nga grupi i punës për siperqaqen 80.8851 ha është:
80.8851 ha x 8,812.5 lekë/ha = **712,799.94** lekë/viti.

5. Parcelat me numër pasurie nr.67/1, nr.67/4, nr.67/8, nr.67/9, nr.68/1, nr.68/4, nr.68/7, nr.68/8, nr.69/1, nr.70/1, nr.71/1, nr.82/1, nr.84/1, boniteti VIII (tetë); nr.22/1, nr.23/1, nr.24/1, nr.24/4, nr.61/4, nr.62/1, boniteti IX (nëntë); nr.5/1, nr.15/1, nr.15/3, nr.18/1, nr.19/1, nr.20/1, nr.20/3, nr.21/1, nr.25/1, bonitetit X (dhjetë), me sipërfaqe totale 210.9979 ha.
Boniteti klasa VI dhe VII është në vlerën prej 6,000 lekë/ha
- Infrastruktura rrugore 25%
- **Infrastruktura ujitëse/kulluese 20%**
- Largësia nga tregu rreth 16km 15.6%
- Niveli i industrisë agropërpunuese rreth 16km 15.6%
- 6,000 leke x 76.25% = 4,575 lekë/ha

Total i vlerës 6,000 + 4,575 lekë/ha = 10,575 lekë/ha
Përllogaritja e qërase nga grupi i punës për siperqaqen 210.9979 ha është:
210.9979 ha x 10,575 lekë/ha = **2,231,302.79** lekë/viti.

Pra, në këtë rast me shtimin e zërit (Infrastruktura ujitëse/kulluese 20%), vlera e totale për dhënien me qera të sipërfaqes 304.4794 ha <u>duhet të ishte 3,163,948.47 lekë/viti.</u>
Sa më sipër, për llogaritjen e cmimit vjetore fillestar të qerasë me përbërje (M.K., L.K.dhe M.S.), është bërë më pak në vlerën prej 356,682.28
lekë në vit diferencë.
Nga subjekti është ofruar që vlera e qirasë të jetë në vlerën prej 3,000,035.53 lekë/vit e cila është referuar dhe në Kontratën nr.305 rep, nr.613 kol, nr.748/1 prot datë 22.09.2020 duke sjellë **efekt negative** në ardhurat dytësore të Buxhetin e shtetit **<u>në vlerën prej 163,912.94 lekë/ vit.</u>**
-Nga auditimi u konstatua se, zhvilimi i procedures, nga MBZHR është realizuar në përputhje me VKM nr.373 datë 20.06.2018, Kreu IV ñProcedurat që ndiqen për dhënien e tokave bujqesore në

pronesi të shtetitò dhe në përfundim Bordi i Vlerësimit të Ofertave (BVO) i ngritur me Urdhër nr.204 prot datë 20.05.2020 nga Titullari i MBZHR.

Oferta të dorëzuara për dhenien e tokës bujqësore shtetërore me qira janë:

Nr	Subjektet	Oferta lekë	Kualifikuar/S'Kualifikuar
1	ñ**F.A**ò	3,000,035.53	**Kualifikohet**

BVO ka kualifikuar, me shkresë nr.3863/5 prot datë 19.06.2020, duke bërë njoftimin e fituesit shoqerinë ñF.Aò shpk, i cili ka paguar detyrimin e pagesës së 2% në vlerën 18,653,205 lekë të sigurimit të investimeve të parashikuar në plan bisnesin, kjo në bazë të mandate pagesës nr.Serial 0004925 datë 05.09.2020 paguar pranë Kompanisë e Sigurimit S.I..
Kontratën nr.305 rep, nr.613 kol, nr.748/1 prot date 22.09.2020 është lidhur midis shoqerisë ñF.Aò shpk dhe MBZHR, me kohëzgjatje me afat për 99 vite.
PROBLEMATIKA:
Në bazë të auditimit të zbatimit të kontratës së qirasë me subjektin ñF.Aò, u konstatua se:
a) Në kontratën e qirasë neni 3 ñVlera e Qirasëò, parashikohet se ñ*Qiramarrësi do të paguaj detyrimin për qiranë vjetore të tokes bujqësore të marë me qira ne vlerën prej* 3,000,035.53 *në viti. Qiramarrësi e kryen parapagim vlerën e qirasë vjetore brenda 30 diteve nga momenti I nenshkrimit te kontratës, ndërsa për periudhen vijuese brenda datës 20 gusht të cdo viti.*
Nga auditimi, u konstatua se subjekti qiramarrësi ñF.Aò shpk ka kryer pagesat e qirasë si më poshtë :
-Viti i parë më datë 04.11.2020, në vlerën 3,000,036 lekë, kjo në kundërshtim me parashikimet në kontratë, pagesa duhet të ishte paguar brenda 30 ditëve nga moment i nënshkrimit të kontratës, pra është në vonesë 12 ditë me vonesë. Në zbatim të nenit 3, dhe nenit 14, pika 1 të kontratës 1 ditë vonesë × 0.05 % e detyrimit vjetor të qirasë = 1,500.02 lekë kamatëvonesa ditore. Kamat vonesë ditore (1,500.02 lekë) x 12 ditë (nga 23 tetor 2020 deri 04 nentor 2020) = 18,000.21 lekë.
Sa më sipër, si pasojë e pagesës së qirasë për ditë të vonuara, janë krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën **18,000.21 lekë** për Kontratën nr.305 rep, nr.613 kol, nr.748/1 prot datë 22.09.2020.
Nga sektori i Bashkëfinancimit, partneriteteve dhe monitorimit të kontratave me përbërje(M.K. dhe E.Q.) nuk janë përllogaritur vlerat e penaliteteve, nuk është realizuar sigurimi i kontratës për vitin 2021, për të cilat duhej të dërgohej zyrtarisht shkresa për shlyerjen e detyrimeve financiare në zbatim të kontratës.
-Gjithashtu në dosjen fizike u evidentua se,me shkresë nr.2567 datë 30.03.2021 ardhur pranë MZHBR, subjekti qiramarrës bazuar në nenin 15 te kontratës *"Forca Madhore"kanë* kërkuar shtyerjen e fillimit të investimeve në bujqesi për të paktën një vite. Arsyeja e kësaj kërkese lidhet me situatën aktuale të pandemisë si pasojë e valës së tretë të Pandemis Covid-19, pamundësinë e lëvizjes së lirë të investitorëve Norvegjesë dhe mungesën e paisjeve dhe mallrave që do të duhej të importonim.Deri në momentin e hartimit të këtij materiali nuk u konstatua, miratimi nga MBZHR, i kësaj kërkese.

6.SUBJEKTI "V.A."
-Nga auditimi u konstatua se subjekti V.A. me shkresë nr.9855 prot datë 20.12.2019 ka shprehur kërkesën dhe ofertën pranë MZHBR për marje toke bujqësore në pronësi të shtetit me qera, për 99 vite, për kultivimin e ullirit të varietetit (frantoi).
-Nga MBZHR (sektori i bashkëfinancimit, partneriteteve dhe monitorimit të kontratave) pas verifikimit të bërë dokumentave të dorëzuara nga subjekti, ka kërkuar miratimin e fillimit të procedurës së dhënies së tokës bujqësore me qera, me Memo me shkresë nr.401/1 prot datë 07.01.2020, drejtuar titullarit Ministri të MBZHR, i cili me urdhër nr.40/2 prot datë 10.02.2020 dhe nr.40/3 prot datë 10.02.2020, duke ngritur grupet e punës:

(i) Për verifikimin në terren mbi gjendjen faktike të sipërfaqes bujqesore, i cili ka konstatuar se infrastruktura ujitjes dhe kullimit nuk ekzistojn por pranë parcelës ndodhet një rezervuar për të marë uje. Tregu me i afërt për grumbullimin e produkteve bujqesore ndhodhet në qytetitn e fierit dhe distance është 15.2 km, niveli i industrisë agropërpunuese është jo i mirë dhe ndodhet ne qytetin e Fierit dhe distance është afërsisht 15.2 km, infrastructures rrugore jo e mire, distance nga rruga e asfaltuar është 4 km.
(ii) Për përgatitjen e procedurës konkurruese dhe për llogaritjen e cmimit vjetore fillestar të qerasë, ku me anë të procesverbalit 4393/2 datë 15.07.2020 gupi i punës pas verifimimeve në terren ka bërë përllogaritja e qerasë.
Boniteti klasa III eshte ne vlerën 12000 lek/ha
- Infrastruktura ujitëse/kulluese 10%
- Infrastruktura rrugore 20%
- Largësia nga tregu 16.45%
- Niveli i industrisë agropërpunuese 16.45%
- 12000 leke x 62.9% = 7548 lekë/ha

Total i vlerës 12000 + 7548 = 19548 lekë/ha
Përllogaritja e qerase nga grupi i punës për siperqaqen 4.3 ha vlera e qiradhenies të jëtë 4.3 ha x 19548 = 84,056.4 lekë/viti,ndërsa nga subjekti është ofruar më shumë në vlerën prej 85,000 lekë.
-Nga auditimi u konstatua se, zhvilimi i procedures, nga MBZHR është realizuar në përputhje me VKM nr.487 datë 17.06.2020, Kreu IV ñProcedurat që ndiqen për dhënien e tokave bujqesore në pronesi të shtetitò dhe në përfundim Bordi i Vlerësimit të Ofertave (BVO) i ngritur me Urdhër nr.6766 prot datë 27.08.2020 nga Titullari i MBZHR.
Oferta të dorëzuara për dhenien e tokës bujqësore shtetërore me qira janë :

Nr	Subjektet	Oferta lekë	Kualifikuar/S'Kualifikuar
1	ñV.A.ò	85,000	**Kualifikohet**

BVO ka kualifikuar, me shkresë nr.6980/3 datë 11.09.2020, duke bërë njoftimin e fituesit shoqerinë ñV.A.ò, e cili ka paguar detyrimin e pagesës së 2% në vlerën 30,000.00 lekë të sigurimit të investimeve të parashikuar në plan bisnesin, kjo në bazë të mandate pagesës datë 10.05.2020 ngurtësuar pranë bankes C. Kontratën.
Kontratën nr.3382 rep, nr.687 kol, nr.9098 prot date 14.10.2020 është lidhur midis subjektit ñV.A.ò dhe MBZHR, me kohëzgjatje me afat për 99 vite.

7. SUBJEKTI "T."

-Nga auditimi u konstatua se subjekti ñT.ò me shkresë nr.5489 prot datë 07.07.2019 ka shprehur kërkesen dhe ofertën pranë MZHBR për marje toke bujqësore në pronësi të shtetit me qera, për 99 vite, për kultivimin e arrës dhe shegës.
-Nga MBZHR (sektori i bashkëfinancimit, partneriteteve dhe monitorimit të kontratave) pas verifikimit të bërë dokumentave të dorëzuara nga subjekti, ka kërkuar miratimin e fillimit të procedurës së dhënies së tokës bujqësore me qera, me Memo me shkresë nr.5489/1 prot datë 12.07.2019, drejtuar titullarit Ministri të MBZHR, i cili me urdher nr.6030 prot datë 29.07.2019 dhe nr.6031 prot datë 29.07.2019, duke ngritur grupet e punës:
(i) Për verifikimin në terren mbi gjendjen faktike të sipërfaqes bujqesore, i cili ka konstatuar se infrastruktura ujitjes dhe kullimit janë funskional. Tregu me i afërt për grumbullimin e produkteve bujqesore ndhodhet në qytetitn e sarandes dhe distance është 10-12 km, niveli i industrisë agropërpunuese është përgjithsisht i mirë. Infrastructures rrugore shum e mirë.
(ii) Për përgatitjen e procedurës konkurruese dhe për llogaritjen e cmimit vjetore fillestar të qerasë, ku me anë të procesverbalit 4393/2 datë 15.07.2020 gupi i punës pas verifimimeve në terren ka bërë përllogaritja e qerasë.
Boniteti klasa VII eshte ne vlerën 5000 lek/ha
- Infrastruktura ujitëse/kulluese 25%

- Infrastruktura rrugore 25%
- Largësia nga tregu 25%
- Niveli I industrisë agropërpunuese 25%
- 5000 leke x 100% = 5,000 lekë/ha

Total i vlerës 5,000 + 5,000 = 10,000 lekë/ha

Përllogaritja e qerasë nga grupi i punës për siperfaqen 9.5812 ha, vlera e qiradhënies të jëtë 9.5812 ha x 10,000 = 95,812 lekë/viti, ndërsa në kontratë nga subjekti është ofruar vlerë prej 100,000 lekë.

-Nga auditimi u konstatua se, zhvillimi i procedurës, nga MBZHR është realizuar në përputhje meVKM nr.373 datë 20.06.2018, Kreu IV ñProcedurat që ndiqen për dhënien e tokave bujqesore në pronesi të shtetitò dhe në përfundim Bordi i Vlerësimit të Ofertave (BVO) i ngritur me Urdhër nr.800 prot datë 23.01.2020 nga Titullari i MBZHR.

Oferta të dorëzuara për dhenien e tokës bujqësore shtetërore me qira janë:

Nr	Subjektet	Oferta lekë	Kualifikuar/S'Kualifikuar
1	ñT.ò	100,000	**Kualifikohet**

BVO ka kualifikuar, me shkresë nr.800/2 prot datë 18.02.2020, duke bërë njoftimin e fituesit shoqerinë ñT.ò, i cili ka paguar detyrimin e pagesës së 2% në vlerën 732,966.96 lekë të sigurimit të investimeve, kjo në bazë të mandate pagesës nr serie.46455349 datë 25.02.2020 pranë kompanisë së sigurimeve A..

Kontratën nr.1230 rep, nr.230 kol, nr.800/3 prot datë 01.04.2020 është lidhur midis subjektit ñT.ò dhe MBZHR, me afat për 99 vite.

Subjekti për vitin 2021 ka paguar detyrimin e pagesës së 2% në vlerën 732,966.96 lekë të sigurimit të investimeve, kjo në bazë të mandate pagesës nr serie.89197003 datë 12.05.2021 pranë kompanisë së sigurimeve A..

Grupi i auditimit,nga verifikimi i dokumentave në dosjen fizike, konstatoj se subjekti ka paguar 2% të investimeve në shumën prej 732,966.96 lekë, por duhet të siguronte vlerën 1,322,667.20lekë, në kundeshtim me Kontratën nr.1230 rep, nr.230 kol, nr.800/3 prot date 01.04.2020 *Neni 5, Garancia/sigurimi i kontratës* ku citon: *Qiramarrësi duhet të paraqesë pranë Qiradhënësit sigurimin e kontratës në formën e një garancie bankare ose sigurimi të lëshuar nga shoqëritë e sigurimit, në vlerën prej 2% e investimeve kapitale të parashikuara në shumën 66,633,360 lekë, e cila e shprehur ne vlerë leku është 1,322,667.20 në momentin e lidhjes së kontratës. Në rast se Qiramarrësi nuk e dorëzon në kohë sigurimin e kontratës, atëherë qiradhënësi ka të drejtë të mos e dorëzojë pasurinë.*

*Gjithashtu,*në lidhje mbi zbatimin e Kontratës,me shkresë nr.3360 prot datë 06.05.2021 ardhur pranë MZHBR, subjekti qiramarrës shprehet se nuk ka realizuar investimet e parashikuara në plan biznes për arsye të pandemisë botërore të shkaktuara nga COVID-19 dhe shpallja e gjendjes së jashtë zakonshme. Subjekti qiramarrës ka kërkuar shtyrjen e afatit për kryerjen e investimeve të parashikuara për vitin 2020-2021.

Me nr.1686 rep, nr.177 kol, nr 3360/2 prot datë 12.05.2021 MZHBR dhe subjekti qiramarrës kane bërë Marrëveshje siguruese (Amendim) i kontratës, nga ku parashikohet së afati për fillimin e investimeve sipas plan biznesit fillon nga moment i nënshkrimit të kësaj marërveshje nga palët.

PROBLEMATIKA:

a) Në kontratën e qirasë neni 1 ñObjekti, afati dhe vlera e kontratësò, pika 3, paragrafi i dytë, parashikohet se ñ*Palët bien dakord që vlera e qirasë vjetore për marrjen me qira të pasurisë 100,000 lekë/ha/viti ("Çmimi i Qirasë" ose "Qiraja"), sipas ofertës fituese të procedurës konkurruese dhe të përcaktuar me vendim nga autoriteti qiradhënës. Vlera e qirasë së tokës objekt i kësaj kontrate, parapaguhet nga ana e qiramarrësit. Pagesa e qirasë për vitin e parë të qiramarrjes kryhet si parapagim menjëherë në momentin e lidhjes së kontratës, ndërsa për periudhën vijuese brenda tremujorit të parë të vitit përkatës*ò.

Nga auditimi, u konstatua se subjekti qiramarrësi ñT.ò shpk ka kryer pagesat e qirasë si më poshtë:
-Viti i parë më datë 08.04.2020, në vlerën 100,000 lekë, kjo në kundërshtim me parashikimet në kontratë, pagesa duhet të ishte paguar menjëherë në momentin e nënshkrimit të kontratës, pra është në vonesë 6 ditë me vonesë. Në zbatim të nenit 1, dhe nenit 7, pika 1 të kontratës 1 ditë vonesë × 0.5 % e detyrimit vjetor të qirasë = 500 lekë kamatëvonesa ditore. Kamat vonesë ditore (500lekë) x 6 ditë (nga 2 prill 2020 deri 8 prill 2020) = 3,000lekë.
Sa më sipër, si pasojë e pagesës së qirasë për ditë të vonuara, janë krijuar Të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën*prej 3,000 lekë* për Kontratën nr.1230 rep, nr.230 kol, nr.800/3 datë 01.04.2020.
Nga sektori i bashkëfinancimit, partneriteteve dhe monitorimit të kontratave me përbërje (M.K. dhe E.Q.) nuk janë përllogaritur vlerat e penaliteteve, për të cilën duhej të dërgohej zyrtarisht shkresa për shlyerjen e detyrimeve financiare në zbatim të kontratës.
Kështu për rregjistrimin e fondit të ñtokës bujqësoreò që i mbetet në administrim të MBZHR, duhet bashkëpunim nga të gjitha institucionet dhe organet kompetente shtetërore, si MBZHR Agjencia Shtetërore e Kadastrës ASHK, DAMT -Qarqeve, Këshilli i Ministrave, për të realizuar procesin e rregjistrimit të pasurive tokë bujqësore pronësi të shtetit në administrim të institucionit të MBZHR, duke patur si qëllim se ky proces ndihmon në realizimin e investimeve mbi tokën bujqësore, nisur nga fakti qëbujqësia mbetet një nga sektorët me potencialin më të madh të zhvillimit në Shqipëri, pasi në vitet e fundit sektori i bujqësisë ka patur një rritje të qëndrueshme dhe një kontribut në rritje në PBB. Në këtë kuadër politikat ekonomike të qeverisë për zhvillimin e bujqësisë në vend, përkrahin dhe nxitin investimet dhe ndërmjet shfrytëzimit të tokës bujqësore.
Gjithashtu, rregjistrimi identifikimi dhe verifikimi real i tokës bujqësore në favor të MBZHR, është një mundësi për të ulur riskun e tjetërsimit të pronave bujqësore, nga palë të treta, si pasojë e situatës së sipërpërmëndur.
Si përfundim, nga auditimi me përzgjedhje të 7 (shtatë) Kontratave të mësipërme, me objekt për dhënie me qira të tokave bujqësore për periudhën në auditimin për vitet 2019 deri më 30.03.2021, u konstatua se:
(i) Në përllogaritjen e çmimit fillestar të qerasë të tokës bujqësore pas verifimimeve në terren, nga grupet e punës respektive të ngritura me urdhër të titullarit të MBZHR, është llogaritur më pak, e për pasojë vlera e qirasë të tokës bujqësore ka sjellë të ardhura më pak në vlerën prej **196,776.94 lekë si efekte negative në Buxhetin e Shtetit**.
(ii) Nga subjektet qiramarrëse të mësipërme, nuk janë zbatuar detyrimet kontraktore, konkretisht për mospagesat e qirasë në kohë, për mosrealizimin e investimeve të paraqitur sipas plan-investimeve, për pasojë **vlera prej 1,570,209.21 lekë, janë të ardhura të mungurara në Buxhetin e Shtetit.**
Në lidhje mbi mangësitë e konstatuara, nga grupi i audituesve u mbajt Aktkonstatimi nr.3 datë 26.07.2021 me nr.5463 prot të MBZHR, të cilët kanë observuar me shkresë nr.5640 prot, datë 02.08.2021 nga M.K., M.S. dhe E.Q. si dhe shoqëruar me shkresën nr.5640Prot datë 02.08.2021 firmosur nga Sekretari i Përgjithshëm si dhe observimet e Projektraportit me shkresë nr.3501/8 prot datë 28.12.2021 nga struktura përgjegjëse zj.M.K. dhe z.E.Q..

Grupi i auditimit pasi i shqyrtoi observimet e paraqitura, mban këtë qëndrim si më poshtë vijon.

Pretendimi i subjektit:
1. Subjekti qiramarrës ñG.E.F.ò shpk si pasojë e pagesës me vonesë të vlerës së qirasë vjetore ka për të paguar shumën prej 584,000 lekë, si të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit, sqarojmë se me shkresën nr. 2711 prot., datë 06.4.2021 i është kërkuar qiramarrësit të kryejë pagesën e shumës 1,079,500 lekë si vlerë e qirasë vjetore për vitin 2021 dhe kamata për vonesën e pagesë për vitete 2019-2021, duke i lënë një afat 30 ditë nga data e marrjes së njoftimit për këtë pagesë. Këtë vlerë qiramarrësi e ka paguar, provuar me Mandat Pagesën datë 30.8.2021 ñF.I.B.ò sha, në të cilin citohet shuma e paguar 584,000 lekë dhe shënimi ñLikujdim kamatëvonese/òG.E.F.ò shpk, NIUS L92607203V (shkresa dhe mandati bashkëlidhur këtij observacioni).
2. Sa i takon konstatimit të audituesve se qiramarrësi nuk ka realizuar 100% investimet e parashikuara në Planin e Biznesit pjesë përbërëse e kontratës së qirasë, por ka paraqitur fatura për realizimin e vetëm

25.52% të tyre, sqarojmë se nga monitorimi i kryer në vend rezultoi se tre pasuritë e dorëzuara më datën 21.11.2019 ishin mbjellë dhe kishte përfunduar infrastruktura mbështetëse (rrugë, kanale, etj). Pasuria nr. 348 në momentin e dorëzimit rezultoi e zënë dhe është dorëzuar me vonesë në përdorim të qiramarrësi (datë 4.2.2020, jo për fajin e tij) dhe kjo pasuri në momentin e monitorimit ishte pastruar, pasi në momentin e dorëzimit ishte me pemë disa vjeçare, punuar, sistemuar gati për mbjellje, por nuk ishte mbjellë. Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga qiramarrësi (fatura dhe situacione) rezulton se qiramarrësi ka kryer investime në vlerën 27,717,811 lekë ose 71.54% të investimeve të parashikuara, vlerën e parealizuar qiramarrësi e ka argumentuar me vonesën në dorëzimin e njërës pasuri për shkak të zaptimit.
3.Në lidhje me subjektin L. N., person fizik, në projektraport për këtë subjekt është konstatuar se qiramarrësi ka kamatëvonesë në pagesën e vlerës së qirasë vjetore në vlerën 43,500 lekë, duke krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit. Me shkresën nr. 680/2 prot., datë 20.4.2021 i është kërkuar qiramarrësit pagesa e kamatëvonesave për vitet 2019 dhe 2020 në vlerën 44,250 lekë, të cilën qiramarrësi e ka likujduar me datë 23.12.2021, bashkëlidhur mandatin për pagesën e kësaj vlere.
4.Në lidhje me subjektin ñA.B.Fò shpk, në projektraport për këtë subjekt është konstatuar se qiramarrësi ka kamatëvonesë në pagesën e vlerës së qirasë vjetore në vlerën 32,509 lekë, duke krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit, të cilën qiramarrësi e ka likujduar me datë 24.12.2021, bashkëlidhur mandati për pagesën e kësaj vlere.

5.Në lidhje me subjektin ñR.S.ò shpk, në projektraport për këtë subjekt është konstatuar se qiramarrësi ka kamatëvonesë në pagesën e vlerës së qirasë vjetore në vlerën 889,200 lekë, duke krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit. Me shkresën nr. 5211 prot., datë 13.7.2021 i është kërkuar qiramarrësit pagesa e kamatëvonesave për vitet 2020 dhe 2021 në vlerën 1,236,300 lekë (qira e pjeshme e papaguar dhe kamatëvonesë), të cilën qiramarrësi nuk e ka likujduar.
Sa i takon konstatimit se sigurimi i kontratës i paraqitur nga qiramarrësi për vitin 2021 nuk është për kontratën e qirasë me palë qiradhënës MBZHR, pasi rezulton në këtë sigurim si institucioni përfitues Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, sqarojmë se në këtë policë sigurimi janë të përcaktuara numri i Kontratës së Qirasë që subjekti ñR.S.ò shpk ka me MBZHR-në ku janë të cituara dhe pasuritë objekt i kësaj kontrate qiraje dhe gjykojmë që institucioni është një lapsus i kompanisë së sigurimit, për të cilin do kërkojmë korigjimin e përfituesit nga AZHBR në MBZHR.
Qëndrimi i grupit të auditimit.
1.Për sa më sipër ky observacion merret në konsideratë.
2.Në observimet e paraqitura nga përfaqësuesit e strukturës përgjegjëse, nuk u konstatuan dokumentacion financiar justifikues mbi ecurinë e investimit.
2.Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.
3. Për sa më sipër ky observacion merret në konsideratë.
4. Për sa më sipër ky observacion merret në konsideratë.
5.Nga MBZHR duhej të kërkohes që nga subjekti ñR.S.ò shpk, duhej të sillej korrigjimi me anë të vertetimit nëse është një lapsur nga kompania e sigurimit.
Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

II. Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, **40 kontrata** janë lidhur sipas VKM nr.460, datë 22.5.2013 ñPër përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò ndryshuar, me VKM nr.373, datë 20.06.2018, për periudhën nga viti 2013 deri në janar të vitit 2019, *duke përzgjedhur disa prej tyre për auditim, në lidhje për fazën e ecurisë së monitorimit të kontratës*, si vijon:
1)Në disa kontrata ka mospërputhje midis kulturës së parashikuar për tôu mbjellë në Planin e Biznesit dhe Kontratës së Qirasë, kulturëne mbjellë në realitet, si edhe mospërputhje mes kulturës së parashikuar në Kontratën e Qirasë dhe asaj të parashikuar në Planin e Biznesit;
2)Nga verfikimi i realizimit të investimeve kapitale rezulton që në shumicën e kontratave qiramarrësit megjithëse kanë kryer investime në terren nuk mund të mbështesin këto investime me dokumenta justifikues (fatura apo deklarata doganore dhe situacione punimesh/shërbimesh), për rrjedhojë shumica e kontratave nuk provon realizimin e investimit jo me pak se 20% e vlerës së parashikuar , e për pasojë mosplotësimi i detyrimit, sjellë dhe zgjidhjen e kontratës së qirasë, sipas parashikimeve të saj;
3)Në disa kontrata qiramarrësi ka kërkuar amendim kontrate, por pa paraqitur dokumentacionin e duhur (plan biznesi për kulturën për të cilën kërkojnë ndryshimin) si dhe në disa kontrata nuk ka amendim të tyre në zbatim të kërkesave të subjekteve (sôka pergjigje nga ana MBZHR). Vihen re se mbas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme të pandemisë Covid-19, disa prej kontratave

kanë bërë amendime, ndërsa disa prej tyre ndonëse kanë paraqitur kërkesë nuk kanë mundur të finalizojnë amendimin.
4)Sipas Kontratës së Qirasë Tip, në parashikimet e Nenit 7 ñSanksioneò janë jashtë çdo llogjike ekonomike, për arsye se kamatvonësat për mospagimin e vlerës së qirasë vjetore janë pambarim pa përcaktuar një tavan për ndërprerjen e tyre.
Penalitetet e parashikuara për moskultivim apo ndryshim të kulturës së miratuar në plan biznes dhe kontratë llogaritet në ditëvonesë dhe jo në vit bujqësor (kulturat në të gjitha kontratat janë kultura që prodhojnë një herë në vit);
5)Disa prej tokave bujqësore të trajtura me qira nuk janë të përfshira në Vendimet e Këshillit të Ministrave që kalojnë në administrim të MBZHR si pasuri shtetërore dhe nuk mund të dorëzohen tek qiramarrësi dhe as nuk mund të regjistrohen ne ZVRPP.
6)Rezulton vlerë e ndryshme e investimeve kapitale të parashikuara në Plan Biznes nga vlera e parashikuar në Kontratën e Qirasë, Shtojca 2;
7)Në disa kontrata janë parashikuar veprimtari blegtorale, në një kohe që as në VKM nr.460/2013 dhe as ne VKM nr.373/2018 nuk është e parashikuar një veprimtari e tillë;
8)Asnjë qiramarrës nuk ka plotësuar numrin e punonjësve të siguruar për parashikuar në Plan Biznes;
9)Në disa kontrata megjithëse janë mbajtur procesverbalet e dorëzimit ka probleme me zaptimin e tyre nga palë të tretë pa tagra pronësie, e për pasojë nuk kemi ecuri të kontratës.
10)Në disa kontrata qiraje janë dhënë me qira dhe pasuri mbi të cilat janë varrezat e zonës, ka ndërtime të ligjshme dhe të paligjshme apo sipërfaqe me dampa me plehra, në të cilat nuk mund të zbatohen parashikimet e kontratës dhe të planit të biznesit;
<u>Nga auditimi për periudhën në auditim, në lidhje mbi ecurinë e kontratës dhe monitorimin e saj, u përzgjodhën kontrata në bazë Qarku dhe në mënyrë rastësore, duke konstatuar, problematikat e mëposhtme:</u>

<u>I.Subjekti "A.." shpk</u>
Shoqëria "A.." shpk dhe ish-MBUMK (Ministria e Bujqesisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit) kanë lidhur Kontratë nr.3819 prot datë 16.09.2013 sipas VKMnr.460, datë 22.5.2013 ñPër përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar për dhënien e tokës bujqësore me qira me afat për 60 vite, për kultivimin e drufrutorë-arrës dhe ullisht si dhe ndertimin e fidanishtes për prodhimin e fidanit të arrës, me vlerëqiraje 622,440 lekë në vit.
Nga auditimi mbi monitorimin e kontratës u konstatua se, me urdhër të titullarit Ministritë ish-MBUMK nr.6166 prot datë 02.09.2014 është ngritur grupi i punës ñPër kalimin e tokës në përdorim në favor të subjektit "A.." shpk. Me proces-verbal të mbajtur me datë 09.09.2014 nga grupi i punës dhe përfaqesuesi i shoqërisë është bërë kalimi i tokës në përdorim. Ky fakt tregon se, toka bujqësore është dorëzuar nga Ministria e Bujqësisë, 1 vit më vonë, në mos plotësim të detyrimit kontraktor neni 3 nga MB në cilësinë e ñQiradhënësitò dhe në mos përputhshmëri me bazën ligjore dhe nën ligjore mbi të cilën është miratuar kontrata në fjalë, si pasojë e mos ngritjes nga titullari MB, grupit të punës për dorëzimin e tokës bujqësore.
1.Nga auditimi deri në momentin e hartimit të këtij materiali, <u>*nuk ka kryer investimet në vlerën deri 20% të vlerës së investimit*</u>, <u>të cilat duhej të realizoheshin *brenda 3 vjetëve*</u> nga momenti i dorëzimit, si dhe <u>*nuk ka kryer investimet në vlerën deri në 70% të vlerës së investimit brenda 5 viteve*</u> të para, e shprehur në bazë të neni 6 pika 5, a dhe b ku shprehet se ñ*a) Nëse në përfundim të vitit të tretë konstatohet që Qiramarrësi ka realizuar jo më shumë se 20% e investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë prishjen e kontratës dhe sekuestrimin e garancisë;*
b) Nëse në përfundim të vitit të pestë konstatohet që Qiramarrësi nuk ka realizuar 70% të totalit të investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtën e vendosjes së një gjobe sipas nenit 7, pika 3.

-Nga auditimi, në lidhje mbi monitorimi i kryer nga sektori i monitorimit, në dosjen fizike u konstatua se, në procesverbali mbajtur M.K., M.S., H.M.dhe Z.C.nga A. Tiranë dhe nga qiramarrësi i Shoqërisë"A.." nr.1484/1 prot, datë 15.2.2019 shprehen se ñ*Qiramarrësi ka hapur rreth katër km rrugë për të shkuar mjetet në token e marrë me qira. Është shpyllëzuar, pastruar, sistemuar dhe punuar e gjithë sipërfaqja. Nuk është mbjellë ende asnjë kulturë me pretendimin se pengohet nga banorë të zonës për një pjesë (rreth 14 ha) të sipërfaqes*.ò

-Nga subjekti janë paraqitur fatura për investimet në infrastrukturë dhe në blerjen e fidanëve. Vlera e faturave të paraqitura është 27,975,273 lekë e 31,500 Euro, konkretisht për punime në përgatitjen e tokës vlera 13,306,926 lekë, për makineri e pajisje vlera 31,500 Euro, blerje fidanësh vlera 14,668,347 lekë, e përkthyer në përqindje qiramarrësi ka realizuar 8.27% të investimeve të parashikuara, e cila nuk është e njëjtë vlera e investimeve të parashikuara në planë biznes në të cilën parashikohet në vlerën 3,155,883 Euro brenda nje afati 4-5 vjet, ose duke u referuar dorëzimit të tokes investimi duhet të mbaronte brenda datës 09.09.2019.

2. Nga auditimi u konstatua se garancia,sigurimi i realizimit të kontratës nuk është rinovuar vit për vit, kjo në kundërshtim me kontratën sipas neni *5 Pika 2: Garancia bankare mund të lëshohet për një afat kohor 1 vjecar dhe do të rinovohet deri në përfundim të investimeve kapitale"*

3. Nga verifikimi në faqen online të Qendrës Kombëtare të Biznesit rezulton se shoqëria ñA..ò shpk, me NIUS L31909015U është me status ñPezulluarò, prej datës 10.2.2020, fakt ky i provuar dhe me Listën e Subjekteve Pasive të publikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

4. Sa më sipër nga sektori i bashkëfinancimit, partneritetit dhe monitorimit të kontratave, M.K. dhe E.Q., me Memo drejtuar titullarit të MBZHR (Ministri) datë 9.4.2021,është paraqitur ecuria e kontratës në lidhje mbi problematikat dhe i është sugjeruar zgjidhja e njëanshme të kontratës për mungesë të aktivitetit tregtar dhe mos realizimit të investimeve të parashikuara në kontratë dhe Planin e Biznesit. Kështu nisur nga këto kushte titullari Ministri me Urdhër nr.227 datë 01.06.2021 ñPër zgjidhjen e kontratës së qirasë nr.3819 prot, datë 16.9.2013 ñPër dhënien me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetitò me palë qiramarrëse shoqëria ñA..ò shpkò është proceduar me zgjidhjen e njëanshme të kontratës, si pasojë e mosplotësimit të detyrimeve kontraktore. Në piken 2 të këtij urdhri citohet: *Zgjidhja e kontratës nuk përjashton shoqërinë "A.." shpk nga shlyerja e detyrimeve financiare në zbatim të kësaj kontrate.*

5.Grupi i auditimit, në bazë të dosjes fizike të monitorimit, ka konstatuar se, subjekti qiramarrësi ñA..ò shpk, në bazë të neni 1 ñObjekti i kontrates ò, pika 3 ñ*Pagesa e qerasë për vitin e parë të qiramarrjes kryehet si parapagim në momentin e lidhjes së kontratës por jo me vonë se 19 shtator 2013 (data e lidhjes së kontratës), ndërsa për periudhën vijuese me datë 13 shtator të cdo viti pasardhë*sò,.

Pagesat kanë rezultuar si më poshtë:

-Për vitin **2015** është bërë pagesa me 29.09.2015, në vlerën 622.440 lekë, kjo në kundërshtim me parashikimet në kontratë, pagesa duhet të ishte paguar deri me datë 13 shtatorë, pra është me vonesë 15 ditë. Në zbatim të nenit 1, dhe nenit 7, pika 1 të kontratës, 1 ditë vonesë × 0.5 % e detyrimit vjetor të qirasë = 3,112.2 lekë kamatë vonesa ditore. Kamat vonesë ditore (3,112.2 lekë) x 15 ditë (nga 14 shtator 2015 deri 29 shtator 2015) = **46,683**lekë;

-Për vitin **2016** është bërë pagesa me 19.01.2018, në vlerën 622.440 lekë, kjo në kundërshtim me parashikimet në kontratë, pagesa duhet të ishte paguar deri me datë 13 shtatorë, pra është me vonesë 492 ditë. Në zbatim të nenit 1, dhe nenit 7, pika 1 të kontratës, 1 ditë vonesë × 0.5 % e detyrimit vjetor të qirasë = 3,112.2 lekë kamatë vonesa ditore. Kamat vonesë ditore (3,112.2 lekë) x 492 ditë (nga 14 shtator 2016 deri 19 janar 2018) = **1,531,202.40** lekë;

-Për vitin **2017** është bërë pagesa me 19.01.2018, në vlerën 622.440 lekë, kjo në kundërshtim me parashikimet në kontratë, pagesa duhet të ishte paguar deri me datë 13 shtatorë, pra është në vonesë 127 ditë. Në zbatim të nenit 1, dhe nenit 7, pika 1 të kontratës, 1 ditë vonesë × 0.5 % e detyrimit vjetor të qirasë = 3,112.2 lekë kamatë vonesa ditore. Kamat vonesë ditore (3,112.2 lekë) x 127 ditë (nga 14 shtator 2017 deri 19 janar 2018) = **395,249.40**
lekë;

-Për vitin **2018** nuk është kryer pagesa e qerasë, kjo në kundërshtim me parashikimet në kontratë, pagesa duhet të ishte paguar deri me datë 13 shtatorë, pra është me vonesë 991 ditë deri me datë 01.06.2021 kjo me urdhërin nr.1559/2 prot për zgjidhjen e nje anshme të kontratës e firmosur nga titullarii MBZHR. Në zbatim të nenit 1, dhe nenit 7, pika 1 të kontratës, 1 ditëvonesë × 0.5 % e detyrimit vjetor të qirasë = 3,112.2 lekë kamatë vonesa ditore. Kamat vonesë ditore (3,112.2 lekë) x 991 ditë (nga 14 shtator 2018 deri 1 qeshor 2021) = 3,084,190.20lekë. Kamatë vonesa 3,084,190.20lekë + 622.440 principali i qerasë = **3,706,630.20** lekë.
-Për vitin **2019** nuk është kryer pagesa e qerasë, kjo në kundërshtim me parashikimet në kontratë, pagesa duhet të ishte paguar deri me datë 13 shtatorë, pra është me vonesë 626 ditë deri me datë 01.06.2021 kjo me urdhërin nr.1559/2 prot për zgjidhjen e një anshme të kontratës e firmosur nga titullari i MBZHR. Në zbatim të nenit 1, dhe nenit 7, pika 1 të kontratës, 1 ditë vonesë × 0.5 % e detyrimit vjetor të qirasë = 3,112.2 lekë kamatë vonesa ditore. Kamat vonesë ditore (3,112.2 lekë) x 626 ditë (nga 14 shtator 2019 deri 1 qeshor 2021) = 1,948,237.20 lekë. Kamatë vonesa 1,948,237.20 lekë + 622.440 principali i qerasë = **2,570,677.20** lekë.
-Për vitin **2020** nuk është kryer pagesa e qerasë, kjo në kundërshtim me parashikimet në kontratë, pagesa duhet të ishte kryer deri me datë 13 shtatorë, pra është me vonesë 260 ditë deri me datë 01.06.2021 kjo me urdhërin nr.1559/2 prot për zgjidhjen e një anshme të kontratës e firmosur nga titullari i MBZHR. Në zbatim të nenit 1, dhe nenit 7, pika 1 të kontratës, 1 ditë vonesë × 0.5 % e detyrimit vjetor të qirasë = 3,112.2 lekë kamatë vonesa ditore. Kamat vonesë ditore (3,112.2 lekë) x 260 ditë (nga 14 shtator 2020 deri 1 qeshor 2021) = 809,172.00
lekë. Kamatë vonesa 809,172.00 lekë + 622.440 principali i qerasë = **1,431,612.00**lekë.
Subjekti është debitor si me posht:
Viti 2015 ne vlerën **46,683** lekë;
Viti 2016 ne vlerën **1,531,202.40** lekë;
Viti 2017 ne vlerën **395,249.40** lekë;
Viti 2018 ne vlerën **3,706,630.20** lekë;
Viti 2019 ne vlerën **2,570,677.20** lekë;
Viti 2020 ne vlerën **1,431,612.00** lekë;
Totali i të gjithe viteve 9,682,054 lekë.
6. Grupi i auditimit, në bazë të dosjes fizike të monitorimit, ka konstatuar se, subjekti qiramarrësi ñA..ò shpk, referuar Plan bisnesit vlera e investimeve të parashikuara është në vlerën 3,155,883 Euro brenda nje afati 5 vjet, nderkohë vlera e faturave të paraqitura është 27,975,273 lekë dhe 31.500 Euro, por theksoj se pavarshisht se nga subjekti eshte paraqitur faturë tatimore për fidanet nga grupi i auditimit nuk do të maret në konsiderat përderisa me proces-verbal nr.1484/1 prot datë 15.2.2019 të mbajtur nga grupi i punes për monitorimin e kontratës së qeras citohet: *Nuk është mbjellë ende asnjë kulturë me pretendimin se pengohet nga banorë të zonës për një pjesë (rreth 14 ha) të sipërfaqes*.ò Investimi i subjektit i marë ne konsiderat është ne vleren 13,306,926 leke dhe 31.500 Euro.
Pra 3,155,883 Euro (investimi total i parashikuar) ï 31,500 (investimi i kryer) Euro = 3,124,383 Euro (Investimi i mbetur për tu kryer sipas plan biznesit)
3,124,383 Euro x 140.30 (kursi i kembimit nga BSH më datë 16.09.2013 data e lidhjes së kontratës) = 438,350,934.90 lekë.
438,350,934.90 lekë - 13,306,926 leke = 425,044,008.90 leke
Gjithashtu,në bazë të neni 6 pika 5, b ku shprehet se *b) Nëse në përfundim të vitit të pestë konstatohet që Qiramarrësi nuk ka realizuar 70% të totalit të investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtën e vendosjes së një gjobe sipas nenit 7, pika 3,* dhe nenit 7 pika 3 ku citon: *Qiramarrësi paguan gjobë për vonesat në realizimin e investimeve kapitale në masën 2% të vlerës së investimeve kapitale të pakryera, për çdo vit vonesë.*
Gjobat për mos realizimin e investimeve duke nisur nga data 09.09.2019 afati 5 vjecar kur duhet të mbaronte investimet kapitale.
09.09.2019- 09.09.2020 gjobe në vlerën **8,500,880.18** lekë
09.09.2020- 01.06.2021 gjobe në vlerën **6,171,871.91**lekë.

Totali i gjobave ne masen 2% të vlerës së investimeve kapitale të pakryera është **14,672,752.09 lekë.**

Si përfundim,detyrimi prej **24,354,806.29 lekë** përbën të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit, si pasojë e mos plotësimit të detyrimeve kontraktore nga subjekti qirramarrës ñA..ò shpk si dhe nga strukturatë MBZHR, nuk janë realizuar monitorime në kohë të vazhdueshme, në mënyrë qëtë sigurohej kontratë e sukseshme, në zhvillimin bujqësore (mbjedhje e ullinjve dhe pemeve arrore), ndikimet në vlerësimin e mjedisit dhe sociale si dhe sigurimi të ardhurave financiare për Buxhetin e Shtetit, nga dhënia me qira e tokave bujqësore, me pronar shtet dhe administrimtë MBZHR.

II.SUBJEKTI "P.I."shpk

Shoqëria ñP.I.ò shpk dhe ish-MBUMK (Ministria e Bujqesisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit) kanë lidhur Kontratë Nr.3620/1 prot datë 06.09.2013 sipas VKMnr.460, datë 22.5.2013 ñPër përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò *i ndryshuar* për dhënien e tokës bujqësore me qira me afat për 60 vite, ndryshuar me Shtojcën 5 nr.4307, nr.1228 Rep, nr.298 Kol, datë 29.05.2017, në të cilën është ndryshuar shkronja ñdò e nenit 2 ñTë drejtat dhe detyrimet e qiramarrësitò, ku parashikohet se në sipërfaqen e pasurisë të realizojë mbjelljen e kulturave bujqësore si luleshtrydhe, fasule, rukola dhe oriz si dhe ka ndryshuar vlera e qirasë vjetore duke u llogaritur vetëm për 80 ha, me vlerëqiraje 20,250 lekë/ha/viti.

Nga auditimi mbi monitorimin e kontratës u konstatua se, me urdhër të titullarit Ministrit tëBujqësisë nr.2914 prot datë 24.04.2014 është ngritur grupi i punës ñPër kalimin e tokës në përdorim në favor të subjektit ñP.I.òshpk. Me proces-verbal të mbajtur me datë 05.06.2014 nga grupi i punës dhe përfaqësuesi i shoqërisë është dorëzuar një pjesë e sipërfaqes së trajtuar me qira tek qiramarrësi (është kryer piketimi) sipërfaqe prej 80 ha dhe pjesa tjetër prej 61.92 ha nuk është dorëzuar për shkak të pretendimeve të banorëve të zonës.

Ky fakt tregon se, toka bujqësore është dorëzuar nga Ministria e Bujqësisë, rreth 1 vit më vonë, në mos plotësim të detyrimit kontraktor neni 3 nga MB në cilësinë e ñQiradhënësitò dhe në mos përputhshmëri me bazën ligjore dhe nën ligjore mbi të cilën është miratuar kontrata në fjalë, si dhe me kodin civil të Republikës së Shqipërisë neni 827 citon: Qiradhënësi me anë inventari i dorëzon qiramarrësit pasurinë e paluajtshme si tokën bujqësore, kullotat, ndërtesat e banimit e ato ndihmëse në shërbim të veprimtarisë bujqësore e blegtorale, si dhe sendet e luajtshme në shërbim të kësaj veprimtarie. si pasojë e mos ngritjes nga titullari MB, grupit të punës për dorëzimin e tokës bujqësore.

1)Në bazë të Shtojcës me nr.4307 Prot, nr.1225 Rep, nr.298 Kol, datë 29.05.2017, qiramarrësi ka ndryshuar Nenin 1, pika 2 të kontratës së qirasë, si edhe Nenin 2, shkronja d, ku është shtuar si aktivitete kultura bujqësore e orizit që do të mbillet në tokë, përvec luleshtrydhes, fasules dhe rukolës që ishte parashikuar fillimisht. Për këtë të fundit subjekti ka paraqitur edhe Planin e Biznesit të vitit 2017, të miratuar për mbjelljen dhe kultivimin e orizit.

-Nga auditimi, në lidhje mbi monitorimin i kryer nga sektori i monitorimit, në dosjen fizike u konstatua se, është ngritur grupi i punës me urdhër të ministrit të Ministrisë së Bujqësisë nr.97 datë 04.02.2019 ñPër verifikimin e realizimit të programit të investimeve kapitaletë kontratës së qerasëò.

Në bazë të proces-verbali mbajtur me datë 08.02.2019 nga grupi i punës me anetarë A.B., M.K., M.S., H.M.dhe E.T. si dhe firmosur nga përfaqësuesi i autorizuar i shoqërisë"P.I." shprehen se ñ*parcelat me numër pasurie 270, 271, 272, 259, 258 dhe një pjesë e vogël (në formë trekëndëshi) e parcelës me numër pasurie 250, ishin në përdorim nga qiramarrësi. Pjesa tjetër e pasurisë me nr 250 ishte e mbjellë me tërfil nga të tretë. Parcela me numër pasurie 272 është e lirë më shumë se gjysma, në të cilën ishte ndërtuar një vend për rojet, zyrë me konstruksion metalik për tharjen e orizit. Po në këtë parcelë qiramarrësi ka shtrirë rrjetin elektrik, shtylla betoni rreth 8 të tillë, nga të cilat tre ishin lidhur me rrjetin dhe në njërën prej saj është montuar transformatori dhe pesë te tjera të palidhura. Në parcelat si më sipër ishin pastruar kanalet dhe ka mbetje të kashtës së kulturës së orizit. Ishin ngritur dhe oxhaqe për mbjelljen e orizit*.ò

-Grupi i audituesve , nga verifikimet në bazë të dosjes fizike, konstatoi se, deri në momentin e hartimit të këtij materiali, *nuk ka kryer investimet në vlerën deri 20% të vlerës së investimit*, të cilat duhej të realizoheshin *brenda 3 vjetëve* nga momenti i dorëzimit, si dhe *nuk ka kryer investimet në vlerën deri në 70% të vlerës së investimit brenda 5 viteve* të para, e shprehur në bazë të neni 6 pika 5, a dhe b ku shprehet se ñ*a) Nëse në përfundim të vitit të tretë konstatohet që Qiramarrësi ka realizuar jo më shumë se 20% e investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë prishjen e kontratës dhe sekuestrimin e garancisë;*
b) Nëse në përfundim të vitit të pestë konstatohet që Qiramarrësi nuk ka realizuar 70% të totalit të investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtën e vendosjes së një gjobe sipas nenit 7, pika 3.
Gjithashtu, subjekti ka paraqitur fatura për investimet dhe nga llogaritjet në bazë të dokumentacionit, në përfundim të pesë viteve të investimeve, rezultoi si më poshtë:
Plan Biznesi i vitit 2013 në total është me vlerë 351,036,645 lekë.
Investimet e kryera sipas faturave të dorëzuara është 44,399,037 lekë.
Realizimi i faktit ndaj Planit të Biznesittë vitit 2013 në total është 13 %.
Në Planin e Biznesit shtesë me Nr.4307 Prot, Nr.1225 Rep, Nr.298 Kol, datë 29.05.2017 janë parashikuar investime në vlerën 15,785,920 lekë. Për realizimin e Planit të Biznesit shtesë të vitit 2017 nuk është asnjë faturë ne dosjen fizike dhe për këtë arsye investimi konsideruar në masën 0 %.
2. Nga auditimi u konstatua se garancia,sigurimi i realizimit të kontratës nuk është dorezuar për vitet 2018, 2019 dhe 2020, kjo në kundërshtim me kontratën sipas neni *5 Pika 2: Garancia bankare mund të lëshohet për një afat kohor 1 vjecar dhe do të rinovohet deri në përfundim të investimeve kapitale"*
3.Me shkresë nr.6947 prot datë 02.09.2020 të MZHBR, i është kthyer pergjigje shoqërisë "P.I.", në lidhje mbi llogaritjen e pagesave të pricipalit të qerasë duke nxjerr dhe penalitetet, si dhe është llogaritur 2% të vlerës së investimit të pa kryera duke llogaritur penalitetet si me poshtë:
Viti i parë i qiramarrjes, viti 2013 përfshin afatin kohor prej datës 6 Shtator 2013 deri më datë 6 Shtator 2014 (llogaritjet janë kryer nga data 5.6.2014 deri në datën 6.9.2014).
Që nga momenti i marrjes së tokës në dorëzim deri në datën 6 Shtator 2014 (datë kur paguhet dhe qiraja për vitin 2014, gjithsej janë 94 ditë.
Qiraja totale 20,250 lekë/ha × 80 ha = 1,620,000 lekë
Qira totale 1,620,000 lekë /365 ditë = 4,438.36 qira ditore
94 ditë x 4,438.36 lekë (qira ditore) = 417,205.48 lekë qira për vitin 2013
Paguar 2,873,880 lekë ï 417,205.48 lekë = **2,456,674.52 lekë tepricë**
Viti i dytë i qiramarrjes, viti 2014, pagesa duhet kryer brenda dates 06.09.2014
Nga 2,456,674.52 lekë, tepricë e vitit 2013 ï 1,620,000 lekë/pagesa për 80 ha = **836,674,52** lekë tepricë në vitin 2014.
Viti i tretë i qiramarrjes, viti 2015, duhet kryer brenda dates 06.09.2015.
Nga 836,674,52 (lekë tepricë) ï 1,620,000 lekë/pagesa për 80 ha = **-783,325.48** lekë të pa paguara për vitin 2015.
Viti i katërt i qiramarrjes, viti 2016, duhet kryer brenda dates 06.09.2016.
Në vitin 2016 është kryer pagesën në vlerën 862,684 lekë, pra më pak se detyrimi i qirasë që duhet të paguanit, e cila është llogaritur si më poshtë:
20,250 lekë/ha × 80 ha = 1,620,000 lekë pagesë që duhej kryer në vitin 2016.
862,684 lekë të paguara në vitin 2016 ï 1,620,000 lekë pagesa që duhej kryer për vitin 2016 = (757,316) lekë debi për tôı paguar për qiranë e vitit 2016.
Kjo pagesë është realizuar me datë 22 Shtator 2016 jo më datë 6 Shtator 2016
15 ditë × 0.5 % të detyrimit vjetor të qirasë = 121,500 lekë kamatëvonesa.
Pra, pagesa totale për qiranë e vitit 2016 do të jetë 757,316 lekë + 121,500 lekë = **878,816** lekë debi për vitin 2016.
Viti i pestë i qiramarrjes, viti 2017 përfshin datën 7 Shtator 2017 deri 6 Shtator 2018.
Në vitin 2017 është paguar vlerën e qirasë vjetore në vlerën 1,723,883 lekë.

Nga 2,456,674.52 lekë, tepricë e vitit 2013 ï 1,620,000 lekë/pagesa për 80 ha = **836,674,52** lekë tepricë në vitin 2014.

Viti i tretë i qiramarrjes, viti 2015, duhet kryer brenda dates 06.09.2015.

Nga 836,674,52 (lekë tepricë) ï 1,620,000 lekë/pagesa për 80 ha = **-783,325.48** lekë të pa paguara për vitin 2015.

Viti i katërt i qiramarrjes, viti 2016, duhet kryer brenda dates 06.09.2016.

Në vitin 2016 është kryer pagesën në vlerën 862,684 lekë, pra më pak se detyrimi i qirasë që duhet të paguanit, e cila është llogaritur si më poshtë:

20,250 lekë/ha × 80 ha = 1,620,000 lekë pagesë që duhej kryer në vitin 2016.

862,684 lekë të paguara në vitin 2016 ï 1,620,000 lekë pagesa që duhej kryer për vitin 2016 = (757,316) lekë debi për tâı paguar për qiranë e vitit 2016.

Kjo pagesë është realizuar me datë 22 Shtator 2016 jo më datë 6 Shtator 2016

15 ditë × 0.5 % të detyrimit vjetor të qirasë = 121,500 lekë kamatëvonesa.

Pra, pagesa totale për qiranë e vitit 2016 do të jetë 757,316 lekë + 121,500 lekë = **878,816** lekë debi për vitin 2016.

Viti i pestë i qiramarrjes, viti 2017 përfshin datën 7 Shtator 2017 deri 6 Shtator 2018.

Në vitin 2017 është paguar vlerën e qirasë vjetore në vlerën 1,723,883 lekë.

Pagesa e qirasë vjetore është kryer në datë 8 Shtator 2018 dhe jo me datë 6 Shtator 2018, pra 1 ditë me vonesë të cilat në zbatim të nenit 1, pika 3 dhe nenit 7, pika 1 të kontratës, llogariten si vijon:

1 ditë vonesë × 0.5 % e detyrimit vjetor të qirasë = 8,100 lekë kamatëvonesa ditore

1,620,000 lekë detyrim vjetor + 8,100 lekë kamatëvonesa = 1,628,100 lekë/ total.

1,723,883 lekë që keni paguar ï 1,628,100 lekë = **95,783** (nëntëdhjetë e pesëmijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tre) lekë të paguara më tepër për vitin 2017.

Viti i gjashtë i qiramarrjes, viti 2018 përfshin datën 7 Shtator 2018 deri 6 Shtator 2019.

Në vitin 2018 është paguar qiranë në vlerën 1,721,250 lekë.

Pagesa e qirasë është kryer më 18 Shtator 2018 dhe jo më 6 Shtator 2018, pra 11 ditë me vonesë të cilat në zbatim të nenit 1, pika 3 dhe nenit 7, pika 1 të kontratës, llogariten si vijon:

11 ditë × 8,100 lekë kamatëvonesa ditore = 89,100 lekë kamatëvonesa totale

1,620,000 lekë detyrim vjetor + 89,100 lekë kamatëvonesa = 1,709,100 lekë/ total.

1,721,250 lekë ï 1,709,100 lekë = **12,150 lekë** paguar më tepër në vitin **2018**.

Sa më lart vlera totale e të gjitha detyrimeve të mësipërme duke shtuar detyrimet e prapambetura edhe duke zbritur pagesat e kryer më tepër nga ana juaj, është si vijon:

-783,325.48 lekë debi nga viti 2015

-878,816 lekë debi nga viti 2016

+95,783 lekë lekë paguar më tepër në vitin 2017

+12,150 lekë paguar më tepër për vitin 2018

= 1,554,208.48 lekë detyrime të prapambetura total për llogari të qirave vjetore dhe kamatë vonesave.

Lidhur me përllogaritjet e kamatëvonesave sqarojmë se neni 7 ñSanksioneò pika 1, i kontratës së qirasë parashikon se ñQiramarrësi, paguan gjobë në vlerën 0.5 % të detyrimit vjetor të qirasë për çdo ditë vonesë në pagesën e qirasë, duke filluar nga data e përcaktuar në këtë kontratëò. Llogaritja e kamatëvonesave është kryer në përputhje me parashikimet e dispozitave të kontratës.

Bazuar në parashikimet kontraktore të sipërcituara për shkak se shoqëria juaj nuk ka shlyer 70 % të totalit të investimeve kapitale të parashikuara në planin e biznesit të vitit 2013, është gjobitur nga qiradhënësi në vlerën 2 % të vlerës së investimeve të pakryera, në vlerën 6,132,752.16 lekë ndërsa për planin e biznesit të vitit 2017 (orizi) nuk ka asnjë faturë investimi dhe gjoba për këtë plan biznes është në vlerën 315,718.4 lekë. Sa më lart gjoba totale për planin e biznesit të viti 2013 dhe të viti 2017 është 6,448,470.56 lekë.

4.Grupi i auditimit, nga verifikimi i dokumentave në dosjen fizike, konstatoi se nuk janë llogaritur kamatë vonesat për të gjithë vitet, gjithashtu për vitin 2018 përllogaritja e ditë vonesave është llogaritur më shumë.

Përllogaritja qerase dhe kamatë vonesave është si me poshtë vijon:

Viti 2013 përfshin afatin kohor prej datës 6 Shtator 2013 deri më datë 6 Shtator 2014 (llogaritjet janë kryer nga data 05.06.2014 deri në datën 06.09.2014).

Që nga momenti i marrjes së tokës në dorëzim 05.06.2014 deri në datën 6 Shtator 2014 (datë kur paguhet dhe qiraja për vitin 2014, gjithsej janë 94 ditë.

Qiraja totale 20,250 lekë/ha × 80 ha = 1,620,000 lekë

Qira totale 1,620,000 lekë /365 ditë = 4,438.36 qira ditore

94 ditë x 4,438.36 lekë (qira ditore) = 417,205.48 lekë qira për vitin 2013

Paguar 2,873,880 lekë ï 417,205.48 lekë = **2,456,674.52 lekë tepricë, duke paguar më shumë.**

Viti 2014 duhet të paguhet brenda 6 Shtator.

Nga 2,456,674.52 lekë, tepricë e vitit 2013 ï 1,620,000 lekë/pagesa për 80 ha = **836,674,52** lekë tepricë në vitin 2014.

Viti 2015 të paguhet brenda 6 Shtator.

Nga 836,674,52 (lekë tepricë) ï 1,620,000 lekë/pagesa për 80 ha = -783,325.48 lekë të pa paguara nga principali i qerasë për vitin 2015.

1 ditë vonesë x 0.5 % e detyrimit vjetor të qirasë se mbetur pa paguar prej 783,325.48 = 3,916.63 lekë kamatë vonesa ditore.

3,916.63 x 732 ditë (pagesë e kryer me datë 08.09.2017) = **2,866,971.26** lekë kamatë vonesa.

Me datë 08.09.2017 është paguar pricipali i qerasë së vitit 2017 dhe difereca tepricës paguar nga subjekti është në shumën 95,783 leke me shume .

783,325.48 (shuma e pa paguar e vitit 2015) - 95,783 leke (diferenca paguar më shumë nga subjekti ne vitin 2017) = 687,542.48 leke diferenca e mbetur për tu paguar nga principali i qerasë së vitit 2015.

1 ditë vonesë x 0.5 % e detyrimit vjetor të qirasë se mbetur pa paguar prej 687,542.48 = 3,437.71 lekë kamatë vonesa ditore.

3,437.71 x 367 ditë (nga data 08.09.2017deri me datë 10.09.2018) = **1,261,640.45** lekë kamatë vonesa.

Me datë 10.09.2018 është paguar pricipali i qerasë së vitit 2018 dhe difereca në tepri paguar nga subjekti është në shumën 76,950 lekë.

687,542.48(shuma e pa paguar) - 76,950 leke diferenca paguar më shumë nga subjekti = 610,592.48 leke diferenca e mbetur për tu paguar.

1 ditë vonesë x 0.5 % e detyrimit vjetor të qirasë se mbetur pa paguar prej **610,592.48** = 3,052.96 lekë kamatëvonesa ditore.

3,052.96 x 932 dite (10.09.2018 deri me datë 30.03.2021) = **2,845,360.96**lekë kamatë vonesa.

Totali pagesës së qerasë principale të pa paguar dhe kamte vonesa është **7,584,565.15** lekë.

610,592.48 Principali I mbetur pa paguar.

2,866,971.26 kamete vonesa.

1,261,640.45 kamate vonesa.

2,845,360.96 kamate vonesa.

Viti 2016 të paguhet brenda 6 Shtator.

Në vitin 2016 është kryer pagesën në vlerën 862,684 lekë, pra më pak se detyrimi i qirasë që duhet të paguanit, e cila është llogaritur si më poshtë:

20,250 lekë/ha × 80 ha = 1,620,000 lekë pagesë që duhej kryer në vitin 2016.

862,684 lekë të paguara në vitin 2016 ï 1,620,000 lekë pagesa që duhej kryer për vitin 2016 = (-757,316) lekë debi për tâı paguar për qiranë e vitit 2016.

Kjo pagesë është realizuar me datë 22 Shtator 2016 jo më datë 6 Shtator 2016.

15 ditë × 0.5 % të detyrimit vjetor të qirasë = **121,500** lekë kamatë vonesa.

Pagesa e pricipalit të qerasë e pa paguar për vitin 2016 është ne vlerën 757,316 lekë.

1 ditë vonesë x 0.5 % e detyrimit të qirasë se mbetur pa paguar prej 757,316 = 3,786.58lekë kamatëvonesa ditore.

3,786.58 x 1650 dite vonesë (22.09.2016 pagesa e pjeshme e qerasë deri me datë 30.03.2021) = 6,247,857lekë kamatë vonesa.

121,500 lekë (kamatë vonesa të qerasë së pa paguar) + 6,247,857lekë(kamatë vonesa te principalit të qerasë mbetur për tu paguar) + 757,316Principali I qerasë pa paguar = **7,126,673lekë për tu paguar.**

Viti 2017 paguhet brenda 6 Shtator.

Në vitin 2017 është paguar vlerën e qirasë vjetore në vlerën 1,723,883 lekë.

Pagesa e qirasë vjetore është kryer në datë 8 Shtator 2018 dhe jo me datë 6 Shtator 2018, pra 1 ditë me vonesë të cilat në zbatim të nenit 1, pika 3 dhe nenit 7, pika 1 të kontratës, llogariten si vijon:

1 ditë vonesë × 0.5 % e detyrimit vjetor të qirasë = 8,100 lekë kamatëvonesa ditore

1,620,000 lekë detyrim vjetor + 8,100 lekë kamatëvonesa = 1,628,100 lekë/ total.

1,723,883 lekë që keni paguar ï 1,628,100 lekë = **95,783** lekë të paguara më tepër për vitin 2017, dhe zbritur nga principali i pa paguar i qerase se vitit 2015.

Viti 2018 paguhet brenda 6 Shtator.

Në vitin 2018 keni paguar qiranë në vlerën 1,721,250 lekë.

Pagesa e qirasë është kryer më 10 Shtator 2018 dhe jo më 6 Shtator 2018, pra 3 ditë me vonesë të cilat në zbatim të nenit 1, pika 3 dhe nenit 7, pika 1 të kontratës, llogariten si vijon:

3 ditë × 8,100 lekë kamatëvonesa ditore = 24,300 lekë kamatëvonesa totale

1,620,000 lekë detyrim vjetor + 24,300 lekë kamatëvonesa = 1,644,300 lekë/ total.

1,721,250 lekë ï 1,644,300 lekë = **76,950 lekë** paguar më tepër në vitin **2018**, dhe zbritur nga principali i pa paguar i qerasë së vitit 2015.

Viti 2019 paguhet brenda 6 Shtator.

Në vitin 2019 është paguar qiranë në vlerën 1,620,000 lekë.

Pagesa e qirasë është kryer më 07 tetor 2019 dhe jo më 6 Shtator 2019, pra 31 ditë me vonesë të cilat në zbatim të nenit 1, pika 3 dhe nenit 7, pika 1 të kontratës, llogariten si vijon:

31 ditë × 8,100 lekë kamatëvonesa ditore = **251,100** lekë kamatëvonesa totale.

Viti 2020 paguhet brenda 6 Shtator.

Në vitin 2020 është paguar qiranë në vlerën 1,620,000 lekë.

Pagesa e qirasë është kryer më 05 tetor 2020 dhe jo më 6 Shtator 2020, pra 29 ditë me vonesë të cilat në zbatim të nenit 1, pika 3 dhe nenit 7, pika 1 të kontratës, llogariten si vijon:

29 ditë × 8,100 lekë kamatëvonesa ditore = **234,900** lekë kamatëvonesa totale.

Sa më lart vlera totale e të gjitha detyrimeve të mësipërme nga kamatë vonesat dhe princalin e qerasë se prapambetur:

7,584,565.15lekë kamatë vonesa vitin dhe principal i qerasë 2015

7,126,673lekë kamatë vonesa vitin dhe principal i qerasë 2016

251,100 lekë kamatë vonesa vitin 2019

234,900 lekë kamatë vonesa vitin 2020

= **15,197,238.15** detyrime të prapambetura total për llogari të qirave vjetore dhe kamatë vonesave.

5.Grupi i auditimit, në bazë të dosjes fizike të monitorimit, ka konstatuar se, subjekti qiramarrësi "P.I" nga llogaritjet e kryera nga faturave të dorëzuara në lidhje me planin e biznesit për vitin 2013, në përfundim të pesë viteve investim, rezultoi se investimet e kryera janë në vlerë totale 44,399,037 lekë. Plani i biznesit i vitit 2013 parashikon në total vlerën 351,036,645 lekë.

Plani i biznesit shtesë, i vitit 2017 parashikon investime me vlerë 34,156,800 lekë. Për realizimin e planit të biznesit shtesë në dosjen fizike nuk ka asnjë faturë dhe për këtë arsye investimi është në masën 0 %.

Referuar kontratës nr.3620/1 protdatë 06.09.2013 nenit 6, pika 5, gërma b, nëse në përfundim të vitit të pestë konstatohet që qiramarrësi nuk ka realizuar 70 % të totalit të investimeve kapitale të parashikuara atëherë qiradhënësi ka të drejtën e vendosjes së një gjobe sipas nenit 7, pika 3.

Sipas kontratës nenit 7 ñSanksioneò, pika 3, parashikohet: ñQiramarrësi paguan gjobë për vonesat në realizimin e investimeve kapitale në masën 2 % të vlerës së investimeve të pakryera, për çdo vit vonesë.ò

Bazuar në parashikimet kontraktore të sipërcituara gjobat për mos realizimin e investimeve të parashikuara në planin e bisnesit të vitit 2013, duke nisur nga data 05.06.2019 afati 5 vjecar kur duhet të mbaronte investimet kapitale.

05.06.2019 - 05.06.2020 gjobë për vitin e parë në vlerën 2% x 306,637,608 lekë (Investimi i parealizuar) =6,132,752.16 Lekë gjobë.
05.06.2020 - 05.06.2021 gjobë për vitin e dytë në vlerën 2% x 306,637,608 lekë (Investimi i parealizuar) =6,132,752.16 Lekë gjobë.
Total gjoba për plani e biznesi 2013 është në vlerën **12,265,504.32** Lekë.
Bazuar në parashikimet kontraktore të sipërcituara gjobat për mos realizimin e investimeve të parashikuara në planin e bisnesit të vitit 2017, duke nisur nga data 05.06.2019 afati 5 vjecar kur duhet të mbaronte investimet kapitale.
05.06.2019 - 05.06.2020 gjobë për vitin e parë në vlerën 2% x 34,156,800 lekë (Investimi i parealizuar) =683,136.00 Lekë gjobë.
05.06.2020 - 05.06.2021 gjobë për vitin e dytë në vlerën 2% x 34,156,800 lekë (Investimi i parealizuar) =683,136.00 Lekë gjobë.
Total gjoba për plani e bisnet 2017 është në vlerën 1,366,272.00 Lekë.
Në total gjoba për mos realizimin e investimeve kapitale për plan bisnesin e viti 2013 dhe 2017 është në vlerën **13,631,776.32** lekë
Si përfundim, detyrimi prej **28,829,014.47** lekë përbën të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit, si pasojë e mos plotësimit të detyrimeve kontraktore nga subjekti qirramarrës "P.I"ò shpk si dhe nga struktura të MBZHR, nuk janë realizuar monitorime në kohë të vazhdueshme, në mënyrë që të sigurohej kontratë e sukseshme, në zhvillimin bujqësore (kultivim ullinj dhe pemëve arrore), ndikimet në vlerësimin e mjedisit dhe sociale si dhe sigurimi të ardhurave financiare për Buxhetin e Shtetit, nga dhënia me qira e tokave bujqësore, me pronar shtet dhe administrimtë MBZHR.

III. Subjekti "Ç" shpk

Subjekti ñÇò shpk dhe Ministria e Bujqesisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave kanë lidhur Kontratë nr Nr.1001 Prot, nr.396 Rep, nr.369 Kol, datë 05.02.2016 sipas VKM Nr.460, datë 22.5.2013 ñPër përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar për dhënien e tokës bujqësore me qira me afat për 60 vite, ngritje vreshti për kultivimin rrushi dhe prodhim vere ,me vlerë qiraje 321,565 lekë në vit.
Nga auditimi mbi monitorimin e kontratës në dosjen fizike u konstatua se, me urdhër të titullarit Ministrit të MBZHR nr.9763/1 datë 19.10.2018 është ngritur grupi i punës ñPër dorëzimin e tokës qiramarrësit subjektit Z. P.Ç shpk. Me procesverbal nr.9763/3 datë 26.10.2018 mbajtur nga B.K, M.K, L.K, A.P nga DAMT, Këshilli i qarkut Berat dhe nga qiramarresi z.P.Ç, për dorëzimin e tokës në zbatim të parashikimeve të kontratës së qirasë, citon: *qiramarrësi e ka përdorur këtë sipërfaqe që prej momentit të nënshkrimit të kontratës, fakt ky i provuar me ngritjen e vreshtit me rrush, i cili ishte një pjesë dyvjeçar, një pjesë njëvjeçar si dhe deklaroi se do të mbjellë edhe një sipërfaqe tjetër e cila siç u konstatua edhe në terren është e punuar gati për t'u mbjellë.*
Ky fakt tregon se, toka bujqësore është dorëzuar nga Ministria e Bujqësisë, rreth *2 vit më vonë, në mos plotësim të detyrimit kontraktor neni 1 dhe neni 3 nga MB në cilësinë e "Qiradhënësit" dhe në mos përputhshmëri me bazën ligjore dhe nën ligjore mbi të cilën është miratuar kontrata në fjalë, si dhe me kodin civil të Republikës së Shqipërisë neni 827 citon: Qiradhënësi me anë inventari i dorëzon qiramarrësit pasurinë e paluajtshme si tokën bujqësore, kullotat, ndërtesat e banimit e ato ndihmëse në shërbim të veprimtarisë bujqësore e blegtorale, si dhe sendet e luajtshme në shërbim të kësaj veprimtarie. si pasojë e mos ngritjes nga titullari MB, grupit të punës për dorëzimin e tokës bujqësore.*

1.Nga auditimi deri në momentin e hartimit të këtij materiali në dosjen fizike nuk u gjend asnjë dokument ose fatura për të vërtetuar realzimin e investimit të kryer, *subjekti nuk ka kryer investimet në vlerën deri 20% të vlerës së investimit*, të cilat duhej të realizoheshin *brenda 3 vjetëve*, si dhe *nuk ka kryer investimet në vlerën deri në 70% të vlerës së investimit brenda 5 viteve* të para, e shprehur në bazë të neni 6 pika 5, a dhe b ku shprehet se ñ*a) Nëse në përfundim të vitit të tretë konstatohet që Qiramarrësi ka realizuar jo më shumë se 20% e investimeve kapitale të*

parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë prishjen e kontratës dhe sekuestrimin e garancisë;
b) Nëse në përfundim të vitit të pestë konstatohet që Qiramarrësi nuk ka realizuar 70% të totalit të investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtën e vendosjes së një gjobe sipas nenit 7, pika 3.
2. Nga auditimi u konstatua se garancia,sigurimi i realizimit të kontratës nuk është rinovuar vit për vit, kjo në kundërshtim me kontratën sipas neni *5 Pika 2: Garancia bankare mund të lëshohet për një afat kohor 1 vjecar dhe do të rinovohet deri në përfundim të investimeve kapitale"*
3.Grupi i auditimit, në bazë të dosjes fizike të monitorimit, ka konstatuar se, subjekti qiramarrësi ñÇò shpk, në bazë të neni 1 ñObjekti i kontrates ò, pika 3 ñ*Pagesa e qerasë për vitin e parë të qiramarrjes kryehet si parapagim në momentin e lidhjes së kontratës por jo me vonë se 22 shkurt 2016, ndersa për periudhen vijuese me datë 05 shkurt të cdo viti pasardhë*sò,.
Pagesat kanë rezultuar si më poshtë:
-Për vitin **2016** është bërë pagesa me datë 16.02.2016, në vlerën 321,565 lekë.
-Përvitin **2017** është bërë pagesa me date 24.05.2017, në vlerën 321,565 lekë, kjo në kundërshtim me parashikimet në kontratë, pagesa duhet të ishte paguar deri me datë 05 shkurt, pra është në vonesë 107 ditë. Në zbatim të nenit 1, dhe nenit 7, pika 1 të kontratës, 1 ditë vonesë × 0.5 % e detyrimit vjetor të qirasë = 1,607.83lekë kamatë vonesa ditore. Kamat vonesë ditore (1,607.83lekë) x 107 ditë (nga 06 shkurt 2017 deri 24 maj 2017) = **172,037.28**lekë;
-Përvitin **2018** është bërë pagesa me datë 23.05.2018, në vlerën 321,565 lekë, kjo në kundërshtim me parashikimet në kontratë, pagesa duhet të ishte paguar deri me datë 05 shkurt, pra është në vonesë 106 ditë. Në zbatim të nenit 1, dhe nenit 7, pika 1 të kontratës, 1 ditë vonesë × 0.5 % e detyrimit vjetor të qirasë = 1,607.83lekë kamatë vonesa ditore. Kamat vonesë ditore (1,607.83lekë) x 106 ditë (nga 06 shkurt 2018 deri 23 maj 2018) = **170,429.45**
lekë;
-Për vitin **2019**është bërë pagesa me datë 17.01.2019, në vlerën 321,565 lekë.
-Për vitin **2020**është bërë pagesa me datë29.01.2020, në vlerën 321,565 lekë.
-Për vitin **2021**është bërë pagesa me datë02.02.2021, në vlerën 321,565 lekë.
Subjekti është debitor për kamatë vonesat për vitin 2017 në vleren 172,037.28 lekë dhe për vitin 2018 në vlerën 170,429.45, pra shuma e të dyjave është debitor në vlerën 342,466.73 lekë.
Në dosje u evidentua se, subjekti ka bërë pagesë me datë 29.10.2019 në vlerën 157,566 leke për detyrimet e prapambetura **342,466.73** leke (debitor per vitin 2017 dhe 2018) - 157,566 lekë paguar nga subjekti = **184,900.73** leke debi e mbetur e pa paguar.
4. Grupi i auditimit, në bazë të dosjes fizike të monitorimit, ka konstatuar se, subjekti qiramarrësi "Ç"nuk ka dorezuar ose paraqitur asnjë dokument ose fatura për të vërtetuar realzimin e investimit të kryer. Sipar Planit të Biznesit subjekti "Ç" do te investoj 154,286,259 lekë.
Bazuar në parashikimet kontraktore të sipërcituara gjobat për mos realizimin e investimeve të parashikuara në planin e bisnesit, duke nisur nga data e 05.02.2021 afati 5 vjecar kur duhet të mbaronte investimet kapitale.
05.02.2021 deri me datë 30.03.2021 (periudha e auditimit) gjobë për vitin e parë për 53 ditë në vlerën 2% x 154,286,259 lekë (Investimi i parealizuar) =448,064Lekë gjobë për 53 ditë vonesë.
Pra, vlera prej *632,964.93* lekë përbën detyrimin për të paguar subjekti "Ç", si mosplotësim të detyrimeve kontraktore.

IV. Subjekti "A.M."

Subjekti ñA.M.ò dhe Ministria e Bujqesisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit Të Ujrave kanë lidhur Kontratë nr Nr. 2548 Prot, nr.115 Rep, nr.68 Kol, datë 24.03.2015 sipas vkm Nr.460, datë 22.5.2013*"Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit" i ndryshuar* për dhënien e tokës bujqësore me qira me afat për 90 vite, ngritje e kompleksit blegtoral dhe ndërtimi i fabrikës së përpunimit të qumështit, me vlerë qiraje 570,906 lekë në vit.

1.Nga auditimi mbi monitorimin e kontratës në dosjen fizike u konstatua se, me urdhër të titullarit Ministritë MBZHR nr.1042/1 datë 04.02.2019 është ngritur grupi i punës ñPër dorëzimin e tokës qiramarrësit subjektit ñA.M.ò. Me procesverbal nr.1042/2 datë 06.02.2019 mbajtur nga M.K, L.K, A.M nga DAMT, keshilli i qarkut Elbasan dhe nga qiramarresi A.M..

Ky fakt tregon se, toka bujqësore është dorëzuar nga Ministria e Bujqësisë, rreth *4 vite më vonë, në mos plotësim të detyrimit kontraktor neni 1 dhe neni 3 nga MB në cilësinë e "Qiradhënësit" dhe në mos përputhshmëri me bazën ligjore dhe nën ligjore mbi të cilën është miratuar kontrata në fjalë, si dhe me kodin civil të Republikës së Shqipërisë neni 827 citon: Qiradhënësi me anë inventari i dorëzon qiramarrësit pasurinë e paluajtshme si tokën bujqësore, kullotat, ndërtesat e banimit e ato ndihmëse në shërbim të veprimtarisë bujqësore e blegtorale, si dhe sendet e luajtshme në shërbim të kësaj veprimtarie. si pasojë e mos ngritjes nga titullari MB, grupit të punës për dorëzimin e tokës bujqësore.*

Kjo kontratë, është parashikuar veprimtari blegtorale, ndonëse në aktin nënligjor të aplikuar të kohës, të VKM nr.460, datë 22.5.2013ñPër përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar, nuk parashikon veprimtari blegtorale, Kreu VI ñAfatet e dhënies me qira të tokaveò pika 1, shprehet se, tokat jepen me qira për veprimtari bujqësore. Ky fakt juridik është në kundërshtim me ligjin nr.8318 datë 01.04.1998 ñPër dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetëroreò i ndryshuar, neni 8, mbi të cilin është miratuar VKM e ndryshuar me VKM nr.373 datë 20.06.2018 ñPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar me VKM nr.487 datë 17.06.2020 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.373 datë 20.06.2018 të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e kriterevetë rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit.ò, të cilat në përmbajtjen e tyre kreu IV, pika 8, nënpika (b, d,dh) dhe kreu VI pika1,nuk janë shprehur për veprimtari për prodhim blegtoral.

Ligji nr.8318 datë 01.04.1998 ñPër dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetëroreò i ndryshuar, neni 8,shprehet se:

(1).deri në 10 vjet për kontratat e qirasë afatshkurtër, ku përfshihen veprimtaritë për **prodhimin e bimëve të arave** dhe eterovajore.

(2).deri në 30 vjet për kontratat e qirasë afatmesëm, ku **përfshihen veprimtaritë për prodhimin blegtorial**, për prodhimin e fidanëve, mjediset e mbrojtura dhe pyjet e ulëta (cungishte).

(3).deri në 99 vjet për kontratat e qirasë afatgjatë, ku përfshihen veprimtaritë për turizëm, rekreacion, pyll i lartë dhe pemët frutore.

2.Grupi i auditimit, në bazë të dosjes fizike të monitorimit, ka konstatuar se, subjekti qiramarrësi ñA.M.ò , në bazë të neni 1 ñObjekti i kontrates ò, pika 3 ñ*Pagesa e qerasë për vitin e parë të qiramarrjes kryehet si parapagim në momentin e lidhjes së kontratës por jo me vonë se 07 prill 2015, ndersa për periudhen vijuese me datë 24 mars të cdo viti pasardhë*sò,

Qiramarresi pavarsisht se nuk e ka marë token në dorezim ka paguar qirane për vitin 2015, 2016, 2017, dhe 2018

Pagesat pas marjes së tokës ne dorezim rezultojnë si më poshtë:

-Për vitin **2019**është bërë pagesa me datë12.05.2020, në vlerën 570,906 lekë, kjo në kundërshtim me parashikimet në kontratë, pagesa duhet të ishte paguar deri me datë 24 mars, pra është në vonesë 414 ditë. Në zbatim të nenit 1, dhe nenit 7, pika 1 të kontratës, 1 ditë vonesë × 0.5 % e detyrimit vjetor të qirasë = 2,854.53lekë kamatë vonesa ditore. Kamat vonesë ditore (2,854.53lekë) x 414 ditë (nga 25 mars 2019 deri 12 maj 2020) = **1,181,775.42**lekë;

-Për vitin **2020**është bërë pagesa me datë20.05.2020, në vlerën 570,906 lekë, kjo në kundërshtim me parashikimet në kontratë, pagesa duhet të ishte paguar deri me datë 24 mars, pra është në vonesë 56 ditë. Në zbatim të nenit 1, dhe nenit 7, pika 1 të kontratës, 1 ditë vonesë × 0.5 % e detyrimit vjetor të qirasë = 2,854.53lekë kamatë vonesa ditore. Kamat vonesë ditore (2,854.53lekë) x 56 ditë (nga 25 mars 2019 deri 20 maj 2020) = **159,853.68**

Deri në momentin e hartimit të këtij materiali subjekti nuk ka paguar pricipalin e qerasë që duhet ta paguente drri me date 24.03.2021.

Subjekti është debitor për kamatë vonesat për vitin 2019 në vleren **1,181,775.42 lekë dhe për vitin 2020 në vlerën 159,853.68 lekë.**
Në total subjekti është debitor ne vlerën **1,341,629.10**lekë.
3. Nga auditimi u konstatua se garancia,sigurimi i realizimit të kontratës nuk është dorezuar për vitet 2019, 2020 dhe 2021 kjo në kundërshtim me kontratën sipas neni *5 Pika 2: Garancia bankare mund të lëshohet për një afat kohor 1 vjecar dhe do të rinovohet deri në përfundim të investimeve kapitale.*

V. Subjekti "P." shpk

Subjekti "P." shpk dhe MZHBR kanë lidhur Kontratë Nr.2711 Prot, nr.827 Rep, nr. 679 Kol, datë 31.03.2017 sipas VKM nr.460, datë 22.5.2013 ñ*Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit" i ndryshuar* për dhënien e tokës bujqësore me qira me afat për 60 vite, për kultivimin e bimëve farogjere për sigurimin dhe plotësimin e nevojave për ushqim të blegtorisë dhe krijimin e një ferme blegtorale për mbarështrimin e gjedhit për mish, me vlerë qiraje 1,317,330 lekë në vit.
1. Nga auditimi mbi monitorimin e kontratës u konstatua se, me urdhër të ish-titullarit te Ministritë nr.269 Prot, Datë 19.06.2017 është ngritur grupi i punës ñMbi kalimin e tokës në përdorim (qira) shoqërisë ñP.ò shpk. Sipërfaqja është marrë në dorëzim nga qiramarrësi me procesverbalin e dorezimit të datës 11.07.2017.
Kjo kontratë, është parashikuar veprimtari blegtorale, ndonëse në aktin nënligjor të aplikuar të kohës, të VKM nr.460, datë 22.5.2013ñPër përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar, nuk parashikon veprimtari blegtorale, Kreu VI ñAfatet e dhënies me qira të tokaveò pika 1, shprehet se, tokat jepen me qira për veprimtari bujqësore. Ky fakt juridik është në kundërshtim me ligjin nr.8318 datë 01.04.1998 ñPër dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetëroreò i ndryshuar, neni 8, mbi të cilin është miratuar VKM e ndryshuar me VKM nr.373 datë 20.06.2018 ñPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar me VKM nr.487 datë 17.06.2020 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.373 datë 20.06.2018 të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e kriterevetë rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit.ò, të cilat në përmbajtjen e tyre kreu IV, pika 8, nënpika (b, d,dh) dhe kreu VI pika1,nuk janë shprehur për veprimtari për prodhim blegtoral.
Ligji nr.8318 datë 01.04.1998 ñPër dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetëroreò i ndryshuar, neni 8,shprehet se:
(1).deri në 10 vjet për kontratat e qirasë afatshkurtër, ku përfshihen veprimtaritë për **prodhimin e bimëve të arave** dhe eterovajore.
(2).deri në 30 vjet për kontratat e qirasë afatmesëm, ku **përfshihen veprimtaritë për prodhimin blegtorial**, për prodhimin e fidanëve, mjediset e mbrojtura dhe pyjet e ulëta (cungishte).
(3).deri në 99 vjet për kontratat e qirasë afatgjatë, ku përfshihen veprimtaritë për turizëm, rekreacion, pyll i lartë dhe pemët frutore.
2. Nga auditimi deri në momentin e hartimit të këtij materiali, *nuk ka kryer investimet në vlerën deri 20% të vlerës së investimit*, të cilat duhej të realizoheshin *brenda 3 vjetëve* nga momenti i dorëzimit, pasi nga subjekti nuk janë paraqitur fatura për investimet e shprehur në bazë kontratës neni 6 pika 5, a ku shprehet se ñ*a) Nëse në përfundim të vitit të tretë konstatohet që Qiramarrësi ka realizuar jo më shumë se 20% e investimeve kapitale të parashikuara, atëherë Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë prishjen e kontratës dhe sekuestrimin e garancisë;*
3. Subjekti ka kryer sigurimin e kontratës per vitin e parë me date 31.03.2017 pranë kompanis ñA.Cò. Ndërsa për vitet në vazhdim nuk është kryer sigurimi i kontratës.
4. Grupi i auditimit, në bazë të dosjes fizike të monitorimit, ka konstatuar se, subjekti qiramarrësi "P." shpk, në bazë të neni 1 ñObjekti i kontrates ò, pika 3 ñ*Pagesa e qirasë për vitin e parë kryhet si parapagim në momentin e lidhjes së kontratës por jo më vonë se 14 Prill 2017, ndërsa për periudhën vijuese më datë 31 Mars të çdo viti pasardhës*ò.

Pagesat kanë rezultuar si më poshtë:
- Për vitin **2017** është kryer pagesa me 20.04.2017, në vlerën 1,317,330 lekë, kjo në kundërshtim me parashikimet në kontratë, pagesa duhet të ishte paguar deri me datë 14 prill, pra është me vonesë 5 ditë. Në zbatim të nenit 1, dhe nenit 7, pika 1 të kontratës, 1 ditë vonesë × 0.5 % e detyrimit vjetor të qirasë = 6,586.65 lekë kamatë vonesa ditore. Kamat vonesë ditore (6,586.65 lekë) x 5 ditë (nga 15 prill 2017 deri 20 prill 2017) = **32,933.25** lekë;
- Për vitin **2018** është bërë pagesa me 29.03.2018, në vlerën 1,317,330 lekë, Brenda dates se përcaktuar ne kontratë.
- Për vitin **2019** është kryer pagesa me 04.04.2019, në vlerën 1,317,330 lekë, kjo në kundërshtim me parashikimet në kontratë, pagesa duhet të ishte deri me datë 31 mars, pra është me vonesë 3 ditë. Në zbatim të nenit 1, dhe nenit 7, pika 1 të kontratës, 1 ditë vonesë × 0.5 % e detyrimit vjetor të qirasë = 6,586.65 lekë kamatë vonesa ditore. Kamat vonesë ditore (6,586.65 lekë) x 3 ditë (nga 1 prill 2019 deri 4 prill 2019) = **19,759.95** lekë;
- Për vitin **2020** nuk është kryer pagesa e qerasë, kjo në kundërshtim me parashikimet në kontratë, pagesa duhet të ishte kryer deri me datë 31 mars, pra është me vonesë 426 ditë e llogaritur deri me datë 01.06.2021. Në zbatim të nenit 1, dhe nenit 7, pika 1 të kontratës, 1 ditë vonesë × 0.5 % e detyrimit vjetor të qirasë = 6,586.65 lekë kamatë vonesa ditore. Kamat vonesë ditore (6,586.65 lekë) x 426 ditë (nga 01 prill 2020 deri 1 qershor 2021) = 2,805,912.90 lekë. Kamatë vonesa 2,805,912.90 lekë + 1,317,330 principali i qerasë = **4,123,242.90** lekë.
- Për vitin **2021** nuk është kryer pagesa e qerasë, kjo në kundërshtim me parashikimet në kontratë, pagesa duhet të ishte kryer deri me datë 31 mars, pra është me vonesë 61 ditë e llogaritur deri me datë 01.06.2021. Në zbatim të nenit 1, dhe nenit 7, pika 1 të kontratës, 1 ditë vonesë × 0.5 % e detyrimit vjetor të qirasë = 6,586.65 lekë kamatë vonesa ditore. Kamat vonesë ditore (6,586.65 lekë) x 61 ditë (nga 01 prill 2021 deri 1 qershor 2021) = 401,785.65 lekë. Kamatë vonesa 401,785.65 lekë + 1,317,330 principali i qerasë = **1,719,115.65** lekë.

Subjekti është debitor si me posht:
Viti 2017 ne vlerën **32,933.25** lekë;
Viti 2019 ne vlerën **19,759.95** lekë;
Viti 2020 ne vlerën **4,123,242.90** lekë;
Viti 2021 ne vlerën **1,719,115.65** lekë;
Totali i të gjithe viteve 5,895,051.75 lekë.
Në total subjekti është debitor ne vlerën, *detyrimi prej **5,895,051.75 Lekë** përbën të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit, si pasojë e mos plotësimit të detyrimeve kontraktore nga subjekti qirramarrës "P." shpk si dhe nga strukturatë MBZHR, nuk janë realizuar monitorime në kohë të vazhdueshme, në mënyrë qëtë sigurohej kontratë e sukseshme.*

Si përfundim, nga auditimi i monitorimit të ecurisë për 5 (katër) kontrata, u konstatua se, **vlera prej 61,053,466.54 lekë përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Shtetit**, si pasojë e mos plotësimit të detyrimeve kontraktore nga subjektet qirramarrëse nga njëra palë konkretisht, ñAò, ñP.Iò, ñK.Çò, ñA.M.ò dhe ñP.ò dhe ngapala tjetër strukturat e MBZHR, nuk janë realizuar monitorime në kohë të vazhdueshme dhe në cilësi.
Monitorimi i tyre në përputhshmëri dhe në pjesën finaciare, do të siguronte, kontrata të sukseshme, dukë synuar zhvillimin bujqësor, e për rrjedhojë, sigurimin e të ardhurave financiare për Buxhetin e Shtetit, nga dhënia me qira e tokave bujqësore, me pronar shtet dhe administrim të MBZHR.
Në disa prej kontratave të qirasë të lidhura gjatë viteve 2013 ï 2018 të audituara në lidhje mbi ecurinë dhe monitorimin , u konstatua se, një pjesë e sipërfaqeve të dhëna me qira, janë të mbivendosura, mbi varreza publike të zonës, mbi ndërtime të paligjshme si dhe në përdorim të një pale tretë, për pasojë subjektet qiramarrëse nuk kanë mundur të shfrytëzojnë sipërfaqen e plotë dhe të zhvillojnë plotësisht kontratën.Struktura përgjegjëse e monitorimit të kontratave për periudhën në auditim, ka identifikuar dhe verifikuar problematikën e mësipërme, duke njoftuar titullarit e MBZHR. Problematikat, tregojnë mangësinë e mungesës së rregjistrit të plotë dhe të

saktë, të fondit të tokës bujqësore në administrim të MBZHR, i cili duhej hartuar në bashkëpunim dhe koordinim midis institucioneve dhe organeve kompetente shtetërore, më konkretisht si vijon:

1.Subjekti "M" shpk është lidhur me Ministrinë e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, kontrata nr. 8136Prot, datë 23.10.2015,për sipërfaqen prej 18.9174 ha tokë bujqësore të ndodhur të ndodhur në Zonën Kadastrale 1582 e përbërë prej ngastrave me numra pasurie 114/19, 114/21, 114/22, Fshati Dushk i Madh, Njësia Administrative Dushk, Rrethi Lushnje, Qarku Fier .

Nga auditimi u konstatua se, sipas verifikimit në terren i strukturës përgjegjëse për monitorim në datën 14.11.2018 rezultoi se qiramarrësi nuk mund të shfrytëzojë sipërfaqen me numër pasurie 114/22 me sipërfaqe 7000 m^2 Zona Kadastrale 1582 e cila **është e zënë me varreza** dhe pasurinë me nr. 114/19 Zona Kadastrale 1582 me sipërfaqe 23,843 m^2 e ndarë sipas ligjit 7501 referuar hartës treguese e cila është e zënë nga vreshta.

Neni 2 i kontratës ñTë drejtat dhe detyrimet e qiramarrësitò, pika f, i cili parashikon se ñQiramarrësi ka për detyrim të regjistrojë këtë kontratë pranë zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.....ò

Për këtë problematikë shoqëria ñMò shpk është drejtuar pranë qiradhënësit edhe me shkresën nr. 849 Prot. datë 24.01.2019 ku informon se ka aplikuar për regjistrimin e Kontratës së Qirasë pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnje që në datë 28.11.2015, ndërsa çertifikata e regjistrimit është lëshuar nga kjo zyrë në datën 29.9.2016.

Regjistrimi i kontratës është bërë vetëm për pasurinë me numër 114/21 me sipërfaqe 158.331 m^2. Për pasuritë me numër 114/19 me sipërfaqe 23.843 m^2 dhe 114/22 me sipërfaqe 7.000 m^2, nuk u bë i mundur regjistrimi nga ana e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnje, sepse sipas saj pasuria 114/19 rezulton e ndarë sipas ligjit nr. 7501 por me AMTP të paregjistruara deri në atë kohë, ndërsa pasuria 114/22 e përcaktuar si varrezë publike me vendim të Këshillit të Komunës Dushk i Madh, gjithashtu edhe ky vendim i paregjistruar. Për ta zgjidhur këtë administratori i shoqërisë ñMò shpk me deklaratën noteriale nr. 1978 Rep. nr. 1308/3 Kol. datë 8.9.2016 deklaron se heq dorë nga regjistrimi i kontratës për pasuritë me numër 114/19 dhe 114/22 Zona Kadastrale 1582.

Si përfundim shoqëria shfrytëzon vetëm sipërfaqen me numër pasurie 114/21 me sipërfaqe 158.331 m^2 Zona Kadastrale 1582, pasuri të cilën e ka regjistruar pranë ZVRPP Lushnje.

Gjithashtu neni 1 ñObjekti i kontratësò, pika 2, parashikon se ñPalët bien dakord që vlera e shpërblimit vjetor për marrjen me qira të pasurisë të jetë **14,100 lekë/ha/vit ose 266,735.34 lek/total/vit....**ò, pika 3, ñPagesa e qirasë për vitin e parë kryhet si parapagim në momentin e lidhjes së kontratës por jo më vonë se 06 Nëntor 2015, ndërsa për periudhën vijuese më datë 23 Tetor të çdo viti pasardhësò.

Sa më sipër, në Memon e datës 01.02.2019, sektori i bashkëfinancimit për partneritet dhe monitorimit i është drejtuar Ministrit të MBZHR, për problematikën e konstatuar si dhe ka sugjeruar, si vijon:

1.Të procedohet me marrjen e inforA.Monit pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnje për gjendjen juridike të pasurive me numër 114/19 dhe 114/22 Zona Kadastrale 1582.

2.Pas marrjes së inforA.Monit nga ZVRPP Lushnje të procedohet me amendimin e kontratës së qirasë për shoqërinë "M" shpk duke zbritur sipërfaqen që nuk mund të shfrytëzohet si dhe ndryshimin e vlerës së qirasë në përputhje me sipërfaqen e re.

Deri në momentin e hartimit të këtij materiali të mbarimit të auditimit pranë MBZHR datë 31.07.2021, nga ZVRR-Lushnjë, nuk është përcjellë inforA.Moni.

2. Subjekti "B.A" shpk dhe Ministria e Bujqesisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave kanë lidhur kontratë nr.7075 Prot, Nr.6075 Rep. nr.2615 Kol, datë 7.10.2014.

Në zbatim të Urdhërit nr.509 datë 30.10.2014 ñ*Mbi kalimin e tokës në përdorim (qira) shoqërisë "B.A" shpk*ò, është ngritur grupi i punës i cili ka proçeduar me mbajtjen e procesverbalit të dorëzimit të sipërfaqes në zbatim të parashikimeve të kontratës së qirasë në datën 7.11.2014 në

fshatin Arrameras, Bashkia Fushë- Krujë. Në procesverbalin e dorëzimit citohet se : ñ*Nga verifikimi në terren konstatohen brenda sipërfaqes tokë bujqësore, objekt kontrate, ku janë afro 20-25 ndërtime pa leje (shtëpi banimi) me sipërfaqet funksionale të tyre si dhe rreth 70 % e sipërfaqes totale është zaptuar prej 23 vjetësh nga banorët e fshatit me pretendimin se janë në kufinjtë e pronave të tyre për periudhën para vitit 1946, por nuk disponojnë asnjë dokumentacion pronësie nga AKKP-ja. Sipërfaqja e tokës bujqësore e zënë nga ndërtimet pa leje, duke marrë në konsideratë sipërfaqet funksionale të tyre (oborre, kopshte dhe rrugët lidhëse midis tyre dhe rrugëve të parcelave) zë gati 8 % të sasisë totale të dhënë me qira me kontratën nr.7075 Prot. datë 7.10.2014 "Për dhënien me qira të tokës bujqësor në pronësi të shtetit".*

Një pjesë e sipërfaqes së marrë me qira është e zaptuar nga të tretë. Në këto sipërfaqe janë ndërtuar shtëpi banimi. Qiramarrësi kërkon zbritjen e këtyre sipërfaqeve nga sipërfaqja e përgjithshme e kontratës dhe zbritjen përkatëse të vlerës së qirasë. Pasurinë me numër 9/21 Zona Kadastrale 1042 me sipërfaqe 900 m^2 qiramarrësi thotë se nuk e ka të mundur identifikimin e vendodhjes së saj.

3. Subjekti "D.F"shpk dhe Ministria e Bujqesisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave kanë lidhur Kontratë nr Nr.6097 Prot, nr.1861Rep, nr.798Kol, datë 8.9.2017 sipas VKM Nr.460, datë 22.5.2013 ñPër përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar,me afat për 90 vite. Titullari i MZHBR me Urdhërin nr.497, datë 15.11.2018 ñPër ngritjen e Grupit të Punës për dorëzimin e tokës qiramarrësit subjektit ñD.Fò shpk, me datë 15.11.2018 nuk ka mundur të kryejë dorëzimin e tokës, për arsye se pjesa më e madhe e sipërfaqes ishte e punuar dhe e mbjellë nga të tretë. Në terren u paraqit z.E.J (fermer), i cili sqaroi se në një pjesë të kësaj sipërfaqeje afërsisht prej 30 dynym, ka mbjellë foragjere dhe se për këtë sipërfaqe ka lidhur kontratë qiraje 1 vjecare me palë qiradhënëse Njësisë Administrative Levan, tek e cila kishte shlyer detyrimet e qirasë vjetore. Parcelat me numër pasurie 613 dhe 624 janë të papunuara dhe pambjellë. Parcelat me numër pasurie 619 dhe 621 janë të gjitha të mbjella me tërshërë dhe foragjere. Parcela me numër pasurie 617 gjysma është e mbjellë me jonxhe dhe pjesa tjetër e pambjellë. Për këtë i është kërkuar inforA.Mon ZVRPP Fier e cila informon që këto pasuri janë në pronësi shtet, Bashkisë Fier e cila konfirmon se zaptuesit e tokës nuk kanë asnjë dokument të provojë tagrat e tyre përë këtë shfrytëzim dhe DAMT Këshilli i Qarkut Fier e cila informon se këto pasuri nuk janë përfshirë në VKM nr.45/2014, ñPër kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe institucioneve-kërkimore të kësaj ministrie aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronaveò.

Kontrata është nënshkruar në zbatim të Vendimit 460, datë 22.5.2013, të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e kritereve, të rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò, ndryshuar me Vendimin nr.143, datë 24.2.2016, të Këshillit të Ministrave, në të cilin ka ndryshuar pika e Kreut II ñObjekti i kontratësò, ku parashikohet se ñObjekti i qiradhënies, sipas këtij vendimi, janë të gjitha sipërfaqet e tokës në pronësi të shtetit.ò

dhe Ministria e Bujqesisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave kanë lidhur Kontratë nr Nr.6097 Prot, nr.1861 Rep, nr.798 Kol, datë 8.9.2017 sipas VKM Nr.460, datë 22.5.2013 ñPër përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar për dhënien e tokës bujqësore me qira me afat për 90 vite. Titullari i MZHBR me Urdhërin nr.497, datë 15.11.2018 ñPër ngritjen e Grupit të Punës për dorëzimin e tokës qiramarrësit subjektit ñD.Fò shpk, me datë 15.11.2018 nuk ka mundur të kryejë dorëzimin e tokës, për arsye se pjesa më e madhe e sipërfaqes ishte e punuar dhe e mbjellë nga të tretë. Në terren u paraqit z.E.J. (fermer), i cili sqaroi se në një pjesë të kësaj sipërfaqeje afërsisht prej 30 dynym, ka mbjellë foragjere dhe se për këtë sipërfaqe ka lidhur kontratë qiraje 1 vjecare me palë qiradhënëse Njësisë Administrative Levan, tek e cila kishte shlyer detyrimet e qirasë vjetore. Parcelat me numër pasurie 613 dhe 624 janë të papunuara dhe pambjellë. Parcelat me numër pasurie 619 dhe 621 janë të gjitha të mbjella me tërshërë dhe foragjere. Parcela me numër pasurie 617 gjysma është e mbjellë me jonxhe dhe pjesa tjetër e pambjellë. Për këtë i është kërkuar

inforA.Mon ZVRPP Fier e cila informon që këto pasuri janë në pronësi shtet, Bashkisë Fier e cila konfirmon se zaptuesit e tokës nuk kanë asnjë dokument të provojë tagrat e tyre përë këtë shfrytëzim dhe DAMT Këshilli i Qarkut Fier e cila informon se këto pasuri nuk janë përfshirë në VKM nr.45/2014, ñPër kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe institucioneve-kërkimore të kësaj ministrie aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronaveò.
Kontrata është nënshkruar në zbatim të Vendimit 460, datë 22.5.2013, të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e kritereve, të rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò, ndryshuar me Vendimin nr.143, datë 24.2.2016, të Këshillit të Ministrave, në të cilin ka ndryshuar pika e Kreut II ñObjekti i kontratësò, ku parashikohet se ñObjekti i qiradhënies, sipas këtij vendimi, janë të gjitha sipërfaqet e tokës në pronësi të shtetitò.

Në lidhje mbi mangësitë e konstatuara, nga grupi i audituesve u mbajt Aktkonstatimi nr.4 datë 26.07.2021 me nr.5464 prot të MBZHR. Në lidhje mbi konstatimet e evidentuara nga grupi i auditimit të KLSH-së, nga MBZHR janë dërguar me shkresën nr.5640 prot datë 02.08.2021 firmosur nga Sekretari i Përgjithshëm, si dhe me shkresë nr.3501/8 prot datë 28.12.2021, ku është observuar në lidhje me likujdimin e detyrimeve për tre subjekte, ndërsa në lidhje me problematikat e tjera të konstatuara nuk janë paraqitur observime, kështu nëse punonjësit e MBZHR nuk paraqesin dokumenta apo prova të reja mbi problematikat e trajtuara do të konsiderohen të mirëqëna.

Titulli i Gjetjes 1:	Mbi ndryshime ligjore të akteve nënligjore për dhënien me qira të tokës bujqësore në administrim nga MBZHR
Situata :	Në kontratën nr.2548 prot., me nr.115 rep, nr.68 kol, datë 24.03.2015 lidhur midis subjektit ñ*A.M.*ò dhe ish-Ministrisë së Bujqesisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, me objekt për ngritjen e kompleksit blegtoral dhe ndërtimin e fabrikës së përpunimit të qumështit në tokë bujqësore, duke parashikuar **veprimtari blegtorale** dhe në kontratën nr.2711 prot, nr.827 rep, nr. 679 kol, datë 31.03.2017 lidhur midis subjektit ñ*P.*ò dhe MBZHR, me objekt për dhënien e tokës bujqësore me qira, për kultivimin e bimëve farogjere për sigurimin dhe **plotësimin e nevojave për ushqim të blegtorisë dhe krijimin e një ferme blegtorale** për mbarështrimin e gjedhit për mish. Për të dyja janë parashikuar veprimtari blegtorale, ndonëse në aktin nënligjor të aplikuar të kohës, të VKM nr.460, datë 22.5.2013ñPër përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar, nuk parashikon veprimtari blegtorale, Kreu VI ñAfatet e dhënies me qira të tokaveò pika 1, shprehet se, tokat jepen me qira për veprimtari bujqësore.
Kriteri:	Ligji nr.8318 datë 01.04.1998 ñPër dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetëroreò i ndryshuar,VKM nr.373 datë 20.06.2018 ñPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar me VKM nr.487 datë 17.06.2020 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.373 datë 20.06.2018 të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e kriterevetë rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit.ò;VKM-së nr. 45/2014, ñPër kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe ishinstitucioneve kërkimore-shkencore të kësaj ministrie, aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronaveòsi dhe çdo akt juridik që ka lidhje me këtë fushë objekti, në Republikën e Shqipërisë
Ndikimi/Efekti:	Ky fakt juridik është në kundërshtim me ligjin nr.8318 datë 01.04.1998 ñPër dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetëroreò i ndryshuar, neni 8, mbi të cilin është miratuar VKM e ndryshuar me VKM nr.373 datë 20.06.2018 ñPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar me VKM nr.487 datë 17.06.2020 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.373 datë 20.06.2018 të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e kriterevetë rregullave,

	procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit.ò, të cilat në përmbajtjen e tyre kreu IV, pika 8, nënpika (b, d,dh) dhe kreu VI pika1,nuk janë shprehur për veprimtari për prodhim blegtoral. Ligji nr.8318 datë 01.04.1998 ñPër dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetëroreò i ndryshuar, neni 8,shprehet se: **(1).**deri në 10 vjet për kontratat e qirasë afatshkurtër, ku përfshihen veprimtaritë për **prodhimin e bimëve të arave** dhe eterovajore. **(2).**deri në 30 vjet për kontratat e qirasë afatmesëm, ku **përfshihen veprimtaritë për prodhimin blegtorial**, për prodhimin e fidanëve, mjediset e mbrojtura dhe pyjet e ulëta (cungishte). **(3).**deri në 99 vjet për kontratat e qirasë afatgjatë, ku përfshihen veprimtaritë për turizëm, rekreacion, pyll i lartë dhe pemët frutore.
Shkaku:	Sa më sipër, nisur nga këto parregullsi, nga MBZHR nuk është inicuar përmirësimi i përmbajtjes së nr.373 datë 20.06.2018 të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e kriterevetë rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit.ò duke e përshtatur atë dhe harmonizuar me disa kërkesa të ligjit nr.8318 datë 01.04.1998 ñPër dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetëroreò i ndryshuar .
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si ministri përgjegjëse të marrë masa në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave, për përmirësimin e VKM nr.373 datë 20.06.2018 të Këshillit të Ministrave ñ*Për përcaktimin e kritereve të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit*ò, në përputhshmëri me kërkesat e ligjit nr.8318 datë 01.04.1998 ñ*Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetërore"* i ndryshuar, me qëllim për caktimin e drejtë dhe të saktë, të objekteve të kontratave të qiradhënies së tokës bujqësore, duke garantuar zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimin rural në të gjitha dimensionet.
Afati	Mënjëherë dhe në vijimësi

Titulli i Gjetjes 2:	Mbi statusin juridik të tokës bujqësore në administrim nga MBZHR
Situata :	Sipërfaqet e tokës bujqësore të dhëna me qira janë siguruar në mbështetje të Vendimeve të Këshillit të Ministrave si vijon: (i)VKM nr.995, datë 9.12.2015,òPër kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të sipërfaqes së tokës bujqësore prej 926.55 Ha, në pronësi shtetërore, dhënë në përdorim Komunave Buçimas, Çërravë dhe Udenisht dhe për disa ndryshime në Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.244, datë 4.4.2012, nr.417, datë 8.6.2011 dhe nr.534, datë 1.5.2008ò ka kaluar në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së toka bujqësore në pronësi të shtetit me *sipërfaqe 926,55 Ha*. (ii)VKM nr.45, datë 29.01.2014 ñPër kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërrmarjeve bujqësore dhe institucioneve kërkimore shkencore të kësaj ministrie aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronaveò, pika 1, ka kaluar në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së toka bujqësore në pronësi të shtetit me *sipërfaqe 18,076 Ha.* (iii)VKM nr.142, datë 24.2.2016 ñPër kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Uëjrave të sipërfaqes së tokës bujqësore, në pronësi të shtetërore, në fshatin Vojnik, Njësia Administrative Maqellarë, Bashkia Dibërò ka kaluar në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së toka bujqësore në pronësi të shtetit me *sipërfaqe 31,4 Ha,* pasuria nr.2/17, Zona Kadastrale 3811. Sa më sipër, fondi i tokës bujqësore në pronësi të shtetit në përgjegjësi administrimi të MBZHR është 19,033.95 ha. Nga kjo sipërfaqe janë dhënë me qira nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për periudhën 2013-2021 sipërfaqja prej 2,519 ha e 7,366 m^2.

	Gjithashtu nga fondi i disponueshëm i tokave në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së, është kaluar sipërfaqa prej 617,68 ha nën administrim të AIDA-s, për zhvillimin e investimeve strategjike të programuara. Për periudhën 2019-2021 është dhënë me qira sipërfaqja prej 714ha e 3,484m^2. Aktualisht sipërfaqja e lirë e disponueshme në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së, për tâu dhënë me qira, është 15,896 ha e 5, 334 m^2, duke konstatuar se, gjendja juridike e tyrë është e pa rregjistruar pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, duke rritur riskun e tjetërsimit të pronave bujqësore, nga palë të treta. Ndërsa sipërfaqja prej 3137 është rregjistruar, në momentin kur ka filluar procedura e dhënies me qira të tokës bujqësore nga MBZHR, por nga auditimi Pasqyrave financiare për vitin 2019 dhe 2020, llogaria (210) ñtoka, trojeò figuron në vlerën 0 lekë. Gjithashtu, u konstatua se fondi i tokës bujqësore shtetërore disponibël, i dhënë në bazë tëVKM-së nr. 45/2014, nuk është shoqëruar me një kopje të listës së inventarit për pasuritë, të njehësuar me origjinalin, si pjesë e kësaj VKM, ndonëse nga MBZHR me shkresë nr.7254 prot datë 24.09.2019, i është kërkuar Këshillit të Ministrave por nuk ka pasur asnjë përgjigje në lidhje mbi këtë kërkesë. Në kushtet kur lista e inventarit të ngastrave që do të jepen me qira ka munguar dhe vijon të mungojë, duke dalë e paqartë se si strukturat përgjegjëse për administrimin e tokave bujqësore në MBZHR, bëjnë shpalljen publike dhe përditësimin e saj, sikundër dikton VKM nr. 373 datë 20.6.2018 ñPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò. Kjo situatë është e mbartur në vite në Ministrinë e Bujqësië dhe nga struktura përgjegjëse të saj, nuk është ndërmarrë asnjë masë për rregjistrimin e sipërfaqes në pronësi.
Kriteri:	Ligji nr.8318 datë 01.04.1998 ñPër dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetëroreò i ndryshuar,VKM nr.373 datë 20.06.2018 ñPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar me VKM nr.487 datë 17.06.2020 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.373 datë 20.06.2018 të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e kriterevetë rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit.ò;VKM-së nr. 45/2014, ñPër kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe ishinstitucioneve kërkimore-shkencore të kësaj ministrie, aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronaveòsi dhe çdo akt juridik që ka lidhje me këtë fushë objekti, në Republikën e Shqipërisë
Ndikimi/Efekti:	Mos rregjistrimi i tokës bujqësore, mos evidenitimi me zona kadastrale , rrit riskun për tjetërsimin nga palë të treta si dhe ky proces nuk ndihmon në realizimin e investimeve mbi tokën bujqësore, nisur nga fakti që bujqësia mbetet një nga sektorët me potencialin më të madh të zhvillimit në Shqipëri.
Shkaku:	Nga auditimi u konstatua se, nga MBZHR dhe KM nuk janë marrë nisma ligjore për rregjistrimin e tokës si dhe numri i pakët të punonjësve të strukturës për administrim dhe monitorim të tokës bujqësore.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi	-Nga ana e MBZHR të merren masa, për verifikimin dhe hartimin e një regjistri të plotë dhe të saktë, ku të evidentohet gjithë fondi i tokës bujqësore që i ka kaluar në administrimin MBZHR, duke bashkëpunuar dhe koordinuar midis institucioneve dhe organeve kompetente shtetërore, konkretisht me: Këshillin e Ministrave dhe Drejtoritë Rajonale të Administrimit të Tokave në Qarqe, për të verifikuar dhe saktësuar sipërfaqet e tokave në administrim të MBZHR-së. -Nga ana e MBZHR të merren masa, për rregjistrimin e fondit të tokës bujqësore që është në administrimin të saj, në bazë të bashkëpunimit dhe koordinimit me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, duke neguciuar mbi kostot e vleave të regjistrimit si dhe/ose duke planifikur në buxhetin vjetor të MBZHR-së fonde të dedikuara për të finalizuar procesin e rregjistrimit të tokave bujqësore.
Afati	Deri në 31 dhjetor 2022

Titulli i Gjetjes 3:	Mbi numrin jo të mjaftueshëm të punonjësve në strukturën e MBZHR për administrimin dhe monitorimin e tokës bujqësore.
Situata :	MBZHR, në mbështetje të VKM nr.373, datë 20.06.2018 ñPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe të kontratës TIP për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar, ka lidhur **10 kontrata** *mbas janarit të vitit 2019 deri në dhjetor të vitit 2020* dhe **1 kontratë** *deri më 31.03.2021*, të cilat janë audituar në lidhje mbi përcaktimin e kritereve, mbi përllogaritjen e vlerës së çmimit të qirasë së tokës bujqësore, mbi përzgjedhjen e subjektit qiramarrës, mbi hartimin dhe miratimin e kontratës si dhe ecurinë e moritorimit të kontratës deri më 31.03.2021. Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, **40 kontrata** janë lidhur sipas VKM nr.460, datë 22.5.2013 ñPër përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò ndryshuar, me VKM nr.373, datë 20.06.2018, për periudhën nga viti 2013 deri në janar të vitit 2019, *duke përzgjedhur disa prej tyre për auditim, në lidhje për fazën e ecurisë së monitorimit të kontratës*. Në bazë të të Urdhërave të Kryeministrit nr.168, datë 05.10.2017 ñPër miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Ruralò i ndryshuar me Urdhër të Kryeministrit nr.39 datë 22.01.2021, ku sipas rregulloreve të brëndshme të miratuara nga titullari i MBZHR me urdhërat nr.324/1 datë 25.09.2018 ñPër miratimin e strukturës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Ruralò dhe nr.4276 prot datë 02.06.2021, është Sektori i Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të Kontratave me përbërje (1 shef sektori dhe 3 specialistë) pranë Drejtorisë së Prokurimeve dhe Partneriteteve, përgjegjës për monitorimin dhe mbajtjen e regjistrit të kontratave të qerasë dhe ecurinë e up date të tyre, në përbushje të detyrave funksionale. Kjo strukturë nuk ka punuar asnjëherë me staf të plotë me burime njërëzore për shkak të mos rekrutimit të punonjësve nga ana e DAP si dhe punonjësit e pakët e këtij sektori, përtej kryerjes së detyrave funksionale, janë përfshirë rast pas rasti nga titullari i MBZHR (Ministri), duke marrë pjesë edhe në: (1) grupet të vlerësimit në terren, të tokës bujësore që jepet me qira, me detyrë për, verifikimin e gjendjes faktike të sipërfaqes së tokës bujqesore, verifikimin e gjendjes e infrastruktures ujitëse dhe kulluese te saj, distancën nga tregjet, nivelin e industrisë agropërpunuese, si dhe shkallën e zhvillimit të infrastrukturës rrugore të zonës; (2) grupet e përllogaritjes së vlerës së çmimit të qerasë vjetore për tokën që jepet me qira, me detyrë për, përcaktimin e shkallës së bonitetit të tokës me qëllim përcaktimin e qerasë fillestare minimale, mbivlerën e të cilës shtohen (në %) dhe komponentë të tjerë[6]. Kështu,vendosja në grupe të ndryshme të punonjësve të sektorit, për propozimin, miratimin, monitorimin, në të njëjtën kohë, nuk është në përputhshmëri, sipas kërkesave që dikton ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar. Kështu në bazë të auditimit, në lidhje mbi punën e monitorimit të kontratave nga sektori bashkëfinancimit, partneriteteve dhe monitorimit të kontratave, për periudhën e audituar, u konstatua se; - deri në në fund të vitit 2019, ka realizuar 8 monitorime, nga 40 kontrata në fuqi (ose monitoruara rreth 20 % të kontratave) ; -përgjatë vitit 2020, ka realizuar 6 monitorime nga 50 kontrata ne fuqi (ose monitoruara rreth 12% të kontratave); -përgjatë 3 mujorit të parë të vitit 2021, nuk ka realizuar asnjë monitorim nga 51 kontrata. Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, edhe një strukturë ndihmëse,Sekretariati Teknik i Komisionit Qeveritar të Tokës, nuk funksionon prej datës 31.12.2019, për shkak të shfuqizimit të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008 ñPër shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokënò, i ndryshuar. Pra si përfundim, struktura përgjegjëse e vetme (sektori i bashkëfinancimit, partneriteteve dhe monitorimit të kontratave) për monitorimin e kontratave të qirasë të tokës bujqësore, nuk është me kapacitet të plotë me burime njërëzore si dhe vendosja e punonjësve të pakët nga ana e titullarit të MBZHR, në disa procese pune në të njëjtën

[6] 1. Gjendja e infrastruktures ujitëse dhe kulluese te saj,
2. Distanca nga tregjet (pika grumbullimi, tregjeve te zonave urbane)
3. Shkallen e e zvillimit të infrastruktures rrugore të zonës
4. Distanca nga sipërmarrjet agro-përpunuese(të produkteve bujqesore ose blegtorale)

	kohë, konkretisht; për vlerësimin e tokës në terren, përllogaritjen e vlerës së çmimit të qerasë vjetore , për hartimin e kontratës së qirasë si dhe monitorimin e tyre, nuk ka bërë të mundur të kemi efektivitet të plotë të monitorimit të ecurisë së kontratave të qirasë të tokave bujqësore, kjo në kundërshtim me detyrimin që parashikon VKM nr. 373, datë 20.6.2018 ñPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò kreu VII ñMonitorimi i kontrataveò, pika 5 si dhe me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar.
Kriteri:	Ligji nr.8318 datë 01.04.1998 ñPër dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetëroreò i ndryshuar,VKM nr.373 datë 20.06.2018 ñPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar me VKM nr.487 datë 17.06.2020 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.373 datë 20.06.2018 të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e kriterevetë rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit.ò;VKM-së nr. 45/2014, ñPër kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe ishinstitucioneve kërkimore-shkencore të kësaj ministrie, aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronaveòsi dhe çdo akt juridik që ka lidhje me këtë fushë objekti, në Republikën e Shqipërisë
Ndikimi/Efekti:	Gjithashtu, sipas burimit të MBZHR (Sektori i administrimit të tokave), gjatë këtyre viteve mbi fondin e tokës bujqësore kanë vepruar shumë faktorë si dhe janë evidentuar shumë problematika të veçanta që kanë të bëjnë me: *(i.) Okupimet nga ndërtimet informale;* *(ii).Procesi i ndarjes së tokës në fshat ka vazhduar deri në 15.8.2008*; *(iii).Ndërtime të veprave strategjike që po realizohen në vendin tonë në lidhje me infrastrukturënpër ndërtimin e rrugëve, etj.* *(iv).Fragmentarizimi i skajshëm i tokës bujqësore në pronësi private dhe në pronësi shtetërore.* *(v) Zaptimet e paligjshme nga fermerët.* *(vi) Gabimet e ndryshme që janë bërë gjatë raportimit të fondit të tokës* *(vii) Sipërfaqet e tokës bujqësore që janë hequr nga ky fond me vendime të Këshillit të Ministrave, si dhe objekt i investimeve strategjike.* *(viii) Sipërfaqet e tokës bujqësore, të cilat kanë kaluar në përgjegjësi administrimi njësive vendore me Vendime të Këshillit të Ministrave.* *(ix) Gabime në Sistemin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme .*
Shkaku:	Sa më sipër, numri i punonjësve në lidhje mbi administrimin e tokës bujqësore, në përmbushje të detyrimit të dhënies me qira të kësaj pasurie, te realizimit të procedurave, të monitorimit, është i pakët, ku prej auditimit u konstatua se, jo të gjitha kontratat janë monitoruar në kohë dhe me cilësi.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi	-MBZHR, të rishikojë me kujdes burimet njerëzore të disponueshme në funksion të detyrave që lidhen me me administrimin e tokës bujqësore, nga pikëpamja sasiore (numër punonjësish në raport me kontratat, subjekt monitorimi) dhe nga pikëpamja e ekspertizës., në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike. -Nga titullari i MBZHR për realizimin e procedurës së dhënies me qira të tokës bujqësore, të vendosë në grupet e punës persona, në mënyrë të tillë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, dhe kontrollin, sipas kërkesave që dikton Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar.
Afati	Menjëherë

Titulli i Gjetjes 4:	Mbi problematikat evidentuara si dhe mbi monitorimin e kontratavetë qirasë të dhëna nga MBZHR për tokën bujqësore.
Situata :	Nga verifikimi i monitorimit të kontratave në lidhje me detyrimin kontraktor të realizimit të investimeve kapitale, në 3 kontrata, të cilat janë dhënë mbi bazën nënligjore të aplikuar të kohës, me VKM nr.460, datë 22.5.2013ñPër përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar, u konstatua se, qiramarrësit megjithëse kanë kryer

	investime në terren **nuk** mund të mbështesin investimet me dokumenta justifikues (fatura apo deklarata doganore dhe situacione punimesh/shërbimesh), për rrjedhojë për këto kontrata **nuk** provohet plotësimi i kushteve të kontratës, për realizimin e investimit jo më pak se 20% e vlerës së parashikuar brenda vitit të 3-të pas lidhjes së kontratës si dhe 70% brenda vitit të 5-të, e për pasojë mosplotësimi i detyrimeve kontraktore, në kundërshtim me nenin 6, pika 5/b, me nenin 7, pika 3 të kontratës, duke përllogaritur penalitetet, më konkretisht: **1**.Shoqëria "A.I" shpk dhe ish-MBUMK (Ministria e Bujqesisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit) kanë lidhur Kontratë nr.3819 prot datë 16.09.2013, për dhënien e tokës bujqësore me qira me afat për 60 vite, me object të kultivimit të drufrutorë të arrës së bashku me fidanishte dhe të kultivimit të ullinjëve, me vlerë qiraje 622,440 lekë në vit. Nga auditimi rezultoi se, MBZHR ka zgjidhur kontratën në mënyrë të njëanshme me shkresë me urdhër të titullarit, nr.227 datë 01.06.2021, për shkak se, subjekti nuk ka kryer investimet në vlerën deri 20% të vlerës së investimit, si dhe ky subjekt nuk ka kryer investimet në vlerën deri në 70% të vlerës së investimit brenda 5 viteve të para. Grupi i auditimit kreu përllogaritjet e penaliteteve për investimin e pakryer nga ku rezultoi se: Investimi i parashikuar në planin e biznenist është në vlerën 3,155,883 Euro brenda një afati 5 vjecar; Investimi i realizuar është në total rreth 126,346 Euro: nga të cilat 13,306,926 leke dhe 31.500 Euro; dhe Investimi i parealizuar rezulton rreth 3,029,536 Eur (ose 425,044,008 lekë[7]) Totali i penaliteteve në masën 2% të vlerës së investimeve kapitale të pakryera është **14,672,752.09 lekë** (ose 104,581 Euro). **2**. Shoqëria ñP.Iò shpk dhe ish-MBUMK (Ministria e Bujqesisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit) kanë lidhur Kontratë Nr.3620/1 prot datë 06.09.2013, për dhënien e tokës bujqësore me qira me afat për 60 vite, ndryshuar me Shtojcën 5 nr.4307, nr.1228 Rep, nr.298 Kol, datë 29.05.2017. Nga auditimi konstatua se, për realizimin e investimit me vlerë prej 351,036,645 lekë sipas Kontratë Nr.3620/1 prot datë 06.09.2013 në Plan biznesit të vitit 2013, u kontatuan dokumentacion në dosjen fizike sipas faturave të dorëzuara në vlerën prej 44,399,037 lekë, dmth 13% të vlerës së investimit, në mos plotësim të detyrimit kontraktor, sipas neni 6 pika 5/a e për rrjedhojë penaliteti i parashikuar në masën 2% të vlerës së investimeve kapitale të të pakryera është në vlerën 12,265,504.32 lekë. -Ndërsa për kontratën shtesë nr.4307 Prot, Nr.1225 Rep, Nr.298 Kol, datë 29.05.2017 sipas Plan Biznesit të vitit 2017, nuk u konstatua dokumentacion justifikues në dosjen fizike, për vlerën e investimit të parashikuar në kontratë dhe për këtë arsye investimi konsiderohet në masën 0 %, për rrjedhojë penaliteti i parashikuar në mos plotësim të detyrimit kontraktor sipas neni 6 pika 5/b penaliteti i parashikuar në masën 2% sipas nenit 7 pika 3, është në vlerën 1,366,272.00 lekë. Pra në total, penalitetet për mos realizimin e investimeve kapitale sipas Plan biznesi të vitit 2013 dhe vitit 2017 është në vlerën **13,631,776.32** lekë. **3**. Subjekti ñÇò shpk dhe Ministria e Bujqesisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave kanë lidhur Kontratë nr.1001 Prot, nr.396 Rep, nr.369 Kol, datë 05.02.2016, për dhënien e tokës bujqësore me qira me afat për 60 vite, ngritje vreshti për kultivimin rrushi dhe prodhim vere me vlerë qiraje 321,565 lekë në vit. Nga auditimi mbi monitorimin e kontratës në dosjen fizike u konstatua se, me urdhër të titullarit Ministrit të MBZHR nr.9763/1 datë 19.10.2018, (pra 2 vite e 8 muaj pas lidhjes së kontratës),është ngritur grupi i punës ñPër dorëzimin e tokës qiramarrësit subjektit Z. P.Ç shpk, ndërsa në procesverbalin nr.9763/3 datë 26.10.2018 mbajtur nga grupi i dorëzimit,citohet se *ñqiramarrësi e ka përdorur këtë sipërfaqe që prej momentit të nënshkrimit të kontratës",* fakt që tregon se nga ana e MBZHR veprimet administrative janë bërë me vonesë, por kjo vonesë nuk ka penguar përdorimin i tokës bujqësore nga qiramarrësi. Investimi i parashikuar në planin e biznesi për 5 vitet e para është në vlerën 154,286,259 lekë, ndërsa nga auditimi i dosjes fizike nuk u konstatua asnjë dokument ose fatura për të vërtetuar realizimin e investimit të vitit të pestë kryer në masën prej 70%, pra duhet të kishte të provuar vlerën e investimit prej 108,000,381 lekë, penaliteti me vonesë të investimit për 53 ditë është në vlerën prej **448,064 lekë.**

[7] Për efekt perllogaritjesh kursi I këmbimit Euro/ALL është 140.30, sipas kursit të kembimit nga BSH më datë 16.09.2013 - data e lidhjes së kontratës

Kriteri:	Ligji nr.8318 datë 01.04.1998 ñPër dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetëroreò i ndryshuar,VKM nr.373 datë 20.06.2018 ñPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar me VKM nr.487 datë 17.06.2020 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.373 datë 20.06.2018 të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e kriterevetë rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit.ò;VKM-së nr. 45/2014, ñPër kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe ishinstitucioneve kërkimore-shkencore të kësaj ministrie, aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronaveòsi dhe çdo akt juridik që ka lidhje me këtë fushë objekti, në Republikën e Shqipërisë
Ndikimi/Efekti:	**Si përfundim, vlera prej 28,304,528.3** lekë **përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Shtetit**, si pasojë e mos plotësimit të detyrimeve kontraktore nga subjektet qirramarrëse e mësipërme.
Shkaku:	Sa më sipër, numri i punonjësve në lidhje mbi administrimin e tokës bujqësore, në përmbushje të detyrimit të dhënies me qira të kësaj pasurie, te realizimit të procedurave, të monitorimit, është i pakët, ku prej auditimit u konstatua se, jo të gjitha kontratat janë monitoruar në kohë dhe me cilësi.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi	Nga MBZHR, të merren masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **28,304,528.3** lekë si pasojë e mos plotësimit të detyrimit kontraktor nga mos kryerja e investimeve në kohë, duke krijuar vlera financiare të cilat përfaqësojnë të ardhura të munguara ndaj buxhetit të shtetit, si vijon: -Për subjektin ñAô, në vlerën prej 14,672,752.09 lekë (ose 104,581 Euro). -Për subjektin ñP.Iò shpk, në vlerën 13,631,776.32 lekë. -Për subjekti ñÇ", në vlerën 448,064 lekë.
Afati	Menjëherë

Titulli i Gjetjes 5:	Mbi problematikat evidentuara si dhe mbi monitorimin e kontratavetë qirasë të dhëna nga MBZHR për tokën bujqësore.
Situata :	Nga verifikimi i miratimit dhe monitorimit të kontratave, të cilat janë dhënë, mbi bazën nënligjore, konkretisht me VKM nr.460, datë 22.5.2013ñPër përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar, u konstatua se, ka mospërputhje midis vlerës së investimit parashikuar në plan biznes, paraqitur gjatë fazës së procedurës së dhënies me qira, me vlerën e investimit të paraqitur në kontratën e qirasë, duke rezultuar më e ulët. Ky fakt cënon procesin e dhënies me qira, gjatë të cilit është pretenduar nga subjekti, për vlerë më të madhe të investimit si dhe lidhja e këtyre kontratave është në kundërshtim me bazën nënligjore të aplikuar të kohës, më konkretisht si vijon: **1.**Subjekti Kantina ñÇ" shpk dhe Ministria e Bujqesisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave kanë lidhur kontratë nr.1001 prot, nr.396 rep, nr.369 kol, datë 05.02.2016, rezultoi se, investimi i parashikuar në plan biznes është në vlerën 154,286,259 leke, ndërsa në në kontratë ky investim paraqitet 120,900,000 lekë (ose 33,386,259 lekë më e ulët). **2**.Shoqëria "A" shpk dhe ish-MBUMK (Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit) kanë lidhur kontratë nr.3819 prot datë 16.09.2013, rezultoi se, investimi i parashikuar në plan biznes është në vlerën 3,155,883 Euro (ose 442,770,385 lekë) ndërsa në kontratë kjo vlerë është 272,303,322 lekë (ose 170,467,063 lekë më ulët). **3.**Shoqëria ñPò shpk dhe ish-MBUMK (Ministria e Bujqesisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit) kanë lidhur kontratë nr.3620/1 prot datë 06.09.2013, rezultoi se, investimi i parashikuar në plan biznes është me vlerë 351,036,645 lekë ndërsa në kontratë kjo vlerë është 146,459,808 lekë (ose 204,576,837 lekë më e ulët). **4**.Subjekti ñA.M.ò dhe Ministria e Bujqesisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave kanë lidhur kontratë nr nr. 2548 prot, nr.115 rep, nr.68 kol, datë 24.03.2015, rezultoi se, investimi i parashikuar në plan biznes është në vlerën 57,638,000 lekë, ndërsa në kontratë kjo vlerë është 34,370,000 lekë (ose 23,268,000 lekë më ulët).
Kriteri:	Ligji nr.8318 datë 01.04.1998 ñPër dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetëroreò i ndryshuar,VKM nr.373 datë 20.06.2018 ñPër

	përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar me VKM nr.487 datë 17.06.2020 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.373 datë 20.06.2018 të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e kriterevetë rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit.ò;VKM-së nr. 45/2014, ñPër kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe ishinstitucioneve kërkimore-shkencore të kësaj ministrie, aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronaveòsi dhe çdo akt juridik që ka lidhje me këtë fushë objekti, në Republikën e Shqipërisë
Ndikimi/Efekti:	Monitorimi i tyre në përputhshmëri dhe në pjesën finaciare, do të siguronte, kontrata të sukseshme, dukë synuar zhvillimin bujqësor, e për rrjedhojë, sigurimin e të ardhurave financiare për Buxhetin e Shtetit, nga dhënia me qira e tokave bujqësore, me pronar shtet dhe administrim të MBZHR.
Shkaku:	Sa më sipër, numri i punonjësve në lidhje mbi administrimin e tokës bujqësore, në përmbushje të detyrimit të dhënies me qira të kësaj pasurie, te realizimit të procedurave, të monitorimit, është i pakët, ku prej auditimit u konstatua se, jo të gjitha kontratat janë monitoruar në kohë dhe me cilësi.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi	Titullari i MBZHR të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, me qëllim vlerësimin e kontratave të mësipërme dhe të identifikimit të kontratave të tjera nësë kanë, të njëjtën problematikë të mospërputhjes së vlerës së investimit parashikuar në plan biznes, paraqitur gjatë fazës së procedurës së dhënies me qira, me vlerën e investimit të paraqitur në kontratën e qirasë, duke mundësuar më pas, dakortësinë për amendim kontrate midis palëve, duke vendosur në kontratë si vlerë investimi vlerën e plan biznesit si dhe të rivlerësohet afati i kohës për realizimin me sukses të kontratës.
Afati	Menjëherë

Titulli i Gjetjes 6:	Mbi problematikat evidentuara si dhe mbi monitorimin e kontratavetë qirasë të dhëna nga MBZHR për tokën bujqësore.
Situata :	Në disa prej kontratave të qirasë të lidhura gjatë viteve 2013 ï 2018 të audituara në lidhje mbi ecurinë dhe monitorimin , u konstatua se, një pjesë e sipërfaqeve të dhëna me qira, janë të mbivendosura, mbi varreza publike të zonës, mbi ndërtime të paligjshme si dhe në përdorim të një pale tretë, për pasojë subjektet qiramarrëse nuk kanë mundur të shfrytëzojnë sipërfaqen e plotë dhe të zhvillojnë plotësisht kontratën.Struktura përgjegjëse e monitorimit të kontratave për periudhën në auditim, ka identifikuar dhe verifikuar problematikën e mësipërme, duke njoftuar titullarit e MBZHR. Problematikat, tregojnë mangësinë e mungesës së rregjistrit të plotë dhe të saktë, të fondit të tokës bujqësore në administrim të MBZHR, i cili duhej hartuar në bashkëpunim dhe koordinim midis institucioneve dhe organeve kompetente shtetërore, më konkretisht si vijon: **1.**Subjekti ñMò shpk ka lidhur me Ministrinë e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, kontratën nr. 8136 prot, datë 23.10.2015, për sipërfaqen prej 18.9174 ha tokë bujqësore të ndodhur të ndodhur në Zonën Kadastrale 1582 e përbërë prej ngastrave me numra pasurie 114/19, 114/21, 114/22, Fshati Dushk i Madh, Njësia Administrative Dushk, Rrethi Lushnje, Qarku Fier . Nga auditimi u konstatua se, sipas verifikimit në terren i strukturës përgjegjëse për monitorimnë MBZHR, në datën 14.11.2018 rezultoi se qiramarrësi nuk mund të shfrytëzojë sipërfaqen me numër pasurie 114/22 me sipërfaqe 7000 m^2 Zona Kadastrale 1582 e cila **është e zënë me varreza** dhe pasurinë me nr. 114/19 Zona Kadastrale 1582 me sipërfaqe 23,843 m^2 e ndarë sipas ligjit nr.7501 datë 19.07.1991 ñPër tokënò i ndryshuar, referuar hartës treguese e cila është e zënë nga vreshta. Për këtë problematikë shoqëria ñMò shpk është drejtuar pranë qiradhënësit me shkresën nr. 849 Prot. datë 24.01.2019 ku informon se ka aplikuar për regjistrimin e Kontratës së Qirasë pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnje që në datë 28.11.2015, ndërsa çertifikata e regjistrimit është lëshuar nga kjo zyrë në datën 29.9.2016. Regjistrimi i kontratës është bërë vetëm për pasurinë me numër 114/21 me sipërfaqe 158.331 m^2. Për pasuritë me numër 114/19 me sipërfaqe 23.843 m^2 dhe 114/22 me sipërfaqe 7.000 m^2, nuk u bë i mundur regjistrimi nga ana e Zyrës Vendore të

	Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnje, sepse sipas saj pasuria 114/19 rezulton e ndarë sipas ligjit nr. 7501 por me AMTP të paregjistruara deri në atë kohë, ndërsa pasuria 114/22 e përcaktuar si varrezë publike me vendim të Këshillit të Komunës Dushk i Madh, gjithashtu edhe ky vendim i paregjistruar. Për ta zgjidhur këtë administratori i shoqërisë ñMò shpk me deklaratën noteriale nr. 1978 rep. nr. 1308/3 kol. datë 8.9.2016 deklaron se heq dorë nga regjistrimi i kontratës për pasuritë me numër 114/19 dhe 114/22 Zona Kadastrale 1582. Si përfundim shoqëria shfrytëzon vetëm sipërfaqen me numër pasurie 114/21 me sipërfaqe 158.331 m^2 Zona Kadastrale 1582, pasuri të cilën e ka regjistruar pranë ZVRPP Lushnje. Sa më sipër, në Memon e datës 01.02.2019, sektori i bashkëfinancimit per partneritet dhe monitorimit i është drejtuar Ministrit të MBZHR, për problematikën e konstatuar, ku deri në momentin e hartimit të këtij materiali, nga ZVRR-Lushnjë, nuk është përcjellë inforA.Moni. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 82-87 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).* **2.**Subjekti ñB.Aò shpk dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave kanë lidhur kontratë nr.7075 prot, nr.6075 rep. nr.2615 kol, datë 7.10.2014, për të cilën, në zbatim të Urdhërit nr.509 datë 30.10.2014 ñ*Mbi kalimin e tokës në përdorim (qira) shoqërisë "B.A" shpk*ò, është ngritur grupi i punës i cili ka proçeduar me mbajtjen e procesverbalit të dorëzimit të sipërfaqes në zbatim të parashikimeve të kontratës së qirasë në datën 7.11.2014 në fshatin Arrameras, Bashkia Fushë- Krujë. Në procesverbalin e dorëzimit citohet se : ñ*Nga verifikimi në terren konstatohen brenda sipërfaqes tokë bujqësore, objekt kontrate, ku janë afro 20-25 ndërtime pa leje (shtëpi banimi) me sipërfaqet funksionale të tyre si dhe rreth 70 % e sipërfaqes totale është zaptuar prej 23 vjetësh nga banorët e fshatit me pretendimin se janë në kufinjtë e pronave të tyre për periudhën para vitit 1946, por nuk disponojnë asnjë dokumentacion pronësie nga AKKP-ja. Sipërfaqja e tokës bujqësore e zënë nga ndërtimet pa leje, duke marrë në konsideratë sipërfaqet funksionale të tyre (oborre, kopshte dhe rrugët lidhëse midis tyre dhe rrugëve të parcelave) zë gati 8 % të sasisë totale të dhënë me qira me kontratën nr.7075 Prot. datë 7.10.2014 "Për dhënien me qira të tokës bujqësor në pronësi të shtetit".* Një pjesë e sipërfaqes së marrë me qira **është e zaptuar nga të tretë.** Në këto sipërfaqe janë ndërtuar shtëpi banimi. Qiramarrësi kërkon zbritjen e këtyre sipërfaqeve nga sipërfaqja e përgjithshme e kontratës dhe zbritjen përkatëse të vlerës së qirasë. Pasurinë me numër 9/21 Zona Kadastrale 1042 me sipërfaqe 900 m^2 qiramarrësi thotë se nuk e ka të mundur identifikimin e vendodhjes së saj. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 84-86 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).* **3.** Subjekti ñD.Fò shpk dhe Ministria e Bujqesisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave kanë lidhur Kontratë nr.6097 prot, nr.1861rep, nr.798 kol, datë 8.9.2017 sipas VKM Nr.460, datë 22.5.2013 ñPër përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar,me afat për 90 vite. Titullari i MZHBR me Urdhërin nr.497, datë 15.11.2018 ñPër ngritjen e Grupit të Punës për dorëzimin e tokës qiramarrësit subjektit ñD.Fò shpk, me datë 15.11.2018 nuk ka mundur të kryejë dorëzimin e tokës, për arsye se **pjesa më e madhe e sipërfaqes ishte e punuar dhe e mbjellë nga të tretë.** Për këtë i është kërkuar inforA.Mon ZVRPP Fier e cila informon që këto pasuri janë në pronësi shtet, Bashkisë Fier e cila konfirmon se zaptuesit e tokës nuk kanë asnjë dokument të provojë tagrat e tyre përë këtë shfrytëzim dhe DAMT Këshilli i Qarkut Fier e cila informon se këto pasuri nuk janë përfshirë në VKM nr.45/2014, ñPër kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe institucioneve-kërkimore të kësaj ministrie aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronaveò.
Kriteri:	Ligji nr.8318 datë 01.04.1998 ñPër dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetëroreò i ndryshuar,VKM nr.373 datë 20.06.2018 ñPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar me VKM nr.487 datë 17.06.2020 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.373 datë 20.06.2018 të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e kriterevetë rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit.ò;VKM-së nr. 45/2014, ñPër kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë,

	Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe ishinstitucioneve kërkimore-shkencore të kësaj ministrie, aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronaveòsi dhe çdo akt juridik që ka lidhje me këtë fushë objekti, në Republikën e Shqipërisë
Ndikimi/Efekti:	Kontratat e mësipërme nuk kanë ecurië pozitive, për shkak të problematikave të evidentuara, duke mos e justifikuar qëllimin për të cilin ato janë lidhur.
Shkaku:	Nga verifikimi i akteve të konstatimit të mbajtura nga përfaqësues të MBZHR-së, rezultuan raste: të dhënies me qira të tokave bujqësore mbi varrezat e zonës; në sipërfaqet e dhëna me qira rezultojnë ndërtime të paligjshme; ose raste ku disa prej tokave bujqësore dhënë me qira rezultojnë në përdorim nga të tretë si pasojë e kontratës me Njësinë Administrative respective. Gjithë sa më sipër, si pasojë e mungesës së një liste të plotë të tokës bujqësore.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi	Nga titullari i institucionit, për kontratat e mësipërme të dakortësohet për amendim kontratë midis palëve, duke vendosur në kontratë sipërfaqen e saktë për përdorim si dhe të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, për verifikimin dhe identifikimin në terren të kontratave të tjera, nëse kanë mbivendosje të sipërfaqeve bujqësore me aktivitete jo të zhvillimit bujqësor rural, me qëllim realizimin me sukses të kontratës. -Për të gjitha rastet në vijim, MBZHR të marrë masa që të mos japë me qera tokë bujqësore, pa realizuar procesin e idendifikimit dhe verifikimit të mospasjes së mbivendosjeve sipas shkaqeve të sipërpërmëndura.
Afati	Menjëherë

Titulli i Gjetjes 7:	Mbi problematikat evidentuara si dhe mbi monitorimin e kontratave të qirasë të dhëna nga MBZHR për tokën bujqësore.
Situata :	Për periudhën në auditim nga MZHBR, janë realizuar 11 procedura dhënie me qira të tokës bujqësore, nga të cilat nga grupi i auditimit u përzgjodhën 7 kontrata, ku në 2 procedura gjatë procesit të realizimit të dhënies me qira, u konstatua që, përllogaritja e çmimit fillestar të qerasë të tokës bujqësore pas verifikimit në terren, nga grupet e punës të ngritura me urdhër të titullarit të MBZHR, është llogaritur më pak, e për pasojë vlera e qirasë të tokës bujqësore ka sjellë të ardhura më pak në vlerën prej **196,776.94 lekë si efekte negative** në Buxhetin e Shtetit, konkretisht: **1.**Për Kontratën nr.180 Rep, nr.33/4 Kol nr.317 prot datë 15.01.2020 me subjektin ñAò shpk; **2.**Për Kontratën nr.305 Rep, nr.613 Kol, nr.748/1 prot datë 22.09.2020 me subjektin ñF.Aò, Kjo në kundërshtim me ligjin nr.8318 datë 01.04.1998 ñPër dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetëroreò i ndryshuar,sipas VKM nr.373 datë 20.06.2018 ñPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar me VKM nr.487 datë 17.06.2020 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.373 datë 20.06.2018 të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e kriterevetë rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit.ò
Kriteri:	Ligji nr.8318 datë 01.04.1998 ñPër dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetëroreò i ndryshuar,VKM nr.373 datë 20.06.2018 ñPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar me VKM nr.487 datë 17.06.2020 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.373 datë 20.06.2018 të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e kriterevetë rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit.ò;VKM-së nr. 45/2014, ñPër kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe ishinstitucioneve kërkimore-shkencore të kësaj ministrie, aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronaveòsi dhe çdo akt juridik që ka lidhje me këtë fushë objekti, në Republikën e Shqipërisë
Ndikimi/Efekti:	(i) Në përllogaritjen e çmimit fillestar të qerasë të tokës bujqësore pas verifimimeve në terren, nga grupet e punës të ngritura me urdhër të titullarit të MBZHR, duke e llogaritur më pak, e për pasojë vlera e qirasë të tokës bujqësore ka sjellë të ardhura më

	pak në vlerën prej **196,776.94 lekë si efekte negative në Buxhetin e Shtetit**. (ii) Nga subjektet qiramarrëse nuk janë zbatuar detyrimet kontraktore, konkretisht për mospagesat e qirasë në kohë, për mosrealizimin e investimeve të paraqitur sipas plan-investimeve, për pasojë **vlera prej 1,570,209.21 lekë, janë të ardhura të mungurara në Buxhetin e Shtetit.**
Shkaku:	Në përllogaritjen e çmimit fillestar të qerasë të tokës bujqësore pas verifikimit në terren, nga grupet e punës të ngritura me urdhër të titullarit të MBZHR, është përllogaritur më pak.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi	Nga MBZHR, të merren masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës prej 196,776.94 lekë, e cila përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit, për shkak të llogaritjes më pak të vlerës së qirasë , konkretisht: -Vlera prej 32,864 lekë për subjektin ñAò. -Vlera prej 163,912.94 lekë për subjektin ñF.Aò.
Afati	Menjëherë

Titulli i Gjetjes 8:	Monitorimi i kontratave
Situata :	Kanë likuiduar me vonesë pagesat e qerasë vjetore në kundërshtim me sa parashikuar në kontratat respektive, por për këtë nga strukturat monitoruese të MBZHR, nuk janë përllogaritur dhe mbajtur penalitete sipas nenit 7, pika 1 e kontratës tip, sipas të cilit qiramarrësi, paguan kamatëvonesën në vlerën 0.5% të detyrimit vjetor të qirasë për çdo ditë vonese në pagesën e qirasë, duke filluar nga data e përcaktuar në këtë kontratë. Konkretish, kamatevonesat të llogaritura nga grupi i auditimit për mos pagimin ne kohë te vleres së qerasë për subjektet si vijon: **1.** Shoqëria "A" shpk dhe ish-MBUMK (Ministria e Bujqesisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit) kanë lidhur Kontratë nr.3819 prot datë 16.09.2013. Kamate vonesat të llogaritura nga grupi i auditimit për mos pagimin ne kohë te vleres së qerasë është **9,682,054** lekë. **2**.Shoqëria ñP.Iò shpk dhe ish-MBUMK (Ministria e Bujqesisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit) kanë lidhur Kontratë Nr.3620/1 prot datë 06.09.2013. Kamate vonesat të llogaritura nga grupi i auditimit për mos pagimin ne kohë te vleres së qerasë është **15,197,238.15** lekë. **3.**Subjekti ñÇ" shpk dhe Ministria e Bujqesisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave kanë lidhur Kontratë nr Nr.1001 Prot, nr.396 Rep, nr.369 Kol, datë 05.02.2016. Kamate vonesat të llogaritura nga grupi i auditimit për mos pagimin në kohë të vleres së qerasë është**184,900.73** lekë. **4.**Subjekti ñA.M.ò dhe Ministria e Bujqesisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit Të Ujrave kanë lidhur Kontratë nr Nr. 2548 Prot, nr.115 Rep, nr.68 Kol, datë 24.03.2015 Kamatë vonesat të llogaritura nga grupi i auditimit për mos pagimin në kohë të vleres së qerasë është**1,341,629.10** lekë. **5.**Subjekti "P." shpk dhe MZHBR kanë lidhur Kontratë Nr.2711 Prot, nr.827 Rep, nr. 679 Kol, datë 31.03.2017.Kamate vonesat të llogaritura nga grupi i auditimit për mos pagimin në kohë të vleres së qerasë është **5,895,051.75** lekë. **6.**Subjektin ñR.Sòdhe MZHBR kanelidhur Kontrata nr.178 Rep, nr.32/4 Kol, nr.311 prot datë 15.01.2020. Kamatë vonesat të llogaritura nga grupi i auditimit për mos pagimin në kohë të vleres së qerasë është **889,200** lekë. **7.**Subjektin ñF.Aò lidhur Kontrata nr.305Rep, nr.613 Kol, nr.748/1 prot datë 22.09.2020. Kamatë vonesat të llogaritura nga grupi i auditimit për mos pagimin në kohë të vleres së qerasë është **18,000.21** lekë.
Kriteri:	Ligji nr.8318 datë 01.04.1998 ñPër dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetëroreò i ndryshuar,VKM nr.373 datë 20.06.2018 ñPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar me VKM nr.487 datë 17.06.2020 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.373 datë 20.06.2018 të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e kriterevetë rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit.ò;VKM-së nr. 45/2014, ñPër kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të ish-

	ndërmarrjeve bujqësore dhe ishinstitucioneve kërkimore-shkencore të kësaj ministrie, aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronaveòsi dhe çdo akt juridik që ka lidhje me këtë fushë objekti, në Republikën e Shqipërisë
Ndikimi/Efekti:	Vlera prej **33,868,081.75** lekë janë të ardhura të munguara.
Shkaku:	si pasojë e penaliteteve e moslikuidimit në kohë të qerave vjetore
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi	Nga MBZHR të merren masa për arkëtimin e vlerës **33,208,072.75** lekë të krijuara si pasojë e penaliteteve e moslikuidimit ne kohe të qerave vjetore, duke krijuar vlera financiare të cilat përfaqësojnë të ardhura të munguara ndaj buxhetit të shtetit, si vijon: -Për subjektin ñR.Sò, në vlerën prej **889,200 lekë.** -Për subjektin ñF.Aò, në vlerën prej **18,000.21 lekë.** -Për Subjektin "A", në vlerën prej **9,682,054 lekë.** -Për subjektin ñP.Iò,në vlerën prej **15,197,238.15**lekë. -Për Subjekti ñÇ", në vlerën prej **184,900.73**lekë. -Për Subjekti ñA.M.ò, në vlerën prej **1,341,629.10**lekë. -Për Subjekti ñP.ò, në vlerën prej **5,895,051.75** lekë.
Afati	Menjëherë

3.4. AUDITIMI I LLOGARIVE VJETORE TË ADMINISTRATËS SË INSTITUCIONIT

a. Auditimi i bilancit kontabël dhe plotësimi i pasqyrave financiare përkatëse në zbatim të UMF nr. 14, datë 28.12.2006, ñPër përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyreò i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007.
b.Auditimi i për llogarie të të ardhurave dhe shpenzimeve .
c. Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.
ç. Auditimit të pasqyrës së fluksit të mjeteve monetare.

a. Auditimi i Bilancit Kontabël dhe Plotësimi i Pasqyrave Financiare përkatëse:
Për hartimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2019 për Aparatin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, janë respektuar rregullat dhe kriteret e përcaktuara në:
- VKM nr.248 dt.10.04.1998 "Për miratimin e Planit Kontabël Publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qëndrore, lokale dhe njësive që varen prej tyre" i ndryshuar
- Udhëzimit nr.8 dt.09.03.2018 të MFE ",Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme"

Bilanci i vitit 2019 (me të gjitha pasqyrat financiare përkatëse) është hartuar dhe depozituar më datë 30.03.2020 brenda afatit ligjor, i miratuar edhe nga Dega e Thesarit Tiranë me nr.prot.2596/1 datë 30.03.2020. Pasqyrat Financiare të Bilancit janë sigluar nga Nënpunësi i Parë Zbatues i Autorizuar dhe nga hartuesi i tyre, bazuar në Nenin 42 të Ligjit 9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisëò. Pasqyrat e llogaridhënies vjetore kanë të plotësuara pasqyrat si vijon: Pasqyra e Pozicionit Financiar(Formati 1), Pasqyra e Performancës Financiare (Formati 2), Pasqyra e Flukseve Monetare(Formati 3), Pasqyra e Ndryshimeve në Aktivet Neto/Fondet Neto (Formati 4), Pasqyra Investimet dhe Burimet e Financimit (Formati 6), Pasqyra Gjendje dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Formati 7/a dhe 7/b), Pasqyra Numri i Punonjësve dhe Fondi i Pagave (Format 8) si dhe pasqyrat dhe anekset përkatëse mbi shpenzimet e të ardhurat e ushtrimit, investimet sipas Pyetësori dhe Shënime Shpjeguese (Formati 5). Veprimet janë mbartur nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh dhe më tej në bilanc. Përgatitja e të dhënave për Pasqyrat Financiare të vitit 2019 është bërë duke kryer paraprakisht rregjistrimin në mënyrë kronologjike sipas natyrës të të gjitha veprimeve financiare të realizuara nga Aparati i MBZHR gjatë vitit, rakordimi i llogarive analitike me ato sintetike si dhe përmbledhja në centralizator.

b. Llogaritë e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

- Në Pasqyrën e Performanca Financiare Grupimi A – Format 2 janë të pasqyruara të Ardhurat e Institucionit të realizuara në vitin 2019. Ato janë të ndara në 7 Kategori (sipas zërave përkatës), ku paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

Në lekë

Nr. Llogarije	P E R S H K R I M I I OPERACIONEVE	VITI 2019 USHTRIMOR	VITI 2018 I MEPARSHEM
A	**TE ARDHURAT**	**448,653,190**	**313,065,614**
70	I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET	0	0
700	1.Tatimi mbi te Ardhurat	0	0
7000	Tatim mbi te ardhurat personale		
7001	Tatim mbi Fitimin		
7002	Tatim mbi Biznesin e vogel		
7009	Te tjera Tatime mbi te ardhurat		
702	2.Tatimi mbi Pasurine	0	0
7020	Tatim mbi Pasurine e palujtshme		
7021	Tatim mbi shitjen e pasurise se palujtshe		
7029	Te tjera tatime mbi Pasurine		
703	3.Tatime mbi mallrat e sherbimet brenda vendit	0	0
7030	Tatim mbi vleren e shtuar(TVSH)		
7031	Akciza		
7032	Takse mbi sherbimet specifike		
7033	Takse mbi perdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie		
7035	Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie		
704	4.Takse mbi tregtine dhe transaksionet nderkombtare	0	0
7040	Takse doganore per mallrat e importit		
7041	Takse doganore per mallrat e eksportit		
7042	Tarife sherbimi doganor e kaliposte		
7049	Te tjera taksa mbi tregtine e transaksionet nderkombtare		
705	5.Takse e rruges		
708	6.Te tjera Tatime e Taksa kombtare		
709	7.Gjoba e Kamat vonesa		
75	**II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOQERORE E SHENDETESORE**	**0**	**0**
750	NGA TE PUNESUARIT		
751	NGA PUNEDHENESI		
752	NGA TE VETPUNESUARIT		
753	NGA FERMERET		
754	NGA SIGURIMET VULLNETARE		
755	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHOQERORE		
756	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHENDETESORE		
71	**III.TE ARDHURA JO TATIMORE**	**22,052,562**	**0**
710	1.Nga ndermarrjet dhe pronesia	0	0
7100	Nga Ndermarrjet publike jo financiare		
7101	Nga Ndermarrjet publike financiare		

7109	Te tjera nga ndermarrjet dhe pronesia		
711	2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	22,052,562	0
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore		
7111	Te ardhura sekondare e pagesa sherbimesh		
7112	Takse per veprime gjyqsore e noteriale		
7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e sherbimeve	22,052,562	
7114	Te ardhura nga biletat		
7115	Gjoba, kamatvonesa, sekuestrime e zhdemtime		
7116	Te ardhura nga transferimi prones,Legalizimi i ndertimeve pa leje		
719	3.Te tjera te ardhura jo tatimore		
76	**IV.TE ARDHURA FINANCIARE**	**0**	**0**
760	Nga interesat e huadhenies se brendshme		
761	Nga interesat e huadhenies se Huaj		
765	Nga interesat e depozitave		
766	Nga kembimet valutore		
72	**V.GRANTE KORENTE**	**426,600,628**	**313,065,614**
720	1.Grant korent I Brendshem	426,600,628	253,425,614
7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	411,927,212	223,186,885
7201	Nga Buxheti per NJQP(Vendore)		
7202	Nga Buxheti per pagesa te posacme te ISSH		
7203	Nga Buxheti per mbulim deficiti(ISSH E ISKSH)		
7204	Pjesmarrje e institucioneve ne tatime nacionale		
7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit		
7206	Financim I pritshe nga buxheti	14,673,416	30,238,729
7207	Sponsorizime te brendshme(nga te trete)		
7209	Te tjera grante korente te brendshme		
721	2.Grant korent I Huaj	0	59,640,000
	Nga Qeveri te Huaja		
	Nga Organizata Nderkombetare		59,640,000
	VI.TE ARDHURA TE TJERA	**0**	**0**
781	Te ardhura nga investimet ne ekonomi		
782	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive afatshkurtra		
783	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive afatgjata		
784	Rimarrje Shumash per shpenzime te viteve ardhshme		
787	Terheqje nga seksioni I investimeve		
73	**VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE**		

Burimi: MBZHR

Duke iu referuar tabelës vërejmë se **Llog.71** që përfaqëson të ardhurat e MBZHR në vlerën 22,052,562 lekë, ku në krahasim me vitin 2018 janë ngritur në po të njëjtën vlerë. Këto janë siguruar nga **Kat.lll -"Të Ardhura Jo Tatimore"** në vlerën 22,052,562 lekë; si dhe **Kat.V-"Grante Korente**" në vlerën 426,600,628 lekë ose 96 % të të ardhurave.

Llog.72 "Grante Korente" ka një vlerë prej 426,600,628 lekësh me një shtesë prej 113,535,014 leke më të madhe nga viti i kaluar.

-Duke iu referuar kësaj Pasqyre , **Grupimit B SHPENZIMET** , ka një total në vlerën 358,722,799 lekë të ndara sipas zërave :

Llog.600 "*Paga, shpërblime e të tjera shpenzime personeli*" në vlerën 156,490,421 lekë ose 44% të totalit të shpenzimeve;

Llog.601 "*Kontribute për sig. Shoqërore e shëndetësore*" në vlerën 24,870,163 lekë ose 7 % të totalit të shpenzimeve;
Llog.602 "*Blerje Mallra dhe shërbime të tjera*" në vlerën 247,075,523 lekë ose 69% të totalit të shpenzimeve; Ka diferenca të konsiderueshme në vlera tek disa prej llogarive si:
Log.6021ï ñMateriale dhe Sherbime Specialeò rritje prej 26,603,150 lekë ku përfshihen blerje matrikujsh gjethe dhe të imta, blerje vaksina RevPlasja, Pritje për të huaj etj.
Log.6024ï ñShpenzime Udhëtimiò rritje prej 9,719,300 lekë ku përfshihen dietat brenda dhe jashtë vendit,
Llog.6022- ñShërbime nga të tretëò ka një rritje prej **10,191,549** lekë ku përfshihen shpenzime bankatre, shpenzime për ngrohje ftohje, shërbime panairi ñShqiperia Punon Token etj
Llog.6025 ñShërbime për mirëmbajtje të zakonshmeò ka një rritje prej 1,011,222 lekë ku përfshihen riparimi i automjeteve.
Llog.6026 ñShpenzime për qiramarrjeò ka një rritje në vlerën 1,996,526 lekë si rezultat i pjesmarrjes ne panairin e Berlinit dhe marrjes me qera të ambinetit etj.
Llog.6023 ñShpenzime transporti ka një rritje në vlerën 56,353 lekë si rezultat i blerjeve te gomave, siguracion si blerje karburant per nevojat te MBZHRetj.
Kateg. V- TRANSFERIME KORENTE në vlerën 20,217,083 lekë ose 6 % të totalit të shpenzimeve, ku pjesën më të madhe e zë
Llog.606 -ñ*Transferta për buxhete familjare eindividët*ò në vlerën 1,199,826,204 lekë ose 98.7 % të tij dhe
Llog.605 -"*Transferime korenteme jashtë*" në vlerën 18,957,493 lekë ose 1.3%;
Llog.63 "*Ndryshimi i gjendjeve të inventarit***"** në vlerën -89,930,391 lekë, përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit në magazinën e materialeve dhe objekteve të inventarit të imët në përdorim të punonjësve. **Llog.686 "Shuma të Parashikuara për Aktivet Financiare**ò nuk përputhet në vlerë (0 lekë) me **Llog.711** e Kat.III TË ARDHURA JO TATIMORE.

Në lekë

Nr. Llog	**P E R S H K R I M I I OPERACIONEVE**	**VITI 2019 USHTRIMOR**	**VITI 2018 I MEPARSHEM**
600	**I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE**	**156,490,421**	**134,916,784**
6001	Paga, personel I perhershem	150,320,333	130,780,555
6002	Paga personel I Perkohshem	6,170,088	4,136,229
6003	Shperblime		
6009	Shpenzime te tjera per personelin		
601	**II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE**	**24,870,163**	**21,403,214**
6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	22,257,468	19,114,014
6011	Kontributi I Sigurimeve Shendetesore	2,612,695	2,289,200
602	**III.BLERJE MALLRA E SHERBIME**	**247,075,523**	**206,163,965**
602	Mallra dhe sherbime te tjera		
6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	3,139,975	4,695,677
6021	Materiale dhe sherbime speciale	117,422,787	90,819,637
6022	Sherbime nga te trete	51,664,978	41,473,429
6023	Shpenzime transporti	9,576,683	9,520,330
6024	Shpenzime udhetimi	29,015,851	19,296,551
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	5,525,160	4,513,938
6026	Shpenzime per qeramarrje	3,675,848	1,679,322
6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale	22,659,123	25,652,314
6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua		
6029	Shpenzime te tjera operative	4,395,118	8,512,767
603	**IV.SUBVECIONE**	**0**	**0**

6030	Subvecione per diference cmimi		
6031	Subvecione per te nxitur punesimin		
6032	Subvecione per te mbuluar humbjet		
6033	Subvecione per sipermarrjet individuale		
6039	Subvecione te tjera		
	V.TRANSFERIME KORENTE	**20,217,083**	**33,951,834**
604	**1.Transferime korente te brendshme**	**0**	**0**
6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise		
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme		
6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqerore e Shendetsore		
6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse		
605	**2.Transferime korente me jashte**	**18,957,493**	**32,764,718**
6051	Transferime Per Organizatat Nderkombetare	18,957,493	32,764,718
6052	Transferime Per Qeverite e Huaja		
6053	Transferime Per institucionet jo fitimprurese te huaja		
6059	Transferime Te tjera korrente me jashte shtetit		
606	**3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe**	**1,259,590**	**1,187,116**
6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH		
6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	1,259,590	1,187,116
	VI.SHPENZIME FINANCIARE	**0**	**0**
65	**1.Shpenzime Financiare te brendshme**	**0**	**0**
650	Interesa per bono thesarit dhe kredi direkte		
651	Interesa per huamarrje te tj. Brendshme		
652	Interesa Letra tjera vlere Qeverise		
656	Shpenz.nga kembimet valutore		0
66	**2.Shpenzime Financiare te jashtme**	**0**	**0**
660	Interesa per huamarrje nga Qeveri.te Huaja		
661	Interesa per financime nga Institucionet.nderkomb		
662	Interesa per huamarrje te tjera jashtme		
	VII.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA	**0**	**0**
681	Kuotat e amortizimit te AAGJ, te shfrytezimit		
682	Vlera e mbetur e AAGJ, te nxjerra jashte perdorimit e te shitura		
683	Shuma te parashikuara te shfrytezimit		
686	Shuma te parashikuara per aktivet financiare		
63	**VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT**	**-89,930,391**	**83,370,183**
	IX.SHPENZIME TE TJERA	**0**	
85	**TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES**	**89,930,391**	**-83,370,183**
	(Rezultati I Veprimtarise se vititUshtrimor)		

Burimi: MBZHR

Nga auditimi rezultoi se formatet e miratuara nga Ministria e Financave janë zbatuar.

Ndryshimi i gjendjes së inventarit në Grupimin B është i barabartë me diferencën e Klasës 3 në Aktiv të Bilancit.

Nga grupi i auditimit u bë rakordimi i shpenzimeve të Pasqyrës së Performancës Financiare me thesarin ku konstatohet se:

- Vlerat e paraqitura në pasqyrën financiare me vlerat e paraqitura në Akt rakordimin me Degën e Thesarit Tiranë ñ*Mallra dhe shërbime te tjera*ò, sipas Planit limit 280,797,372 lekë, bilancit në vlerën 247,075,523 lekë, ndërsa Akt rakordimit me Degën e Thesarit vlera është 240,451,599 lekë, ku diferenca prej 6,623,924 lekë janë detyrime të periudhës, por që ky detyrim do të paguhet në periudhën e ardhshme ushtrimore.
-ñ*Paga, shpërblime e të tjera personeli*ò sipas bilancit paraqiten në vlerën 156,490,421 lekë, ndërsa sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 156,637,810 lekë, ku diferenca prej 147,389 lekë vjen si rezultat diferencës së pagës dhjetor 2019 me atë të dhjetor 2018.
Në thesar në muajin janar të vitit 2020 kanë kaluar pagat e dhjetor 2019, ndërsa në pasqyrë vlera e Paga, përfitime të punonjësve është totali për periudhën Janar-Dhjetor 2019, ku vlera e pagave Dhjetor 2019 kalon në thesar në janar të 2020. I njëjti fenomen ndodh dhe me Llog. 601 ò*Kontrib.të sig.shoq.e shëndets*ò. Duke analizuar pasqyrën e Situacioneve konstatuam se pagesat e faturave të papaguara të vitit 2018 dhe likujduar në 2019 janë pasqyruar të ndara sipas Artikujve (602, 231) përkatës, si më poshtë.
Pasqyra krahasuese si më poshtë:

Në lekë

Nr. Llog	Shpenzimet e ushtrimit 2019	Pasqyrat financiare	Rakordimi me thesarin	Diferenca
60	**I. Shpenzime Korrente**	**358,722,799**	**442,165,941**	**83,443,142**
600	Paga përfitime të punonjësve	156,490,421	156,637,810	147,389
601	Kontrib.te sig.shoq.e shendets.	24,870,163	24,859,449	-10,714
602	Mallra dhe shërbime te tjera	247,075,523	240,451,599	-6,623,924
605	Transferta korente me jashtë	18,957,493	18,957,493	0
606	Transferta për buxh. familjare e individë	1,259,590	1,259,590	0

Në Grupimin A të Ardhurat te Pasqyra Format 2 -Llog. 720 në vlerën 426,600,628 lekë nga ku financimi nga buxheti i shtetit për vitin 2019 (NJQP) në shumën 1411,927,212 lekë dhe financimi i pritshëm nga buxheti i shtetit i në vlerën 14,673,416 lekë.
Të ardhurat tatimore e jo tatimore janë pasqyruar në Formatin 2 në vlerën 2,739,815 lekë dhe sipas

Në lekë

48	**72**	**IV. Grante Korrente (a+b)**	**426,600,628**	**313,065,614**
49	**720**	**a) Grant I brendshëm**	**426,600,628**	**253,425,614**
50	7200	Nga buxheti për NJQP (Qendrore)	411,927,212	223,186,885
51	7206	Financimi I pritshëm nga buxheti	14,673,416	30,238,729
52	**721**	**b) Grante korrent I jashtem**	**0**	0

Në lekë

34	**71**	**III. TE ARDHUTRA JO TATIMORE(a+b+c)**	**22,052,562**	**24,951,362**
35	710	a) Nga ndërmarrjet dhe pronësia	0	0
36	711	b) Shërbime administ. e ardhura sekondare	22,052,562	0
37	719	c) Te tjera te ardhura jo tatimore	0	

-Në Pasqyrën Formati 2 "Të Ardhurat Jo Tatimore", përfaqësojnë të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve, të ardhura nga licencat për shoqëritë private, korrigjim nga vitet e kaluara, qira toke, te ardhura nga matrikujt, tarife peshkimi. Kamat konesat etj.

Në lekë

Kodi I llogarisë ekonomike	Përshkrimi i të ardhurave 2019	Shuma lekë	Pjese e Institucionit	Derdhur në Buxhet
7109600	Të ardhura nga qira ndërtese	727.800		727800
7111021	Të ardhura nga licencat	13.848.307		13.848.307
7109100	Të ardhura nga qiratë e tokës buj	26.214.621		26.214.721
7113099	Të ardhura nga basenet ujore	13.326.590		13.326.590
7113099	Të ardhura nga mallra e shërbim	200.000		200.000
7113018	Të ardhura nga shitja matrikuj	12.175.162	12.175.162	

7115500	Të ardhura nga kamatvonesat	506.044		506.044
7115499	Të ardhurat nga gjoba	250.000		250.000
7115600	Të ardhura nga zhdëmtime	16.440		16.440
7200105	Të ardhura nga Brukseli BE	230.851	212.562	18.289
	TOTALI	**67.495.815**	**12.387.724**	**55.108.091**

Të ardhurat e realizuara nga MBZHR janë nga lejet dhe licencat për tregtimin me pakicë dhe shumicë të produkteve të mbrojtjes së bimëve PMB ï të dhe produkteve veterinare, PMV-të, të ardhurat nga qiratë e tokave bujqësore të dhëna me qira sipas kontratave të lidhura në MBZHR, qirat e ambjentit të dhënë me qira brenda ndërtesës së MBZHR, të ardhura nga shitja e matrikujve për të imta dhe gjedhë, tregtim kafshë me pakicë, si dhe treguesit e tjerë gjoba ,zhdëmtime të ardhura grande nga BE-ja etje.
Për vitin 2019 të ardhurat vjetore totale të realizuara në aparatin e MBZHR-së janë **67,495,815** lekë ndaj **95,128,000** lekë të planifikuar, ose në masën 71% ndaj planifikimit në projekt buxhet për vitin 2019.
Pjesa e institucionit,të ardhurat nga shitja e matrikujve,ishte planifikuar **30,000,00** lekë dhe u realizua **12,175,162** lekë ose në masën 40% ndaj planit vjetor. Mosrealizimi I planit të vitit 2019 erdhi nga mosrealizimi i të ardhurave të planifikuara për shitjen e matrikujve për gjedhë dhe të imta e cila u realizuar në masën 40% ndaj planifikimit vjetor.
Të ardhurat e derdhura në buxhet u realizuan **55,108,091** nga **95,128,000** lekë ose në masën 85% ndaj parashikimit në projekt Buxhet.
Peshën specifike më të madhe e zëne të ardhurat nga qeratë e paguara nga subjekte që kanë kontrata qiraje për tokë me qira që janë **26,214,621** lekë ose **38.8** % vlerës totale të të ardhurave të realizuara për vitin 2019, pastaj vijnë të ardhurat nga licencat qe jane **13,848,307** lekë ose 20% e vlerës totale të të ardhurave të cilat në të dy rastet derdhen total ne buxhetin e shtetit.
Të ardhurat nga shitja e matrikujve për gjedhë dhe të imta janë realizuar **12,175,162** lekë ose 18% të të ardhurave totale të vitit 2019. Këto të ardhura trashëgohen për tu përdorur përsëri në të ardhmen për blerje matrikuj sipas procedurave të prokurimeve. Zërat e tjerë të të ardhurave sipas tabeles zënë peshë specifike me të vogël dhe janë sipas rastit veçanërisht kamtvonesat,gjobat, zhdëmtiet e tjerë. Nga të ardhurat e realizuara në total janë derdhur në buxhet **55,108,091** lekë dhe janë trashëguar për tu përdorur nga Institucioni Aparati I MBZHR-së **12,387,724** lekë
Dokumentacioni që mbahet ne sektorin e financës për të ardhurat që ndiqen e reakordohen me drejtorinë e thesart Tiranë çdo muaj janë:
1. Shkresa e miratuar me vlerën përkatëse për arkëtim nga sektorët teknikë,sektori I PMB dhe PMV,si dhe nga Sektori i monitorimit të kontratave për tokat bujqësore dhenë me qira,
2. Mandate i arkëtimit,që lëshohet nga sektori I financës, sipas shkresës së lartëpërmendur
3. Dokumenti i pagesës fotokopje, që verteton pagesën,lëshuar nga banka përkatëse.

c. Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.
Bilanci kontabël i **vitit 2019** (llogaria vjetore 2019) për MBZHR është përpiluar nga Sektori i Financës dhe miratuar nga Drejtori i Drejtorisë së Financës. Kopje e gjithë pasqyrave financiare është dërguar në Degën e Thesarit Tiranë me shkresën nr. 2596/1, datë 30.03.2020. Nga Dega e Thesarit Tiranë është bërë edhe vulosja e bilancit dhe formateve të pasqyrave financiare; Pasqyrimi kontabël i MBZHR për vitin 2019 është i përbërë nga pasqyrat financiare sipas formateve të miratuara nga Ministria e Financave si dhe është respektuar afati i dorëzimit të tij në thesar.
Përmbledhja e llogarive vjetore për vitin 2019 dhe krahasimi me periudhat e mëparshme.

Aktivi - Pasqyra e Pozicionit Financiar për vitin 2019
Në lekë

Referenca	E M E R T I M I	Ushtrimi 2019 I Mbyllur	Ushtrimi 2018 Paraardhes

Logarive			
A	**A K T I V E T**	**3,066,052,313**	**2,969,294,273**
	I.Aktivet Afat shkurtra	**237,906,719**	**175,875,071**
	1.Mjete monetare dhe ekujvalent te tyre	**97,276,071**	**107,195,596**
531	Mjrete monetare ne Arke		
512,56	Mjrete monetare ne Banke	441,840	441,840
520	Disponibilitete ne Thesar	96,834,231	106,753,756
50	Letra me vlere		
532	Vlera te tjera		
54	Akreditiva dhe paradhenie		
59	Provigjone zhvlersimi letra me vlere (-)		
	2.Gjendje Inventari qarkullues	**125,957,232**	**36,026,841**
31	Materiale	89,034,936	27,891,965
32	Inventar I imet	36,922,296	8,134,876
33	Prodhim nre proces		
34	Produkte		
35	Mallra		
36	Kafshe ne rritje e majmeri		
37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve		
38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
39	Provigjone perzhvlersimin e inventarit (-)		
	3.Llogari te Arketushme	**14,673,416**	**32,652,634**
411	Kliente e llogari te ngjashme		
423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba		
431	Tatim e Taksa		
432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti		
435	Sigurime Shoqerore		
436	Sigurime Shendetsore		
437,438,	Organizma te tjere shteterore		
44	Institucione te tjera publike		
465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		
468	Debitore te ndryshem	0	2,413,905
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	14,673,416	30,238,729
45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
	4.Te tjera aktive afatshkurtra	**0**	**0**
409	Parapagime		
473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
477	Diferenca konvertimi aktive		
481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime		
486	Shpenzime te periudhave te ardhshme		
	II.Aktivet Afat gjata	**2,828,145,594**	**2,793,419,202**
20	**1.Aktive Afatgjata jo materiale**	**0**	**0**
201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		

202	Studime dhe kerkime		
203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		
21	**2.Aktive Afatgjata materiale**	**596,137,242**	**629,320,484**
210	Toka, T,roje, Terene		
211	Pyje, Plantacione		
212	Ndertesa e Konstruksione	125,353,931	126,974,438
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	0	0
214	Iinstalime teknike, makineri e paisje	3,811,638	4,012,251
215	Mjete Transporti	21,831,219	26,936,044
216	Rezerva Shteterore	0	0
217	Kafshe pune e prodhimi	0	0
218	Inventar ekonomik	17,167,610	59,033,813
24	Aktive afatgjata te demtuara	20,306,511	20,306,511
28	Caktime te Aktiveve Afatgjata	407,666,333	392,057,427
25-26	**3.Aktive Afatgjata Financiare**	**2,154,739,000**	**2,154,739,000**
25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet	2,154,739,000	2,154,739,000
	4.Investime	**77,269,352**	**9,359,718**
230	Per Aktive Afatgjata jo materiale	6,604,800	4,204,800
231	Per Aktive Afatgjata materiale	70,664,552	5,154,918

Grupimi A – AKTIVET , përfaqëson shumën: *Aktivet Afatshkurtra* (Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre, Gjendje Inventari qarkullues, Llogari te Arkëtueshme dhe Të tjera aktive afatshkurtra)me *Aktivet Afatgjata* (Aktive Afatgjata jo materiale, Aktive Afatgjata materiale, Aktive Afatgjata Financiare dhe Investime) .

Nga të dhënat përmbledhëse të *Aktivit për vitin ushtrimor 2019*, rezulton se totali i Aktivit me 31.12.2019 ka vlerën **3,066,052,313 lekë** dhe se në krahasim me vitin 2018 është **96,758,040lekë** më shumë;

"Aktivet Afatgjata"(AAGJJM, AAGJM dhe AAGJF) në vlerën 2,828,145,594 lekë zënë 92.2% të vlerës totale të aktivit;

Aktivet Afat Shkurtra zënë 7.7 % të vlerës totale në vlerën 237,906,719 lekë.

Aktivet Afatgjata në krahasim me vitin 2018, janë rritur në vlerën 34,726,392lekë, ndërsa Aktivet Qarkulluese janë rritur në vlerën 62,031,648lekë.

<u>Auditimi i Aktiveve Afatgjata</u>:

a. <u>Objektivat e auditimit</u> të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:

- Aktivet ekzistojnë fizikisht; ato i përkasin subjektit;

- janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte

- është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve korrente dhe aktiveve të qëndrueshme;

- inforA.Monet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe e korrekte.

b. <u>Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:</u>

Për auditimin e aktiveve të qëndrueshme, paraprakisht u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:

- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve të qëndrueshme në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;

- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhura ndonjë variacion anormal mbi aktivet e qëndrueshme;

- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;

- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuara dhe udhëzimeve përkatëse.

- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjate ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet, evidentimi kontabël.
- U verifikua rregullshmëria e procedurës së kalimeve kapitale të AAGJM si dhe e atyre për jashtë përdorimit.

c. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e Aktiveve Afatgjata:
1. Gjatë hyrjes se aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se:
- Aktivet e blera kontabilizohen sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Aktivet e prodhuara nga subjekti (Nëse ka) kontabilizohen sipas kostos së tyre të prodhimit.
- Aktivet e marra falas kontabilizohen duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivet e sjella në subjekt nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes. (UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 ñ*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar)*.

Në mënyrë analitike llogaritë financiare të aktivit të pasqyrës financiare paraqiten si më poshtë vijon:
1.Aktivet Afatgjata
-Llog.210 ñTokaTroje, Terenò paraqitet ne kontabilitet ne vlerën 0. Referuar VKM nr. 995, datë 9.12.2015,òVKM nr.45, datë 29.01.2014 si dhe VKM nr.142, datë 24.2.2016 ñPër kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Uëjraveò fondi i tokës bujqësore në pronësi të shtetit në përgjegjësi administrimi të MBZHR **është 19,033.95 Ha.**Nga kjo sipërfaqe janë dhënë me qira nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për **periudhën 2013-2021 sipërfaqja prej 2519 Ha e 7366 m^2**.
Për periudhën 2019-2021 (objekt auditimi) është dhënë me qira **sipërfaqja prej 714.35 Ha.**
Nga auditimi u konstatua se sektori i menaxhimit te pronave ashtu si dhe sektori I monitorimit te kontratave nuk disponon asnje regjister të miratuar ku te evidentoje te gjitha pronat te cilat referuar VKM sipërpërmendur kanë kaluar ne administrim të MBZHR. Gjithashtu nga auditimi u konstatua se edhe per tokat të cilat janë dhënë me qera për periudhën objekt auditimi, te cilat jane regjitruar ne hipoteke nga sektori I monitorimit nuk janë të kontabilizura, por figurojne në vlerën 0.
Nga auditimi u konstatua se nuk janë kontabilizuar asnjë nga tokat të cilat MBZHR ka në përdorim, apo tokave te cilat MBZHR ka dhene me qera.Kjo çështje për grupin e auditimit është konsideruar materiale, pasi në llog.210 ñToka,Troje,Tereò duhet të ishte konatabilizuar, pas regjistrimit te tokes ne hipotekë, I cili behet nga vete punonjesit e sektorit te finances, si dhe duke ju referuar zones kadestrale dheVKM nr. 89, datë 3.2.2016, ñ*Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë" përcaktohet vlera e seciles nga tokave të cilat MBZHR ka në përdorim.*
-Llog.212"Ndërtime e konstruksione**",** paraqitet në fund të vitit 2019 në vlerën prej 125,353,931 lekë, ku është pakesuar vlera prej 1,620,507 lekë. Nga auditimi i kësaj llogarie për vitin 2019, në vlerën 4,728,215 eshte rikonstrukturuar ambjenti i ndërtesës së MBZHR nga ku gjendja në fillim të vitit së bashku me investimin e kryer e duke zbritur amortizimin progresin rakordon në vlerën 125,353,931 të kontabilizuar ne bilanc.
-Llog. 214 ñInstalime Teknike makineri, pajisjeò, paraqitet në fund të vitit 2019 në vlerën 3,811,638 lekë e cila nuk ka lëvizje dhe duke e krahasuar me inventarin e vitit 2018 ka një vlerë më të vogël prej 200,613 lekë e cila përbën amortizimin e akumuluar.
- Llog.215 ñMjete Transportiò, paraqitet në fund të vitit 2019 në vlerën 21,831,219 lekë, Mjete transporti referuar formatit 7/a ka një shtësë pa pagasë në shumën 34,586,628 lekë nga marrja nga institucione të tjera të 8 makinave si dhe pakësim në shumën 45,935,381 lekë nga dhenia e 8 makinave të tjera.

Referuar amoritizimit te makinave, nga materiali i marre nga sektori i finances, si dhe inventarit të Aseteve të kryer nga MZHBR rezuton se ne total jane te konatibilizuara 15 makina dhe 5 motocikleta të cilat janë në përdorim të MBZHR.

- **Llog.218 "Inventar ekonomikò**, paraqitet në vlerën prej 17,167,610 lekë dhe sipas inventarit 31.12.2019, vlera e kësaj llogarie ka shtesa në këto vlera: 10,144,262 lekë asete të ardhura nga Banka Botërore; në vlerën 168,000 lekë blerje rafte arkivi si dhe në vlerën 1,074,327 lekë asete të ardhura pa pagese nga GIZ; si dhe pakësimet gjatë vitit në vlerën prej 8,601,877 lekë (pakësime të bëra dalje bashkive).në vlerën 262,800 lekë dalje prej ndermarrjeve në varësi si dhe në vlerën 41,472,576 lekë dalje Ministrisë se Mjedisit (ujrave)

- **Llog.28 "Caktimeñ**, paraqitet në AKTIVE në vlerën 407,666,333 lekë dhe në krahasim nga viti paraardhës ka një rritje prej 15,608,906 lekë. Kjo llogari përbëhet nga shuma 407,666,333 lekë cila i përket vitin 2018 si dhe shtesat gjatë vitit 2019 të detajuara si më poshtë vijon:

-supervizimi i rikonstruksionit të 67 qëndrave shëndetësore nga viti 2018 në shumën 826,617 lekë

-supervizimi i rikonstruksioit të qëndrave shëndetësore në disa qytete/njesi për vitin 2019 në shumën 603,498 lekë.

-Kosto loakle e projektit FOOD4HEALTH në vlerën 409,675 lekë

-TVSH për projektin FOOD SAFETY ne vlerën 999,1801 lekë.

-TVSH për IPA 2013 ñMbeshtetje për modernizimin e sektorit të blektoris) ne vleën 609,109 lekë.

-TVSH në llogarine Fondi Kombetar IPA 2013 në vlerën 3,620,000 lekë

-TVSH për projektin Zhvillimi i qendrueshëm i zonave Rurale te Shqipërise në vlerën 7,043,579 lekë

-TVSH për projektin (Dokumenti sektorial për Admisnitrimin e ujrave (IPA II) ne vlerën 181,545 lekë

-TVSH për projekin SARED , (Mbeshtetje për bujqësinë dhe Zhvillimin Rural në vlerën 1,782,585 lekë

-TVSH për projektin SRD, Zhvillim i Qendrueshëm i Zonave Rurale të Shqipërisë në vlerën 970,233 lekë

-**Në llog.230** paraqitet ne kontabilitet ne vleren 6,604,800 lekë, vlerë e cila përfaqëson investimet ne proces për ñProjektin e Merkatos së peshkut Vloreò në vlerën 2,400,000 lekë; për projektin e QTTB Korce në vlerën 2,040,000 lekë si dhe projektin QTTB Fush Kruje në vlerën 2,164,800 lekë.

-Invesitmet

Në llog.231 e cila paraqitet ne kontabilitet ne vlerën 70,664,552 me një rritje n masën 70% nga viti i mëparshëm vjen si rezultat i investimeve në proces per ñRikonstruskioni i merkatos se tregetimit te peshkut me shumice Shëngjinò në vlerën 34,632,845 lekë si dhe ñRikonstruskioni i merkatos se tregetimit te peshkut me shumice Vlorëò në vlërën 36,031,707 lekë.

2.Aktivet Afatshkurtra

- **Llog.520 "Disponibilitete në Thesar"** janë pasqyruar shuma e të ardhurave nga shitja e matrikujve për vitin 2019 dhe të ardhurat e trashëguara nga viti 2018 si dhe matrikujt dhe grandi i jashtëm për blerj vaksinash ardhur nga BE-ja. Vlera në bilanc paraqitet bashkë me garancitë e punimeve të trashëguara ndër vite në vlerën 96,834,231 lekë.

- **Llog.423 "Personeli, paradhënie, deficite gjoba**ò paraqitet ne blinan ne vlerën 0 lekë.

Nga auditimi u konstatua se nuk janë kontabilizuar gjobat/kamat vonesat te cilat janë vënë përfitueve të tokave prej mos likuidimit të qerase fikse mujore ne afatin e përcaktuar të cilën kane detyrim ligjor ta paguajne cdo muaj sipas kontaratës se lidhur midis MBZHR dhe përfituesit. Gjeneza e disa prej ketyre gjobave i ka fillesat qe në fitin 2013. Kjo llogari nuk pasqyron vleren reale te institucionit.

- Llog.486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" paraqet gjendjen e debitoëve e cila është e trashëguar ndër vite, kur në bilancin e MBZHR paraqitet ne vlerën 0.

Nga auditimi u konstatua se vlera 0 e kontabilizuar ne blilanc për llog.486 ñShpenzime te periudhave të ardhshmeò nuk është e sakte. MBZHR likuidon rreth 7 (shtatë) ish-punonjës të cilët nga vendimi i Gjykatës likuidohen cdo muaj me page. Ky detyrim edhe pse i njohur prej sektorit

të finances, nuk kontabilizohet por planifikohet vetëm ne PBA, duke mos pasqyruar kështu ne mënyre të saktë dhe të drejt llog përkatëse.
Për të evidentuar këto detyrime, do të përdoren llogari specifike të kontabilitetit të llogarisë 486, ñShpenzime të periudhave të ardhshmeò, Nga pikëpamja e kontabilitetit, regjistrimet për detyrimet e prapambetura duhet të bëhen si më poshtë: - Debitohet llogaria përkatëse 486, ñShpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambeturaò; dhe - Kreditohet llogaria përkatëse 467, ñKreditorë të ndryshëmò. Ku është relatuar në Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò. *Duke ju referuar parimeve dhe rregullave të organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, ku thuhet se: "Metoda e njohjes së shpenzimeve dhe të ardhurave në sektorin publik ka të bëjë me: - Njohjen e shpenzimeve të vitit buxhetor në çastin e ndodhjes së tyre, pavarësisht nga data e pagesës; Udhëzimi shprehet që këto veprime në kontabilitet do bëhen në rastin e mungesës së fondeve, që në situatën e mësipërme nuk ka mungesë fondesh.* Mos reflektimi i tyre si shpenzime të periudhës, çon në denatyrimin e detyrimeve të institucionit për periudhën ushtrimore 2019.
- Llog. 4342 ñTë tjera operacione me shtetinò, në vlerë prej 14,673,416 lekë ku paga e sigurime të personelit për tu paguar në Janar të vitit 2019, detyrimet për tu paguar për sigurimet shoqërore e shëndetësore, pra janë shpenzime të vitit 2019 që do të paguhen në vitin 2020. Janë burime financimi për detyrimet afatshkurtër gjendje (kryesisht të muajit Dhjetor) që sipas Ligjit të Buxhetit mbulohen nga buxheti i vitit pasardhës; si dhe fatura të papaguara nga Banka por të kaluara nga Thesari ditët e fundit të vitit 2019. Vlera e Llog.4342 është 15,565,313 lekë më e vogël se viti 2018.
*Nga Ministria, së bashku me njësitë e varësisë, në bashkëpunim dhe me Ministrinë e Financave të merren masa për të siguruar regjistrimin si dhe arkëtimin e debitorëve të trashëguar me vite dhe të krijuar rishtazi. Për debitorët pa shpresë arkëtimi të riverifikojë dhe evidentojë realisht statusin apo mundësinë për arkëtim të detyrimit në favor të buxhetit të shtetit dhe vetëm pas miratimit nga Ministria e Financave për "**Debitorët pa shpresë arkëtimi**", të bëjë parashkrimin e tyre dhe sistemimin në kontabilitet.*

Grupimi B - PASIVET

Pasivi i Pasqyrës Financiare për vitin 2019

Referenca e Llog	E M E R T I M I	Ushtrimi 2019 I Mbyllur	Ushtrimi 2018 Paraardhes
B	**PASIVET(DETYRIMET)**	**111,441,947**	**139,340,690**
	I.Pasivet Afat shkurtra	**111,441,947**	**139,340,690**
	1. Llogari te Pagushme	**111,441,947**	**139,340,690**
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to		15,428,638
42	Detyrime ndaj personelit	9,791,478	9,913,959
16,17,18	Hua Afat shkurtra		
460	Huadhenes		
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	1,057,120	1,083,760
432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
435	Sigurime Shoqerore	3,395,520	3,378,069
436	Sigurime Shendetsore	429,298	434,303
437,438,	Organizma te tjere shteterore		
44	Institucione te tjera publike		
45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		

466	Kreditore per mjete ne ruajtje	96,768,531	106,688,056
467	Kreditore te ndryshem	0	0
4341	Operacione me shtetin(detyrime	0	2,413,905
49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
	2.Te tjera pasive afatshkurtra	0	0
419	Kreditore, Parapagime		
475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
478	Diferenca konvertimi pasive		
480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se ttitullit		
	II.Pasivet Afat Gjata	0	0
Klase 4	Llogari te pagushme		
16.17,18	Huate Afat gjata		
	Provigjonet afatgjata		
Klasa 4	Te tjera		
C	**AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)**	**2,954,610,366**	**2,829,953,583**
D	**FONDI I KONSOLIDUAR :**	**2,954,610,366**	**2,829,953,583**
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	224,497,750	356,660,081
12	Rezultatet e mbartura	65,700	65,700
85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	89,930,391	-83,370,183
111	Rezerva		
115	Nga Fondet e veta te investimeve		
15	Shuma te parashikuiara per rreziqe e Zhvleresime		
105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshmne	484,935,685	401,417,145
106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja	441,840	441,840
107	Vlera e mjeëteve te caktuara ne perdorim		
109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata	2,154,739,000	2,154,739,000
	Te Tjera		
E	**TOTALI I PASIVEVE(B+C)**	**3,066,052,313**	**2,969,294,273**

Nga të dhënat përmbledhëse të Pasivit të Pasqyrës Financiare rezulton se totali i pasivit me 31.12.2019, paraqitet me vlerën 111,441,947 lekë, ku me C-ñAKTIVET NETO/FONDETò janë në vlerën 2,954,610,366 lekë e njëjtë në vlerë me D- ñFONDI I KONSOLIDUARò ndërsa B-ñDETYRIMETò janë në vlerën 111,441,947 lekë e njëjtë në vlerë me ñPasivet Afatshkurtraò.

- Llog. 401"Furnitorë e llogari të lidhura me tëò, në vlerën 0 lekë në Pasqyrën Financiare Format 1 përfaqëson detyrimet ndaj furnitorëve ku MBZHR nuk ka.

- **Llog 42"Detyrime ndaj Personelit"** në vlerën 9,791,478 lekë , përfaqëson pagat e muajit Dhjetor 2019; e cila përfaqëson edhe tatimin e pagave të muajit Dhjetor 2019 të cilat likuidohen në Janar të vitit 2020 me fondet buxhetore të planifikuara për vitin 2020.

- **Llog.435 & 436"Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore**ñ përfaqëson kontributet e sigurimit shoqëror në shumën 13,395,520 lekë dhe sigurimit shëndetësor në shumën 429,298 lekë të muajit Dhjetor 2019,të cilat likuidohen në muajin Janar 2020 me fondet buxhetore të planifikuara për vitin 2020.

- **Llog.466 "Kreditore për mjete në ruajtje"** është në vlerën 96,768,531 lekë. Kjo llogari mbart në vetvete ngurtësimin 5% si garanci punimesh për Rikonstruksionet e kryera që institucioni e ndal në momentin e likuidimit të situacioneve si dhe clirimit të kësaj garancie mbas periudhës së mbarimit të afatit të sigurimit të punimeve.

- **Llog.4341 "Te tjera operacione me shtetin (kreditor)**ò në shumën prej 0 lekë. Nga auditimi u konstua se nga MZHBR nuk jane kontabilizuar detyrimet të cilat kanë lindura nga mospagesa e e qirave të tokave bujqesore të dhëna nga MZHBR (llog 423 e cila pasqyrohet ne vlerën 0) si dhe mos regjistrimi i debitoreve te ndryshëm si ato të lindur prej ekzekutimit të vendimeve gjzqësore (llog 468 paraqitur ne bilanc në vlerën 0)

	Llog.	**Vlera / leke**
Llogaria 4341 Operacione me shtetin (detyrime)		**0**
Kundraparti		
Debitorë	423	0
Debitorë të ndryshëm	468	0
	Total	**0**

-Llog.467 "Kreditore të ndryshëm (kreditorë për investime)ñ në shumën prej 0 lekë janë fatura shpenzimesh të krijuara në fund viti nga dt.21.12.2019 deri në dt.28.12.2019, të cilat janë shpenzime të kaluara me thesar dhe të pakaluara nga banka (apo të kaluara në banke në vitin 2020). Kjo llogari pasqyrohet në vlrën 0 lekë, por nga auditimi u konstatua se nuk pasqyron nje vlerë të saktë, pasi nuk janë njohur Vendimet Gjyqësore apo gjobat te cilat duhet te ishin rregjistrua ne llogarine 426.

Rakordimet e Pasqyrave Financiare:

Auditimi u bë me zgjedhje për këto llogari, formate e pasqyra financiare:

- Auditimi për **barazimin e vlerës totale** të Pasivit me Aktivin:

-Totali i aktiveve **A** është i barabartë me totalin e pasiveve **E(B+C)** të bilancit kontabël (*Format1*), në shumën 1,632,396,697 lekë.

Në pasiv të bilancit janë paraqitur me **C** ñ***Aktivet Neto/Fondet***" të institucionit që arrijnë në vlerën **2,954,610,336** lekë, e cila konfirmohet si diferencë ndërmjet vlerës së Aktivit të bilancit**A** ï 3,066,052,313 lekë dhe grupeve **B** ñ*Detyrimeve*ò ï 111.441.947 lekë.

- Tek Pasqyra e Performancës Financiare (*Format 2*) Vlera e Grupimit Aò Të Ardhuarat" *është i barabartë me totalin* Vlera e Grupimit B òShpenzimetò dhe vlera e Llog.85 (-196,864 lekë).

- Llog.85 ñRezultati i veprimtarisë së Vitit Ushtrimor*"* në *Formatin 2* është në vlerën 89,930,391 lekë e njëjtë në vlerë **me Llog.85** ñRezultati i Veprimtarisë Ushtrimoreò në Grupimin D te Pasqyra e Pozicionit Financiar (*Format1).*

- Llog. 63 ñNdryshim i gjendjeve të inventarit*"*, evidentuar në Pasqyrën *Format 2* për -89,930,391 lekë në fund të vitit 2019, rakordon me ndryshimin e gjendjes së magazinës dhe është sa diferenca e klasës 3 ñGjendja e Inventarit Qarkulluesònë aktivin e bilancit. *Pra,* janë të barabarta që të dyja me vlerën prej 89,930,391 lekë**.**

- Pasqyra e Flukseve Monetare Formati 3.

Nga auditimi rezulton se ñAkordimi i Fondeve Buxhetore për Shpenzime korrenteò,Vlerat në lekë e Arkëtimeve është e njëjtë me vlerat respektive të llogarive në Pasqyrën Format 1 për vitin 2019 në vlerën 493,347,372 lekë ; ñAkordim Fonde Buxhetore për shpenzime Kapitaleò për vitin 2019 është në vlerën 212,682,032 lekë.

òTransferime në Buxhet të Fondeve të pa përdoruraò në vlerën prej 55,108,091 lekë;

Rezulton me Rënie të vlerës monetare në shumën 9,919,525 lekë;

Teprica në fillim të vitit 2019 është e njëjtë në vlerë me atë të mbylljes së vitit 2018 në shumën prej 107,195,596 lekë;

Teprica e Likuiditeteve të vitit 2019 është 97,276,071 lekë e njëjtë në vlerë me Llog.520 ñDisponibilitete në Thesarò te Pasqyra Format 1.

- Pasqyra e Ndryshimeve të Aktiveve Neto Format 4.

Totali i Fondeve sipas Pasqyrës Format 4 është i barabartë me totalin e Fondeve në Pasqyrën Format 1.

- Pasqyra e Investimeve dhe Burimet e Financimit Format 6.

Nga Grupi i Audititmit u bënë verifikimet:Llog.105 e F6 është e barabartë me Llog.105 në F1; Llog.106 e F6 është e barabartë me Llog.106 në F1;
Llog.111 e F6 është e barabartë me Llog.111 në F1;
Llog.115 e F6 është e barabartë me Llog.115 në F1;
Llog.12 e F6 është e barabartë me Llog.12 në F1;
Llog.16+17 e F6 është e barabartë me Llog.16+17 në F1;
Llog.230 & Llog.231 e F6 janë të barabarta me Llog.230 & Llog.231 në F1;
Llog.25/26 e F6 është e barabartë me Llog.25/26 në F1.

- Pasqyra Pyetësor dhe Shënime Shpjeguese Format 5.

Kjo pasqyrë është plotësuar pjesërisht duke mos analiaur disa nga llogarite perkatëse e për pasoje duke mos e përmbushur qëllimin e saj në kundërshtim meme ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò i ndryshuardhe udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Pyetësori dhe shënimet shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore (formati nr.5), për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, është i miratuar nga MFE dhe përbëhet nga 19 pika që mbulon elemente të ndryshme të raportimit financiar të njësisë.

Në inforA.Monin shpjegues për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare të viteve 2019 dhe 2020, për Aparatin e MBZHR, evidentohen mangësi në plotësimin e tyre si në vendosjen e përgjigjeve respektive po ose jo, ashtu edhe në zbërthimin me analizë të llogarive përkatëse. Plotësimi i të gjitha posteve të kësaj pasqyre do të sillte një lehtësi në verifikimin e cdo llogarie dhe dhënien e opinionit mbi saktësinë, plotësinë dhe qartësinë e pasqyrave financiare.

Per vitin 2020 "Auditimi i llogarive vjetore"

a. Auditimi i Bilancit Kontabël dhe Plotësimi i Pasqyrave Financiare përkatëse:

Për hartimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2020 për Aparatin e Ministrisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, janë respektuar rregullat dhe kriteret e përcaktuara në:

- VKM nr.248 dt.10.04.1998 "Për miratimin e Planit Kontabël Publik të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qëndrore, lokale dhe njësive që varen prej tyre" I ndryshuar
- Udhëzimit nr.8 dt.09.03.2018 të MFE ",Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme"
- Bilanci i vitit 2020 (me të gjitha pasqyrat financiare përkatëse) është hartuar dhe depozituar më datë 25.03.2021 brenda afatit ligjor, i miratuar edhe nga Dega e Thesarit Tiranë me nr.prot.2502 datë 26.03.2021. Pasqyrat Financiare të Bilancit janë sigluar nga Nënpunësi i Parë Zbatues i Autorizuar (Sekretari i Përgjithshëm) dhe nga hartuesi i tyre Shef i Sektorit të Financës, bazuar në Nenin 42 të Ligjit 9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisëò. Pasqyrat e llogaridhënies vjetore kanë të plotësuara pasqyrat si vijon: Pasqyra e Pozicionit Financiar(Formati 1), Pasqyra e Performancës Financiare (Formati 2), Pasqyra e Flukseve Monetare(Formati 3), Pasqyra e Ndryshimeve në Aktivet Neto/Fondet Neto (Formati 4), Pasqyra Investimet dhe Burimet e Financimit (Formati 6), Pasqyra Gjendje dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Formati 7/a dhe 7/b), Pasqyra Numri i Punonjësve dhe Fondi i Pagave (Format 8) si dhe pasqyrat dhe anekset përkatëse mbi shpenzimet e të ardhurat e ushtrimit, investimet sipas Pyetësori dhe Shënime Shpjeguese (Formati 5). Veprimet janë mbartur nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh dhe më tej në bilanc. Përgatitja e të dhënave për Pasqyrat Financiare të vitit 2020 është bërë duke kryer paraprakisht rregjistrimin në mënyrë kronologjike sipas natyrës të të gjitha veprimeve financiare të realizuara nga Aparati i Ministrisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural gjatë vitit, rakordimi i llogarive analitike me ato sintetike si dhe përmbledhja në centralizator.

b. Llogaritë e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

- Në Pasqyrën e Performanca Financiare Grupimi A – Format 2 janë të pasqyruara të Ardhurat e Institucionit të realizuara në vitin 2020**. Ato janë të ndara në 7 Kategori (sipas zërave përkatës), ku paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:**

Në lekë

Nr. Llogarije	P E R S H K R I M I I OPERACIONEVE	VITI 2020 USHTRIMOR	VITI 2019 I MEPARSHEM
A	**TE ARDHURAT**	**403,128,262**	**448,653,190**
70	I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET	0	0
700	1.Tatimi mbi te Ardhurat	0	0
7000	Tatim mbi te ardhurat personale		
7001	Tatim mbi Fitimin		
7002	Tatim mbi Biznesin e vogel		
7009	Te tjera Tatime mbi te ardhurat		
702	2.Tatimi mbi Pasurine	0	0
7020	Tatim mbi Pasurine e palujtshme		
7021	Tatim mbi shitjen e pasurise se palujtshe		
7029	Te tjera tatime mbi Pasurine		
703	3.Tatime mbi mallrat e sherbimet brenda vendit	0	0
7030	Tatim mbi vleren e shtuar(TVSH)		
7031	Akciza		
7032	Takse mbi sherbimet specifike		
7033	Takse mbi perdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie		
7035	Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie		
704	4.Takse mbi tregtine dhe transaksionet nderkombtare	0	0
7040	Takse doganore per mallrat e importit		
7041	Takse doganore per mallrat e eksportit		
7042	Tarife sherbimi doganor e kaliposte		
7049	Te tjera taksa mbi tregtine e transaksionet nderkombtare		
705	5.Takse e rruges		
708	6.Te tjera Tatime e Taksa kombtare		
709	7.Gjoba e Kamat vonesa		
75	**II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOQERORE E SHENDETESORE**	**0**	**0**
750	NGA TE PUNESUARIT		
751	NGA PUNEDHENESI		
752	NGA TE VETPUNESUARIT		
753	NGA FERMERET		
754	NGA SIGURIMET VULLNETARE		
755	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHOQERORE		
756	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHENDETESORE		
71	**III.TE ARDHURA JO TATIMORE**	**0**	**22,052,562**
710	1.Nga ndermarrjet dhe pronesia	0	0
7100	Nga Ndermarrjet publike jo financiare		
7101	Nga Ndermarrjet publike financiare		
7109	Te tjera nga ndermarrjet dhe pronesia		
711	2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	0	22,052,562
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore		
7111	Te ardhura sekondare e pagesa sherbimesh		
7112	Takse per veprime gjyqsore e noteriale		

7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e sherbimeve		22,052,562
7114	Te ardhura nga biletat		
7115	Gjoba, kamatvonesa, sekuestrime e zhdemtime		
7116	Te ardhura nga transferimi prones,Legalizimi i ndertimeve pa leje		
719	3.Te tjera te ardhura jo tatimore		
76	**IV.TE ARDHURA FINANCIARE**	**0**	**0**
760	Nga interesat e huadhenies se brendshme		
761	Nga interesat e huadhenies se Huaj		
765	Nga interesat e depozitave		
766	Nga kembimet valutore		
72	**V.GRANTE KORENTE**	**403,128,262**	**426,600,628**
720	1.Grant korent I Brendshem	403,128,262	426,600,628
7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	387,832,782	411,927,212
7201	Nga Buxheti per NJQP(Vendore)		
7202	Nga Buxheti per pagesa te posacme te ISSH		
7203	Nga Buxheti per mbulim deficiti(ISSH E ISKSH)		
7204	Pjesmarrje e institucioneve ne tatime nacionale		
7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit		
7206	Financim I pritshe nga buxheti	15,295,480	14,673,416
7207	Sponsorizime te brendshme(nga te trete)		
7209	Te tjera grante korente te brendshme		
721	2.Grant korent I Huaj	0	0
	Nga Qeveri te Huaja		
	Nga Organizata Nderkombetare		
	VI.TE ARDHURA TE TJERA	**0**	**0**
781	Te ardhura nga investimet ne ekonomi		
782	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive afatshkurtra		
783	Rimarrje Shumash te parashikuara per aktive afatgjata		
784	Rimarrje Shumash per shpenzime te viteve ardhshme		
787	Terheqje nga seksioni I investimeve		
73	**VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE**		

Burimi: MBZHR

Duke iu referuar tabelës vërejmë se **Llog.71** që përfaqëson të ardhurat e MBZHR në vlerën 0 lekë. Këto janë siguruar nga **Kat.lll -"Të Ardhura Jo Tatimore"** në vlerën 0 lekë (nga verifikimi i Akt Rakordimit të të Ardhurave në Thesar 2020 rakordon vlera e siperpermendur); si dhe **Kat.V-"Grante Korente**" në vlerën 403,128,262 lekë ose 98 % të të ardhurave.

Llog.72 "Grante Korente" ka një vlerë prej 403,128,262 lekësh me një shtes prej 23,472,366 leke më të madhe nga viti i kaluar.

Në lekë

Nr. Llogarije	**P E R S H K R I M I I OPERACIONEVE**	**VITI 2020 USHTRIMOR**	**VITI 2019 I MEPARSHEM**
B	**SHPENZIMET**	**464,602,457**	**358,722,799**
600	**I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE**	**155,522,279**	**156,490,421**
6001	Paga, personel I perhershem	149,034,897	150,320,333
6002	Paga personel I Perkohshem	6,487,382	6,170,088
6003	Shperblime		
6009	Shpenzime te tjera per personelin		
601	**II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE**	**25,095,958**	**24,870,163**
6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	22,463,269	22,257,468
6011	Kontributi I Sigurimeve Shendetesore	2,632,689	2,612,695

602	**III.BLERJE MALLRA E SHERBIME**	**176,614,940**	**247,075,523**
602	Mallra dhe sherbime te tjera		
6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	4,342,626	3,139,975
6021	Materiale dhe sherbime speciale	65,062,477	117,422,787
6022	Sherbime nga te trete	61,971,672	51,664,978
6023	Shpenzime transporti	14,027,156	9,576,683
6024	Shpenzime udhetimi	12,143,092	29,015,851
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	3,598,200	5,525,160
6026	Shpenzime per qeramarrje	30,000	3,675,848
6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale	12,031,987	22,659,123
6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua	0	
6029	Shpenzime te tjera operative	3,407,730	4,395,118
603	**IV.SUBVECIONE**	**0**	**0**
6030	Subvecione per diference cmimi		
6031	Subvecione per te nxitur punesimin		
6032	Subvecione per te mbuluar humbjet		
6033	Subvecione per sipermarrjet individuale		
6039	Subvecione te tjera		
	V.TRANSFERIME KORENTE	**45,895,085**	**20,217,083**
604	**1.Transferime korente te brendshme**	**0**	**0**
6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise		
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme		
6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqerore e Shendetsore		
6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse		
605	**2.Transferime korente me jashte**	**44,399,882**	**18,957,493**
6051	Transferime Per Organizatat Nderkombetare	19,399,882	18,957,493
6052	Transferime Per Qeverite e Huaja		
6053	Transferime Per institucionet jo fitimprurese te huaja		
6059	Transferime Te tjera korrente me jashte shtetit	25,000,000	
606	**3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe**	**1,495,203**	**1,259,590**
6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH		
6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	1,495,203	1,259,590
	VI.SHPENZIME FINANCIARE	**0**	**0**
65	**1.Shpenzime Financiare te brendshme**	**0**	**0**
650	Interesa per bono thesarit dhe kredi direkte		
651	Interesa per huamarrje te tj. Brendshme		
652	Interesa Letra tjera vlere Qeverise		
656	Shpenz.nga kembimet valutore		0
66	**2.Shpenzime Financiare te jashtme**	**0**	**0**
660	Interesa per huamarrje nga Qeveri.te Huaja		
661	Interesa per financime nga Institucionet.nderkomb		
662	Interesa per huamarrje te tjera jashtme		
	VII.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA	**0**	**0**
681	Kuotat e amortizimit te AAGJ, te shfrytezimit		
682	Vlera e mbetur e AAGJ, te nxjerra jashte perdorimit e te shitura		

683	Shuma te parashikuara te shfrytezimit		
686	Shuma te parashikuara per aktivet financiare		
63	**VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT**	**61,474,195**	**-89,930,391**
	IX.SHPENZIME TE TJERA		
85	**TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES**	**-61,474,195**	**89,930,391**
	(Rezultati I Veprimtarise se vititUshtrimor)		

Burimi: MBZHR

Grupimit B SHPENZIMET , të ndara sipas zërave :

Llog.600 "*Paga, shpërblime e të tjera shpenzime personeli*" në vlerën 155,522,279 lekë ose 33.4 % të totalit të shpenzimeve;

Llog.601 "*Kontribute për sig. Shoqërore e shëndetësore*" në vlerën 25,095,958 lekë ose 16 % të totalit të shpenzimeve;

Llog.602 "*Blerje Mallra dhe shërbime të tjera*" në vlerën 176,614,940 lekë ose 70% të totalit të shpenzimeve; Kjo llogari përmban shpenzimet për aparatin e MBZHR si; blerje kancelari, blerje matrikuj, taksat e e regjistrimit te pronave etj...

Ka diferenca të konsiderueshme në vlera tek disa prej llogarive si:

Llog.6020- ñMateriale zyre të pergjithshmeò ka një rritje prej **1,202,651 lekë** si rezultat i blerje se materialeve zyre te ndryshme, si tonera, materiale pastrimi etj per nevojat e institucionit.

Llog.6023 ñShërbime transportiñ ka një rrtije në vlerën 4,450,473 lekë krahasuar me vitin 2019, për shpenzime blerje krburanti, goma automtjesh si dhe siguracion automjetesh.

Llog.6022 ñShërbime nga te treteñ, një rritje ne vlerën, 10,306,694 lekë. Si dhe figuron në ulje te vlerës së shpënzimit për llogaritë:

Llog.6021 ñMateriale dhe sherbime specialeñ, ka një renie ne vlerën 52.360,310 lekë,.

Llog.6029 ñShpenzime të tjera operative një rënie në vlerën 987,388 lekë.

Llog.6025 ñShërbime për mirëmbajtje të zakonshmeò ka një rënie ne vlerën ne vlerën 1,926,960 lekë etj.

Kateg. V- TRANSFERIME KORENTE në vlerën 45,895,085 lekë ose 9,87 % të totalit të shpenzimeve, ku pjesën më të madhe e zë

Llog.606 -ñ*Transferta për buxhete familjare eindividët*ò në vlerën 1,495,203 lekë ose 96.7 % të tij e cila përbëhet nga ndihma ekonomike të dhëna për rast fatkeqësie ose ndihma familjarë.

Llog.605 -"*Transferime korenteme jashtë*" në vlerën 44,399,882 lekë ose 3.4%;

Llog.63 "*Ndryshimi i gjendjeve të inventarit***"** në vlerën 61,474,195 lekë, përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit në magazinën e materialeve dhe objekteve të inventarit të imët në përdorim të punonjësve.

Llog.686 "Shuma të Parashikuara për Aktivet Financiareò në vlerën 0 lekë përputhet me **Llog.711** e Kat.III TË ARDHURA JO TATIMORE.

Nga auditimi rezultoi se formatet e miratuara nga Ministria e Financave janë zbatuar.

Ndryshimi i gjendjes së inventarit në Grupimin B është i barabartë me diferencën e Klasës 3 në Aktiv të Bilancit.

Nga grupi i auditimit u bë rakordimi i shpenzimeve të Pasqyrës së Performancës Financiare me thesarin ku konstatohet se:

- Vlerat e paraqitura në pasqyrën financiare me vlerat e paraqitura në Akt rakordimin me Degën e Thesarit Tiranë ñ*Mallra dhe shërbime te tjera*ò, sipas bilancit në vlerën 176,614,940lekë, ndërsa Akt rakordimit me Degën e Thesarit vlera është 176,614,940 lekë, ku nuk ka diferenca.

-ñ*Paga, shpërblime e të tjera personeli*ò sipas bilancit paraqiten në vlerën 155,522,279 lekë, ndërsa sipas akt rakordimit me degën e thesarit vlera e tyre është 154,973,458 lekë, ku diferenca prej 548,821 lekë vjen si rezultat diferencës së pagës dhjetor 2020 me atë të janar 2021.

Në thesar në muajin janar të vitit 2021 kanë kaluar pagat e dhjetor 2020, ndërsa në pasqyrë vlera e Paga, përfitime të punonjësve është totali për periudhën Janar-Dhjetor 2020, ku vlera e pagave Dhjetor 2020 kalon në thesar në janar të 2021. I njëjti fenomen ndodh dhe me Llog. 601 ò*Kontrib.të sig.shoq.e shëndets*ò ku kemi një diference ne vlerën 73,243 lekë.

Pasqyra krahasuese si më poshtë:

Në lekë

Nr. Llog	Shpenzimet e ushtrimit 2020	Pasqyrat financiare	Rakordimi me thesarin	Diferenca
60	**I. Shpenzime Korrente**	**464,602,457**	**402,506,198**	**622,064**
600	Paga përfitime të punonjësve	155,522,279	154,973,458	548,821
601	Kontrib.te sig.shoq.e shendets.	25,095,958	25,022,715	73,243
602	Mallra dhe shërbime te tjera	176,614,940	176,614,940	0
605	Transferta korente me jashtë	44,399,882	44,399,882	0
606	Transferta paguar nga inst tjera e org pusht.Vendor	1,495,203	1,495,203	0

Në Grupimin A të Ardhurat te Pasqyra Format 2 -Llog. 720 financimi nga buxheti i shtetit për vitin 2020 (*grant*) në shumën 387,832,782 lekë dhe financimi i pritshëm nga buxheti i shtetit i në vlerën 15,295,480 lekë.

Të ardhurat tatimore e jo tatimore janë pasqyruar në Formatin 2 në vlerën 0 lekë

Në lekë

48	**72**	**IV. Grante Korrente (a+b)**	**403,128,262**	**426,600,628**
49	**720**	**a) Grant I brendshëm**	**403,128,262**	**426,600,628**
50	7200	Nga buxheti për NJQP (Qendrore)	387,823,782	411,927,212
51	7206	Financimi I pritshëm nga buxheti	15,295,480	14,673,416
52	**721**	**b) Grante korrent I jashtem**	**0**	0

Në lekë

34	**71**	**III. TE ARDHUTRA JO TATIMORE(a+b+c)**	**0**	**22,052,562**
35	710	a) Nga ndërmarrjet dhe pronësia	0	0
36	711	b) Shërbime administ. e ardhura sekondare	0	22,052,562
37	719	c) Te tjera te ardhura jo tatimore	0	

-Në Pasqyrën Formati 2 "Të Ardhurat Jo Tatimore", përfaqësojnë të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve, të ardhura nga licencat për shoqëritë private, korrigjim nga vitet e kaluara etj.

Në lekë

Kodi I llogarisë ekonomike	Përshkrimi I të ardhurave 2020	Shuma lekë	Pjese e Institucionit	Derdhur në Buxhet
7109600	Të ardhura nga qira ndërtese	545.850		545.850
7111021	Të ardhura nga licencat	49.591.610		49.591.610
7109100	Të ardhura nga qiratë e tokës buj	31.392.506		31.392.506
7113099	Të ardhura nga basenet ujore	194.571		194.571
7113099	Të ardhura nga mallra e sherbim	220.000		220.000
7113018	Të ardhura nga shitja matrikuj	10.125.068	10.125.068	
7115500	Të ardhura nga kamatvonesat	110.172		110.072
7115600	Të ardhura nga zhdëmtime	74.654		74.654
7200105	Të ardhura nga Brukseli BE	31.755.361	31.755.361	
7780100	Korigjim nga vitet e kaluara	806.945		806,945
	TOTALI	**124.816.738**	**41.880.429**	**82.936.308**

- Shuma **124,816,738** leke jane te ardhura te realizuara nga aktiviteti I institucionit si të ardhura nga qiraja,licensa ,banesat ujore, kamatvonesat etj.

Për vitin 2020 janë realizuar **124,816,738** lekë të ardhura gjithsej nga **86,728,000** lekë të planifikuara në projekt buxhet për vitin 2019. Ose në masën 144% ndaj planifikimit.

Tejkalimi erdhi si rezultat I grantit nga BE me **31.755.361** lekë te ardhurat nga liçencat 49.591.610 lekë nga 20.000.000 lekë të planifikuara pra janë dyfishuar në krahasim me planifikimin në projektbuxhet për vitin 2020

Peshën specifike më të madhe e ze zëri i të ardhurave nga licencat që është **49,591,610** lekë siç shihet dhe nga tabela më lart ose 39.7 % ndaj totalit të të ardhurave të realizuara për vitin 2020.
Krahasuar me të ardhurat e vitit 2019 në zërin e licencave kemi nje rritje në masën **35,743,303** lekë si rrjedhojë e rritjes dhe tregtimit të plehrave në bujqësi.
Pas kësaj vjen zëri të ardhurat nga qeratë e tokës bujqësore dhënë me qira të paguara nga subjekte që kanë kontrata qiraje toke që janë **31,392,506** lekë ose 25 % vlerës totale të të ardhurave të realizuara për vitin 2020, por krahasuar me vitin 2019 kemi një rritje në vlerë apsolute **5,150,885** lekë e cila vjen nga lidhja e kontratqve të reja.
Të ardhurat nga shitja e matrikujve për gjedhë dhe të imta të cilat trashëgohen janë realizuar **10,125,068** lekë ose 8% te te ardhurave totale të vitit 2020.Këto të ardhura kënë rënë në krahasim me vitin 2019 pasi ndryshoi udhëzimi dhe për rrjedhojë matrikujt nuk do të shiten por do të jepen falas fermerëve në ferma,për rrjedhojë ky zë të ardhurash nuk do të jetë më për vitin 2021 në tabelën e të ardhurave.
Në tabelë kemi dhe një grand nga BE dhënë për blerje vaksinash për luftimin e sëmundjeve të ndryshme në blegtori.në vlerë **31,755,361** lekë i cili është pjesë e Institucionit për tu përdorur.
Të ardhurat nga basenet ujore kanë rënë ndjeshëm por dhe nuk do të jenë më si zë për vitin 2021 pasi basenet nuk janë më pjesë ë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
Për vitin 2020 u derdhën në buxhet **82,936,308** lëkë dhe u trashëguan për tu përdoruar nga Institucioni Aparati I MBZHR-së **41,800,429** lekë
Krahasuar me vitin 2019 u derdhën në buxhët më shumë **27,8280,217** lekë dhe u trashëguan më shumë **29,367,673** lekë.

c. Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur saktë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si edhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Bilanci kontabël i **vitit 2020** për MBZHR është përpiluar nga Sektori i Financës dhe miratuar nga Drejtori i Drejtorisë së Financës. Kopje e gjithë pasqyrave financiare është dërguar në Degën e Thesarit Tiranë me shkresën nr. 2502, datë 25.03.2021. Nga Dega e Thesarit Tiranë është bërë edhe vulosja e bilancit dhe formateve të pasqyrave financiare; Pasqyrimi kontabël i MZHBR për vitin 2020 është i përbërë nga pasqyrat financiare sipas formateve të miratuara nga Ministria e Financave si dhe është respektuar afati i dorëzimit të tij në thesar.
Përmbledhja e llogarive vjetore për vitin 2020 dhe krahasimi me periudhat e mëparshme.

Aktivi - Pasqyra e Pozicionit Financiar për vitin 2020

Në lekë

Referenca e Llog	**E M E R T I M I**	**Ushtrimi 2020 Mbyllur**	**Ushtrimi 2019 Paraardhes**
A	**A K T I V E T**	**4,080,678,305**	**3,066,052,313**
	I.Aktivet Afat shkurtra	**288,940,282**	**237,906,719**
	1.Mjete monetare dhe ekujvalent te tyre	**182,006,025**	**97,276,071**
531	Mjrete monetare ne Arke		
512,56	Mjrete monetare ne Banke	441,840	441,840
520	Disponibilitete ne Thesar	181,564,185	96,834,231
50	Letra me vlere		
532	Vlera te tjera		
54	Akreditiva dhe paradhenie		
59	Provigjone zhvlersimi letra me vlere (-)		
	2.Gjendje Inventari qarkullues	**64,483,037**	**125,957,232**
31	Materiale	27,646,987	89,034,936
32	Inventar I imet	36,836,050	36,922,296
33	Prodhim nre proces		
34	Produkte		

35	Mallra		
36	Kafshe ne rritje e majmeri		
37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve		
38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
39	Provigjone perzhvlersimin e inventarit (-)		
	3.Llogari te Arketushme	**17,451,220**	**14,673,416**
411	Kliente e llogari te ngjashme		
423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba		
431	Tatim e Taksa		
432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti		
435	Sigurime Shoqerore		
436	Sigurime Shendetsore		
437,438,	Organizma te tjere shteterore		
44	Institucione te tjera publike		
465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		
468	Debitore te ndryshem	0	0
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	17,451,220	14,673,416
45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
	4.Te tjera aktive afatshkurtra	**25,000,000**	**0**
409	Parapagime		
473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
477	Diferenca konvertimi aktive		
481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime		
486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	25,000,000	
	II.Aktivet Afat gjata	**3,791,738,023**	**2,828,145,594**
20	**1.Aktive Afatgjata jo materiale**	**3,504,000**	**0**
201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
202	Studime dhe kerkime	3,504,000	
203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		
21	**2.Aktive Afatgjata materiale**	**815,621,491**	**596,137,242**
210	Toka, T,roje, Terene		
211	Pyje, Plantacione		
212	Ndertesa e Konstruksione	119,086,234	125,353,931
213	Rruge, rrjete, vepra ujore		0
214	Iinstalime teknike, makineri e paisje	3,621,056	3,811,638
215	Mjete Transporti	24,593,738	21,831,219
216	Rezerva Shteterore		0
217	Kafshe pune e prodhimi		0
218	Inventar ekonomik	14,144,108	17,167,610
24	Aktive afatgjata te demtuara	20,843,909	20,306,511
28	Caktime te Aktiveve Afatgjata	633,332,446	407,666,333
25-26	**3.Aktive Afatgjata Financiare**	**2,154,739,000**	**2,154,739,000**
25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet	2,154,739,000	2,154,739,000

	4.Investime	**817,873,532**	**77,269,352**
230	Per Aktive Afatgjata jo materiale	4,317,900	6,604,800
231	Per Aktive Afatgjata materiale	813,555,632	70,664,552

Grupimi A – AKTIVET , përfaqëson shumën: *Aktivet Afatshkurtra* (Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre, Gjendje Inventari qarkullues, Llogari te Arkëtueshme dhe Të tjera aktive afatshkurtra)me *Aktivet Afatgjata* (Aktive Afatgjata jo materiale, Aktive Afatgjata materiale, Aktive Afatgjata Financiare dhe Investime) .
Nga të dhënat përmbledhëse të *Aktivit për vitin ushtrimor 2020*, rezulton se totali i Aktivit me 31.12.2020 ka vlerën **4,080,678,305 lekë** dhe se në krahasim me vitin 2019 është **1,014,625,992 lekë** më shumë;
"Aktivet Afatgjata"(AAGJJM, AAGJM dhe AAGJF) në vlerën 3,791,738,023 lekë zënë 93% të vlerës totale të aktivit;
Aktivet Afatshkurtra zënë 7.1 % të vlerës totale ne vlerën 288,940,282 lekë .
Aktivet Afatgjata në krahasim me vitin 2019, janë rritur në vlerën 963,592,429lekë, ndërsa Aktivet Afatshkurtra janë ulur në vlerën 51,033,563lekë.

<u>Auditimi i Aktiveve Afatgjata</u>:
a. <u>Objektivat e auditimit</u> të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:
- Aktivet ekzistojnë fizikisht; ato i përkasin subjektit;
- janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte
- është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve korrente dhe aktiveve të qëndrueshme;
- inforA.Monet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe e korrekte.
b. <u>Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:</u>
Për auditimin e aktiveve të qëndrueshme, paraprakisht u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:
- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve të qëndrueshme në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhura ndonjë variacion anormal mbi aktivet e qëndrueshme;
- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;
- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuara dhe udhëzimeve përkatëse.
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjate ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet, evidentimi kontabël.
- U verifikua rregullshmëria e procedurës së kalimeve kapitale të AAGJM.
c. <u>Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e Aktiveve Afatgjata:</u>
1. Gjatë hyrjes se aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se:
- Aktivet e blera kontabilizohen sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Aktivet e prodhuara nga subjekti (Nëse ka) kontabilizohen sipas kostos së tyre të prodhimit.
- Aktivet e marra falas kontabilizohen duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivet e sjella në subjekt nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes. (UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 ñ*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar)*.
Në mënyrë analitike llogaritë financiare të aktivit të pasqyrës financiare paraqiten si më poshtë vijon:
1.Aktivet Afatgjata
-Llog.210 "Toka,Troje,Terene" paraqitet ne vlerën 0 lekë. ***Nga auditimi u konstatua se edhe per vitin 2020 vazhdon e njëjta problematike si për vitin 2019 ku, nuk ka te miratuar një regjister i administrimit te tokave te cilat kane kaluar ne perdorim te MBZHR ashtu si dhe nuk***

është kontabilzuar vlera e tokes per to. Gjithashtu edhe per tokat të cilat MBZHR për vitin 2019 dhe 2020 ka regjistruar, nuk janë të kontabilizuara.

-Llog.212"Ndërtime e konstruksione**",** paraqitet në fund të vitit 2020 në vlerën prej 119,086,234 lekë, ku është zbritur vlera prej 6,267,697 lekë, vlerë e cila ka të bëjë amortizimin vjetor të ndertesës.

-Llog. 214 ñInstalime Teknike makineri, pajisjeò, paraqitet në fund të vitit 2020 në vlerën 3,621,056 lekë e cila nuk një rënie në vlerën 190,582 lekë e cila përbën amortizimin vjetor për vitin 2020.

- Llog.215 ñMjete Transportiò, paraqitet në fund të vitit 2020 në vlerën 24,593,738 lekë, Mjete transporti referuar formatit 7/a ka një shtës në shumën 9,315,00 lekë si rezultat i marrjes së tre autoveturave pa pagesë por brenda sistemit si dhe pagësim ne vlerën 2,507,400 lekë nxjerrjes jashtë përdorimit të se një autoveture dhe nje motociklete

- Llog.218 "Inventar ekonomikò, paraqitet në vlerën prej 14,144,108 lekë dhe ku për vitin 2020 është shtuar vlera 1,022,265 lekë si rezultat i blerjeve si Projektor Epson, Kamera Digital, Telefona, Printer, Fotokopje etj, si dhe pakësime në vlerën 10,462,742 ku percaktohet vlera aktiveve të vlerësuar për dalje jashtë përdorimit.

- **Llog.28 "Caktime**ñ, paraqitet në AKTIVE në vlerën 633,332,446 lekë dhe në krahasim nga viti paraardhës ka një rritje prej 225,666,113 lekë.

Kjo llogari përbëhet nga vlera 16,013,079 lekë e cila përfaqëson TVSH dhe dosto lokale për vitin 2020, nga vlera 23,772,754 lekë ku janë paguar situacionet e merkatos së peshkut Shëngjin, vlera 104,835,657 lekë e cila përfaqëson vepra ujore të përfunduara me situacion përfundimtar dhe aktmarrje të përkohshme në dorëzim si dhe vlera 29,806,978 lekë projekte të paguara për të tretë pëe vitin 2020.

-Llog.230 "Për aktive afatgjatë jo materiale" paraqitet ne aktiv në vlerën 4,317,900 lekë me vlerë e cila vjen si rezultat i dy investimeve të cilat janë në proces, Projketi i themelimit të portit të peshkimit Vlorë në vlerën 2,114,700 lekë dhe Projekti i themelimit të portit të kanalit të Butrintit në vlerën 2,203,200 lekë.

-Llog 231 "Për aktive afatgjatë materiale" paraqitet ne aktiv ne vlerën 813,555,632 lekë, vlere e cila përfaqëson Investimet ne proces. Gjithësej janë 22 investime nga të cilat janë ende në proces zbatimi, të tilla si: Rikonstruksion i merkatose se Tregtimit te peshkut me shumice Vlore; Dropull i poshtem Rezervuari Drofti (Re Lume+STPP; Rikonstruksion i kanalit ujites Postribe; Skema ujitese Armen (Peshkepi); Mbrojtje nga lumi Drin i zi Zalli i Sines Loti 2; Rehabilitimi i Hidrovorit te Çukes Sarande etjé .

2.Aktivet Afatshkurtra

- Llog.520 "Disponibilitete në Thesar" janë pasqyruar të ardhurat në shumën 181,564,185 lekë e cila përbëhët nga llog 466 në vlerën 63,091,456 dhe kapitulli 60/602 në vlerën 118,472,728 lekë. Pra totali i llog 520 eshte i përmbërë nga 5% e garancise se projekteve ne vlerën 63,091,456 lekë, mbledhur me të ardhurat nga subjektet brenda vendit ne vlerën 65,700 lekë për përmbytjet, mbledhur me të ardhurat nga shitja e matrikujve në vlerën 31,154,426 lekë mbledhur dhe me sponsorizime nga BE për rimbursim të vaksinave për gjethe dhe të imta.

- Llog.423 "Personeli, paradhënie, deficite gjobaò është në vlerën prej lekë ku nga auditimi ashtu si edhe për vitin 2019 nuk janë kontabilizuar gjobat/kamat vonesat te cilat janë vënë përfitueve të tokave prej mos likuidimit të qerase fikse mujore ne afatin e përcaktuar të cilën kane detyrim ligjor ta paguajne cdo muaj sipas kontaratës se lidhur midis MBZHR dhe përfituesit. Gjeneza e disa prej ketyre gjobave i ka fillesat qe në fitin 2013. Kjo llogari nuk pasqyron vleren reale te institucionit.

- Llog.486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme"regjistrua në vlerën 0 lekë. Nga auditimi ashtu si dhe për vitin 2019 u konstatua se vlera 0 e kontabilizuar ne blilanc për llog.486 ñShpenzime te periudhave të ardhshmeò nuk është e sakte. MBZHR likuidon rreth 7 (shtatë) ish-punonjës të cilët nga vendimi i Gjykatës likuidohen cdo muaj me page. Ky detyrim edhe pse i

njohur prej sektorit të finances, nuk kontabilizohet por planifikohet vetëm ne PBA, duke mos pasqyruar kështu ne mënyre të saktë dhe të drejt llog përkatëse.
Për të evidentuar këto detyrime, do të përdoren llogari specifike të kontabilitetit të llogarisë 486, ñShpenzime të periudhave të ardhshmeò, Nga pikëpamja e kontabilitetit, regjistrimet për detyrimet e prapambetura të bëhen si më poshtë: - Debitohet llogaria përkatëse 486, ñShpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambeturaò; dhe - Kreditohet llogaria përkatëse 467, ñKreditorë të ndryshëmò. Ku është relatuar në Udhëzimin nr. 8, datë 9.3.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò. *Duke ju referuar parimeve dhe rregullave të organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, ku thuhet se: "Metoda e njohjes së shpenzimeve dhe të ardhurave në sektorin publik ka të bëjë me: - Njohjen e shpenzimeve të vitit buxhetor në çastin e ndodhjes së tyre, pavarësisht nga data e pagesës; Udhëzimi shprehet që këto veprime në kontabilitet do bëhen në rastin e mungesës së fondeve, që në situatën e mësipërme nuk ka mungesë fondesh.* Mos reflektimi i tyre si shpenzime të periudhës, çon në denatyrimin e detyrimeve të institucionit për periudhën ushtrimore 2019.
- Llog. 4342 "Të tjera operacione me shtetin", në vlerë prej 17,451,220lekë lekë ku Janë burime financimi për detyrimet afatshkurtër gjendje (kryesisht të muajit Dhjetor) që sipas Ligjit të Buxhetit mbulohen nga buxheti i vitit pasardhës në vlerën 15,295,480 lekë; si dhe fatura të papaguara referuar llog.401 lidhur me detyrmin ndaj furnitorëve ne vlerën 2,155,740 lekë.

Grupimi B - PASIVET

Nr. Llogarije	P E R S H K R I M I I OPERACIONEVE	VITI 2020 USHTRIMOR	VITI 2019 I MEPARSHEM
B	**PASIVET(DETYRIMET)**	**223,949,704**	**111,441,947**
	I.Pasivet Afat shkurtra	**223,949,704**	**111,441,947**
	1. Llogari te Pagushme	**223,949,704**	**111,441,947**
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	2,155,740	
42	Detyrime ndaj personelit	10,228,344	9,791,478
16,17,18	Hua Afat shkurtra		
460	Huadhenes		
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	1,080,832	1,057,120
432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
435	Sigurime Shoqerore	3,538,897	3,395,520
436	Sigurime Shendetsore	447,407	429,298
437,438,	Organizma te tjere shteterore		
44	Institucione te tjera publike		
45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	181,498,484	96,768,531
467	Kreditore te ndryshem	25,000,000	0
4341	Operacione me shtetin(detyrime	0	0
49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
	2.Te tjera pasive afatshkurtra	**0**	**0**
419	Kreditore, Parapagime		
475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
478	Diferenca konvertimi pasive		
480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		

487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se ttitullit		
	II.Pasivet Afat Gjata	0	0
Klase 4	Llogari te pagushme		
16.17,18	Huate Afat gjata		
	Provigjonet afatgjata		
Klasa 4	Te tjera		
C	**AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)**	**3,856,728,601**	**2,954,610,366**
D	**FONDI I KONSOLIDUAR :**	**3,856,728,601**	**2,954,610,366**
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	311,750,278	224,497,750
12	**Rezultatet e mbartura**	**65,700**	**65,700**
85	**Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore**	**-61,474,195**	**89,930,391**
111	Rezerva		
115	Nga Fondet e veta te investimeve		
15	Shuma te parashikuiara per rreziqe e Zhvleresime		
105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshmne	1,451,205,978	484,935,685
106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja	441,840	441,840
107	Vlera e mjeëteve te caktuara ne perdorim		
109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata		
	Te Tjera	2,154,739,000	2,154,739,000
E	**TOTALI I PASIVEVE(B+C)**	**4,080,678,305**	**3,066,052,313**

Nga të dhënat përmbledhëse të Pasivit të Pasqyrës Financiare rezulton se totali i pasivit me 31.12.2020, paraqitet me vlerën 4,080,678,305 lekë, ku me C-ñAKTIVET NETO/FONDETò janë në vlerën 3,856,728,601 lekë e njëjtë në vlerë me D- ñFONDI I KONSOLIDUARò dhe zënë respektivisht 95 % të vlerës totale të pasivit ndërsa B-ñDETYRIMETò janë në vlerën 233,949,704 lekë e njëjtë në vlerë me ñPasivet Afatshkurtraò zënë rreth 5 %.

- Llog. 401"Furnitorë e llogari të lidhura me tëò, në vlerën 2,155,740 lekë në Pasqyrën Financiare Format 1 përfaqëson detyrimet ndaj furnitorëve vlerë e cila përbëhet nga pjesa e mbetur e detyrimeve të krijuara gjatë vitit 2020 si dhe fatura të sjella në fund të vitit 2020. Kjo llogari mbrat detyrimin e prapambetur qe MBYHR ka për Investinme (projekti230) ne vlerën 1,820,740 lekë si dhe Shpenzime per likuidatoprin e MADA në vlerën 335,520 lekë.

- **Llog 42"Detyrime ndaj Personelit"** në vlerën 10,228,344 lekë , përfaqëson pagat e muajit Dhjetor 2019; si dhe tatimi i pagave të muajit Dhjetor 2019 të cilat likuidohen në Janar të vitit 2020 me fondet buxhetore të planifikuara për vitin 2020.

- **Llog.435 & 436"Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore**ñ përfaqëson kontributet e sigurimit shoqëror në shumën 3,538,897 lekë dhe sigurimit shëndetësor në shumën 447,407 lekë të muajit Dhjetor 2019,të cilat likuidohen në muajin Janar 2020 me fondet buxhetore të planifikuara për vitin 2020.

- **Llog.466 "Kreditore për mjete në ruajtje"** është në vlerën 181,498,484 lekë.

Kjo llogari mbart në vetvete ngurtësimin 5% si garanci punimesh për Rikonstruksionet e kryera që institucioni e ndal në momentin e likuidimit të situacioneve si dhe clirimit të kësaj garancie mbas periudhës së mbarimit të afatit të sigurimit të punimeve.

- **Llog.4341 "Te tjera operacione me shtetin (kreditor**)ò në shumën prej 0 lekë. Nga auditimi u konstatua se kjo llogari duhe të pasqyronte gjobat te cilat kane lindur si rrjedhoje e mospageses se qerase se tokes per kontratat e lidhura me perfituesin pra llog.423 ashtu si dhe llog 468 te cilat duhe te ishin te njohura detyrimet per shpenzimet gjyqesore te cilat edhe per kete vit nuk jane t regjistruara. Kjo llogari nuk paraqet nje vlere te sakte te kreditoreve te institucionit.

	Llog.	**Vlera / leke**
Llogaria 4341 Operacione me shtetin (detyrime)		**0**

Kundraparti		
Llogaria 423 ,429 personel paradhenie deficite gjoba	423/429	0
Debitorë të ndryshëm	468	0
	Total	**0**

-Llog.467 "Kreditore të ndryshëm në shumën prej 25,000,000 lekë, i njohur dhe si shpenzim për periudhat e ardhshme llog.486 po në të njëjmtën vlerë pasqyron fondin e tranferuar ne llogari të Misionit për përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit në Bruksel, nga i cili nuk është disbursuar asnjë pagesë për arsye se Sekretariati i MBZHR në Bruksel nuk është funksional. Po nga auditimi grupi konstatoi se ky nuk është i vetmi detyrim i cili është kontabilizuar pasi mungojne dhe detyrimet per shpenzimet bujqësore të cilat MBZHR i njeh si të atilla.

Rakordimet e Pasqyrave Financiare:

Auditimi u bë me zgjedhje për këto llogari, formate e pasqyra financiare:

- Auditimi për **barazimin e vlerës totale** të Pasivit me Aktivin:

-Totali i aktiveve **A** është i barabartë me totalin e pasiveve **E(B+C)** të bilancit kontabël (*Format1*), në shumën 4,080,678,305 lekë.

Në pasiv të bilancit janë paraqitur me **C** ñ***Aktivet Neto/Fondet***" të institucionit që arrijnë në vlerën **3,856,728,601** lekë, e cila konfirmohet si diferencë ndërmjet vlerës së Aktivit të bilancit**A** ï 4,080,678,305 lekë dhe grupeve **B** ñ*Detyrimeve*ò ï 222,949,704 lekë.

- Tek Pasqyra e Performancës Financiare (*Format 2*) Vlera e Grupimit Aò Të Ardhuarat" *është i barabartë me totalin* Vlera e Grupimit B òShpenzimetò dhe vlera e Llog.85 (61,474,195 lekë).

- Llog.85 ñRezultati i veprimtarisë së Vitit Ushtrimor*"* në *Formatin 2* është në vlerën 61,474,195 lekë e njëjtë në vlerë **me Llog.85** ñRezultati i Veprimtarisë Ushtrimoreò në Grupimin D te Pasqyra e Pozicionit Financiar (*Format1).*

- Llog. 63 ñNdryshim i gjendjeve të inventarit*"*, evidentuar në Pasqyrën *Format 2* për 61,474,195lekë në fund të vitit 2020, rakordon me ndryshimin e gjendjes së magazinës dhe është sa diferenca e klasës 3 ñGjendja e Inventarit Qarkulluesònë aktivin e bilancit. *Pra,* janë të barabarta që të dyja me vlerën prej 61,474,195lekë**.**

- Pasqyra e Flukseve Monetare Formati 3.

Nga auditimi rezulton se ñAkordimi i Fondeve Buxhetore për Shpenzime korrenteò,Vlerat në lekë e Arkëtimeve është e njëjtë me vlerat respektive të llogarive në Pasqyrën Format 1 për vitin 2020 në vlerën 423,079,222 lekë; ñAkordim Fonde Buxhetore për shpenzime Kapitaleò për vitin 2020 është në vlerën 1,047,368,559 lekë.

òTransferime në Buxhet të Fondeve të pa përdoruraò në vlerën prej 98,162,790 lekë;

Rezulton me Rritje të vlerës monetare në shumën 84,729,954 lekë;

Teprica në fillim të vitit 2020 është e njëjtë në vlerë me atë të mbylljes së vitit 2019 në shumën prej 97,276,071 lekë;

Teprica e Likuiditeteve të vitit 2020 është 182,006,025 lekë e njëjtë në vlerë me Llog.520 ñDisponibilitete në Thesarò te Pasqyra Format 1.

- Pasqyra e Ndryshimeve të Aktiveve Neto Format 4.

Totali i Fondeve sipas Pasqyrës Format 4 është i barabartë me totalin e Fondeve në Pasqyrën Format 1.

- Pasqyra e Investimeve dhe Burimet e Financimit Format 6.

Nga Grupi i Auditimit u bënë verifikimet:Llog.105 e F6 është e barabartë me Llog.105 në F1;
Llog.106 e F6 është e barabartë me Llog.106 në F1;
Llog.111 e F6 është e barabartë me Llog.111 në F1;
Llog.115 e F6 është e barabartë me Llog.115 në F1;
Llog.12 e F6 është e barabartë me Llog.12 në F1;
Llog.16+17 e F6 është e barabartë me Llog.16+17 në F1;
Llog.230 & Llog.231 e F6 janë të barabarta me Llog.230 & Llog.231 në F1;
Llog.25/26 e F6 është e barabartë me Llog.25/26 në F1.

- Pasqyra Pyetësor dhe Shënime Shpjeguese Format 5.

Kjo pasqyrë është plotësuar pjesërisht duke mos e përmbushur qëllimin e saj. Plotësimi i të gjitha posteve të kësaj pasqyre do të sillte një lehtësi në verifikimin e cdo llogarie dhe dhënien e opinionit mbi saktësinë, plotësinë dhe qartësinë e pasqyrave financiare.

Nga MBZHR janë paraqitur vetëm observacion mbi Akt konstatimin nr.2, datë 30.07.2021, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 30.07.2021, ndërsa për projektraportin nuk u paraqitën, për rrjedhojë qëndrimi i grupit të auditimit mbetet i njëjtë.

Pretendimi i subjektit: "*Ne asnje rast në drejtorine e buxhetimit dhe menaxhimit financiar, nga nan e sektorit përkatës nuk është depozituar urdhër për kontabilizim e detyrimeve për kamatvonesat apo gjoba, për tokat me qera si dhe urdhër titullari, nga sektori perkatës për kontabilizimin e tokave të regjistruara. Ne momentin qe pranë DBMF do të depozitohet dokumentacioni sipas parashikimeve ne urdhrin nr.30/2011 nga ana jone do të kryehen të gjitha veprimet kontabile në pajtim me përcaktimet ligjore"*
Qëndrimi i Grupit të Auditimit: DBMF nuk mund te operoje si nje depratament I cili kryen veprimtarine e tij pa bashkepunimin, informimin dhe komunikimin zyrar me deparatemntite e tjera, si Sektori I monitorimit, apo sektori I administrimit te pronave. Ne cilesine e nepunesit zbatues, DBMF eshte drejtori ekzekutive ku kryen likuidimet per te gjithe veprimtarine financiare te insitucionit, si dhe informon ne bashkepunim me drejtorit apo sektoret e tjera ne lidhje me detyrimet apo jo te paleve te treta, cka sjell dhe pasqyrimin e sakte/real ne kontabilitet.
Për sa më sipër trajtuar obesvacioni nuk meret ne konsiderat.

Titulli i Gjetjes 1	**Moskontabilizim i tokave bujqësore te cilat janë në administrim & dhënë me qëra nga MBZHR**
Situata:	Nga auditimi rezultoi se, llog**Llog.210** ñTokaTroje, Terenò paraqitet ne kontabilitet ne vlerën 0 lekë.VKM nr. 995, datë 9.12.2015,òVKM nr.45, datë 29.01.2014 si dhe VKM nr.142, datë 24.2.2016 ñPër kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Uëjraveò fondi i tokës bujqësore në pronësi të shtetit në përgjegjësi administrimi të MBZHR **është 19,033.95 Ha.**Për periudhën 2019- mars 2021 (objekt auditimi) është dhënë me qira sipërfaqja **prej 714.35**Ha të cilat nga ana se sektorit të monitorimeve është kryer regjistrimit I tyre ne hipotek.Nga auditimi u konstatua se nuk janë kontabilizuar asnjë nga tokat të cilat MBZHR ka në përdorim, apo tokave te cilat MBZHR ka dhene me qera. Kjo çështje për grupin e auditimit është konsideruar materiale, pasi në llog.210 ñToka,Troje,Tereò duhet të ishte konatabilizuar, pas regjistrimit te tokes ne hipotekë, I cili behet nga vete punonjesit e sektorit te finances, si dhe duke ju referuar zones kadestrale dhe VKM nr. 89, datë 3.2.2016, ñ*Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë" përcaktohet vlera e seciles nga tokave të cilat MBZHR ka në përdorim.* -Për periudhën objekt auditimi është kryer regjistrimi i pronësisë dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme në inventarin e shtetit sipas kërkesave të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 ñPër inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendoreò, i ndryshuar). Eshtë regjistruar pasuria në Zyrën e Kadastrës Shtetërore, në bazë të përcaktimeve të ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 ñPër pasuritë e paluajtshme shtetëroreò, i ndryshuar si dhe ligjit nr. 33/2010 ñPër regjistrimin e pasurive të paluajtshmeò. Por nga auditimi u konstatua se Sipërfaqet e trojeve në llog nr.210 si dhe vlerat e tyre për periudhën objekt auditimi, nuk janë regjistruar në bilancin kontabël dhe janë evidentuar për vleftën 0 lekë. Sipërfaqja totale e tokës që ka MBZHR në dispozicion nuk është vlerësuar dhe nuk është pasqyruar në kontabilitet. Për sa sipër, nuk ka gjetur zbatim pika 3.3 ñRregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar (bilanci)ò , paragrafi 62, dhe paragrafi 91, të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò.
Kriteri :	Ligji nr. 9228 datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò i ndryshuar. Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò.
Ndikimi/Efekti	Pasqyrat financiare nuk sigurojnë të dhënave të plota dhe nuk paraqesin, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje lidhur me këtë zë, në rregjistrat kontabël.
Shkaku:	Mungesë veprimesh nga strukturat përgjegjëse.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Titullari i Institucionit të marrë masa për ngritje e grupit të punës me qëllim vlerësimin dhe saktësimin e vlerës së aktiveve afatgjata jo materiale ñToka troje terrenò, në administrim të institucionit MBZHR. Nga Drejtorina e Buxhetimit dhe Menaxhimit Financiar (Sektori i Finances) të merren masa për të kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare vlerën e

	drejtë të Aktiveve Afatgjata Materiale, menjëherë pas përfundimit të procesit të vlerësimit nga grupi i punës. Të ngrihet një grup pune për të pasqyruar dinamikën dhe lëvizjet e aktiveve afatgjata materiale, të ndërtojë gjurmën e auditimit të këtyre pasurive, duke saktësuar dhe administruar dokumentacionin e nevojshëm, dhe mbi këtë bazë të ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore dhe të aplikohet për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të institucionit. Të ngrihet një grup pune me qëllim identifikimin me planimetri dhe genplane të sipërfaqes së tokës truall që i përket institucionit dhe pas përllogaritjes së vlerave nga ekspertët e fushës, të ndërmerren veprimet e nevojshme të regjistrimit të saj në kontabilitet, duke evidentuar situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit dhe në pajtueshmëri me legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Titulli i Gjetjes 2	**Mos regjistrim I debitoreve si dhe gjobave te qeramarresve**
Situata:	-Nga auditimi rezultoi se, **Llog.486 "Shpenzime te periudhave të ardhshme për vitin 2019 & 2020 është 0 lekë**. Nga auditimi u konstatua se kjo vlerë nuk është e saktë pasi MBZHR likuidon rreth 7 (shtatë) ish-punonjës të cilët nga vendimi i Gjykatës likuidohen cdo muaj me page. Ky detyrim edhe pse i njohur prej sektorit të finances, nuk kontabilizohet por planifikohet vetëm ne PBA, duke mos pasqyruar kështu ne mënyre të saktë dhe të drejt llog përkatëse në kundërshtim me pikën 42 të Udhëzimit nr. 8, datë 9.3.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò **-Llog.423 "Personeli, paradhënie, deficite gjoba**òparaqitet ne blinan ne vlerën 0 lekë, nga ku u konstatua se se nuk janë kontabilizuar gjobat/kamat vonesat te cilat janë vënë përfitueve të tokave prej mos likuidimit të qerase fikse mujore ne afatin e përcaktuar të cilën kane detyrim ligjor ta paguajne cdo muaj sipas kontaratës se lidhur midis MBZHR dhe përfituesit. Gjeneza e disa prej ketyre gjobave i ka fillesat qe në fitin 2013.
Kriteri :	Ligji nr. 9228 datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò i ndryshuar. Pika 42 te Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò.
Ndikimi/Efekti	Pasqyrat financiare nuk sigurojnë të dhënave të plota dhe nuk paraqesin, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje lidhur me këtë zë, në rregjistrat kontabël.
Shkaku:	Mungesë veprimesh nga strukturat përgjegjëse.
Rëndësia:	I Lartë
Rekomandimi:	-Departamenti Juridik ne bashkëpunim me Drejtorine e Buxhetimit dhe Menaxhimit Financiar (Sektorin e Finances) të marrë masa ku për të gjitha vendimet gjyqesore të evidentojnë veçmas në pasqyrat financiare vjetore zërin e detyrimeve të prapambetur ñpër vendimet gjyqësore ku konkretisht të debitoje llogarine përkatëse 486 ñShpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambeturaòsi dhe te Kreditohet llogaria përkatëse 467 ñKreditorë të ndryshëmò. -Intitucioni të marrë masa ku të ngrej nje grup pune për saktësimin dhe vertetimin e te gjithe kamatvoneseva/gjobave të cilat kane ardhur si rezultat i moslikuidimeve apo gjobave te marra nga mosrespektimi I kontrates dypalëshe te lidhur. Pas saktesimit te vleres, nga sektori I finaces të marre masa ku të kryej konatbilizimin ku konkretisht te debitoje llog.423 ñPersoneli, paradhënie, deficite gjobaò si dhe të kreditoje llogari 4341 ñOperacione me shtetinò(Detyrime)

Titulli i Gjetjes 3	**Mosdhënia e inforA.Monit të plotë në pyetësorin me shënime shpjeguese për vitet 2019 - 2020 (Formati 5)**
Situata:	Nga auditimi rezultoi se, pyetësori dhe shënimet shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore (formati nr.5), për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, është i miratuar nga MFE dhe përbëhet nga 19 pika. Në inforA.Monin shpjegues për pasqyrat financiare të viteve 2019 dhe 2020, evidentohen mangësi në plotësimin e tyre si në vendosjen e përgjigjeve respektive ñpoò ose ñjoò, ashtu edhe në zbërthimin me analizë të llogarive përkatëse.
Kriteri :	Ligji nr. 9228 datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò i ndryshuar. Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò.
Ndikimi/Efekti	Mosrespektimi i standardeve kontabël.
Shkaku:	Mungesë veprimesh nga strukturat përgjegjëse.

Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Nga Sektori i Financës të merren masat që në vijimësi, pyetësori dhe shënimet shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore (formati nr.5), të përgatiten dhe paraqiten në përputhje me standardet kontabël kombëtare dhe ky seksion të plotësohet me të dhëna të sakta për elementë të ndryshme të raportimit financiar të njësisë.

3.5. MBI VLERËSIMIN E FUNKSIONIMIT TË SISTEMEVE TË MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT DHE VLERËSIMI I AUDITIMIT TË BRËNDSHËM

MBI VLERËSIMIN E FUNKSIONIMIT TË SISTEMEVE TË MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT

a. Vlerësimi i Mjedisit të Kontrollit
b. Vlerësimi i Menaxhimit të riskut
c. Vlerësimi i Aktiviteteve të Kontrollit.
ç.Informimi, Komunikimi
d. Monitorimi.

Nga auditimi i kryer në bazë të programit të auditimit nr. 528/1, datë 14.05.2021, mbi vlerësimin e funksionit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

A. Vlerësimi i Mjedisit të Kontrollit

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Titullarët e njësive të sektorit publik janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit. Mjedisi i kontrollit vlerësohet bazuar në komponentët si më poshtë.

1. *Integriteti personal dhe etika profesionale nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike*;

Titullari i njësisë publike dhe stafi duhet të udhëhiqen nga integriteti personal dhe profesional në marrjen e vendimeve dhe në kryerjen e detyrave të tyre.

Kodi i etikes në institucion është miratuar me urdhër të ministrit të MBZHR Nr.85, nr.1613/1 prot, datë 17.02.2020 ñPër miratimin e rregullores së Etikës”referuar përcaktimeve të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, në Kapitullin III, pika 3.1 përcakohtet se óKuadri i sjelljes së menaxherëve dhe stafit duhet të përcaktohen nga titullari i njësisë publike në një Kod të Brendshëm Etike, ose në një Kod Sjelljejeô. Gjithashtu, edhe në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, ñPër parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publikeò, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003, ñPër rregullat e etikës në administratën publikeò, intsitucionet duhet të hartojnë kod etike.

Gjithashtu në rregulloret e saj të brendshme konkretisht Rregullore Nr.1, nr 1984 prot, datë 27.02.2019 për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të MBZHR dhe Rregullore nr.4276 prot, datë 02.06.2021 për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të MBZHR kreu VIII, IX, X trajtohen çështjet lidhur me kodin e sjelljes dhe etiken personale dhe profesionale, gjithashtu në këto rregullore përcaktohen dhe qëllimet dhe detyrat e njësive organizative, marrëdhëniet ndërmjet tyre, çështjet e displines, delegimi i kompetencave e rregulla të tjera të përgjithshme.

Edhe pse këto dokumenta jane hartuar, referuar dokumentave të vena në dispozicion MBZHR nuk ka ndonjë procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etiken dhe për marrjen e masave si rrjedhojë e kësaj.

2) *politikat menaxheriale dhe stilin e punës;*

Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit reflektojnë pikëpamjet kryesore të drejtuesit rreth mënyrës se si duhen organizuar punonjësit dhe aktivitetet e një njësie. Qasja ndaj punës dhe ngritja e sistemeve, zakonisht paraqiten në një strategji institucionale.

Referuar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, neni 9 ñPërgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizuesò, pika 4, germa ñaò Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto përgjegjësi kryesore:
a) *propozimin te nëpunësi autorizues i njësisë publike të sistemit të rregullave dhe procedurave të brendshme të njësisë, të planeve strategjike dhe të objektivave afatmesëm dhe vjetorë, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre në njësi;*dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. IV ñZbatimi i MFKò, pika, 4.2.10 ñRoli i nëpunësit autorizues të njësisëò, germa a,Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka identifikuar vizionin, misionin, prioritetet strategjike dhe qëllimet në Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësinë 2014-2020 miratuar me VKM nr. 709, datë 29.10.2014 ñPër miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020ò, ndërsa objektivat janë të përcaktuara në PBA 2021-2023 dokumentimi i fazës teknike nr.8189 prot, 01.09.2020, gjithashtu ka hartuar plane pune dhe ka kryer analiza vjetore të veprimtarisë.
Referuar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 nenit 8, pika 8/b, përcaktohet se ó*Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore:* ***b)*** *ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike*ô. Në nenin 27 të këtij ligji përcaktohet se ó*Grupi për menaxhimin strategjik përbëhet nga titullari i njësisë publike, zëvendëstitullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë. Kreu i auditimit të brendshëm merr pjesë në mbledhjet e grupit për menaxhimin strategjik pa të drejtë vendimmarrjeje. Çështjet, që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, duhet të diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë publike. Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze që dalin brenda njësisë i parashtrohen grupit për menaxhimin strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave'*.
Me Urdhër të Ministrit të MBZHR Nr.110, nr 1312 prot, datë 06.02.2019 është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik në përputhje me përcaktimet e ligjiti i cili ka funksinuar deri në Gusht të 2020. Më 06.08.2020 me Urdhër të Ministrit të MBZHR nr.309, nr. 6365 prot, është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik i cili ka funksionuar deri në Shkurt të 2021 dhe me Urdhër nr,65 të Ministrit të MBZHR nr.1292prot datë 05.02.2021, është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik aktual.
Në Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 óPër përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publikeô, lidhur me rolin e GMS në sistemin e MFK, përcaktohet se ó*GMS duhet të mblidhet të paktën 4 herë në vit.Vendimet duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike'*. Për sa më sipër, për periudhën 2019, 2020 dhe tremujori i parë 2021 në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga <u>subjekti nuk rezulton që mbledhjet e kryera nga GMS të jenë sistematike e periodike në kundërshtim me përcaktimet e ligjit.</u> Për vitin 2019 në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton vetëm një Vendim i Grupit të Menaxhimit Strategjik per PBA 2020-2021 i cili është pa datë. Ndërsa për viti 2020 rezultojnë 3 vendime, Vendim i Grupit të Menaxhimit Strategjik per PBA 2021-2023 (shtator 2020), Vendimi i Grupit të Menaxhimit Strategjik Nr. Extra prot., datë 25.06.2020 për rishikimin e buxhetit 2020, dhe Vendimi i Grupit të Menaxhimit Strategjik Nr. Extra prot., datë 20.11.2020 për rishikimin e buxhetit 2021-2023.

3*) strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit;*
Për vitin 2019 dhe 2020 MBZHR ka funksionuar në zbatim të strukturës organizative, miratuar me urdhrin nr.109 datë 31.07.2018 me 163 punonjës.
Deri në fillim të vitit 2021 Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 150, datë 09.11.2020, me 174 punonjës. Në Janar të vitit 2021 me urdhrin e Kryeministrit nr. 39, datë 22.01.2021 është miratuar struktura e re e MBZHR me 174 punonjes gjithsej.
Për periudhen objekt auditimit, Ministria e Bujqësise dhe Zhvillimit Rural ka funksionuar në bazë të Rregullores Nr.1, nr1984 prot, datë 27.02.2019 për organizimin dhe fuksionimin e brendshëm

të MBZHR, dhe më pas me Rregulloren Nr. 4276 prot, datë 02.06.2021, e cila eshte miratuar 7 muaj me vone nga miratimi i ndryshimeve strukturore që kerkonin këtë përditësim të rregullores, kjo në kundërshtim me ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò i ndryshuar, neni 20.
Në institucion janë përcaktuar nëpunësi autorizues (NA) dhe ai zbatues (NZ), në përputhje me kërkesat e Nenit 12/1, ñPërgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatuesòtë ligjitnr.10296, datë 08. 07. 2010, të ndryshuar.
Me shkresën nr.1347/1 prot, është konfirmuar NA për Ministrine e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Z.E.H.
Rolin e Nëpunësit Zbatues e mban Z.A.V, drejtor i Financës së institucionit miratuar me shkresën 56002/2 prot datë 16.12.2013.

4) politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore;
Politikat e burimeve njerëzore dhe praktikat e ngjashme lidhen me rekrutimin, emërimin, trajnimin, vlerësimin e performancës, avancimin në detyrë dhe veprimet disiplinore. Ato përbëjnë një pjesë të rëndësishme të kontrollit të brendshëm.
Ne MBZHR , burimet njerezore menaxhohen nga Sektori i Burimeve Njerezore dhe Akiv-Protokollit. Ky Sektor mbulon ceshtjet qe kane te bejne me hartimin e strukturave, procedurat e rekrutimit, emerimeve lirimeve, procedurat disiplinore, administrimin e dosjeve te personelit, plotesimin e regjistrit qendror te personelit, pergatitjen e pershkrimeve te punes, vleresimet e rezultateve etj. Ky sektor bashkëpunon me Shkollën Shqipetare të Administrates Publike për trajnimet dhe kualifikimet e stafit.
Bëhen trajnime të vazhdueshme për ngritjen e nivelit profesional nga Shkolla e Administratës Publiket por konstatohet se për vitet objekt auditimi nuk ka patur një program strategjik dhe vjetor të trajnimeve të shpallur nga institucioni.

B. Menaxhimi i riskut.
Menaxhimi i riskut është procesi i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut. Pas planifikimit të fondeve buxhetore institucionit analizon dhe bën kontrollin e risqeve hap pas hapi të cilët mund të venë në rrezik realizimin e treguesve buxhetore dhe per kete MBZHR ka hartuar regjistrer te risqeve per disa drejtori, por procesi i menaxhimit të riskut nuk është i formalizuar në regjister i konsoliduar i risqeve per insitucionin i miratuar. Gjithashtu në kundërshtim me nenin 8, pika 8/a te ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, të ndryshuar, ku përcaktohet se ó*Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore:* ***a)*** *miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave*ô, dhe nenit 21, pika 2: ñMenaxhimi i riskutò: ku percaktohet : *"Për t'i zbatuar veprimtaritë e parashtruara në pikën 1 të këtij neni, titullari i njësisë publike, (ose duke deleguar këtë detyrë) miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet, ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut,* rezulton se në Ministrinë Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk është finalizuar hartimi i matricës dhe strategjisë së menaxhimit të riskut, e cila rezulton në mungesë të monitorimit të risqeve.

C.Aktivitetet e kontrollit.
Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synin arritjen e objektivave dhe të misionit të saj, që është hartimi, zbatimi dhe zbërthimi i strategjive dhe politikave të punëve të brendshme, në përputhje me programin politik të Qeverisë duke i shërbyer interesit publik me paanësi, duke zbatuar legjislacionin në fuqi, duke kryer shërbimet publike dhe duke hartuar e zbatuar politikat e përgjithshme shtetërore në fushën e punëve të brendshme. Proceset kryesore të punës dhe funksionet administrative e nenpunesit civil janë të shkruara në rregulloren e brendshme per organizimin dhe funksionimin e institucionit dhe në strukturën organike.

Nëpunësi autorizues në bazë të ligjit për buxhetin merr përsipër angazhimet për realizimin e programit buxhetor. Në funksion të kontrolleve parandaluese është kryer ndarja e detyrave, në lidhje me kryerjen e transaksioneve financiare, është përdorur sistemi me dy firma.
Në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, neni 16, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. III ñProcesi i implementimit të Menaxhimin Financiar dhe Kontrollitò, pika 3.2 ñCikli i MFK-seò, Hapi 5 ñGjurmët e auditimitò, janë ndërtuar hartat e proceseve të punës dhe gjurmet e auditimit për disa nga proceset kryesore të punës të sektorit të fiancës dhe buxhetit, por jo për strukturat e tjera.
Gjithashtu nga auditimi u konstatua se disa prej sistemeve të kontrollit të brendshëm nuk kanë funksionuar në harmoni me njeri- tjetrin, konkretisht:
(i) nuk janë koordinuar sistemet e kontrollit mbi monitorimin e kontratave me qera për tokat bujqësore në administrim të MBZHR për të cilat nga auditimi i pasqyrave financiare 2019 ï 2020 (llogaria 210) toka troje figurojnë në vlerën 0.
(ii) Drejtuesi i NjAB, njësi e cila ka varesi të drejtëpërdrejtë nga Ministri i MBZHR, në disa prej auditimeve të realizuara sipas Planit vjetor për vitin 2019 dhe 2020, nga Drejtori i Përgjithshëm janë miratuar Autorizime duke e përcaktuar në grup auditimi dhe si pasojë janë përfituara dieta në trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës në kundërshtim me ligjin nr 114/2015 ñPër Auditin e Brendshëmò Kreu IV, neni 10, pika 2, neni 14, neni 15 si dhe me me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò.

Ç. Informim komunikimi

Shkëmbimi i inforcionit realizohet ndërmjet punonjësve të institucionit si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht. Nepermjete Rregullores se Organizimit dhe Funksionimit të Brendshem të MBZHR, Rregullores së Etikes dhe përshkrimeve të punës punpnjesit njihen me rolin pergjegjesite dhe detytimet e tyre ne kete aspekt. Komunikimi i informacionit realizohet nëpërmjete shkresave zyrtate me institucionet e tjera, si dhe nëpërmjete emaileve zyrtare.
Titullari, Zv/titullaret si dhe Nëpunesi Autorizues sigurojnë informacionit periodik nga titullaret e programeve si dhe titullaret e njesive te varesise, raportimet rezultojne mujore, katermujore dhe vjetore dhe jane kryesisht te karakterit ekonomik financiar.
InforA.Moni dhe komunikimi lidhen gjithashtu edhe me teknologjinë e informacionit dhe zbatimin e rregullave të tyre për gjenerimin, përpunimin, përdorimin dhe ruajtjen e informacionit dhe në Ministrinë e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural rregullat e komunikimit të brendshëm dhe te jashtem percaktohen nga AKSHI.

D. Monitorimi

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të afrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë ngritur. Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen e një sistemi për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim vlerësimin lidhur me funksionimin e duhur dhe garantimin e përditësimit të tij, sa herë që ndryshojnë.
Me qëllim monitorimin e institucioneve të varësisë, në nenin 9 pika 3 e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, të ndryshuar.
Monitorimi i sistemit të MFK nga titullari mund të realizohet nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të kontrollit të brendshëm, sikurse paqaritet në Shtojcën 2 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Duke ju përgjigjur pyetjeve të pyetësorit të vetëvlerësimit, institucioni bën vlerësimin e zhvillimit të komponentëve të veçantë të kontrollit të brendshëm, ku çdo përgjigje me jo tregon se ka mangësi dhe duhen marrë masas për përmirësime. Për sa më sipër, për periudhën nën auditim, nga shqyrtimi i plotësimit të pyetësorëve të vetëvlerësimitrezulton se është plotësuar në zbatim tëformatit të miratuar pjesë e Manualit për MFK, aneksi 6 kërkesat e kapitullit V siç cilësohet në Kapitullin III, Hapi III, kreu ñProcesi i Implementimit të MFKò dhe kreun V, të Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e Titullarit të Financave nr. 54, datë 15.7.2010, i ndryshuar.

Në nenin 18 pika 1 e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, të ndryshuar. Për sa më sipër, Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural, në bazë të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, me ndryshime, ka hartuar deklaratën dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2019 dhe 2020 dhe një kopje i eshte dërguar, Ministrise së Financave dhe Ekonomisë. me shkresat nr. 2055/1, datë 28.02.2020 ñMbi pyetesorin e vetëvlerësimit të vitit 2019 për MBZHRò dhe nr. 1742/1, datë 26.02.2021 ñMbi raportimin vjetor të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe pyetesorin e vetëvlerësimit të vitit 2020 për MBZHRò. Per te gjithë vitet objekt aditimi këto dokumenta janë dërguar brenda afatit të caktuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 i cili është jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual. Për të realizuar kete detyrim, nëpunësi autorizues i njësisë publike ka zbatuar një sistem të brendshëm raportimi për të marrë informacion nga të gjitha njësitë e varësisë, për të mbështetur deklaratën, sipas ligjit.
Raportet janë hartuar në bazë të formatit të përshkruar në Shtojcën 2 të Udhëzimit të Titullarit të Financave nr. 28, datë 15.12.2011 dhe gjithashtu është hartuar plani i zhvillimit të sistemit të MFK për vitin 2020 dhe 2021.
Përveç monitorimit të vazhdueshëm titullari i MBZHR-së dhe nëpunësi autorizues përdor edhe auditimin e brendshëm të njësisë. MBZHR në përbërje të strukurës ka dhe Drejtorinë e Auditimit. Ligji për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik, garanton objektivitetin dhe pavarësinë e Sektorit të Aditimit të Brendshëm në MBZHR. Në bazë të ligjit dhe Urdhrave të Kryeministrit ñPër miratimin e strukturës dhe të organikës së MBZHRò, Drejtoria e Auditit varet dhe raporton direkt tek titullari i njësisë. Gjithashtu gjatë vititn 2020 ka funksionuar dhe Komiteti i Auditimit, anetaret e të cilit janë emeruar me Urdher te Ministrit te MBZHR Nr. 227, nr.2637/1 datë 29.03.2019. Gjatë auditimit është konstatuar se është hartuar gjurma e auditit e hartimit të programit buxhetor dhe e zbatimit të buxhetit, por jo për strukturat e tjera.

Në kuadër të monitorimit, rezulton të ketëproblematika në monitorimin e kontratave të dhënies me qira për tokat bujqësore si pasojë e mungesës së burimeve njerëzore që nuk janë planifikuar në strukturë, mangësi këto të cilat nuk janë pasqyruar në pyetësoret e vetëvlerësimit , dhe që duke mos monitoruar risqet vënë në rrezik arritjen e objektivave të njësisë.

Titulli i Gjetjes :	Mbi mos zbatimin e detyrimeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit
Situata:	Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti rezulton se mbledhjet e kryera nga GMS të jenë sistematike e periodike në kundërshtim me përcaktimet e ligjit. Ne MBZHR bëhen trajnime të vazhdueshme për ngritjen e nivelit profesional nga Shkolla e Administratës Publiket por konstatohet se për vitet objekt auditimi nuk ka patur një program strategjik dhe vjetor të trajnimeve të shpallur nga institucioni. MBZHR ka hartuar regjistrer te risqeve per disa drejtori, por procesi i menaxhimit të riskut nuk është i formalizuar në regjister i konsoliduar i risqeve per insitucionin i miratuar. Gjithashtu rezulton se në Ministrinë Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk është finalizuar hartimi i matricës dhe strategjisë së menaxhimit të riskut, e cila rezulton në mungesë të monitorimit të risqeve. Gjithashtu nga auditimi u konstatua se disa prej sistemeve të kontrollit të brendshëm nuk kanë funksionuar në harmoni me njeri- tjetrin.
Kriteri:	Neni 8, pika 8/a, neni 27, te ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, të ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	- Risk per mos rakordimin koordinim dhe bashkëpunimin midis hallkave - Mosnjohje të të gjithë stafit me çështjet e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. - Problematika në monitorimin e kontratave
Shkaku:	- Mungesa e burimeve njerezore - Mungesë e njohjes se thelle mbi menaxhimit financiar dhe kontrollin.

Rëndësia:	E Larte
Rekomandimi	1.Të merren masa që të hartohet një program strategjik dhe vjetor të trajnimeve. 2.Të merren masa që të formalizohet regjisteri i konsoliduar i risqeve per insitucionin dhe te miratohet.
Afati i zbatimit	Menjëherë dhe në vazhdimësi

VLERËSIMI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Planifikimi dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve, realizimi i programit vjetor të auditimit nga ana sasiore dhe analiza sipas llojeve dhe zbulimeve si dhe kapacitetet audituese të sektorit të auditimit.Ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara.Auditimi i përputhshmërisë me Ligji nr. 114/2015, dt. 22.10.2015 ñ*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".*

Grupi i audituesve të KLSH-së, për të realizuar objektin e auditimit, *u fokusua*, në auditimin e çështjeve të mëposhtme:

a) Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm. Niveli profesional i audituesve, certifikimi i tyre dhe trajnimet e detyrueshme

b) Bashkëpunimi me Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, niveli i raportimit në këtë drejtori

c) Realizimi i treguesve të planifikuar nga DAB

d) Sigurimi i brëndshëm i cilësisë së auditimit,

duke u mbështetur në përputhshmëri në bazën ligjore ,nënligjore dhe në standartet, konkretisht, në ligjin nr.114, datë 22.10.2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100 datë 25.10.2016, nëligjinnr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinòi ndryshuar, në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30 datë 27.12.2011 ñPër menazhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, si dhe çdo akt juridik që është në fuqi, që ka lidhje me auditimin e brendshëm të sektorit publik në Republikën e Shqipërisë.

Duke u bazuar, në objektin e auditit të brendshëm në njësitë publike, që është njëra nga tre shtyllat e kontrollit të brendshëm financiar publik (sipas standarteve ndërkombëtare të kontrollit të brendshëm Kuadri COSO dhe sipas Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit), i cili konsiderohet si një filtër i domosdoshëm për ti dhënë titullarit të njësisë publike, nivelin e sigurisë mbi saktësinë e aktivitetit ekonomiko financiar të njësisë shpenzuese të varësisë.

Kështu në këtë konteks, në MBZHR sipas strukturës së miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr.168, datë 05.10.2017 ñPër miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Ruralò i ndryshuar me Urdhër të KM nr.39 datë 22.01.2021,funksionon Njësia e Auditit të Brendshëm (Drejtoria e Auditit të Brendshëm) në varësi funksionale nga Titullari (Ministri) i MBZHR.

Pra,kryerja e auditimeve të plota/ të kombinuara ose tematike sipas planifikimit vjetor i përgjigjet ligjit nr.114, datë 22.10.2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò neni 1. Në këtë mënyrë njësia e auditimit të brendshëm angazhohet në shërbime të sigurisë së arsyeshme duke ofruar një vlerësim të pavarur të veprimtarisë ekonomiko ï financiare të institucionit. Ky shërbim karakterizohet nga pavarësia si një nga karakteristikat parësore të njësisë së auditimit të brendshëm në institucion me qëllim ofrimin paraprakisht të një sigurie të arsyeshme për ofrimin e këshillimit ndaj titullarit mbi mënyrën e menaxhimit, të institucionit që drejton.

Pretendimi i subjektit:

Lidhur me konstatimet e grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me bazën nënligjore keni cituar duke u mbështetur në përputhshmëri në bazën ligjore, nënligjore dhe ..... në *Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.12, datë 5.6.2012 "Për procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik".* **Auditimi i çështjeve mbështetur në këtë udhëzim të shfuqizuar është i pavlefshëm.** Bashkëlidhur ju vemë në dispozicion *Udhëzim nr.20, datë 17.10.2016.* Procedurat, metodologjia, rregullimi i veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik, vlerësohen nga data 1 shtator 2020, mbështetur edhe në ndryshimet e bëra. Bashkëlidhur ju vemë në dispozicion *Urdhrin nr.4, datë 10.1.2020.*

Qëndrimi i grupit të auditimit:
Përsa i përket observacionit të paraqitur nga NJAB nuk jemi mbështetur në asnjë moment të aktkonstatimit në urdhrin e shfuqizuar, por kemi cituar dhe si bazë ligjore *Udhëzimin nr.20, datë 17.10.2016 që* ka shfuqizuar *Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.12, datë 5.6.2012* dhe kemi theksuarçdo akt juridik që është në fuqi, që ka lidhje me auditimin e brendshëm të sektorit publik në Republikën e Shqipërisë.
Për sa më sipër ky observacion merret në konsideratë.

Për periudhën 2019, 2020 deri më 31.03.2021 veprimtaria e NJAB është kryer në zbatim të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, neni 12 germa ñçò dhe neni 14 gërma ñcò , Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100 datë 25.10.2016, Kapituilli III ñPlanifikimi i veprimtarive të Auditimit të Brendshëmò, Kapitulli II ñProgramimi i veprimtarive të Auditimit të Brendshëmò, pika 2.1 dhe 2.2, Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.12 datë 05.06.2012 ñPër procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publikò.
Përveç këtyre akteve, në punën audituese, ka shërbyer edhe legjislacioni në fuqi, sipas fushave objekt auditimi, si dhe manuale e metodika të tjera specifike.
Më poshtë po paraqesim, konstatimet për periudhën nën auditim;
a. Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm. Niveli profesional i audituesve, certifikimi i tyre dhe trajnimet e detyrueshme.
Nga auditimi u konstatua se, për periudhën 01.01.2019-31.03.2021 struktura organizative është miratuar nga Kryeministri me urdhrin nr. 168 datë 05.10.2017 ñPër miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Bujqësië dhe Zhvillimit Ruralò.
Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në MBZHR funksionon si drejtori, në përputhje me ligjin nr.114, datë 22.10.2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, VKM nr.83, datë 03.02.2016 ñ Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publikò .
NJAB e shtrin auditimin në aparatin e Ministrisë dhe në njësitë e varësisë së saj.
Gjatë periudhës nën auditim, janë realizuar auditime në institucionet e varësisë të MBZHR, në Agjensitë Rajonale ish Drejtoritë e Bujqësisë në rrethe, Drejtoritë Rajonale të Ujitjes dhe Kullimit, në Qëndrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore.

Njësia e Auditit të Brendshëm
Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në MBZHR ka këtë strukturë:

Drejtor	1
Specialist	4
Gjithsej	**5** punonjës

Për periudhën 01.01-08.02.2019 NJAB ka funksionuar me 3 specialistë dhe me drejtues të komanduar.
Për periudhën 08.02-31.12.2019 NJAB ka funksionuar me 3 specialistë dhe 1 drejtor, pra struktura nuk ka qënë e plotë me 4 specialistë dhe 1 drejtor.
Për periudhën 01.01.2020 e në vazhdim NJAB ka funksionuar e plotë.
Për periudhën 01.01.2019 deri më 08.02.2019 Drejtoresha e NJAB B.K është transferuar në lëvizje paralele në Drejtorinë e Prokurimeve në MBZHR. Z A.H është komanduar Drejtor i NJAB me shkresën nr 9356/1 datë 12.10.2018 të Ministrit të MBZHR.
Për periudhën 15.02.2021 deri më 31.03.2021 Drejtoresha e NJAB B.K është transferuar në pozicionin Drejtor në Drejtorinë e Auditimit në MB bazuar në shkresën nr 952 datë 17.02.2021 ñDërgim Urdhriò të Ministrit të Mbrojtjes. Z A.H është komanduar Drejtor i NJAB me shkresën nr 465/2 datë 15.02.2021 të Ministrit të MBZHR.
Të gjithë punonjësit e DAB janë diplomuar në ekonomik dhe administrim biznesi. Arsimi profesional i tyre është në përputhje me kriteret e përcaktuara me përshkrimet e vendeve të punës ekonomist finance, agrare, administrim biznesi, që aplikohet për strukturat e auditimit. Të gjithë punonjësit e kësaj Drejtorie janë çertifikuar si auditues të brendshëm.

Funksionimi i Komitetit të Auditimit të Brendshëm
Komiteti i Auditimit të Brendshëm dhe anëtarët e tij janë emëruar me Urdhër të Ministrit të MBZHR-së nr. 227, Nr.2637/1 prot, datë 29.03.2019 ñPër emërimin e anëtarëve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm në MBZHRò, me mandat dy vjeçar me të drejtë riemërimi dhe funksionon edhe për Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural dhe Autoritetin Kombëtar të Ushqimit Komiteti, të cilat kanë njësi auditimi. Komiteti i Auditimit të Brendshëm ka monitoruar dhe ofruar këshilla e rekomandime për Ministrin, në lidhje me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, dhe ka mbështetur Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në përmbushjen e përgjegjësive të saj. Nga data e emërimit të anëtarëve deri më 31.12.2019, Komiteti i Auditimit të Brendshëm ka zhvilluar 5 mbledhje dhe ka marrë 4 vendime.
Të gjithë punonjësit e auditimit të brendshëm, janë të çertifikuar si auditë të brendshëm dhe janë të pajisur me çertifikatë sigurie nga struktura përgjegjëse të MBZHR.
b) Bashkëpunimi me Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, niveli i raportimit në këtë drejtori.
Për periudhën objekt auditimi Plani strategjik dhe vjetor, janë hartuar nga DAB dhe pas miratimit nga Ministri i MBZHR është dërguar në afat pranë Njësisë Qendrore të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave.
Me urdhrin nr.8812/2 datë 19.10.2018 është miratuar nga Ministri, Plani strategjik i auditimit për periudhën 2019-2021 dhe plani vjetor i veprimtarisë së auditimit për vitin 2019.
Me urdhrin nr.7455/1 datë 18.10.2019 është miratuar nga Ministri, Plani strategjik i auditimit për periudhën 2020-2022 dhe plani vjetor i veprimtarisë së auditimit për vitin 2020.
Me urdhrin nr.7710/1 datë 16.10.2020 është miratuar nga Ministri Plani strategjik i auditimit për periudhën 2021-2023 dhe plani vjetor i veprimtarisë së auditimit për vitin 2021.
Gjatë zbatimit të planit, ka patur edhe shmangie (shtesa), kryesisht në drejtim të auditimit të zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme, por gjithmonë brenda planit vjetor të miratuar ose në rastet e urdhëruara nga Ministri. Gjatë periudhës objekt auditimi janë planifikuar për tu audituar segmente të vecanta pjesë e aparatit të MBZHR-së (Drejtoria e Peshkimit dhe Akuakulturës, Sektori IPA, IPARD-i) dhe një auditim tematik në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.
Për periudhën objekt auditimi, DAB duke respektuar afatet (brenda muajit Tetor të cdo viti kalendarik) e përcaktuara në Manualin e Auditimit, ka hartuar planin strategjik dhe atë vjetor dhe pas miratimit nga titullari i MM- së, e ka dërguar edhe në Njësinë Qendrore të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave.

Gjatë periudhës objekt auditmi Njësia Qendrore e Harmonizimit nuk ka kryer vlerësim të jashtëm të cilësisë së NJAB në MBZHR.
c) Realizimi i treguesve të planifikuar nga DAB
Plani strategjik i hartuar nga DAB, bën të mundur mbulimin e risqeve kryesore gjatë periudhës disa vjeçare (zakonisht 3 vjet), ku për hartimin e planit strategjik, D/AB ka plotësuar formularët standard si:
- Pyetësorë për planin strategjik
- Përmbledhje e risqeve të identifikuara;
- Identifikimi i sistemit për subjektet;
- Lidhja midis riskut dhe punës së planifikuar të auditimit;
- Pyetësorë vlerësimi për kontrollin e brendshëm, etj.

Në planin strategjik të përgatitur nga DAB, janë përfshirë;
1. Qëllimi dhe objektivat;
2. Prioritete, ku fokusohet veprimtaria e auditimit;
3. Llogaritja e burimeve të nevojshme për auditimin;
4. Kufizimet e auditimit;
5. Plani i përgatitjes profesionale të audituesve (trajnime);

Në planin vjetor të auditimeve përgatitur nga DAB, janë përfshirë;
1. Objektivat kryesore vjetore;
2. Përmbledhje e veprimtarisë për periudhën paraardhëse
3. Ndikimi i faktorëve në planifikimin e veprimtarisë
4. Lista e subjekteve dhe sistemeve për tu audituar
5. Risqet e mundshme që mund të ndikojnë në realizimin e programit vjetor;
6. Burimet e auditimit;
7. Kufizimet e mundshme të qëllimit të auditimit;
8. Kostot e auditimit.
9. Planifikimi i nevojave të stafit për trainim

Në planin strategjik, për periudhën objekt auditimi, është mbajtur parasysh, që subjekte apo sisteme që vlerësohen me një nivel të lartë risku, të jenë objekt i punës audituese, për afate më të shkurtra e më të shpeshta.

Për kryerjen e auditimeve nga DAB, në zbatim të manualit të auditimit dhe programit vjetor, miratuar nga ministri, janë përgatitur programet e auditimit, për çdo subjekt që auditohet.

Programet e auditimit përmbajnë;
- Objektin e auditimit;
- Subjektin e auditimi;
- Qëllimin e auditimit;
- Llojin e auditimit;
- Metodën dhe teknikën e auditimit;
- Periudhën e auditimit;
- Afatin;
- Drejtimet (çështjet) që do të auditohen;
- Bazën ligjore;
- Grupin e auditimit.

Drejtoria e AB, për vitin 2019-2020- mars 2021, ka planifikuar dhe realizuar:

Periudha	**Të planifikuara**	**Auditime të plota (të kombinuara)**	**Auditime të pjesshme**	**Të realizuara, gjithësej**	**Auditime të plota**	**Auditime të pjesshme**	**%**
2019	16	15	1	18	14	4	83 %
2020	16	14	2	20	16	4	125 %
03.2021	16	14	2	5	5	-	31 %

- Auditime të pjesshme
  2019, Planifikuar 1: Auditim Financiar Sektori IPA.
  Realizuar 4: Auditim Financiar Sektori IPA, 3 me kërkesë të Titullarit (Ministrit)
  2020, Plani 2: Auditim Financiar Sektori IPA, Zyra Komisionerit MDHP (marrëveshje).
  Realizuar 4: Sektori IPA, Komisioneri, 2 me kërkesë të Titullarit (Ministrit)
  2021, Plani 2: Auditim Financiar Sektori IPA, Zyra Komisionerit MDHP (marrëveshje).
  Realizuar në Dhjetor 2021.

- Për vitin 2021 realizimi 3 mujor është 5 subjekte nga 16 subjekte në Planin Vjetor, nga të cilat 3 janë raportuar tek Ministri me Memo dhe 2 janë raportuar në fillim të muajit Maj 2021.

Gjetje me efekte financiare.

Bazuar në gjetjet e rezultuara sipas auditimeve me bazë sistemi, për përmirësimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe të organizimit të kontrollit të brendshëm, për periudhën 2019 deri në 31.03.2021, janë dhënë rekomandime. Këto rekomandime janë pranuar nga strukturat e institucioneve të varësisë duke përcaktuar në afatet për realizimin e tyre, në ñlimitin kohorò *në vijimësi*

Rekomandimet janë dhënë sipas sistemeve si më poshtë:
- Sistemi i prokurimeve dhe blerjeve,
- Sistemiipagave,
- Sistemi i tatimeve, kontributeve shoqërore,
- Sistemi i administrimit dhe dokumentimit të materialeve,
- Sistemetëtjera,

Për vitin 2019 janë konstatuar ose zbuluar shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi të shoqëruar me efekte financiare për buxhetin e shtetit, gjithsej në shumën **19, 880 mijë lekë**, e konkretisht në:

- prokurime, blerje dhe investime: 0 lekë.
- paga, shpërblime 0 lekë.
- fondet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore 0 lekë.
- administrimin e tokave dhe pronave dhe pasurisë së MBZHR-së, **19, 880 mijë lekë** e cila përbëhet nga detyrimet pasqyruar në bilanc të 5 subjekteve (ISUV, ESHFF, AREB KO, DUK KO dhe DUK DR) të varësisë të trashëguara ndër vite, mungesë inventari të ish punonjësve, debitorë pa analiza, të paidentifikuar (adresa dhe dokumentacion), debitorë në administrimin e tokave me qira si më poshtë:

000/lekë

Nr.	**Subjektet**	**Shuma detyrimit**	**Sistemi**	**Natyra e detyrimit**
1	ISUV	727	Administrimit të tokave, pronave dhe pasurisë së MBZHR	Mungesa e inventarit nga 3 ish punonjës
2	ESHFF	19		Një subjekt arkëtuar më pak se tarifa e shërbimit
3	AREB Korcë	4 390		10 debitorë të trashëguar nga ish DB-të për administrimin e qerave dhe
4	DUK Korcë	2 394		Debitorë të trashëguar nga ish bordet pananaliza e dokumentacion të plotë
5	DUK Durrës	12 350		Debitorë të trashëguar nga ish bordet pananaliza e dokumentacion të plotë.
	Total	**19 880**		

Për vitin 2020 janë konstatuar ose zbuluar shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi të shoqëruar me efekte financiare për buxhetin e shtetit, gjithsej në shumën **2 982 mijë lekë**, e konkretisht në:

- prokurime, blerje dhe investime: 0 lekë.
- paga, shpërblime **30 mijë lekë** në dy subjekte: 12 mijë lekë në QTTB Shkodër, 18 mijë lekë në QTTB Vlorë si rezultat i dhënies pagë më tepër për 4 ish punonjës.
- fondet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore,0 lekë.
- administrimin e tokave dhe pronave dhe pasurisë së MBZHR-së, **2 952 mijë lekë** në dy subjekte: 1 511 mijë lekë në QTTB Vlorë, mungesë inventari nga 2 ish punonjës dhe 1 441 mijë lekë në AREB Lushnjë debitorë nga dhënia me qira e tokave bujqësore trashëguar nga ish DB-të.

Rekomandime të dhëna.

Për vitin 2019 janë dhënë gjithsej, 398 rekomandime. Të ndarë:
- për përmirësimin e sistemeve 155
- për përmirësimin e kuadrit ligjor 23.
- të karakterit organizativ 146.
- për arkëtime të dëmeve të shkaktuara buxhetit të shtetit 66.
- rekomandime të tjera 8.

Për vitin 2020 janë dhënë gjithsej, 306 rekomandime. Të ndarë:
- për përmirësimin e sistemeve (të pagesave, etj.), 103 .
- për përmirësimin e kuadrit ligjor 12.

- të karakterit organizativ 169.
- për arkëtime të dëmeve të shkaktuara buxhetit të shtetit 8.
- rekomandime të tjera (administrimin e aktiveve, etj.) 14 rekomandime.

Zbatimi i Rekomandimeve.

Shkalla e zbatimit të rekomandimeve deri në mbyllje të periudhës së raportimit, për periudhën 2019 ï mars 2021, paraqitet si më poshtë:

Periudha	Të rekomanduara	Të pranuara	Të zbatuara	Të pazbatuara	Realizimi %
2019	398	398	334	64	83.9 %
2020	306	306	228	112	74.5 %
Mars 2021	101	101	32	101	31.7 %

Inventarizimi dhe arkivimi i dosjeve.

Nga shqyrtimi me përzgjedhje rastësore i dosjeve të auditimit, u konstatua se të gjitha dosjet e evaduar nuk janë të arkivuara. Kjo bie në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154 ñ*Për Arkivat*ò, kreu VI ñ***Dorëzimi i dokumenteve në arkivat shtetërorë***ò, Neni 42 pika 1. ñ *Dokumentet arkivore, me mbarimin e afatit të shërbimit operativ pranë arkivave të institucioneve fondkrijuese, dorëzohen nga këta të fundit për ruajtje dhe administrim në arkivat shtetërorë*ò , në përputhje me nenin 9 shkronja ç) ñ *arkivat shtetërorë të sistemit, që funksionojnë në mënyrë të përhershme pranë institucioneve qendrore fondkrijuese;të këtij ligji, të sistemuara dhe të inventarizuara, sipas rregullave të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave*ò .

Pasi fushat prioritare janë përcaktuar dhe risqet janë identifikuar dhe vlerësuar. NjAB ka programuar dhe zhvilluar veprimtarinë e auditimit sipas strategjisë së auditimit të miratuar më parë. Në pjesën e përgjithshme të planit strategjik, përfshihet specifikimi i llojit të auditimit, numri i angazhimeve të auditimit për periudhën që do të auditohet, vlerësohet koha e mjaftueshme për kryerjen e çdo angazhimi auditimi.

d)Sigurimi i brendshëm i cilësisë

Sigurimi i brendshëm i cilësisë gjatë punës audituese është planifikuar nga ana e drejtorit të Drejtorisë të Auditimit të Brendshëm në përputhje me Manualin e Auditit të Brendshëm. Përvitet objekt auditimi Drejtori i NJAB ka planifikuar që **sigurimi i brendshëm i cilësisë** gjatë punës në terren deri në përfundimin e raportimit tek titullari i subjektit të audituar dhe Ministri do tërealizohet brenda drejtorisë, simëposhtë: a) *" nga një auditues I cili nuk ka marrë pjesë në angazhimin e auditimit, nuk ka qënë pjesë e grupit të auditimit. Drejtoria punon gjithnjë me dy grupe auditimi me nga dy auditues secili grup. Kështu auditi i një grupi kontrollon materialet e grupit tjetër".*

Në dosjet e sipërcituara nuk ka asnjë gjurmë të sigurimit të brendshëm të cilësisë të realizuar nga auditues brenda drejtorisë që nuk kanë qenë pjesë e grupit të auditimit. Vlerësimi i brendshëm i cilësisë është bërë nga përgjegjësi i grupit të auditimit dhe drejtori i NJAB.

Sigurimi i brendshëm i cilësisë është realizuar nga përgjegjësi i grupit të auditimit dhe nga Drejtori i NJAB pas përfundimit të punës në terren, pas raportimit tek titullari i subjektit të audituar dhe Ministri, për realizimin e angazhimit të auditimit të brendshëm në subjektin përkatës.

Para dërgimit të Raport Përfundimtarit të auditimit, në dosjet e audituara nuk ka gjurmë të kontrollit të cilësisë, në zbatim të kërkesave të Manualit të AB. Kontrolli i cilësisë është kryer, duke evidentuar dhe sqaruar gjetjet dhe rekomandimet mbas përgatitjes së raportit përfundimtar të auditimit. Procedura e vlerësimit të cilësisë, mbulojnë aspekte të veprimtarisë së DAB, duke përfshirë objektivin, vlerësimin e riskut, planifikimin dhe zbatimin e angazhimeve, raportimi dhe trajnimin, etj.

Pretendimi i subjektit:

Lidhur me konstatimet e grupit të auditimit të KLSH-së:

Drejtori ka planifikuar sigurimin e brendshëm të cilësisë nga puna në terren deri në përfundim të raportimit tek titullari i subjektit të audituar dhe Ministri të realizuar brenda drejtorisë, duke përcaktuar si përgjegjës grupi në

auditime punonjësin më të vjetër në profesion. Në të gjitha dosjet e auditimit ndodhet jo vetëm formulari i sigurimit të brendshëm të cilësisë i realizuar nga përgjegjësi i grupit të auditimit i cili ka edhe vjetërsi pune më shumë në auditim dhe nga Drejtori i DAB, por edhe formulari i evadimit të auditimit, formulari standard nr.14.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Përsa i përket observacioneve të paraqitura nga Drejtori i NJAB planifikimi i sigurimit të brendshëm të cilësisë është bërë në disa mynyra. Duke pasur parasysh kapacitetet audituese të drejtorisë mund të jetë e pamundur që sigurimi i brendshëm i cilësisë të realizohet në mynyrën e sipërcituar në aktkonstatim planifikuar nga Drejtori i NJAB (*nga një auditues i cili nuk ka marrë pjesë në angazhimin e auditimit, nuk ka qënë pjesë e grupit të auditimit*). Nëse sigurimi i brendshëm i cilësisë nuk mund të kryhet në formën e sipërcituar të meret parasysh në të ardhmen në hartimin e planeve strategjike vjetore të auditimit.

Për sa më sipër ky observacion merret pjesërisht në konsideratë.

e)Nga auditimi me përzgjedhje i dosjeve të auditimit në zbatim të planit të auditimit miratuar nga Ministri i MBZHR-së për vitet 2019-2020, në lidhje mbi përfitimet financiare (dieta, shpenzime udhëtimi, shpenzime hoteli) për anetarët e grupeve të auditimit pjesë e DAB.

(1)Në zbatim të Planit të auditimit për vitin 2019 me shkresë nr.7436/1 datë 11.10.2018 është planifikuar Programi i auditimit i DUK Lezhë për periudhën e auditimit 01.01.2016 deri më 31.12.2018, të miratuara nga Ministri i MBZHR-së.

Grupi i auditimit i miratuar nga Titullari i MBZHR, me përbërje (audites F.N përgjegjës grupi, A.H, L.G anëtarë). Në Memon drejtuar Drejtorit të NJAB datë 28.12.2018 anëtarët e grupit të auditimit F.N përgjegjës grupi dhe L.G audituese dërgojnë informacion lidhur me fillimin e auditimit në DUK Lezhë mbi bazë të planifikimit paraprak nga Drejtori i NJAB. Në dosjen e auditimit ñDUKò Lezhë, Autorizimi për fillim auditimi është lëshuar në 14.12.2018 me nr. 1330, me përgjegjës grupi F.N dhe anëtar A.H dhe L.G, firmosur nga drejtori i komanduar A.H.

Nga auditimi u konstatua se, në detyrimet financiare (dieta, shpenzime udhëtimi, shpenzime hoteli), me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm A.M me nr. prot 1330/2 datë 11.02.2019 është shtuar në përbërjen e grupit të auditimit Zj. B.K, duke përfituar në trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës.

Argumentimi i dhënë nga DP z.A.M, në bazë të shkresës nr. prot 1330/2 datë 11.02.2019, shprehet se ñ*Zj B.K me detyrë Drejtor i DAB është dërguar me shërbim për organizimin e angazhimit të auditimit sipas standarteve dhe metodologjisë së miratuar, takim me subjektin, realizimin e takimit përmbyllës dhe kryerjen e auditimit nga datat 11.02.2019 deri në 22.02.2019"*, por në bazë të auditimit të dosjes fizike, znj. B.K nuk figuron Autorizim Shtesë nga Titullari i MBZHR si dhe në ndarjen e detyrave në faqen 35 të dosjes gjatë punës së auditimit të ñDUKò Lezhë si dhe takimi përmbyllës <u>nuk mund të zgjasë 10 ditë</u>.

Pretendimi i subjektit:

Lidhur me konstatimet e grupit të auditimit të KLSH-së:

Plani Vjetor 2019 i auditimit është miratuar me shkresë nr. 7436/1, datë 11.10.2018 nga Ministri i MBZHR-së, nuk ka Program auditimi të DUK Lezhë për periudhën e auditimit 1.1.2016 deri më 31.12.2018, të miratuar nga Ministri me shkresën nr. 7436/1, datë 11.10.2018. Keni trajtuar me dy standarte rastin e pjesmarrjes në auditimin e DUK Lezhë të drejtorit B.K me drejtorin A.H i komanduar në këtë detyrë.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Në shkresën me nr rendor 1 të dosjes së auditimit DUK Lezhë drejtuar drejtorit të komanduar A.H audituesjaFilloretaNikaj shkruan se për kryerjen e auditimit janë caktuar Znj F.N, znj. L.G dhe z.A.H i ngarkuar me detyrën e Drejtorit të komanduar, mbështetur në planin e auditimit të brendshëm miratuar me shkresë nr. 7436/1, datë 11.10.2018 nga Ministri i MBZHR-së. Në auditimin e DUK Lezhë nuk kemi të bëjmë me dy standarte pasi Z A.H është planifikuar në auditim në periudhën që ka qenë audites i thjeshtë dhe jo drejtor i komanduar.

Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

(2)Në zbatim të Planit të auditimit për vitin 2020 me shkresë nr.7455/1 datë 18.10.2019 është planifikuar auditimi i ñARSHVMBò Vlorë, për periudhën 01.09.2019 deri më 30.06.2020, të miratuara nga Ministri i MBZHR-së.
Grupi i auditimit i miratuar nga Titullari i MBZHR, me përbërje (auditues F.N përgjegjës grupi dhe L.G anëtare). Në Memon drejtuar Drejtorit të NJAB datë 29.06.2020, jepet informacion lidhur me fillimin e auditimit në njësinë e varësisë mbi bazë të planifikimit paraprak nga Drejtori i NJAB . Në dosjen e auditimit ñARSHVMBò Vlorë, Autorizimi për fillim auditimi është lëshuar në 29.06.2020 me nr. 4912 firmosur nga Drejtori i NJAB B.K, me grup auditues F.N përgjegjës grupi dhe L.G anëtare.
Nga auditimi u konstatua se, në detyrimet financiare (dieta, shpenzime udhëtimi, shpenzime hoteli), me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm A.M me nr.prot 1412/1 datë 06.07.2019 është shtuar në përbërjen e grupit të auditimit Zj. B.K, duke përfituar në trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, e cila në bazë të auditimit të dosjes fizike, znj. B.K nuk figuron Autorizim Shtesë nga Titullari i MBZHR si dhe zj. B.K nuk ka nënshkruar deklaratë të pavarësisë dhe as nuk figuron në programin e auditimit, ndarjen e detyrave gjatë punës së auditimit të ñARSHVMBò Vlorë.
(3)Në zbatim të Planit të auditimit për vitin 2020 me shkresë nr.7455/1 datë 18.10.2019 është planifikuar auditimi i ñQTTBò Shkodër ,për periudhën 01.01.2018 deri më 31.12.2019, të miratuara nga Ministri i MBZHR-së.
Grupi i auditimit i miratuar nga Titullari i MBZHR, me përbërje (A.H përgjegjës grupi, dhe Reshit Haka anëtar). Në Memon drejtuar Drejtorit të NJAB datë 24.01.2020, jepet informacion lidhur me fillimin e auditimit në njësinë e varësisë mbi bazë të planifikimit paraprak nga Drejtori i NJAB. Në dosjen e auditimit ñQTTBò Shkodër, Autorizimi për fillim auditimi është lëshuar në 24.01.2020 me nr. 680 firmosur nga Drejtori i NJAB B.K, me grup auditues A.H përgjegjës grupi, dhe Reshit Haka anëtar.
Nga auditimi u konstatua se, në detyrimet financiare (dieta, shpenzime udhëtimi, shpenzime hoteli), me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm A.M me nr.prot 680/1 datë 31.01.2020 është shtuar në përbërjen e grupit të auditimit Zj. B.K, duke përfituar në trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, e cila në bazë të auditimit të dosjes fizike, znj. B.K nuk figuron Autorizim Shtesë nga Titullari i MBZHR si dhe zj. B.K nuk ka nënshkruar deklaratë të pavarësisë dhe as nuk figuron në programin e auditimit, ndarjen e detyrave gjatë punës së auditimit të ñQTTBò Shkodër.
(4) Në zbatim të Planit të auditimit për vitin 2020 me shkresë nr.7455/1 datë 18.10.2019 është planifikuar auditimi i ñDUKò Korçë, për periudhën 01.05.2019 deri më 31.10.2020, të miratuara nga Ministri i MBZHR-së.
Grupi i auditimit i miratuar nga Titullari i MBZHR, me përbërje (F.N përgjegjës grupi dhe L.G anëtare).Në Memon drejtuar Drejtorit të NJAB datë 05.10.2020, jepet informacion lidhur me fillimin e auditimit në njësinë e varësisë mbi bazë të planifikimit paraprak nga Drejtori i NJAB . Në dosjen e auditimit ñDUKò Korçë, Autorizimi për fillim auditimi është lëshuar në 05.10.2020 me nr. 7848 firmosur nga Drejtori i NJAB B.K, me grup auditues F.N përgjegjës grupi dhe L.G anëtare.
Nga auditimi u konstatua se, në detyrimet financiare (dieta, shpenzime udhëtimi, shpenzime hoteli), me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm A.M me nr.prot 7847/1 datë 16.10.2020 është shtuar në përbërjen e grupit të auditimit Zj. B.K, duke përfituar në trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, e cila në bazë të auditimit të dosjes fizike, znj. B.K nuk figuron Autorizim Shtesë nga Titullari i MBZHR si dhe zj. B.K nuk ka nënshkruar deklaratë të pavarësisë dhe as nuk figuron në programin e auditimit, ndarjen e detyrave gjatë punës së auditimit të ñDUKò Korçë.
Gjithashtu nga auditimi u konstatua se, Deklaratën e pavarësisë e ka nënshkruar z. L.K i me Autorizim shtesë nga Ministri i MBZHR nr 92 prot 1804, datë 21.02.2020, i caktuar në përputhshmëri, si përgjegjës për përmbushjen e kushteve të kontratës, supervizionit, kolaudimit

dhe marrjes në dorëzim të punimeve dhe projekteve të zbatimit për mirëmbajtjen e kanaleve ujitëse e kulluese në ñDUKò Korcë.
(5)Në zbatim të Planit të auditimit për vitin 2020 me shkresë nr.7455/1 datë 18.10.2019 është planifikuar auditimi i ñDUKò Fier, për periudhën 01.04.2019 deri më 30.08.2020, të miratuara nga Ministri i MBZHR-së.
Grupi i auditimit i miratuar nga Titullari i MBZHR, me përbërje (F.N përgjegjës grupi dhe L.G anëtare). Në Memon drejtuar Drejtorit të NJAB datë 14.09.2020 nr.7193, jepet informacion lidhur me fillimin e auditimit në njësinë e varësisë mbi bazë të planifikimit paraprak nga Drejtori i NJAB . Në dosjen e auditimit ñDUKò Fier, Autorizimi për fillim auditimi është lëshuar në 18.09.2020 me nr. 7193/1 firmosur nga Drejtori i NJAB B.K, me grup auditues F.N përgjegjës grupi dhe L.G anëtare.
Nga auditimi u konstatua se, në detyrimet financiare (dieta, shpenzime udhëtimi, shpenzime hoteli), me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm A.M me nr.prot 7193/2 datë 18.09.2020 është shtuar në përbërjen e grupit të auditimit Zj. B.K, duke përfituar në trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, e cila në bazë të auditimit të dosjes fizike, znj. B.K nuk figuron Autorizim Shtesë nga Titullari i MBZHR si dhe zj. B.K nuk ka nënshkruar deklaratë të pavarësisë dhe as nuk figuron në programin e auditimit, ndarjen e detyrave gjatë punës së auditimit të ñDUKò Fier.

Në lidhje me këto konstatime u mbajt Akt konstatimi nr.9 mbi vlerësimin e auditit të brendshëm, protokolluar në MBZHR me nr.5467 prot, datë 26.07.2021.
Grupi i auditimit pasi i shqyrtoi observimet e paraqitura me nr 5467/1, datë 30.07.2021 dhe observimet me shkresë nr.3501/3 prot datë 21.12.2021, të cilat janë të njëjta në përmbajtje midis njëri tjetrit, për rrjedhojë grupi i auditimit mban këtë qëndrim si më poshtë vijon.

Pretendimi i subjektit:
Lidhur me konstatimet e grupit të auditimit të KLSH-së:
Autorizimi është nga DP z. A.M pasi me Urdhëri të Ministrit të MBZHR nr. 570, nr. 7975 Prot, datë 16.10.2019 për ñ*Miratimin e Autorizimeve për Shërbimin Brenda Vendit*ò ka urdhëruar Z.A.M në cilësinë e Drejtuesit të Programit Buxhetor të firmosë autorizimet, planin e lëvizjes së punonjësve që dërgohen më shërbim jashtë qendrës së punës. Refruar argumentimit të paraqitur në Autorizimin nr. 1330/2 prot, Zj B.K me detyrë Drejtor i DAB është dërguar me shërbim për organizimin e angazhimit të auditimit sipas standarteve dhe metodologjisë së miratuar, takimin fillestar me subjektin, realizimin e takimit përmbyllës dhe kryerjen e auditimit nga datat 11.2.2019 deri në 22.2.2019ò. Tregohet që nuk është vetëm për takim përmbyllës. Në dosjen fizike të auditimitznj. B.K nuk është ndarjen e detyrave në faqen 35 të dosjes, pasi ky formular është për grupin e auditimit dhe jo për rolin monitorues të drejtorit.
Bashkëlidhur observacionit janë memoinvestiguese për çdo subjekt që auditohet, takim fillestar, takim përfundimtar, memo të firmosura nga subjekti, Drejtoresha e DAB dhe grupi i auditimit. Jeni shprehur në dosjen fizike zonja B.K nuk ka nënshkruar deklaratë pavarësie dhe as nuk figuron në programin e auditimit, ndarjen e detyrave, pasi ky formular është për grupin e auditimit dhe jo për rolin monitorues të drejtorit. Drejtuesi i njësisë së auditimit është përgjegjës për: a) organizimin e angazhimeve të auditimit të brendshëm, angazhimet e auditimit të kryer gjatë periudhës së raportuar. Nuk ka bazë ligjore që përjashton dhe vendos afat kohor për prezencën e Drejtoreshës në Institucionin që auditohet. Drejtuesi i DAB është monitories për të dy grupet e auditimit dhe shkon sa herë është e nevojshme në subjektet që auditohen, detyrë e përcaktuar në ligjin për AB

Qëndrimi i grupit të auditimit:
Sqarojmë se Urdhëri i Ministrit të MBZHR nr. 570, nr. 7975 Prot, datë 16.10.2019 për ñ*Miratimin e Autorizimeve për Shërbimin Brenda Vendit*ò ka urdhëruar Z.A.M në cilësinë e Drejtuesit të Programit Buxhetor të firmosë autorizimet, planin e lëvizjes së punonjësve që dërgohen më shërbim jashtë qendrës së punës, por jo të autorizojë punonjës të pa planifikuar. Refruar argumentimit të paraqitur në Autorizimin ZNJ. B.K me cilësinë Drejtor i DAB nuk mund të kryejë apo planifikohet nga Z. A.M për auditime në terren. Prezenca e Drejtorit të NJAB në mynyrë të vazhdueshme vetëm në rolin fizik monitorues të audituesve rrit në mynyrë fiktive koston e auditimit pa prodhuar asnjë benefit në punën e audituesve. Sqarojmë se është detyrë e Drejtorit të NJAB të sigurojë se burimet e auditimit të brendshëm janë të shpërndara në mënyrë efektive dhe jo e kundërta.

Për sa më sipër ky observacion nuk merret në konsideratë.

Titulli i Gjetjes 1:	**Sigurimi i brendshëm i cilësisë**
Situata:	Sigurimi i brendshëm i cilësisë gjatë punës audituese është planifikuar nga ana e drejtorit të Drejtorisë të Auditimit të Brendshëm. Për vitet objekt auditimi, nga titullari i NJAB, është parashikuar që sigurimi i cilësisë, të realizohet nga një tjetër anëtar i njësisë, i cili nuk është pjesë e auditimit. Nga auditimi u konstatua se, nuk është zbatuar kriteri i mësipërm, pasi në të gjitha dosjet fizike të audituara , u konstua që sigrimi i cilësisë është realizuar nga pjestarë të grupit të auditimit, në konflikt të interesit.
Kriteri:	Manuali i Auditit të Brendshëm, 2016
Ndikimi/Efekti:	Vlerësimi i brendshëm i cilësisë është bërë nga përgjegjësi i grupit të auditimit dhe drejtori i NJAB pjesë e grupit të auditimit.
Shkaku:	Moskordinimi ndërmjet audituesve që kryejnë dhe atyre që sigurojnë cilësine e auditimit brenda Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandime	Me qëllim respektimin e rregullave të parashikuara, NjAB duhet të përmbushë detyrimet ligjore për sigurimin e gjurmës së auditit të brendshëm të cilësisë, në mënyrë për të bërë të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, për MBZHR dhe njësive të varësisë.

Titulli i Gjetjes 2:	**Autorizimit për të përfituar trajtim financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës**
Situata:	Njësia e Auditit të brendshëm (Drejtoria e Auditit të Brendshëm) është strukturë në varësi të plotë të titullarit (Ministrit) të MBZHR, i cili ka të drejtën e krijimit/ndryshimit të grupeve të auditimit të krijuara në bazë të Planit të Auditimeve vjetore planifikuar nga drejtuesi i NJAB, në përputhje me Ligjin nr 114/2015 ñPër Auditin e Brendshëmò Kreu IV, neni 10, pika 2 ñNjAB është e pavarur funksionalisht dhe raporton në mënyrë të drejtëpërdrejtë tek titullari i njësisë publikeò. Për rrjedhojë Autorizimet, për përfituar në trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës,të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm z. A.M janë në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò.
Kriteri:	Ligjin nr 114/2015 ñPër Auditin e Brendshëmò Kreu IV, neni 10, pika 2 ñNjAB është e pavarur funksionalisht dhe raporton në mënyrë të drejtëpërdrejtë tek titullari i njësisë publikeò.
Ndikimi/Efekti:	Nga ndryshimi i grupeve të auditimit pa autorizim të Ministrit kemi një rritje në kostot e auditimit me 606,430 lekë. Kjo shumë është një rritje artificiale e kostos në auditim për shkak të traitimit financiar të Drejtorit të NJAB me autorizim nga Drejtori i Përgjithshëm z. A.M.
Shkaku:	Mungesa e autorizimit të Ministrit të MBZHR-së për të ndryshuar grupet e auditimit të planifikuar në planin vjetor nga Drejtori i Auditit të Brendshëm
Rëndësia:	I Lartë
Rekomandime	Njësia e Auditimit të Brendshëm duhet të kryejë auditime vetëm mbi bazën e planit të auditimeve vjetore planifikuar nga drejtuesi i NJAB. Të drejtën e shtimit/ndryshimit të grupeve të auditimit e ka vetëm titullari (Ministrit) i MBZHR-së.

Titulli i Gjetjes 3:	**Kryerja në terren e auditimeve nga drejtuesi i NJAB**
Situata:	Pjesëmarrja e drejtuesit të NJAB si anëtar grupit në terren gjatë periudhës së auditimit, në kryerjen një ose disa pikave të auditimit bie në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò Kreu V ñ *Të drejtat dhe përgjegjësitë e audituesve të brendshëm*ò neni 14, ñ*Përgjegjësitë e drejtuesit të NJAB*ò, pikat a;b;c; ç ,d dhe dh. *Drejtuesi i NJAB angazhohet në organizimin e angazhimeve, hartimin e Kartës së Auditimit, hartimin dhe zbatimin e planit strategjik e vjetor, përgatitjen e raportit vjetor, angazhimet e auditimit të kryer gjatë periudhës së raportuar, shmangiet nga plani, vlerësimin e sistemeve të kontrollit, veprimet e ndërmarra nga titullari i njësisë publike për zbatimin e rekomandimeve dhe raportimin tek titullari i*

	njësisë publike sipas pikave të sipërcituara (a,b,c, ç dhe d) nëligjin nr. 114/2015 për auditimin e brendshëm. Janë audituesit e brendshëm të NJAB që në përputhje me ligjin nr. 114/2015 për auditimin e brendshëm në sektorin publik KREU V ñ *Të drejtat dhe përgjegjësitë e audituesve të brendshëm*ò NENI 15, ò, **pikat a;b;c; ç; d dhe dh***kanë të drejtat të kryejnë auditime në mënyrë të pavarur, gjetjes së fakteve apo rasteve gjatë kryerjes së auditimit apo të lidhur me të, të ruajnë dokumentet për çdo angazhim auditimi të kryer, të japin rekomandime për njësinë e audituar për përmirësimin e veprimtarisë, efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe për masat që duhen ndërmarrë në rastet e konstatimit të dëmeve ekonomike e financiare për zhdëmtimin e tyre dhe për të ulur mundësinë e përsëritjes sipas pikave të sipërcituara (a,b,c, ç d dhe dh) nëligjin nr. 114/2015 për auditimin e brendshëm*ò.
Kriteri:	Ligji nr. 114/2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò Kreu V ñ *Të drejtat dhe përgjegjësitë e audituesve të brendshëm*ò , neni 14, ñ*Përgjegjësitë e drejtuesit të NJAB*ò
Ndikimi/Efekti:	Nga pjesëmarrja në auditim e Drejtorit të NJAB me risk të mesëm e të ulët pa autorizim përkatës kemi një rritje në kostot e auditimit me 606,430 lekë. Kjo shumë është një rritje artificiale e kostos në auditim për shkak të traitimit financiar të Drejtorit të NJAB, ku në asnjë rast nuk është konsideruar raporti kosto/benefit.
Shkaku:	Mungesa e analizës së riskut në pjesëmarrjen e Drejtorit të NJAB në grupet e auditimit
Rëndësia:	I lartë
Rekomandime	Njësia e Auditimit të Brendshëm duhet të marrë masa për hartimin e planeve vjetore të auditimit në bazë të analizës së riskut. Pjesëmarrja e Drejtorit të NJAB në terren të jetë e justifikuar me autorizim të Ministrit të MBZHR-së në bazë të analizës së riskut me qëllim auditimin e zonave me risk më të lartë parregullsish dhe problematikash.

Titulli i gjetjes 4:	**Mos Inventarizim i Dosjeve të Auditimit për vitn 2019,2020 deri 31.03.2021**
Situata:	Nga auditimi me përzgjedhje i dosjeve te auditmit për periudhën objekt auditimit në të gjithë rastet, dosjet nuk janë të arkivuara, por janë mbajtur në zyrat e specialistes së auditimit të institucionit. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 ñPër arkivatò, si dhe ñNorma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisëò, neni 13
Kriteri:	Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 ñPër arkivatò, si dhe ñNorma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisëò, neni 13
Ndikimi/Efekti:	Mos dokumentim fizik i dosjeve të auditimit
Shkaku:	Mos inventarizim i dosjeve të auditimit
Rëndësia:	E Ulët
Rekomandimi:	Nga MBZHR, të merren masa për kryerjen e inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Gjetje nga auditimi: Në kontratën nr.2548 prot., me nr.115 rep, nr.68 kol, datë 24.03.2015 lidhur midis subjektit ñ*A.M.*ò dhe ish-Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave sot (Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural), me objekt për ngritjen e kompleksit blegtoral dhe ndërtimin e fabrikës së përpunimit të qumështit në tokë bujqësore, duke parashikuar **veprimtari blegtorale** si dhe në kontratën nr.2711 prot, nr.827 rep, nr. 679 kol, datë 31.03.2017 lidhur midis subjektit ñ*P.*ò dhe MBZHR, me objekt për dhënien e tokës bujqësore me qira, për kultivimin e bimëve farogjere për sigurimin dhe **plotësimin e nevojave për ushqim të blegtorisë dhe krijimin e një ferme blegtorale** për mbarështrimin e gjedhit për mish. Për kontratat e mësipërme janë parashikuar veprimtari blegtorale, ndonëse në aktin nënligjor të aplikuar të kohës,

të VKM nr.460, datë 22.5.2013ñPër përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar, nuk parashikon veprimtari blegtorale, në referim të kreu VI ñAfatet e dhënies me qira të tokaveò pika 1, shprehet se, tokat jepen me qira për veprimtari bujqësore.
Ky fakt juridik është në kundërshtim me ligjin nr.8318 datë 01.04.1998 ñPër dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetëroreò i ndryshuar, neni 8, mbi të cilin është miratuar VKM nr.460, datë 22.5.2013, i ndryshuar me VKM nr.373 datë 20.06.2018 ñPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò, i ndryshuar me VKM nr.487 datë 17.06.2020 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.373 datë 20.06.2018 të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e kriterevetë rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò, të cilat në përmbajtjen e tyre kreu IV, pika 8, nënpika (b, d,dh) dhe kreu VI pika1, nuk janë shprehur për veprimtari për prodhim blegtoral.
Ligji nr.8318 datë 01.04.1998 ñPër dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetëroreò i ndryshuar, neni 8,shprehet se:
(1).deri në 10 vjet për kontratat e qirasë afatshkurtër, ku përfshihen veprimtaritë për **prodhimin e bimëve të arave** dhe eterovajore.
(2).deri në 30 vjet për kontratat e qirasë afatmesëm, ku **përfshihen veprimtaritë për prodhimin blegtorial**, për prodhimin e fidanëve, mjediset e mbrojtura dhe pyjet e ulëta (cungishte).
(3).deri në 99 vjet për kontratat e qirasë afatgjatë, ku përfshihen veprimtaritë për turizëm, rekreacion, pyll i lartë dhe pemët frutore.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 50-52 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si ministri përgjegjëse të marrë masa në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave, për përmirësimin e VKM nr.373 datë 20.06.2018 të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e kriterevetë rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò, në përputhshmëri me kërkesat e ligjit nr.8318 datë 01.04.1998 ñPër dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetëroreò i ndryshuar, me qëllim për caktimin e drejtë dhe të saktë, të objekteve të kontratave të qiradhënies së tokës bujqësore, duke garantuar zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimin rural në të gjitha dimesionet.

Menjëherë dhe në vijimësi

MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, llog **Llog.210** ñTokaTroje, Terenò paraqitet në kontabilitet në vlerën 0 lekë. VKM nr. 995, datë 9.12.2015,òVKM nr.45, datë 29.01.2014 si dhe VKM nr.142, datë 24.2.2016 ñPër kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujëraveò fondi i tokës bujqësore në pronësi të shtetit në përgjegjësi administrimi të MBZHR është 19,033.95 Ha. Për periudhën objekt auditimi është dhënë me qira sipërfaqja prej 714.35 Ha të cilat nga ana se sektorit të monitorimeve është kryer regjistrimit i tyre ne hipotekë. Nga auditimi u konstatua se nuk janë kontabilizuar asnjë nga tokat të cilat MBZHR ka në përdorim, apo tokave të cilat MBZHR ka dhëne me qera. Kjo çështje për grupin e auditimit është konsideruar materiale, pasi në llog.210 ñToka,Troje,Terrenò duhet të ishte kontabilizuar, pas regjistrimit të tokës bujqësore të dhënë me qira, në hipotekë, i cili bëhet nga vetë punonjësit e sektorit të financës, si dhe duke ju referuar zonës kadestrale dhe VKM nr. 89, datë 3.2.2016, ñ*Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë" përcaktohet vlera e secilës nga tokave të cilat MBZHR ka në përdorim.*
-Për periudhën objekt auditimi është kryer regjistrimi i pronësisë dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme në inventarin e shtetit sipas kërkesave të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 ñPër inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e

qeverisjes vendoreò, i ndryshuar). Është regjistruar pasuria në Zyrën e Kadastrës Shtetërore, në bazë të përcaktimeve të ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 ñPër pasuritë e paluajtshme shtetëroreò, i ndryshuar si dhe ligjit nr. 33/2010 ñPër regjistrimin e pasurive të paluajtshmeò.
Por nga auditimi u konstatua se sipërfaqet e trojeve në llog nr.210 si dhe vlerat e tyre për periudhën objekt auditimi, nuk janë regjistruar në bilancin kontabël dhe janë evidentuar për vleftën 0 lekë. Sipërfaqja totale e tokës që ka MBZHR në dispozicion nuk është vlerësuar dhe nuk është pasqyruar në kontabilitet. Për sa sipër, nuk ka gjetur zbatim pika 3.3 ñRregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar (bilanci)ò , paragrafi 62, dhe paragrafi 91, të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 108-139 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

1.1Rekomandimi: Titullari i Institucionit të marrë masa për ngritje e grupit të punës me qëllim vlerësimin dhe saktësimin e vlerës së aktiveve afatgjata jo materiale ñToka troje terrenò, në administrim të institucionit MBZHR. Nga Drejtoria e Buxhetimit dhe Menaxhimit Financiar (Sektori i Financës) të merren masa për të kontabilizuar dhe paraqitur në pasqyrat financiare vlerën e drejtë të Aktiveve Afatgjata Materiale, menjëherë pas përfundimit të procesit të vlerësimit nga grupi i punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2Rekomandimi: Titullari i Institucionit të ngrejë një grup pune për të pasqyruar dinamikën dhe lëvizjet e aktiveve afatgjata materiale, të ndërtojë gjurmën e auditimit të këtyre pasurive, duke saktësuar dhe administruar dokumentacionin e nevojshëm, dhe mbi këtë bazë të ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore dhe të aplikohet për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të institucionit. Të ngrihet një grup pune me qëllim identifikimin me planimetri dhe genplane të sipërfaqes së tokës truall që i përket institucionit dhe pas përllogaritjes së vlerave nga ekspertët e fushës, të ndërmerren veprimet e nevojshme të regjistrimit të saj në kontabilitet, duke evidentuar situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit dhe në pajtueshmëri me legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, Llog.486 ñShpenzime te periudhave të ardhshme për vitin 2019 & 2020 është 0 lekë. Për vitin 2019 sektori i financës ka likuiduar ish-punonjësit bazuar në vendimet gjyqësore në vlerën 23,180 mijë lekë dhe për vitin 2020 janë likuiduar në vlerën 13,170 mijë lekë. Ky detyrim edhe pse i njohur prej sektorit të financës, nuk kontabilizohet por planifikohet vetëm në PBA, duke mos pasqyruar kështu në mënyre të saktë dhe të drejt llog përkatëse në kundërshtim me pikën 42 të Udhëzimit nr. 8, datë 9.3.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò
- Llog.423 ñPersoneli, paradhënie, deficite gjobaò paraqitet në bilanc në vlerën 0 lekë, nga ku u konstatua se nuk janë kontabilizuar gjobat/kamat vonesat të cilat janë vënë përfituesve të tokave prej mos likuidimit të qerase fikse mujore në afatin e përcaktuar të cilën kanë detyrim ligjor ta paguajnë çdo muaj sipas kontratës së lidhur midis MBZHR dhe përfituesit. Gjeneza e disa prej këtyre gjobave është që prej vitit 2013.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 108-139 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetimit dhe Menaxhimit Financiar (Sektori i Financës) të marrë masa ku për të gjitha vendimet gjyqësore, të evidentojnë veçmas në pasqyrat financiare vjetore zërin e detyrimeve të prapambetur ñpër vendimet gjyqësore ku konkretisht të debitoje llogarinë përkatëse 486 ñShpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambeturaò si dhe te Kreditohet llogaria përkatëse 467 ñKreditorë të ndryshëmò.

Titullari i Institucionit të marrë masa ku të ngrejë një grup pune për saktësimin dhe vërtetimin e të gjithë kamatëvonesave/gjobave të cilat kane ardhur si rezultat i mos likuidimeve apo gjobave të marra nga mosrespektimi i kontratës dypalëshe të lidhur. Pas saktësimit të vlerës, nga sektori i financës të marren masa ku të kryhet konatbilizimi ku konkretisht, të debitohet llog.423 ñPersoneli, paradhënie, deficite gjobaò si dhe të kreditohet llog. 4341 ñOperacione me shtetinò(Detyrime).

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, pyetësori dhe shënimet shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore (formati nr.5), për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, është i miratuar nga MFE dhe përbëhet nga 19 pika. Në inforA.Monin shpjegues për pasqyrat financiare të viteve 2018 dhe 2019, evidentohen mangësi në plotësimin e tyre, si në vendosjen e përgjigjeve respektive ñpoò ose ñjoò, ashtu edhe në zbërthimin me analizë të llogarive përkatëse, në kundërshtim me UMF nr.8 datë 09.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 108-130 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Nga Sektori i Financës të merren masat që në vijimësi, pyetësori dhe shënimet shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore (formati nr.5), të përgatiten dhe paraqiten në përputhje me standardet kontabël kombëtare dhe ky seksion të plotësohet me të dhëna të sakta për elementë të ndryshme të raportimit financiar të njësisë.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në lidhje mbi respektimin e strukturave në MBZHR për periudhën 01.01.2019 deri më 30.03.201, u konstatua se, aparati i Ministrisë së Bujqësisë ka pësuar ndryshime në strukturë dhe organikë, në bazë të:
(1) Urdhërit të Kryeministritnr.109, datë 31.07.2018 ñ*Për disa ndryshime në urdhërin nr.168 datë 05.10.2017 të kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe organikës së MZHBR*ò me numër total të strukturës plan 163 punonjës, ndërsa fakti në fillim të vitit 2019 rezultoi me 136 punonjës, me diferencë prej 27 vende vakande, nga të cilat 16 vënde për nëpunës civil dhe 11 vënde me kod pune. Deri në fund të vitit 2020 në dhjetor, numri i vakancave ka pësuar ulje në 17 vënde vakante nga të cilat 9 vënde për nëpunës civil dhe 8 vënde me kod pune. Në zbatim të Urdhërit të Kryeministritnr.109, datë 31.07.2018, Ministri i MBZHR, ka miratuar urdhërin me nr.324/1 datë 25.09.2018 ñPër miratimin rregullores së strukturës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Ruralò
(2) Urdhërit të Kryeministrit nr.150,datë 05.11.2020 ñ*Për miratimin e strukturës dhe organikës së MZHBR*ò numri total i strukturës plan u bë 174 punonjës. Ky ndryshim në strukturë është kërkuar nga Ministri i MBZHR në bazë të Relacionit me shkresë nr. 7892/1, datë 06.10.2020
(3) Urdhërit të Kryeministrit nr.162, datë 14.12.2020 ñ*Për disa ndryshime në urdhërin nr.150 të kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe organikës së MZHBR*ò, ku nuk ka ndryshim të numrit total të strukturës plan 174 punonjës, por ka vetëm ndryshime në emërtimin e disa sektorëve.
Gjithashtu, sipas Urdhërit nr.39 të Ministrit të MBZHR-së, datë 22.01.2021, në zbatim të urdhërit nr.150 të Kryeministrit, datë 09.11.2020 ñ*Për miratimin e strukturës dhe organikës së MBZHR*ò është miratuar struktura plan e MBZHR-së, me numër total plan 174 punonjës në aparatin e MBZHR-së, ndër kohë që struktura fakt deri në Mars të vitit 2021 ka qenë 142 punonjës, duke rezultuar 32 vënde vakante, nga të cilat 26 vënde për nëpunësit civil dhe 6 vënde me Kod Pune.
Kjo është edhe struktura plan që ka Aparati i MBZHR-së deri më datën 31.03.2021.
Nga sa më sipër, ndonëse kemi rritje të numrit në plan të punonjësve të aparatit të MBZHR, kemi vakanca gati prej 20% të pozicioneve të vendeve të punës, të cilat konsistojnë më shumë në nivel specialist, i cili është tregues jo pozitiv për funksionimin me kapacitet të plotë të MBZHR, për pasojë mund të sjellë performancë të dobët të institucionit në realizimin e objektivave në lidhje me

faktin që sistemi bujqësor dhe zhvillimi rural, mbetet një nga sektorët me potencialin më të madh të zhvillimit në Shqipëri.
Vlen të përmëndet që nga ana e Sektorit të Burimeve Njerzore të MBZHR-së janë bërë shpallje për plotësimin e vakancave si në sistemin e HRMIS (Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore) për të kaluar më pas në sistemin online të rekrutimit, në platformën administrata.al. Por gjithashtu vlen të theksohet se nuk është gjetur një bashkëpunim institucional me Departamentin e Administratës Publike dhe mekanizmat e nevojshëm për zgjidhjen e këtij problem.
Pra është përgjegjësi e strukturave përgjegjëse të aparatit të MBZHR-së për gjetjen e mekanizmave të nëvojshëm për rekrutimin dhe plotësimin e këtyre vakancave.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 20-23 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: MBZHR të mbajë një korespondencë të vazhdueshme dhe më e shpeshtë me Departamentin e Administratës Publike si dhe të gjënden mekanizmat e nevojshmeme qëllim që të kryhet rekrutimi i personelit dhe si rrjedhojë minimizimi i vakancave për të arritur një kapacitet sa më të plotë në personelin e Aparatit të MBZHR-së.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve/Sektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, i dërgon Drejtorisë se Buxhetit dhe Menaxhimit financiar vendimet gjyqësore vetëm në rastin ku ato janë për likuidim. Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore Aseteve dhe Shërbimeve/Sektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, nuk informon në vazhdimësi Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit financiar për të gjitha vendimet gjyqësore, duke penguar:
-Për çështjet që kanë kaluar shkallën e dytë të procesit të apelimit, krijimin e provizioneve nga drejtoria e financës dhe buxhetit për vendimet gjyqësore si ngjarje të ndodhura, t^y cilat sjellin një probabilitet që do të ketë një detyrim për tâu paguar nga ana e njësisë, me qëllim njohjen e tyre në kontabilitet dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare vjetore të njësisë, në përputhje me Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 ñProcedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësinë e qeverisjes së përgjithshmeò, kapitull III pika 34. Pra Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve/Sektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, i dërgon Drejtorisë se Buxhetit dhe Menaxhimit financiar vendimet gjyqësore vetëm në rastin ku ato janë për likuidim dhe nuk informon në vazhdimësi Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit financiar për të gjitha vendimet gjyqësore për kryerjen e një planifikimi të shpenzimeve;
-Për vendime të formës së prerë, buxhetimin e saktë dhe të besueshëm për këtë zë shpenzimesh me qëllim shmangien e detyrimeve të akumuluara, por dhe të pagesave të tarifave përmbarimore si pasojë e mosekzekutimit vullnetar të vendimeve, në përputhje me VKM nr.50, datë 05.02.2014 ñPër miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimitò dhe Udhëzimin nr.1, datë 04.06.2014 ñPër mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit.ò
(Trajtuar më hollësisht në faqet 28-33 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve/Sektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, në cdo rast të mbajë databazën e ecurisë së proceseve gjyqësore e cila gjithashtu duhet tâi vendoset në dispozicion sektorit të financës për qëllime provigjionimi përgjatë hartimit të pasqyrave financiare.
- MBZHR, gjate vitit buxhetor, nëprëmjet sektorëve përkatës të marr masa për mbajtjen e database-s së vendimeve gjyqësore të formës së prerë që parashikojnë detyrime monetare, si dhe për shumat e detyrimeve, shuma totale e të cilëve duhet të bëhet pjesë e procesit të programimit buxhetor të vitit të ardhshëm, sipas përcaktimeve të akteve ligjorë e nënligjorë përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me përzgjedhje i dokumentacionit për shpenzimet e udhëtimit dhe dietave për periudhën objekt auditimi, u konstatua se në disa raste nuk është evidentuar qëllimi i shërbimit, dhe mungon dokumentacioni justifikues bashkangjitur pavarësisht se këto shërbime janë kryer me autorizim të Drejtorit të Pergjithshem z.A.M, të cilit i është deleguar kjo e drejtë në bazë të Urdhërave të Ministrit të MBZHR Urdhëri nr.570 datë 16.10.2019, me shkresë nr.7975 prot dhe Urdhëri nr.7 datë 07.01.2021.
Kështu në bazë të autorizimeve të Drejtorit të Përgjithshëm është shtuar përbërja e grupit të auditimit duke u shtuar në trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punëszj. B.K e cila ka pozicionin e Drejtor i Drejtorisë së Auditit të Brëndshsëm. Ndërkohë Drejtoria e Auditimit në MBZHR është në varësi direkte dhe vihet në lëvizje vëtëm me urdhër të Ministrit. Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm z.A.M për të shtuar përbërjen e grupeve të auditimit bie në kundërshtim me rregulloren e brëndshme të institucionit me nr 1984/1 datë 10.10.2019 dhe me Kreun IV, neni 10, pika 2 e Ligjit nr 114/2015 për Auditin e Brendshëm ñ NJAB është e pavarur funksionalisht dhe raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë tek titullari i njësisë publikeò si dhe pagesat janë në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 ñPër trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, Brenda venditò, i ndryshuar, kreu V, pika 2, dhe Udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2011, ñPër menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publikò, i ndryshuar, Kreu III, pika 36.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 39-50 të Projekt Raportit të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Nënpunësi autorizues/i deleguar i MBZHR në bashkëpunim me sektorin e financës të marrë masa që për çdo udhëtim të verifikohet paraprakisht ligjshmëria përpara dhënies së autorizimit të personave përkatës. Gjithashtu pasi të jepet autorizimi, të bashkëlidhen kërkesat e argumentuara nga personi përgjegjes, ku të citohet data e kërkesës, arsyeja e lëvizjeve të kërkuara si dhe ditët e qëndrimit.
Sektori i financës të marrë masa që pas plotësimit të dokumentave justifikuese të cilat argumentojnë në mënyrë shkresore lëvizjet e punonjësve, të kryhet likuidimi i tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, për vitin 2020 nuk janë finalizuar procedurat e inventarizimit, duke mos pasuar më tej me procesin e asgjësimit për aktivet që nuk kanë destinacion tjetër. Nga ana e komisionit të ngarkuar me kryerjen e inventarizimit fizik si dhe vlerësimin për nxjerrje jashtë përdorimit, janë evidentuar aktive të qëndrueshme, aktive qarkulluese e gjendje inventari që janë jashtë funksionit, për të cilat është bërë dhe regjistrimi përkatës por jo përfundimtar pasi Rezultoi se, nuk ka një vendimmarrje nga ana e menaxhimit, mbi masat që duhën marrë për aktivet te cilat janë vlerësuar për tu nxjerr jashtë përdorimit.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 38-42 të Projekt Raportit të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Insititucioni, të ndjek hapat e mëtejshëm bazuar në konkluzionet e grupeve te inventarizimit për procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese si dhe referuar urdhrit të ngritur nga titullari të hartojne dhe miratojnë procesverbalin për dhënien në përdorim/ tjetërsimin/asgjesim të aktiveve të vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimit, duke bërë të mundur kështu përfundimin e procesit te invetarizimit si dhe heqjen nga kontabiliteti, referuar masave te cilat do merren per aktivet e vlerësuara për tu nxjerr jashtë përdorimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.Gjetje nga auditimi: Sipërfaqet e tokës bujqësore të dhëna me qira janë siguruar në mbështetje të Vendimeve të Këshillit të Ministrave si vijon:
(i)VKM nr.995, datë 9.12.2015 ñPër kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të sipërfaqes së tokës bujqësore prej 926.55 Ha, në pronësi shtetërore, dhënë në përdorim Komunave Buçimas, Çërravë dhe Udenisht

dhe për disa ndryshime në Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.244, datë 4.4.2012, nr.417, datë 8.6.2011 dhe nr.534, datë 1.5.2008ò ka kaluar në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së toka bujqësore në pronësi të shtetit me *sipërfaqe 926,55 Ha.*
(ii)VKM nr.45, datë 29.01.2014 ñPër kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërrmarjeve bujqësore dhe institucioneve kërkimore shkencore të kësaj ministrie aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronaveò, pika 1, ka kaluar në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së toka bujqësore në pronësi të shtetit me *sipërfaqe 18,076 Ha.*
(iii)VKM nr.142, datë 24.2.2016 ñPër kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Uëjrave të sipërfaqes së tokës bujqësore, në pronësi të shtetërore, në fshatin Vojnik, Njësia Administrative Maqellarë, Bashkia Dibërò ka kaluar në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së toka bujqësore në pronësi të shtetit me *sipërfaqe 31,4 Ha,* pasuria nr.2/17, Zona Kadastrale 3811.
Gjithashtu nga fondi i disponueshëm i tokave në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së, është kaluar sipërfaqa prej 617,68 ha nën administrim të AIDA-s, për zhvillimin e investimeve strategjike të programuara.
Nga auditimi u konstatua se, sipërfaqja e fondit të tokës bujqësore në pronësi të shtetit në përgjegjësi administrimi të MBZHR është 19,033.95 ha, ku për periudhën në auditim është dhënë me qira sipërfaqja 714 ha e 3,484m^2, ndërsa në total për periudhën 2013-2021 është dhënë me qira sipërfaqja 2,519 ha e 7,366 m^2, e cila është rregjistruar pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (AKSH), në momentin kur kanë filluar procedurat e dhënies me qira të tokës bujqësore nga MBZHR. Sipërfaqja e lirë e disponueshme në përgjegjësi administrimi të MBZHR-së, për tû dhënë me qira është 15,896 ha e 5, 334 m^2, duke konstatuar se, gjendja juridike është e pa rregjistruar pranë AKSH, duke rritur riskun e tjetërsimit të pronave bujqësore, nga palë të treta.
Gjithashtu, u konstatua se fondi i tokës bujqësore shtetërore disponibël, i dhënë në bazë të VKM-së nr. 45/2014, nuk është shoqëruar me një kopje të listës së inventarit për pasuritë, të njehësuar me origjinalin, si pjesë e kësaj VKM, ndonëse nga MBZHR me shkresë nr.7254 prot datë 24.09.2019, i është kërkuar Këshillit të Ministrave por nuk ka pasur asnjë përgjigje në lidhje mbi këtë kërkesë. Në kushtet kur lista e inventarit të ngastrave që do të jepen me qira ka munguar dhe vijon të mungojë, duke dalë e paqartë se si strukturat përgjegjëse për administrimin e tokave bujqësore në MBZHR, bëjnë shpalljen publike dhe përditësimin e saj, sikundër dikton VKM nr. 373 datë 20.6.2018 ñPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitòi ndryshuar.
Kjo situatë është e mbartur në vite në Ministrinë e Bujqësië dhe nga struktura përgjegjëse të saj, nuk është ndërmarrë asnjë masë për rregjistrimin e sipërfaqes në pronësi.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 50-52 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

8.1 Rekomandim: Nga ana e MBZHR të merren masa, për verifikimin dhe hartimin e një regjistri të plotë dhe të saktë, ku të evidentohet gjithë fondi i tokës bujqësore që i ka kaluar në administrim MBZHR, duke bashkëpunuar dhe koordinuar midis institucioneve dhe organeve kompetente shtetërore, konkretisht me Këshillin e Ministrave dhe Drejtoritë Rajonale të Administrimit të Tokave në Qarqe, për të verifikuar dhe saktësuar sipërfaqet e tokave në administrim të MBZHR-së.

Menjëherë

8.2 Rekomandim: Nga ana e MBZHR të merren masa, për rregjistrimin e fondit të tokës bujqësore që është në administrimin të saj, në bazë të bashkëpunimit dhe koordinimit me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, duke negociuar mbi kostot e vlerave të regjistrimit, dhe duke marrë masa për të planifikuar në buxhetin vjetor të MBZHR-së, fonde të dedikuara për të finalizuar procesin e rregjistrimit të tokave bujqësore.

Deri 31 dhjetor 2022

9. Gjetje nga auditimi: MBZHR, për periudhën në auditim, në mbështetje të VKM nr.373, datë

20.06.2018 ñPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe të kontratës TIP për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar, ka lidhur **11 kontrata,** të cilat u audituan në lidhje mbi përcaktimin e kritereve, mbi përllogaritjen e vlerës së çmimit të qirasë së tokës bujqësore, mbi përzgjedhjen e subjektit qiramarrës, si dhe ecurinë e monitorimit të kontratës deri më 31.03.2021.
Gjithashtu, për periudhën nga viti 2013 deri në fund të vitit 2018, janë lidhur **40 kontrata** në mbështetje të VKM-së nr.460, datë 22.5.2013 ñPër përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò ndryshuar, me VKM nr.373, datë 20.06.2018, nga të cilat 11 kontrata prej tyre u përzgjodhën për auditim për fazën e ecurisë së monitorimit të kontratës.
Në bazë të Urdhërave të Kryeministrit nr.168, datë 05.10.2017 ñPër miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Ruralò i ndryshuar me Urdhër të Kryeministrit nr.39 datë 22.01.2021, ku sipas rregulloreve të brëndshme të miratuara nga titullari i MBZHR me urdhërat nr.324/1 datë 25.09.2018 ñPër miratimin e strukturës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Ruralò dhe nr.4276 prot datë 02.06.2021, është Sektori i Bashkëfinancimit, Partneriteteve dhe Monitorimit të Kontratave me përbërje (1 shef sektori dhe 3 specialistë) pranë Drejtorisë së Prokurimeve dhe Partneriteteve, përgjegjës për monitorimin dhe mbajtjen e regjistrit të kontratave të qerasë dhe ecurinë e up date të tyre, në përbushje të detyrave funksionale.
Kjo strukturë nuk ka funksionuar asnjëherë me staf të plotë me burime njërëzore për shkak të mos rekrutimit të punonjësve nga ana e DAP si dhe punonjësit e pakët e këtij sektori, përtej kryerjes së detyrave funksionale, janë përfshirë rast pas rasti nga titullari i MBZHR (Ministri), duke marrë pjesë edhe në:
(1) grupet të vlerësimit në terren, të tokës bujësore që jepet me qira, me detyrë, verifikimin e gjendjes faktike të sipërfaqes së tokës bujqesore, verifikimin e gjendjes së infrastrukturës ujitëse dhe kulluese te saj, distancën nga tregjet, nivelin e industrisë agropërpunuese, si dhe shkallën e zhvillimit të infrastrukturës rrugore të zonës;
(2) grupet e përllogaritjes së vlerës së çmimit të qerasë vjetore për tokën që jepet me qira, me detyrë, përcaktimin e shkallës së bonitetit të tokës me qëllim përcaktimin e qerasë fillestare minimale, mbivlerën e të cilës shtohen (në %) dhe komponentë të tjerë[8].
Kështu,vendosja në grupe të ndryshme të punonjësve të sektorit, për propozimin, miratimin, monitorimin, në të njëjtën kohë, nuk është në përputhshmëri, sipas kërkesave që dikton ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar.
Nga auditimi, në lidhje mbi punën e monitorimit të kontratave nga sektori bashkëfinancimit, partneriteteve dhe monitorimit të kontratave, për periudhën e audituar, u konstatua se;
- deri në në fund të vitit 2019, ka realizuar 8 monitorime, nga 40 kontrata në fuqi (ose monitoruara rreth 20 % të kontratave) ;
-përgjatë vitit 2020, ka realizuar 6 monitorime nga 50 kontrata ne fuqi (ose monitoruara rreth 12% të kontratave);
-përgjatë 3 mujorit të parë të vitit 2021, nuk ka realizuar asnjë monitorim nga 51 kontrata.
Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, edhe një strukturë ndihmëse, Sekretariati Teknik i Komisionit Qeveritar të Tokës, nuk funksionon prej datës 31.12.2019, për shkak të shfuqizimit të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008 ñPër shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokënò, i ndryshuar.
Pra si përfundim, struktura përgjegjëse e vetme (sektori i bashkëfinancimit, partneriteteve dhe monitorimit të kontratave) për monitorimin e kontratave të qirasë të tokës bujqësore, nuk është me kapacitet të plotë me burime njërëzore si dhe vendosja e punonjësve të pakët nga ana e titullarit të MBZHR, në disa procese pune në të njëjtën kohë, për vlerësimin e tokës në terren, përllogaritjen e vlerës së çmimit të qerasë vjetore , për hartimin e kontratës së qirasë si dhe

[8] 1. Gjendja e infrastruktures ujitëse dhe kulluese te saj,
2. Distanca nga tregjet (pika grumbullimi, tregjeve te zonave urbane)
3. Shkallen e e zvillimit të infrastruktures rrugore të zonës
4. Distanca nga sipërmarrjet agro-përpunuese(të produkteve bujqesore ose blegtorale)

monitorimin e tyre, nuk ka bërë të mundur të kemi efektivitet të plotë të monitorimit të ecurisë së kontratave të qirasë të tokave bujqësore, kjo në kundërshtim me detyrimin që parashikon VKM nr.373 datë 20.6.2018 ñPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò kreu VII ñMonitorimi i kontrataveò, pika 5 si dhe me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 53-108 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

9.1Rekomandim:
-MBZHR, të vlerësojë me kujdes burimet njerëzore të disponueshme në funksion të detyrave që lidhen me administrimin e tokës bujqësore, nga pikëpamja sasiore (numër punonjësish në raport me kontratat, subjekt monitorimi) dhe nga pikëpamja e ekspertizës, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike.
-Nga titullari i MBZHR, për realizimin e procedurës së dhënies me qira të tokës bujqësore, të vendosë në grupet e punës persona, në mënyrë të tillë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, dhe kontrollin, sipas kërkesave që dikton ligji nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i miratimit dhe monitorimit të kontratave, të cilat janë dhënë, mbi bazën nënligjore, konkretisht me VKM nr.460, datë 22.5.2013ñPër përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar, u konstatua se, ka mospërputhje midis vlerës së investimit parashikuar në plan biznes, paraqitur gjatë fazës së procedurës së dhënies me qira, me vlerën e investimit të paraqitur në kontratën e qirasë, duke rezultuar më e ulët. Ky fakt cënon procesin e dhënies me qira, gjatë të cilit është pretenduar nga subjekti, për vlerë më të madhe të investimit si dhe lidhja e këtyre kontratave është në kundërshtim me bazën nënligjore të aplikuar të kohës, më konkretisht si vijon:
1.Subjekti ñÇ" shpk dhe Ministria e Bujqesisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave kanë lidhur kontratë nr.1001 prot, nr.396 rep, nr.369 kol, datë 05.02.2016, rezultoi se, investimi i parashikuar në plan biznes është në vlerën 154,286,259 leke, ndërsa në në kontratë ky investim paraqitet 120,900,000 lekë (ose 33,386,259 lekë më e ulët).
2.Shoqëria "A. L. I. A." shpk dhe ish-MBUMK (Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit) kanë lidhur kontratë nr.3819 prot datë 16.09.2013, rezultoi se, investimi i parashikuar në plan biznes është në vlerën 3,155,883 Euro (ose 442,770,385 lekë) ndërsa në kontratë kjo vlerë është 272,303,322 lekë (ose 170,467,063 lekë më ulët).
3.Shoqëria ñP.Iò shpk dhe ish-MBUMK (Ministria e Bujqesisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit) kanë lidhur kontratë nr.3620/1 prot datë 06.09.2013, rezultoi se, investimi i parashikuar në plan biznes është me vlerë 351,036,645 lekë ndërsa në kontratë kjo vlerë është 146,459,808 lekë (ose 204,576,837 lekë më e ulët).
4.Subjekti ñA.M.ò dhe Ministria e Bujqesisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave kanë lidhur kontratë nr nr. 2548 prot, nr.115 rep, nr.68 kol, datë 24.03.2015, rezultoi se, investimi i parashikuar në plan biznes është në vlerën 57,638,000 lekë, ndërsa në kontratë kjo vlerë është 34,370,000 lekë (ose 23,268,000 lekë më ulët).
(Trajtuar më hollësisht në faqet 53-108 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

10.1 Rekomandim: Titullari i MBZHR të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, me qëllim vlerësimin e kontratave të mësipërme dhe të identifikimit të kontratave të tjera nësë kanë, të njëjtën problematikë të mospërputhjes së vlerës së investimit parashikuar në plan biznes, paraqitur gjatë fazës së procedurës së dhënies me qira, me vlerën e investimit të paraqitur në kontratën e qirasë, duke mundësuar më pas, dakortësinë për amendim kontrate midis palëve, duke

vendosur në kontratë si vlerë investimi vlerën e plan biznesit si dhe të rivlerësohet afati i kohës për realizimin me sukses të kontratës.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Në disa prej kontratave të qirasë të lidhura gjatë viteve 2013 ï 2018 të audituara në lidhje mbi ecurinë dhe monitorimin , u konstatua se, një pjesë e sipërfaqeve të dhëna me qira, janë të mbivendosura, mbi varreza publike të zonës, mbi ndërtime të paligjshme si dhe në përdorim të një pale tretë, për pasojë subjektet qiramarrëse nuk kanë mundur të shfrytëzojnë sipërfaqen e plotë dhe të zhvillojnë plotësisht kontratën.Struktura përgjegjëse e monitorimit të kontratave për periudhën në auditim, ka identifikuar dhe verifikuar problematikën e mësipërme, duke njoftuar titullarit e MBZHR. Problematikat, tregojnë mangësinë e mungesës së rregjistrit të plotë dhe të saktë, të fondit të tokës bujqësore në administrim të MBZHR, i cili duhej hartuar në bashkëpunim dhe koordinim midis institucioneve dhe organeve kompetente shtetërore, më konkretisht si vijon:

1.Subjekti ñMò shpk ka lidhur me Ministrinë e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, kontratën nr. 8136 prot, datë 23.10.2015, për sipërfaqen prej 18.9174 ha tokë bujqësore të ndodhur të ndodhur në Zonën Kadastrale 1582 e përbërë prej ngastrave me numra pasurie 114/19, 114/21, 114/22, Fshati Dushk i Madh, Njësia Administrative Dushk, Rrethi Lushnje, Qarku Fier .

Nga auditimi u konstatua se, sipas verifikimit në terren i strukturës përgjegjëse për monitorimnë MBZHR, në datën 14.11.2018 rezultoi se qiramarrësi nuk mund të shfrytëzojë sipërfaqen me numër pasurie 114/22 me sipërfaqe 7000 m^2 Zona Kadastrale 1582 e cila **është e zënë me varreza** dhe pasurinë me nr. 114/19 Zona Kadastrale 1582 me sipërfaqe 23,843 m^2 e ndarë sipas ligjit nr.7501 datë 19.07.1991 ñPër tokënò i ndryshuar, referuar hartës treguese e cila është e zënë nga vreshta.

Për këtë problematikë shoqëria ñMò shpk është drejtuar pranë qiradhënësit me shkresën nr. 849 Prot. datë 24.01.2019 ku informon se ka aplikuar për regjistrimin e Kontratës së Qirasë pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnje që në datë 28.11.2015, ndërsa çertifikata e regjistrimit është lëshuar nga kjo zyrë në datën 29.9.2016.

Regjistrimi i kontratës është bërë vetëm për pasurinë me numër 114/21 me sipërfaqe 158.331 m^2. Për pasuritë me numër 114/19 me sipërfaqe 23.843 m^2 dhe 114/22 me sipërfaqe 7.000 m^2, nuk u bë i mundur regjistrimi nga ana e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnje, sepse sipas saj pasuria 114/19 rezulton e ndarë sipas ligjit nr. 7501 por me AMTP të paregjistruara deri në atë kohë, ndërsa pasuria 114/22 e përcaktuar si varrezë publike me vendim të Këshillit të Komunës Dushk i Madh, gjithashtu edhe ky vendim i paregjistruar. Për ta zgjidhur këtë administratori i shoqërisë ñMò shpk me deklaratën noteriale nr. 1978 rep. nr. 1308/3 kol. datë 8.9.2016 deklaron se heq dorë nga regjistrimi i kontratës për pasuritë me numër 114/19 dhe 114/22 Zona Kadastrale 1582.

Si përfundim shoqëria shfrytëzon vetëm sipërfaqen me numër pasurie 114/21 me sipërfaqe 158.331 m^2 Zona Kadastrale 1582, pasuri të cilën e ka regjistruar pranë ZVRPP Lushnje.

Sa më sipër, në Memon e datës 01.02.2019, sektori i bashkëfinancimit per partneritet dhe monitorimit i është drejtuar Ministrit të MBZHR, për problematikën e konstatuar, ku deri në momentin e hartimit të këtij materiali, nga ZVRR-Lushnjë, nuk është përcjellë inforA.Moni.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 82-87 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

2.Subjekti ñBò shpk dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave kanë lidhur kontratë nr.7075 prot, nr.6075 rep. nr.2615 kol, datë 7.10.2014, për të cilën, në zbatim të Urdhërit nr.509 datë 30.10.2014 ñ*Mbi kalimin e tokës në përdorim (qira) shoqërisë "B" shpk*ò, është ngritur grupi i punës i cili ka proçeduar me mbajtjen e procesverbalit të dorëzimit të sipërfaqes në zbatim të parashikimeve të kontratës së qirasë në datën 7.11.2014 në fshatin Arrameras, Bashkia Fushë- Krujë. Në procesverbalin e dorëzimit citohet se : ñ*Nga verifikimi në terren konstatohen brenda sipërfaqes tokë bujqësore, objekt kontrate, ku janë afro 20-25 ndërtime pa leje (shtëpi banimi) me sipërfaqet funksionale të tyre si dhe rreth 70 % e sipërfaqes totale është*

zaptuar prej 23 vjetësh nga banorët e fshatit me pretendimin se janë në kufinjtë e pronave të tyre për periudhën para vitit 1946, por nuk disponojnë asnjë dokumentacion pronësie nga AKKP-ja. Sipërfaqja e tokës bujqësore e zënë nga ndërtimet pa leje, duke marrë në konsideratë sipërfaqet funksionale të tyre (oborre, kopshte dhe rrugët lidhëse midis tyre dhe rrugëve të parcelave) zë gati 8 % të sasisë totale të dhënë me qira me kontratën nr.7075 Prot. datë 7.10.2014 "Për dhënien me qira të tokës bujqësor në pronësi të shtetit".

Një pjesë e sipërfaqes së marrë me qira **është e zaptuar nga të tretë.** Në këto sipërfaqe janë ndërtuar shtëpi banimi. Qiramarrësi kërkon zbritjen e këtyre sipërfaqeve nga sipërfaqja e përgjithshme e kontratës dhe zbritjen përkatëse të vlerës së qirasë. Pasurinë me numër 9/21 Zona Kadastrale 1042 me sipërfaqe 900 m ^{2} qiramarrësi thotë se nuk e ka të mundur identifikimin e vendodhjes së saj.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 84-86 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

3. Subjekti ñD.Fòshpk dhe Ministria e Bujqesisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave kanë lidhur Kontratë nr.6097 prot, nr.1861rep, nr.798kol, datë 8.9.2017 sipas VKM Nr.460, datë 22.5.2013 ñPër përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar,me afat për 90 vite. Titullari i MZHBR me Urdhërin nr.497, datë 15.11.2018 ñPër ngritjen e Grupit të Punës për dorëzimin e tokës qiramarrësit subjektit ñD.Fò shpk, me datë 15.11.2018 nuk ka mundur të kryejë dorëzimin e tokës, për arsye se **pjesa më e madhe e sipërfaqes ishte e punuar dhe e mbjellë nga të tretë.** Për këtë i është kërkuar inforA.Mon ZVRPP Fier e cila informon që këto pasuri janë në pronësi shtet, Bashkisë Fier e cila konfirmon se zaptuesit e tokës nuk kanë asnjë dokument të provojë tagrat e tyre përë këtë shfrytëzim dhe DAMT Këshilli i Qarkut Fier e cila informon se këto pasuri nuk janë përfshirë në VKM nr.45/2014, ñPër kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të fondit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe institucioneve-kërkimore të kësaj ministrie aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronaveò.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 84-87 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

11.1 Rekomandim: Nga titullari i institucionit, për kontratat e mësipërme të dakortësohet për amendim kontratë midis palëve, duke vendosur në kontratë sipërfaqen e saktë për përdorim si dhe të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, për verifikimin dhe identifikimin në terren të kontratave të tjera, nëse kanë mbivendosje të sipërfaqeve bujqësore me aktivitete jo të zhvillimit bujqësor rural, me qëllim realizimin me sukses të kontratës.

-Për të gjitha rastet në vijim, MBZHR të marrë masa që të mos japë me qera tokë bujqësore, pa realizuar procesin e idendifikimit dhe verifikimit të mospasjes së mbivendosjeve sipas shkaqeve të sipërpërmëndura.

Menjëherë dhe në vijimësi

12.Gjetje nga auditimi:Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti rezulton se mbledhjet e kryera nga GMS të jenë sistematike e periodike në kundërshtim me përcaktimet e ligjit.

Ne MBZHR bëhen trajnime të vazhdueshme për ngritjen e nivelit profesional nga Shkolla e Administratës Publiket por konstatohet se për vitet objekt auditimi nuk ka patur një program strategjik dhe vjetor të trajnimeve të shpallur nga institucioni. MBZHR ka hartuar regjistrer te risqeve per disa drejtori, por procesi i menaxhimit të riskut nuk është i formalizuar në regjister i konsoliduar i risqeve per insitucionin i miratuar. Gjithashtu rezulton se në Ministrinë Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk është finalizuar hartimi i matricës dhe strategjisë së menaxhimit të riskut, e cila rezulton në mungesë të monitorimit të risqeve.Gjithashtu nga auditimi u konstatua se disa prej sistemeve të kontrollit të brendshëm nuk kanë funksionuar në harmoni me njeri- tjetrin.

(*Trajtuar më hollësisht në faqet 207-212 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).*

12.1 Rekomandim: *N*ga ana e titullarit të MBZHR të merren masa që në insitucion të hartohet një program strategjik dhe vjetor të trajnimeve dhe të formalizohet regjisteri i konsoliduar i risqeve per insitucionin dhe te miratohet.

Menjëherë dhe në vijimësi

13.Gjetje nga auditimi: Struktura e njësisë së auditit të brendshëm në MBZHR, për periudhën 01.01-08.02.2019 ka funksionuar me 3 specialistë dhe me drejtues të komanduar; për periudhën 08.02-31.12.2019 ka funksionuar me 3 specialistë dhe 1 drejtor, pra struktura nuk ka qënë e plotë me 4 specialistë dhe 1 drejtor(për shkak të mos rekrutimit në kohë nga DAP); ndërsa për periudhën 01.01.2020 e në vazhdim ka funksionuar e plotë, duke realizuar për vitin 2019, rreth 83% të auditimeve të planifikuara dhe në vitin 2020, rreth 125% të auditimeve. Kjo njësinga auditimi i njësive të varësisë së MBZHR, për vitin 2019**,** ka konstatuar shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi të shoqëruar me efekte financiare për buxhetin e shtetit, gjithsej në shumën 19,880 mijë lekë dhe për vitin 2020 janë konstatuar shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi të shoqëruar me efekte financiare për buxhetin e shtetit, gjithsej në shumën 2,982 mijë lekë.Grupi i audituesve të KLSH, konstatoi se, nga NjAB nuk është monitoruar procesi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga njësia.
Në dosjet e audituara nuk ka asnjë gjurmë të sigurimit të brendshëm të cilësisë të realizuar nga auditues brenda drejtorisë që nuk kanë qenë pjesë e grupit të auditimit ose nga drejtuesi i NjAB, kjo në kundërshtim me Manualin e Auditit të Brendshëm.
Nga shqyrtimi me përzgjedhje rastësore i dosjeve të auditimit, u konstatua se të gjitha dosjet e evaduar nuk janë të arkivuara, në kundërshtim me ligjin nr. 9154 ñ*Për Arkivat*ò, kreu VI ñ*Dorëzimi i dokumenteve në arkivat shtetërorë*ò, neni 42 pika 1dhe me nenin9 shkronja ç.
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 212-218 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).*

13.1Rekomandimi: Me qëllim respektimin e rregullave të parashikuara, NjAB duhet të përmbushë detyrimet ligjore për sigurimin e gjurmës së auditit të brendshëm të cilësisë, në mënyrë për të bërë të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, për MBZHR dhe njësive të varësisë.
-Nga MBZHR, të merren masa për kryerjen e inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

Menjëherë dhe në vijimësi

MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.Gjetje nga auditimi: Për periudhën në auditim nga MZHBR, janë realizuar 11 procedura dhënie me qira të tokës bujqësore, nga të cilat nga grupi i auditimit u përzgjodhën 7 kontrata, ku në 2 procedura gjatë procesit të realizimit të dhënies me qira, u konstatua që, përllogaritja e çmimit fillestar të qerasë të tokës bujqësore pas verifikimit në terren, nga grupet e punës të ngritura me urdhër të titullarit të MBZHR, është llogaritur më pak, e për pasojë vlera e qirasë të tokës bujqësore ka sjellë të ardhura më pak në vlerën prej **196,776.94 lekë si efekte negative** në Buxhetin e Shtetit, konkretisht:
1.Për Kontratën nr.180 Rep, nr.33/4Kol nr.317 prot datë 15.01.2020 me subjektin ñAò shpk;
2.Për Kontratën nr.305 Rep, nr.613 Kol, nr.748/1 prot datë 22.09.2020 me subjektin ñF.Aò,
Kjo në kundërshtim me ligjin nr.8318 datë 01.04.1998 ñPër dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve e kullotave, që janë pasuri shtetëroreò i ndryshuar,sipas VKM nr.373 datë 20.06.2018 ñPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar me VKM nr.487 datë 17.06.2020 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.373 datë 20.06.2018 të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e kriterevetë rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit.ò
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 45-54 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).*

1.1Rekomandim. Nga MBZHR, të merren masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës prej 196,776.94 lekë, e cila përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit, për shkak të llogaritjes më pak të vlerës së qirasë , konkretisht:
-Vlera prej 32,864 lekë për subjektin ñAò.
-Vlera prej 163,912.94 lekë për subjektin ñF.Aò.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i monitorimit të kontratave në lidhje me detyrimin kontraktor të realizimit të investimeve kapitale, në 3 kontrata, të cilat janë dhënë mbi bazën nënligjore të aplikuar të kohës, me VKM nr.460, datë 22.5.2013ñPër përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetitò i ndryshuar, u konstatua se, qiramarrësit megjithëse kanë kryer investime në terren **nuk** mund tôi mbështesin investimet me dokumenta justifikues (fatura apo deklarata doganore dhe situacione punimesh/shërbimesh), për rrjedhojë për këto kontrata **nuk** provohet plotësimi i kushteve të kontratës, për realizimin e investimit jo më pak se 20% e vlerës së parashikuar brenda vitit të 3-të pas lidhjes së kontratës si dhe 70% brenda vitit të 5-të, e për pasojë mosplotësimi i detyrimeve kontraktore, në kundërshtim me nenin 6, pika 5/b, me nenin 7, pika 3 të kontratës, duke përllogaritur penalitetet, më konkretisht:
1.Shoqëria "A" shpk dhe ish-MBUMK (Ministria e Bujqesisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit) kanë lidhur Kontratë nr.3819 prot datë 16.09.2013, për dhënien e tokës bujqësore me qira me afat për 60 vite, me object të kultivimit të drufrutorë të arrës së bashku me fidanishte dhe të kultivimit të ullinjëve, me vlerë qiraje 622,440 lekë në vit. Nga auditimi rezultoi se, MBZHR ka zgjidhur kontratën në mënyrë të njëanshme me shkresë me urdhër të titullarit, nr.227 datë 01.06.2021, për shkak se, subjekti nuk ka kryer investimet në vlerën deri 20% të vlerës së investimit, si dhe ky subjekt nuk ka kryer investimet në vlerën deri në 70% të vlerës së investimit brenda 5 viteve të para.
Grupi i auditimit kreu përllogaritjet e penaliteteve për investimin e pakryer nga ku rezultoi se: Investimi i parashikuar në planin e biznenist është në vlerën 3,155,883 Euro brenda një afati 5 vjecar; Investimi i realizuar është në total rreth 126,346 Euro: nga të cilat 13,306,926 leke dhe 31.500 Euro; dhe Investimi i parealizuar rezulton rreth 3,029,536 Eur (ose 425,044,008 lekë[9])
Totali i penaliteteve në masën 2% të vlerës së investimeve kapitale të pakryera është **14,672,752.09 lekë** (ose 104,581 Euro).
2. Shoqëria ñP.Iò shpk dhe ish-MBUMK (Ministria e Bujqesisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit) kanë lidhur Kontratë Nr.3620/1 prot datë 06.09.2013, për dhënien e tokës bujqësore me qira me afat për 60 vite, ndryshuar me Shtojcën 5 nr.4307, nr.1228 Rep, nr.298 Kol, datë 29.05.2017. Nga auditimi konstatua se, për realizimin e investimit me vlerë prej 351,036,645 lekë sipas Kontratë Nr.3620/1 prot datë 06.09.2013 në Plan biznesit të vitit 2013, u kontatuan dokumentacion në dosjen fizike sipas faturave të dorëzuara në vlerën prej 44,399,037 lekë, dmth 13% të vlerës së investimit, në mos plotësim të detyrimit kontraktor, sipas neni 6 pika 5/a e për rrjedhojë penaliteti i parashikuar në masën 2% të vlerës së investimeve kapitale të të pakryera është në vlerën 12,265,504.32 lekë.
-Ndërsa për kontratën shtesë nr.4307 Prot, Nr.1225 Rep, Nr.298 Kol, datë 29.05.2017 sipas Plan Biznesit të vitit 2017, nuk u konstatua dokumentacion justifikues në dosjen fizike, për vlerën e investimit të parashikuar në kontratë dhe për këtë arsye investimi konsiderohet në masën 0 %, për rrjedhojë penaliteti i parashikuar në mos plotësim të detyrimit kontraktor sipas neni 6 pika 5/b penaliteti i parashikuar në masën 2% sipas nenit 7 pika 3, është në vlerën 1,366,272.00 lekë.

[9] Për efekt perllogaritjesh kursi I këmbimit Euro/ALL është 140.30, sipas kursit të kembimit nga BSH më datë 16.09.2013 - data e lidhjes së kontratës

Pra në total, penalitetet për mos realizimin e investimeve kapitale sipas Plan biznesi të vitit 2013 dhe vitit 2017 është në vlerën **13,631,776.32** lekë.
3. Subjekti ñÇ" shpk dhe Ministria e Bujqesisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave kanë lidhur Kontratë nr.1001 Prot, nr.396 Rep, nr.369 Kol, datë 05.02.2016, për dhënien e tokës bujqësore me qira me afat për 60 vite, ngritje vreshti për kultivimin rrushi dhe prodhim vere me vlerë qiraje 321,565 lekë në vit. Nga auditimi mbi monitorimin e kontratës në dosjen fizike u konstatua se, me urdhër të titullarit Ministrit të MBZHR nr.9763/1 datë 19.10.2018, (pra 2 vite e 8 muaj pas lidhjes së kontratës),është ngritur grupi i punës ñPër dorëzimin e tokës qiramarrësit subjektit Z. P.Çò shpk, ndërsa në procesverbalin nr.9763/3 datë 26.10.2018 mbajtur nga grupi i dorëzimit, citohet se ñ*qiramarrësi e ka përdorur këtë sipërfaqe që prej momentit të nënshkrimit të kontratës",* fakt që tregon se nga ana e MBZHR veprimet administrative janë bërë me vonesë, por kjo vonesë nuk ka penguar përdorimin i tokës bujqësore nga qiramarrësi.
Investimi i parashikuar në planin e biznesi për 5 vitet e para është në vlerën 154,286,259 lekë, ndërsa nga auditimi i dosjes fizike nuk u konstatua asnjë dokument ose fatura për të vërtetuar realizimin e investimit të vitit të pestë kryer në masën prej 70%, pra duhet të kishte të provuar vlerën e investimit prej 108,000,381 lekë, penaliteti me vonesë të investimit për 53 ditë është në vlerën prej **448,064 lekë.**
(Trajtuar më hollësisht në faqet 53-108 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Nga MBZHR, të merren masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **28,304,528.3** lekë si pasojë e mos plotësimit të detyrimit kontraktor nga mos kryerja e investimeve në kohë, duke krijuar vlera financiare të cilat përfaqësojnë të ardhura të munguara ndaj buxhetit të shtetit, si vijon:
-Për subjektin ñAô, në vlerën prej 14,672,752.09 lekë (ose 104,581 Euro).
-Për subjektin ñP.Iò shpk, në vlerën 13,631,776.32 lekë.
-Për subjekti ñÇ", në vlerën 448,064 lekë.

Menjëherë

3.Gjetje nga auditimi:Në bazë të kontratave tip të mëposhtme, subjektet kanë likuiduar me vonesë pagesat e qerasë vjetore, në kundërshtim me nenin 7, pika 1, sipas të cilit qiramarrësi, paguan kamatë vonesën në vlerën 0.5% të detyrimit vjetor të qirasë për çdo ditë vonese në pagesën e qirasë, duke filluar nga data e përcaktuar në kontratën respective. Penaliteti nuk është pëllogaritur nga struktura përgjegjëse për monitorimin e kontratave. Kamatë vonesat të llogaritura nga grupi i auditimit për mos pagimin në kohë të vlerës së qerasë, janë si vijon:
1. Shoqëria "A" shpk dhe ish-MBUMK (Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit) kanë lidhur kontratë nr.3819 prot datë 16.09.2013, me detyrimin prej vlerës **9,682,054** lekë.
2.Shoqëria ñP.Iò shpk dhe ish-MBUMK (Ministria e Bujqesisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit) kanë lidhur kontratë nr.3620/1 prot datë 06.09.2013, me detyrimin prej vlerës **15,197,238.15** lekë.
3.Subjekti ñÇ" shpk dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave kanë lidhur kontratë nr.1001 prot, nr.396 rep, nr.369 kol, datë 05.02.2016, me detyrimin prej vlerës **184,900.73** lekë.
4.Subjekti ñA.M.ò dhe Ministria e Bujqesisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit Të Ujrave kanë lidhur Kontratë nr Nr. 2548 Prot, nr.115 Rep, nr.68 Kol, datë 24.03.2015, me detyrimin prej vlerës **1,341,629.10**lekë.
5.Subjekti ñP.ò shpk dhe MZHBR kanë lidhur kontratë nr.2711 prot, nr.827 rep, nr. 679 kol, datë 31.03.2017, me detyrimin prej vlerës **5,895,051.75** lekë.
6.Subjektin ñR.Sò dhe MZHBR kanelidhur kontrata nr.178 rep, nr.32/4 Kol, nr.311 prot datë 15.01, me detyrimin prej vlerës **889,200 lekë.**

7.Subjektin ñF.Aò lidhur kontrata nr.305 rep,nr.613 kol, nr.748/1 prot datë 22.09.2020, me detyrimin prej vlerës **18,000.21 lekë.**
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 54-108 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).*

3.1 Rekomandim: Nga MBZHR, të merren masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **33,208,072.75** lekë të krijuara si pasojë e penaliteteve e moslikuidimit ne kohe të qerave vjetore, duke krijuar vlera financiare të cilat përfaqësojnë të ardhura të munguara ndaj buxhetit të shtetit, si vijon:
-Për subjektin ñR.Sò, në vlerën prej 889,200 lekë.
-Për subjektin ñF.Aò, në vlerën prej 18,000.21 lekë.
-Për Subjektin "A", në vlerën prej 9,682,054 lekë.
-Për subjektin ñP.Iò,në vlerën prej 15,197,238.15lekë.
-Për Subjekti ñÇ", në vlerën prej 184,900.73lekë.
-Për Subjekti ñA.M.ò, në vlerën prej 1,341,629.10lekë.
-Për Subjekti ñP.ò, në vlerën prej 5,895,051.75 lekë.

Menjëherë

MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, sipas çeljes fillestare me ligj buxheti për vitin 2019, u planifikuan shpenzime për vendime gjyqësore në vlerën 5,000,000 lekë dhe u realizaun 23,180,000 lekë (ose 363% më shumë nga sa planifikuar).
Gjithashtu nga auditimi rezultoi se, sipas çeljes fillestare me ligjin e buxhetit, për vitin 2020 u planifikuan shpenzime per vendime gjyqësore në vlerën 5,000,000 lekë dhe u realizuan 13,170,000 lekë (ose 163% më shumë nga sa planifikuar).
-Kështu, megjithë planifikimin, diferencat ndërmjet planifikimit dhe realizimit mbulohen nepermjet rialokimeve nga diferencat e lira në fond pagash që rrjedhin nga vëndet vakante.
Përsa i përket detyrimeve të mbartura, u konstatua se këto vendime gjyqësore janë për gjyqfituesit ku vendimi i formës së prerë është për likujdimin e pagës deri në rikthim në vendin e punës. Aktualisht, për gjyqfituesit që nuk janë sistemuar ende në vëndin e tyre të punës, pagesa i bëhet mujore apo në çdo dy muaj nga sektori i financës në MBZHR. Pra nga auditimi i kryer u konstatua se në total për periudhën objekt auditimi janë paguar për vendimet gjyqësore të formës së prerë një total prej **37,326,830 lekë.** Vlen të theksohet se të gjitha këto pagesa janë kryer gjatë periudhës objekt auditimi edhe pse vendimet e formës së prerë mund të jenë marrë edhe para kësaj periudhe.
Gjithashtu u konstatua se:
Nga kryerja e auditimit mbi urdhër shpenzimet për vitin 2019 u konstatua se në 3 praktika, nga 12 praktika të likuidura gjithsej, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është kryer nëpërmjet përmbaruesve privat për të cilën janë shpenzuar si pagesë përmbarimore në vlerën prej **526,672 lekë.**
Nga kryerja e auditimit mbi urdhër shpenzimet për vitin 2020 u konstatua se në 4 praktika, nga 12 praktika të likuidura gjithsej, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është kryer nëpërmjet përmbaruesve privat për të cilën janë shpenzuar si pagesë përmbarimore në vlerën prej **1,138,232 lekë.**
Sa më sipër, për periudhën objekt auditimi, vendimet gjyqësore të formës së prerë, për praktikat e sipërpërmëndura, **nuk** janë ekzekutuar vullnetarisht nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me marrjen e njoftimit të vendimit të formës së prerë dhe kthimit të tij në titull ekzekutiv, por në 7 raste janë kryer në bazë të urdhër ekzekutimeve të lëshuara nga përmbaruesit privat, duke paguar tarifa përmbarimore, veprime të cilat kanë sjellë kosto shtesë për buxhetin e MBZHR-së

për periudhën objekt auditimi **në vlerën 1,664,904 lekë**. Referuar udhëzimit nr.1, datë 04.06.2014, pika 9, përmbaruesi gjyqësor fillon procedurat e ekzekutimit të detyruar nga llogaria e thesarit vetëm, në ato raste kur njësia shpenzuese nuk ka ndjekur vullnetarisht asnjë nga procedurat e parashikuara në pikat 5 ose 6 të këtij udhëzimi, cfare në këtë rast ka ndodhur pasi MBZHR nuk rezulton të ketë paraqitur zyrtarisht nëpërmjet publikimit në faqen on-line, apo në forma të tjera të publikimit, grafikun e shlyerjes sipas rradhes, të cilit gjithashtu duhet tëi përmbahet përmbaruesi, nëpërputhje me pikën 5 të po këtij udhëzimi. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 28-33 të Raport Përfundimtarit të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse të MBZHR-së të marrin masa që shuma totale e detyrimeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të bëhet pjesë e procesit të programimit buxhetor të vitit të ardhshëm, sipas përcaktimeve të akteve ligjorë e nënligjorë përkatës. Ekzekutimi i vendimeve gjyqesore që janë parashikuar të shlyhen nga buxheti përkatës, të bëhet sipas rradhës së paraqitjes zyrtare të tyre në vitin paraardhës dhe grafiku i shlyerjes të bëhet publik nëpërmjet publikimit në faqen on-line të MBZHR, apo në forma të tjera të publikimit, që ju bëhen të ditura publikut, në mënyrë që edhe përmbaruesi tëi përmbahet grafikut të shyerjes së detyrimit të publikuar, duke shmangur kështu kostot e përmbarimit të cilat rëndojnë buxhetin e shtetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i urdhër shpenzimeve të dietave për periudhen objekt auditimi rezulton se pavarësisht se znj, B.K (Drejtori i NJAB pranë MZHBR) nuk ka qenë pjesë e programeve të auditimeve, eshte shtuar në trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës duke u ndryshuar përbërja e grupit të auditimit me autorizimet e Drejtorit të Përgjithshëm dhe si pasojë ka një rritje në kostot e auditimit me vlerën 606,430 lekë, në kundërshtim *me udhëzimin nr.30, datë 26.12.2011 dhe ligjin nr.114/2015 "Për Auditin e Brendshëm".*
Drejtoria e Auditimit në MBZHR është në varësi direkte dhe vihet në lëvizje vetëm me urdhër të Ministrit, në përputhje me *ligjin nr 114/2015 "Për Auditin e Brendshëm" Kreu IV, neni 10, pika 2.*
Në urdhër shpenzimet e audituara nuk ka asnjë shkresë të Ministrit të MZHBR-së që të ndryshohet përbërja e grupeve të auditimit duke shtuar drejtorin e NJAB znj.B.K.
Gjithashtu nga auditimi me përzgjedhje u konstatua se në 3 urdhër shpenzime është përfituar dieta për ditën e premte (dieta ditore dhe fjetje hoteli) duke u kthyer në qëndren e punës (Tiranë) me datë 03.10.2020 dhe 10.10.2020 (e shtunë) dhe si pasojë ka një rritje në kostot e auditimit me vlerën 27,500 lekë.
Sa më sipër është vepruar në kundështim me *VKM nr.997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, Brenda vendit", i ndryshuar, kreu V, pika 2. Me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik", i ndryshuar, Kreu III, pika 36. Me rregulloren e brëndshme të institucionit me nr,1984/1 datë 10.10.2019. Me Ligjin nr.114/2015 "Për Auditin e Brendshëm" Kreun IV, neni 10, pika 2 " NJAB është e pavarur funksionalisht dhe raporton në mynyrë të drejtpërdrejtë tek titullari i njësisë publike" dhe Neni 14 pika c dhe ii dhe meVKM nr.511 datë 24.10.2002 i ndryshuar"Për kohëzgjatjen e punës dhe pushimit në institucionet shtetërore"*
(*Trajtuar më hollësisht në faqet 39-50 të Projekt Raportit të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi
Nga titullari MBZHR, të ngrihet një grup pune, për të evidentuar parregullsitë e konstatuara mbi urdhër shpenzime për vlerën prej 633,930 lekë, e cila është përdorur pa ekonomicitet, efektivitet dhe efiçensë.

Menjëherë

MASA DISIPLINORE

Mbështetur në në nenet 58 dhe 59, të ligjit nr. 152/2013 ñPër nëpunësin civilò si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ***i rekomandohet*** Titullarit të institucionit, që nëpërmjet një grupi pune, të bëjë vlerësimin dhe shqyrtimin e shkeljeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit sipas përgjegjësisë individuale dhe të nisë menjëherë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse.

Menjëherë

V.ANEKSE

ANEKSI 3: SQARIM RRETH LLOJEVE TË NDRYSHME TË OPINIONEVE TË APLIKUARA NGA KLSH.

Në Auditimin e Përputhshmërisë:[10]

a. Opinion i pamodifikuar.

-Audituesi duhet të shprehë një opinion të pamodifikuar në ato raste kur ka marrë siguri të arsyeshme, si dhe nuk ka konstatuar (për çështjet e audituara) aspekte materiale të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara.

-Audituesi duhet të shprehë një opinion të pamodifikuar në ato raste kur ka marrë siguri të kufizuar, si dhe në bazë të punës së kryer, *asgjë nuk ka tërhequr vëmendjen që çështja e audituar nuk është në përputhje në aspektin material me kriteret e aplikuara*.

b. Opinion i modifikuar.

Jepet në ato raste kur audituesi ka marrë siguri të arsyeshme, si dhe ka konstatuar gabime materiale, ose kur audituesi ka marrë siguri të kufizuar, pasi në bazë të punës së kryer nuk ka siguruar evidencë e mjaftueshme për të mbështetur dhënien e opinionit, por që në gjykimin profesional të audituesit mund të kenë mospërputhshmëri të aspektit material.

Opinion i kualifikuar/i cilësuar, jepet në ato raste kur është marrë siguri e arsyeshme, është siguruar një evidencë e majftueshme dhe e plotë, por janë evidentuar raste të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuara, të cilat janë *materiale, por jo të përhapura*, ose kur audituesi nuk është në gjendje të mbledhë prova të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, dhe efektet e mundshme janë materiale, por jo të përhapura.

c. Opinion i kundërt.

Jepet në ato raste kur është marrë siguri e arsyeshme, është siguruar një evidencë e mjaftueshme dhe e përshtatshme/ e plotë, por *devijimet e pajtueshmërisë janë materiale dhe të përhapura*.

d. Refuzim i opinionit.

Refuzimi i opinionit do të jepet në rastet kur audituesi e ka të pamundur që të mbërrijë në një opinion për sa i përket pasqyrave financiare të marra në tërësi, si pasojë e pasigurisë apo e kufizimit të fushëveprimit aq shumë thelbësor, në mënyrë që një opinion me rezerve në disa aspekte të caktuara të mos jetë i përshtatshëm. Formulimi i refuzimit të opinionit qartëson faktin se është e pamundur të jepet një opinion duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha rastet e paqartësisë. Refuzimi i opinioni, është një mohim i përgjegjësisë, pasi *audituesi nuk është në gjendje të marrë prova të mjaftueshme dhe të përshtatshme auditimi*për të siguruar një bazë për dhënien e opinionit, *për t'u shprehur në lidhje me pajtueshmërinë me kriteret e aplikuara, si dhe për të gjykuar nëse efektet e mundshme mund të janë materiale dhe të përhapura.*

Në Auditimin Financiar:11

a. Opinion i Pamodifikuar, Audituesi duhet të shprehë një opinion të pamodifikuar për besueshmërinë e

[10] - Rregullorja e Procedurave te Auditimit të KLSH, miratuar me Vendimin e Kryetarit nr.63, datë 22.6.2020, neni 4, pika 2, faqe 16.

[11] -Rregullorja e Procedurave te Auditimit të KLSH, miratuar me Vendimin e Kryetarit nr.63, datë 22.6.2020, neni 4, pika 2.2, faqe 18.

llogarive kur arrin në përfundimin se llogaritë vjetore janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Në mënyrë që
të formojë këtë opinion, audituesi duhet të konkludojë se ka marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Ky opinion mund të jetë pa rezervë ose me theksim çështjeje. Një opinion ñPa rezervëò, jepet në rastet kur audituesi është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale se: - pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi; - pasqyrat janë në përputhje m---e kërkesat ligjore dhe me rregulloret përkatëse; - janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare.
Një opinion me ñ***Theksim Çështjeje***ò, jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt, për një ose më shumë çështje specifike, që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare por që nuk janë thelbësore për arsyetimin e pasqyrave.
b. Opinion i Modifikuar, jepet në ato raste kur Pasqyrat Financiare përmbajnë gabime materiale, të cilat çojnë në ndryshim të rezultatit financiar, ose kur nga auditimi nuk sigurohet evidencë e mjaftueshme dhe e duhur financiare për të mbështetur dhënien e opinionin, por që në gjykimin profesional të audituesit mund të ketë gabime materiale të cilat sjellin ndryshim të rezultatit financiar. Ky opinion mund të jetë i kualifikuar/me rezervë, i kundërt ose me refuzim opinioni. Një ñOpinion i kualifikuar/me rezervëò, jepet në rastet kur: - audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se *anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura*, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; - audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.
c. Një "Opinion të kundërt", jepet në rastet kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se an*omalitë apo rastet e mosrespektimit të cilat janë materiale individualisht ose së bashku* janë përhapur në llogaritë vjetore apo transaksionet.
d. "Refuzim opinion", jepet në rastet kur: - kur audituesi *nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme auditimi*, mbi të cilat duhet të bazojë mendimin për efektet e mundshme materiale edhe të përhapura mbi llogaritë vjetore apo transaksionet. - në raste jashtëzakonisht të rralla që përfshijnë pasiguri të shumta, ku audituesi pavarësisht se ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe përshtatshme të auditimit në lidhje me secilën prej pasigurive, mund të konkludoj[y] se nuk është e mundur për të formuar një opinion dhe në këtë mënyrë refuzon dhënien e tij.

ANEKSI 4:

QASJA DHE METODOLOGJIA E AUDITIMIT.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal nivelin të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 0,7-2% për të zonat e llogarisë të planifikuara për tâu audituar. Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë faktorët e riskut prej 0,7 % për shpenzimet dhe 2% për investimet, niveli i precizionit pranohet në vlerën 3,520,733 lekë për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti.
Mbi transaksionet u aplikuan:
teste të kontrolleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm (u analizua menaxhimi financiar dhe kontrolli);
Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:
Risku i lidhur me shpenzimin specifik;
Pesha specifike që ky zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.
Për të përzgjedhur minimumin e çështjeve për auditimi, mbi këta zëra shpenzimesh, u aplikuan format e përllogaritjes si më poshtë:

Shënim:
Numri i artikujve për shqyrtim= vlera e populacionit për kategorinë e shpenzimit (p.sh. vlera e llog 600) : vlera e precizionit nga materialiteti x faktori i riskut.

Referuar përcaktimeve të Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, paragrafi 2.4, (KLSH, Tiranë 2015, fq.18, në fuqi për periudhën objekt auditimi), përcaktohet se:
Në kuadër të auditimit të përputhshmërisë, cilësia ose efektiviteti i sistemeve të kontrollit mund të përcaktohet në bazë të nivelit 0,7- 2% të materialitetit nëse auditimi jep siguri të arsyeshme (për shembull, bazuar mbi teste të mjaftueshme kontrolli dhe/ose teste thelbësore):
kur një dobësi e sistemit nuk sjell gabime material, në këtë rast sistemi i kontrollit të brendshëm do të klasifikohet si ñefektivò;
kur gabimet/parregullsitë, të cilat nuk janë parandaluar, zbuluar dhe korrigjuare tejkalojnë pragun e materialitetit prej 2%,; në këto raste, sistemi i kontrollit të brendshëm do të klasifikohet si ñpjesërisht efektivò ose ñjo efektivò.

PËRZGJEDHJA E KAMPIONIT TË AUDITIMIT:

Tre mënyrat e përzgjedhjes së kampioneve: Statistikore dhe Jostatistikore:
Përzgjedhja e 100% të artikujve,
Përzgjedhja e artikujve të veçantë;
Testimi i kampionëve
Pasqyrat financiare te bilancit: audituar 100% llogaritë e bilancit për vitin 2019, për të cilin jepet opinion; transaksionet financiare janë audituar me zgjedhje dhe sondazhe llogaritë e tjera (aktivit dhe pasivit);
Audituar 100% llogaritë e të drejtave të arkëtueshme dhe detyrimeve të pagueshme;
Prokurimet publike e audituar 67% e vlerës për vitin 2019 dhe 71% e vlerës së tyre për vitin 2020.
Inventarizimi i pasurisë audituar 100% për gjithë periudhën objekt auditimi;
Nga kontrolli i sistemit të dokumentacionit justifikuese, për urdhër shpenzimet, u testuan me zgjedhje 3 muajt të vitit 2019 (dhjetor, qershor, shkurt), si dhe Urdhër-Shpenzimet por shpenzime të ndryshme (si dieta, karburanti, etj.);
Procedurat e MFK audituar 100% për gjithë periudhën objekt auditimi;

1. Mbulimi me auditim i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore (llogaria 600 dhe 601)

Nga auditimi në lidhje mbi pagat e punonjësve të aparatit të MBZHR, u konstatua se:

Nr	Viti 2019 Emertimi	Çelja	Shkresa nr. dt	Shpenzime Operative		Plan	Fakt	%
				+	-			
1	Paga	260,100,000	Nr. 24/2, dt 8.01.2019 e MBZHR	50,000,000(kaluar ne 602 për VendimeGJyqësore)	100,000,000	160,100,000	156,637,810	97.8%
	Shtese fondi paga efekt i rritjes pagave (600)	0	-	-	0	0		
2	Sigurime Shoqërore Shëndetësor(601)	51,900,000	Nr. 24/2, dt 8.01.2019 e MBZHR		20,000,000	31,900,000	24,859,449	77.9%
	Totali	**312,000,000**	**0**	**50,000,000**	**120,000,000**	**192,000,000**	**181,497,259**	**94.5%**

Shënim: Të dhënat janë disponuar nga Sektori i Financës në MBZHR

Në tabelën e mëposhtëme janë pasqyruar celja e fondit të pagave, shpenzimet operative,fondi pagave plan dhe pondi pagave fakt për vitin 2020

Nr	Viti 2020 Emertimi	Çelja	Shkresa nr. dt	Shpenzime Operative		Plan	Fakt	%
				+	-			
1	Paga	260,100,000	Nr.312, dt 15.01.2020 e MBZHR	45,000,000(kaluar ne 602 për VendimeGJyqësore)	105,000,000	155,100,000	154,973,458	99.9%
	Shtese fondi paga efekt i rritjes pagave (600)	0	-	-	0	0		
2	Sigurime Shoqërore Shëndetësor(601)	51,900,000	Nr.312, dt 15.01.2020 e MBZHR	12000000	26,800,000	25,100,000	25,022,715	99.7%
	Totali	**312,000,000**	**0**	**57,000,000**	**131,800,000**	**180,200,000**	**179,996,173**	**99.9%**

Shënim: Të dhënat janë disponuar nga Sektori i Financës në MBZHR

Në tabelën e mëposhtëme janë pasqyruar celja e fondit të pagave, shpenzimet operative,fondi pagave plan dhe pondi pagave fakt për vitin katër mujorin e parë të vitit 2021

Nr	Viti 2021 Emertimi	Çelja	Shkresa nr. dt	Shpenzime Operative		Plan	Fakt	%
				+	-			
1	Paga	214,200,000	Nr.982, dt 26.01.2020 e MBZHR			214,200,000	53,097,533	24.8%
	Shtese fondi paga efekt i rritjes pagave (600)	0	-			0		
2	Sigurime Shoqërore Shëndetësor(601)	35,800,000	Nr.982, dt 26.01.2020 e MBZHR			35,800,000	8,691,795	24.3%
	Totali	**250,000,000**	**0**	**0**	**0**	**250,000,000**	**61,789,328**	**24.7%**

Në bazë të të dhënave në tabelat e mëposhtëme pasqyrohen treguesit e realizimit të fondit të pagave për periudhat raportuese 2019-2020. Në total për vitin 2019 është 94.5%, dhe për vitin 2020 është gati 100%.

Nga auditimi u konstatua se pakësimi i fondit të pagave me 50,000,000 lekë për vitin 2019 ka ardhur si pasojë e transferimit në artikullin 602 për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, diferencë e krijuar nga vëndet vakante. Ndërsa 50,000,000 të tjera pakësuar me akt normativ të ministris së financës ñpër rishikimin e buxhetit të shtetit për vitin 2019ò

Gjthashtu pakësimi i fondit të pagave me 45,000,000 lekë për vitin 2020 ka ardhur si pasojë e transferimit në artikullin 602 për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, diferencë e krijuar nga vëndet vakante. Ndërsa 65,000,000 të tjera pakësuar me akt normativ të ministris së financës ñpër rishikimin e buxhetit të shtetit për vitin 2020ò

Konkretisht vavakancat për vitin 2019 në plan 163 punonjës ndërsa në fakt 136 punonjës.

Në fund të vitit dhjetor 2020 sipas ndryshimeve të strukturës me Urdhër të Kryeministrit nr.150,datë 05.11.2020 ñ*Për miratimin e strukturës dhe organikës së MZHBR*ò, parashikuar në plan 174 punonjës ndërsa në fakt janë 143 punonjës.

Mungesat në strukturë janë të gati me 20% të paplotësuara, kanë luhatje dhe për periudha të caktuara ka arritur deri në 143 punonjës.

3.Mbulimi me auditim i të ardhurave dytësore

Programet Buxhetore 2019	Planifikim (PBA)	Realizimi i te ardhurave nga buxheti i shtetit			Realizimi në (%) kundrejt Planifikimit	Përdorimi	
		Gjithsej	Institucioni	Derdhje ne buxhet		Plan limit	Fakt
Te ardhura nga qerate	16,712	34,790	0	34,790	208%	0	0
Te ardhura nga licenca/dhënie lejesh	42,945	43,374	13,012	30,362	101%	1,164	691
Te ardhura nga gjoba/urdhër-zhdëmtime	14,650	72,465	0	72,465	495%	0	0
Te ardhura nga taksa regjistrimi, pulle, ekzekutive dhe tarifa te ndryshme	29,267	14,193	4,258	9,935	48%	0	0

Te ardhura nga shitje dhe veprimtari e drejtpërdrejte	100,579	129,463	116,517	12,946	129%	38,090	23,386
Te tjera	84,280	36,601	10,980	25,621	43%		
Totali	**288,433**	**330,886**	**144,767**	**186,119**	**115%**	**39,254**	**24,077**

Programet Buxhetore	**Planifikim (PBA) 2020**	**Realizimi i te ardhurave nga buxheti i shtetit**			**Realizimi në (%) kundrejt Planifikimit**	**Përdorimi**	
		Gjithsej	**Institucioni**	**Derdhje ne buxhet**		**Plan limit**	**Fakt**
Te ardhura nga qerate	44,667	44,363	0	44,363	99.3%	0	0
Te ardhura nga licenca/dhënie lejesh	34,900	103,352	31,006	72,346	296.1%	1,170	924
Te ardhura nga gjoba/urdhër-zhdëmtime	65,605	64,785	0	64,785	98.8%	0	0
Te ardhura nga taksa regjistrimi, pulle, ekzekutive dhe tarifa te ndryshme	32,326	15,559	4,668	10,891	48.1%	0	0
Te ardhura nga shitje dhe veprimtari e drejtpërdrejte	154,395	131,815	118,634	13,182	85.4%	38,730	26,740
Te tjera	34,711	73,134	21,940	51,194	210.7%	0	0
Totali	**366,604**	**433,008**	**176,247**	**256,761**	**118.1%**	**39,900**	**27,664**

Nga auditimimbikrijimindhepërdorimin e tëardhuradytësore,parashikimi i të ardhurave për sistemin e MBZHR-së është kryer për çdo program buxhetor në Anekset e pasqyrave të Projekt Buxheteve për periudhën objekt auditimit, me klasifikimet përkatëse sipas burimit të krijimit të tyre. Parashikimi është bërë kryesisht duke u bazuar në eksperiencën e krijimit të tyre nga vitet buxhetore paraardhëse. Realizimi i tyre kundrejt parashikimit vjetor, klasifikimi i realizimit të tyre, për pjesën që i takojnë institucionit dhe derdhjes së tyre në buxhetin e shtetit, si dhe përdorimi i tyre kundrejt limitit të përcaktuar janë si më lartë trajtuar në mënyrëtabelare
Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

GRUPI I AUDITIMIT
1.V.G Përgjegjësi i Grupit të Auditimit
2.M.R
3.E.K
4.H.K
5.A.V
6.A.Z

DREJTORI I DEPARTAMENTIT
Y.P